



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar i auditimit i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE MBI
VEPRIMTARINË E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE”**

Korrik 2023

PËRMBLEDHJE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.	3
I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.	7
II. Hyrja	12
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:	12
3. Identifikimi i çështjes:.....	13
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet	14
5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:.....	14
6. Kriteret e vlerësimit:	15
7. Standardet e Auditimit	15
8. Medodat e auditimit	16
9. Dokumentimi i auditimit.....	16
III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT	17
2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:.....	17
2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.	17
2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.	29
2.3 Auditimi i llogarive vjetore.....	39
2.4 Prokurimet e fondeve publike	54
2.5 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	137
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	149
V. ANEKSE.....	174

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, më poshtë e emërtuar “MSHMS”, për periudhën nga data 01.04.2021 deri në 31.12.2022, me objekt “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë”.

Auditimi kishte në fokus pesë drejtime kryesore, sipas programit të miratuar me nr. 1178/1, datë 11.01.2023, i ndryshuar dhe në të u angazhuan 4 (katër) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u përqendrua kryesisht në aktivitetin e MSHMS mbi planifikimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm të njësisë, procedurat e prokurimit publik, zbatimin e kontratave, mbajtjen e evidencës kontabël dhe menaxhimin e aktiveve.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilin prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë zhvillimit të këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë dhe financiar të KLSH, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikatat më të mira audituese të fushës.

Bazuar në rezultatet e auditimit të MSHMS, për periudhën nga data nga data 01.04.2021 deri në 31.12.2022, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të kualifikuar të përputhshmërisë dhe opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport përfundimtar auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

1.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
A/1	Për 41 (dyzet e një) projekte investimi të realizuara në vitin 2021 me një vlerë prej 393,529,023 lekë, si dhe 45 (dyzet e pesë) projekte investimi të realizuara në vitin 2022 me vlerë 250,909,423 lekë, të çelura për MSHMS nuk kishin kaluar në procesin ligjor të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, pra nuk kishin kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të investimeve publike sikundër përcakton VKM nr. 887, datë 29.03.2018, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” pika 7, pasi këto projekte, nuk kanë kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e MFE nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, pika 21 ku përcaktohet se projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së, dhe duhet të jenë në përputhje me	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 138-162 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	- Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikatat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore, si dhe të respektohen projektet e investimeve të parashikuara në PBA.

	prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qendrore. Gjithashtu, u konstatuan projekte investimi në tejkalim të planifikimit në Programin Buxhetor Afatmesëm.			
A/9	Nga auditimi i analizave të Llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitor” në vlerën 634,356,074 lekë, e cila përfaqëson detyrimet që ka MSHMS ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2021, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore dhe për llogarinë 401 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”, që ka të bëjë me komisionet e bonuseve të bebeve që i paguan MSHMS në vlerën 14,650,595 lekë, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në shumën prej 618,564,317 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me fatura të viteve 2015, 2017, 2018 dhe 2020, u konstatua një diferencë prej 1,141,162 lekë e debituar në llogarinë 4342, vlerë e cila është e paargumentuar. Gjithashtu u konstatua se, në lidhje me letër kreditë e “Q. H.” është regjistruar vlere prej (2,240,650.8) në kontabilitet, ndërsa në SIFQ vlera është (224.065,80) lekë me një diferencë prej 2,000,000 lekë, vlerë e cila është e paargumentuar, me efekt në saktësinë e raporteve dhe pasqyrave financiare.	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 138-162 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që për diferencat e konstatuara dhe të paargumentuar të bëjë sistemimet kontabël, me qëllim paraqitjen e drejte të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit.
A/13	Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” dhe rakordimit me vlerat në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C ka një pasqyrim jo të drejtë të vlerave në pasqyrë. Vlera e pasqyruar në llogarinë 12 “Nga Rezultatet e mbartura(+,-“ në shumën prej 1,472,634 lekë është dubluar, pasi kjo vlerë është e reflektuar në llogarinë 85 “Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)”. Ky pasqyrim është bërë gabim dhe në vitin 2021, ku vlera 5,935,118 lekë e ndryshimit të gjendjes së inventarit është dubluar duke e pasqyruar dhe në llogarinë 12 “Nga Rezultatet e mbartura(+,-“ dhe në llogarinë 85 “Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)”. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(vlera neto)” për vitin 2021, për zërin “kompjuter” nga institucioni është përlllogaritur amortizim vjetor më i lartë se vlera e aktiveve, ku si rrjedhojë vlera e amortizimit të akumuluar është më e lartë se vetë kostoja historike e aktiveve. Në kontabilitet është përlllogaritur vlera negative për këto aktive në shumë prej (19,291,624) lekë, vlerë e cila është zbritur nga gjendja e aktiveve, duke ndikuar dhe në pasqyrimin jo real të gjendjes së tyre në kontabilitet dhe pasqyrim jo të drejtë të ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto. Ky veprim kontabël është bërë dhe për vitin 2022 për një grup aktivesh. Veprimi në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”. Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, me ndikim material në fondet neto të institucionit.	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 138-162 të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimin në kontabilitet në bazë të manualit të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet materiale dhe parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

A/28	<p>Nga auditimi i 3 (tre) procedurave të prokurimit "Punë", në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u konstatua se nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave si më poshtë:</p> <p>a. Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstrukcion i godinës së Qendrës Kombëtare Transfuzionit të Gjakut Tiranë", janë s'kualifikuar operatorët ekonomik "P. G" shpk, "N. M. P" sh.a, "S." shpk, me arsyen e gabimit në sasinë e ofertës, referuar edhe vendimit të KPP 550/2020. KVO nuk ka mbajtur në konsideratë legjislacioni e Prokurimit Publik, nenin 92 të ligjit 162/2020 "Shqyrtimi i ofertave", pika 2. Komisioni i Vlerësimit të ofertave, ka kryer s'kualifikim të padrejtë të OE "E.K." shpk, pasi oferta e tij rezultoi pa gabime. Nga auditimi i dokumentacioni i operatorit të shpallur fitues "A.C." shpk, u konstatuan disa pasaktësi në katalogët e pajisjeve duke mos përmblusur specifikimet teknike të kërkuara në DST. Gjithashtu operatori i shpallur fitues, nuk plotëson pikën 2.3.11.a të DST, ku ishte përcaktuar se operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet. Nga dokumentacioni i hedhur në sistem, ky operator ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania "G.R. A..." shpk për zërat 8, 9, 10. Nga auditimi i kompanisë "G..R A.." shpk u konstatua se "Objekti i veprimtarisë së kësaj kompanie është "Tregtim, prodhim dhe instalim i pjesëve të aparateve për ventilim, filtrimin e kondicionimin e ajrit, import eksport, artikuj të ndryshëm, elektroshtepiake, konfeksione, materiale inerte për ndërtim". Pra u konstatua se kjo kompani nuk prodhon pajisjen ose njësinë e ventilimit të ajrit, por vetëm pjesë këmbimi të tyre. Kjo kompani nuk është prodhuese por assembluese e njësive të kondicionimit dhe ventilimit. Referuar edhe faqes zyrtare në internet https://gandr.al/, konstatohen produktet e kompanisë, ku operatori ekonomik ka paraqitur autorizimin e prodhuesit, çka do të thotë se ky operator nuk e plotëson kriterin e përcaktuar në DST.</p> <p>b. Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstrukcion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023) e ndarë në 2 Lote", janë s'kualifikuar operatorë ekonomik me arsyen e gabimit në sasinë e ofertës dhe njësive matëse, referuar edhe vendimit të KPP 550/2020. Nga KVO nuk është mbajtur në konsideratë legjislacioni e Prokurimit Publik, nenin 92 të ligjit 162/2020 "Shqyrtimi i ofertave", pika 2.</p>	Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 138-162 të Raportit të Auditimit	E lartë	<p>- MSHMS, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente.</p> <p>- AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s'kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmblusjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit".</p>
C/1	<p>Nga auditimi i kontratës "Rikonstrukcion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan", u konstatuan disa pasaktësi për punime të pakryera por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve. Në QSH Pajovë, kapitulli e punimeve e dyer dritareve zëri nr. 6, nr. Anal. 2.413 "F.V zgara dekorative hekuri me figuracion mesatare",</p>	Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 138-162 të Raportit të Auditimit	E lartë	<p>MSHMS, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej 684,387 lekë nga kontraktori BOE "B." shpk</p>

	<p>me vlerën 5,158 lekë nuk ishte vendosur në objekt. Në QSH Gjergjan, kapitulli e punimeve çatit zëri nr. 5, nr. Anal. 2.206 “kasetë shkarkimi me llamarinë xingat”, me vlerën 4,260 lekë nuk ishin vendosur në objekt. Në disa QSH-re Gjergjan, kapitulli e punimeve suvatimi dhe lyerje nr. 4, nr. Anal. 2.35 “suva xokoli me granil e çimento”, u konstatua se xokoli nuk kishte lartësi më të madhe se 30 cm, ndërkohë në librezën e masave është llogaritur me lartësi 65 cm, rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej 15 m² me çmimin 434 lekë rezulton vlera prej 6,510 lekë. Në disa QSH-re dhe AMB-ca, nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet <i>Grafiato për suva</i>. Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 6, nr. anal 2.308/a “<i>Suvatim me grafiato</i>” me çmimin sipas VKM-së prej 1,057 lek/m² (në përlllogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga BOE “B.” shpk & “B.N.” shpk me 719 lekë/ m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato, bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “<i>Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre</i>”. Gjithashtu referuar përlllogaritjeve në librezën e masave “<i>Suvatimi me grafiato</i>”, ndodhet në të njëjtat sipërfaqe të veshjes me sistem kapotë. Rrjedhimisht, zëri i “<i>Suvatim me grafiato</i>”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasi më tepër. Nga kontraktori BOE “B.” shpk & “B. N.”, është përfituar padrejtësisht punime të mbivendosura dhe të pa realizuara, në vlerën 570,323 lekë pa TVSH ose 684,387 lekë me TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “<i>Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit</i>”, i ndryshuar, neni 7 dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “<i>Për zbatimin e punimeve të ndërtimit</i>”, Kreu III, pika 4.</p>			<p>dhe “B.N.” shpk, për punime të mbivendosura dhe të likuiduara por të pa realizuara.</p>
C/2	<p>Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës “<i>Rikonstrukcion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier</i>”, u konstatuan disa pasaktësi për punime të mbivendosura zërave të punimeve. Në disa QSH-re, nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet <i>Grafiato për suva</i>. Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 6, nr. anal 2.308/a “<i>Suvatim me grafiato</i>” me çmimin sipas VKM-së prej 1,057 lek/m² (në përlllogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga BOE “B.” shpk & “B.N.” shpk me 600 lekë/ m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato, bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “<i>Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre</i>”.</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 138-162 të Raportit të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>MSHMS, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej 347,752 lekë nga kontraktori OE “C.” shpk, për punime të mbivendosura dhe të likuiduara.</p>

<p>Gjithashtu referuar përllogaritjeve në librezën e masave “Suvatimi me grafiato”, ndodhet në të njëjtat sipërfaqe të veshjes me sistem kapotë. Rrjedhimisht, zëri i “Suvatim me grafiato”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasi më tepër. Nga kontraktori OE “C.” sh.p.k, është përfituar padrejtësisht punime të mbivendosura, në vlerën 289,794 lekë pa TVSH ose 347,752 lekë me TVSH. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.</p>			
--	--	--	--

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Në përfundim të auditimit të përputhshmërisë dhe financiar, të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për periudhën e veprimtarisë nga 01.04.2021 deri në 31.12.2022, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 1178/1, datë 11.01.2023, i ndryshuar miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin, si më poshtë:

Sa i përket auditimit të përputhshmërisë, subjekti i audituar, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, duke u evidentuar mangësi në përcaktimin e kritereve të vendosura në procedurat e prokurimit, në monitorimin dhe zbatimin e kontratave, të cilat për nga rëndësia kanë rezultuar të jenë materiale, por jo të përhapura, duke mbështetur dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Sa i përket auditimit financiar, gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të MSHMS, duke mbështetur dhënien e një opinioni të modifikuar.

Opinion mbi pasqyrat financiare (i modifikuar¹)

Grupi i auditimit të KLSH^{së}, ka audituar pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, pasqyrë mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për Opinioni e modifikuar*”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit më 31 dhjetor 2022, referuar ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar; Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar; Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, me Udhëzimin

¹. Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, miratuar me vendim nr. 246, datë 29.12.2022, kapitulli 7.3.5 “**Opinionet mbi auditimin financiar**”, pika 4.2, “*Opinion i Modifikuar me rezervë*”, jepet në ato raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe datë përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. justifikon dhënien e një **“Opinion të modifikuar/kualifikuar”**.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të INTOSA-it (ISSAI 2000). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen “Përgjegjësitë e audituesit” për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga MSHMS, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit sasior, të përlllogaritur për vitin 2022 (në masën 07-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar) ose në vlerën 24,985 mijë lekë për shpenzimet, gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemi i kontrollit të brendshëm vlerësohen në nivel të mesëm.

*Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në saktësinë dhe plotësinë e transaksioneve dhe sistemit të raportimit financiar të MSHMS, të cilat argumentojnë dhënien e **“Opinion të modifikuar”**, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:*

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

- Nga auditimi i llogarisë 602 **“Blerje mallra e shërbime”** rezultoi se shpenzimet në shumën prej 3,980,859.00 lekë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime në momentin e ndodhjes së tyre, por janë njohur në një periudhë të më vonshme, të cilës nuk i përkasin;

- Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se shumica e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 **“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”**, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 **“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”**, i ndryshuar, paragrafi 34 dhe 42.

- Nga auditimi i analitik i zërave të Llogarisë 4342 **“Të tjera operacione me shtetit debitor”** në vlerën 634,356,074 lekë, u konstatua një diferencë prej 1,141,162 lekë e debituar në llogarinë 4342, vlerë e cila është e paargumentuar. Gjithashtu u konstatua se, në lidhje me letër kredinë e **“Q... H...”** është regjistruar vlere prej (2,240,650.8) lekë në kontabilitet, ndërsa në SIFQ vlera është (224.065,80) lekë me një diferencë prej 2,000,000 lekë, vlerë e cila është e paargumentuara, me efekt në saktësinë e raporteve dhe pasqyrave financiare.

- Nga auditimi analitik i Llogarisë 213 **“Rruge, rrjete, vepra ujore”**, u konstatua se në këtë llogari është kontabilizuar **“Regjistri elektronik i ndihmës ekonomike”** me kosto historike në shumën prej 71,400,000 lekë, vlerë e pasqyruar gabim në këtë llogari kontabël, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare të institucionit.

- Nga auditimi analitik i Llogarisë 28 **“Caktime”**, u konstatuat se, në këtë zë janë pasqyruar, Vlera prej 22,337,073 lekë, e cila ka të bëjë **“Rikonstruksione të ambienteve”**; Vlera prej 113,416,554 lekë, e cila ka të bëjë me regjistrin e PAK; Vlera prej 164,496,000 lekë, e cila ka të bëjë me **“Sistemin e Shërbimit Social”**, të cilat janë aktive nën administrimin e MSHMS, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 **“Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik “ dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”**; Klasa 2 **“Aktivet Afatgjata”**, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë

të pasqyrave financiare të institucionit.

- Nga auditimi i llogaritjes së amortizimit u konstatua se amortizimi vjetor i aktiveve për zërat “Kompjuter, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni” është përlllogaritur me 20% dhe jo me 25%; si dhe për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” transferuar nga Ish-Ministria e Mbrojtjes Sociale, amortizimi vjetor është llogaritur mbi vlerën e mbetur dhe jo me metodën lineare, me efekt material në fondet neto të institucionit.

- Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” dhe rakordimit me vlerat në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C, u konstatua një pasqyrim jo i drejtë të vlerave në pasqyrë, duke dubluar ndryshimin e gjendjes së inventarit, *me ndikim material në fondet neto të institucionit.*

- Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për vitin 2021, për zërin “kompjuter” nga institucioni është përlllogaritur amortizim vjetor më i lartë se vlera e aktiveve, ku si rrjedhojë vlera e amortizimit të akumuluar është më e lartë se vetë kostoja historike e aktiveve. Në kontabilitet është përlllogaritur vlera negative për këto aktive në shumë prej (19,291,624) lekë, vlerë e cila është zbritur nga gjendja e aktiveve, duke ndikuar dhe në pasqyrimin jo real të gjendjes së tyre në kontabilitet dhe pasqyrim jo të drejtë të ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto. Ky veprim kontabël është bërë dhe për vitin 2022 për një grup aktivesh, *me ndikim material në fondet neto të institucionit.*

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e “Kuadrit rregullator” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, dhe për të shmangur gabimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Titullari i Institucionit, Sekretari i Përgjithshëm (në cilësinë e Nëpunësit Autorizues), janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH, është që të shprehë një opinion për Pasqyrave Financiare Vjetore në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesit të KLSH, lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Në gjithashtu: Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të subjektit. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare. Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar²).

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e MSHMS, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSAI P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga MSHMS dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e ***opinionit të kualifikuar*** mbështetur në konstatimet në vijim:

- Nga auditimi u konstatuan 41 projekte investimi të realizuara në vitin 2021 me një vlerë prej 393,529,023 lekë, si dhe 45 projekte investimi të realizuara në vitin 2022 me vlerë 250,909,423 lekë, të çelura për MSHMS pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, pra pa kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të investimeve publike sikundër përcakton VKM nr. 185, datë 29.03.2018, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika nr. 7.

- Nga auditimi u konstatua se aparati i MSHMS, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik.

- Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, për të cilat AK ka hartuar dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht, u konstatua se: Përkthimi i dokumentacionit është bërë pa realizuar asnjë procedurë paraprake blerje të vogël por është bërë blerje e drejtpërdrejtë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 1 pika 2.

² 2 -Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, (vendim nr. 245, datë 29.12.2022. fq.104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 “Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme”, Konkluzionet/ Opinionet e pakualifikuara: “Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme”.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt:

- “*Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore*” u konstatua se: Kriteret në lidhje me Kapacitetet teknik në nënpikën 3.3 pika 3 i vendosur është i pa plotë pasi nga AK nuk është vendosur profili i inxhinierit që AK kërkon/pranon e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton profilin e inxhinierit, veprime në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenit 28 pa plotësuar dhe pika 8 e kërkuar nuk përputhet me objektin dhe natyrën e kontratës, veprime jo në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, të nenit 28 “Kontratat e shërbimeve”.
- “*Blerje pajisje mjekësore për QKTRF*” u konstatua ndryshime nga NJP të specifikimeve teknike për artikujt që prokurohen, pa marrë konfirmimin, nga QKTRF nëse specifikimet e rishikuara/modifikuara përmbushin qëllimin për të cilin nevojitet objekti i prokurimit i kërkuar, veprime në kundërshtim me nenin 67, pika 9 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Pas ndryshimit të specifikimeve teknike të artikullit, NJP nuk ka rishikuar përlogaritjen e fondit limit.
- “*F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*” u konstatua se:
 - Përcaktimi i “Specifikimeve teknike: DEXA” nuk është e dokumentuar se nga kush janë hartuar.
 - Nga auditimi i dosjes fizike konstatohet se mungon deklarata e konfliktit të interesit të grupi të punës, veprime në kundërshtim me VKM-në 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 13, pika 5.
 - Urdhri i prokurimit për realizimin e procedurës ka dalë me datën 04.10.2021, ndërsa regjistrimi në SIFQ është bërë me datën 28.12.2021 veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, pikat 36-38;
 - Përpara lidhjes së kontratës mes OE dhe AK nga një e-mail i dërguar më datë 16.11.2021 është kërkuar nga Kabineti ndryshimi i destinacionit të pajisjeve nga qendrat e përcaktuara në DT, veprime në kundërshtim me: “Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Neni 3; DST Shtojca 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”.
 - Nga auditimi në terren të zbatimit të kontratave me nr. 4073/9, datë 19.11.2021 lidhur mes AK/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe OE “F.” shpk, u konstatua se të dhënat teknike, që kishte pajisja e montuar nuk përputhej me dokumentacionin teknik dhe katalogun e paraqitur nga OE.
- “*B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut*” dhe • “*B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike*” u konstatua vlerësim të pabarabartë të ofertave nga KVO, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 2 pika d); nenin 3 pika 1, dhe VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2.
- Mangësi në dokumentimin e saktë të veprimtarisë së KVO gjatë shqyrtimit të ofertave, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021, nenin 84 “Raporti përmbledhës”.
- Nga auditimi i 3 (tre) procedurave të prokurimit për kategoritë/ zërat “*Punë publike*”, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u konstatua mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave.
- Nga auditimi i kontratës “*Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan*” dhe Kontratës “*Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier*” u konstatuan disa pasaktësi për punime të pakryera, por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve në vlerën 1,032,139 lekë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim: Drejtimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MSHMS, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të saj, për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues te personave me liri të kufizuar. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Hyrja.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*”, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 1178/1, datë 11.01.2023, i ndryshuar, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga data 10.01.2023 deri më datën 08.05.2023, për periudhën e auditimit 01.04.2021-31.12.2022, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J. G, (*përgjegjës grupi*),
2. A. K, anëtar
3. A. G, anëtar
4. E. Sh, anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” në nenin 3 të tij ka përcaktuar se, “Auditim i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord”. Në nenin 12 “*Auditimi i përputhshmërisë*” të po këtij ligji është shprehur se: “Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik”. Në pikën 2 të po këtij neni ka përcaktuar se “*Auditim financiar*” nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.

ISSAI 4000, paragrafi 23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t’i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legislative, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar.

ISSAI 1700, paragrafi 4: Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra

të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

a. Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuarat si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregulloret, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

b. njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

c. promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare.

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

2. Qëllimi i auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

3. Identifikimi i çështjes:

Raporti Përfundimtar synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të institucionit të Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2020 deri në 30.09.2022, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të MSHMS, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e këtij institucionit në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.554/2, datë 10.10.2022.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Niveli menaxherial i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

5. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Audituesit e KLSH^{-së} kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit.

Audituesit e KLSH^{-së} kanë përgjegjësi të respektojnë kërkesat etike dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë të arsyeshme për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Audituesit e KLSH^{-së} kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi çështjet që janë nën auditim.

Audituesit e KLSH^{-së} kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmëritë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)

d) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj;

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 47 , ku nënvizohet se:

“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohet material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”.

Sa më sipër, audituesit aplikojnë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

6. Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 *“Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”*, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*
- Ligji nr. 105/2014 *“Për barnat dhe shërbimin farmaceutike”*;
- Ligji nr. 89/2014 *“Për pajisjet mjekësore”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*; i ndryshuar me VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”*;
- Udhëzimi MF nr.8, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”*; i ndryshuar me Udhëzimin MF nr.5, datë 21.02.2022.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*;
- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 *“Për miratimin e manualit të MFK”*,
- Udhëzimi MFE nr.37, datë 06.10.2020 *“Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”*;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Rregullore e brendshme *“Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”*, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{së} e ndryshuar.

7. Standardet e Auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;

- INTOSAI – P - 1 “*Deklarata e Limës*”;
- INTOSAI – P – 10 - 99 “*Parimet themelore të INTOSAI*”;
- INTOSAI – P - 10 “*Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI*”;
- INTOSAI – P - 12 “*Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve*”;
- INTOSAI – P - 20 “*Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies*”;
- INTOSAI – P - 50 “*Parimet e juridiksionit të SAI*”;
- ISSAI 100 - 129 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”;
- ISSAI 2000 - 2899 “*Standardet e Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 400 “*Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë*”;
- ISSAI 4000 “*Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë*”;
- ISSAI 2705 “*Modifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*”;
- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020.

8. Medodat e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale, si dhe në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontroleve.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike si dhe në kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të MSHMS,, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve , procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.*

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve, dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar mbi Projekt Raportin e Auditimit (dërguar MSHMS me shkresën me nr. 225/54 datë 12.07.2023 prot., në KLSH me nr. 1178/8, datë 13.07.2023 dhe me nr. 225/43, datë 12.07.2023 prot., në KLSH me nr. 1178/7, datë 13.07.2023) u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, e cila është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu ka si mision garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, administron dhe menaxhoi fondet publike sipas shtatë programeve.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.

1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm 2021-2023 dhe PBA-në 2022-2024;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2021 dhe vitin 2022, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;
- 3) Raportet e monitorimit të 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit.

Auditimi u krye duke marrë në konsideratë bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshtë:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 137 datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- VKM nr. 577 datë 22.07.2020 "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2021- 2023";
- Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”;
- Udhëzimi plotësues nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”;
- Udhëzimi nr.9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”;
- Udhëzimi plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”;
- Etj.

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Financimi i MSHMS kryhet si më poshtë:

- Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llog. 600, llog. 601, llog. 602 ,606 dhe 230-231) me financim të brendshëm nga fondet buxhetore;
- Për shpenzimet për investime (llog. 230 & llog. 231), të cilat financohen nga fondet buxhetore dhe financim i huaj.

Buxheti i miratuar për MSHMS paraqitet sipas shtatë programeve të miratuara si më poshtë vijon:

1. Planifikim Menaxhim Administrimi
2. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor
3. Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor
4. Shërbime të Shëndetit Publik
5. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore
6. Përkujdesi Social
7. Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë.

Programimi i PBA-së 2022-2024 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2022

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore” (llog 600 dhe 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (llog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të varësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I rë të PBA 2022-2024

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”, MSHMS ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, i cili është dërguar me shkresën nr.1375/1 prot., datë 30.04.2021, dhe protokolluar pranë MFE me nr. 8351/3 prot., datë 24.05.2021.

Bazuar në VKM nr. 119 datë 3.3.2021 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, u miratuan tavanet përgatitore për ministrinë dhe institucionet buxhetore.

Me Urdhrin Ministrisë nr. 163 datë 17.03.2021 “Për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve në Sistemin e MSHMS”, për hartimin e PBA 2022-2024”, u ngritën EMS për secilin

program buxhetor dhe me Urdhrin e Ministrit nr.166 datë 18.03.2021 “Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, u ngrit GMS në MSHMS, veprime këto në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Me shkresën nr. 1375/1 prot., datë 30.04.2021, MSHMS dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE “Program Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, faza strategjike.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{te} të PBA 2022-2024

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 janë miratuar me VKM nr. 440 datë 22.07.2021 “Për miratimin e taveaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Me shkresën nr. 3397/1 prot., datë 31.08.2021 të Ministrit të MSHMS-së, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2022 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit e MSHMS-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”.

Tabela nr.a/1 - Në PBA 2022-2024 buxheti i planifikuar sipas fushave paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Fusha	Buxheti 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
1	Shëndetësia	56,526,132	56,783,778	57,323,528	59,343,615
2	Mbrojtja Sociale	23,986,960	25,179,260	25,879,260	25,979,260
3	Rehabilitimi i te përndjekurve politikë	1,035,000	1,043,000	1,043,000	1,048,000
4	Investimet	3,561,700	2,061,700	3,011,700	3,011,700

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

▪ Sa i takon fushës së Shëndetësisë, buxheti në vitin 2021 është 56,526,132 mijë lekë. Në PBA 2022-2024, MSHMS parashikon shumën 56,783,778 mijë lekë si buxhet total për vitin 2022, duke reflektuar një rritje prej 0.45% në raport me vitin 2021. Gjithashtu për vitin 2023 MSHMS parashikon shumën 57,323,528 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.94% në raport me vitin 2022, si dhe për vitin 2024 është parashikuar shuma prej 59,343,615 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 3.4% në raport me vitin 2023. Në këtë buxhet janë të përfshira dhe kontributet shëndetësore;

▪ Sa i takon fushës së Mbrojtjes Sociale, buxheti në vitin 2021 është 23,986,960 mijë lekë. Në PBA 2022-2024, MSHMS parashikon shumën 25,179,260 mijë lekë si buxhet total për vitin 2022, duke reflektuar një rritje prej 4.9% në raport me vitin 2021.

Gjithashtu për vitin 2023 MSHMS parashikon shumën prej 25,879,260 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 2.7% në raport me vitin 2022, si dhe për vitin 2024 është parashikuar shuma prej 25,979,260 mijë lekë si buxhet total duke reflektuar një rritje prej 0.3% krahasuar me 2023;

▪ Sa i takon fushës së Rehabilitimi i te përndjekurve politikë, buxheti në vitin 2021 është 1,035,000 mijë lekë. Në PBA 2022-2024, MSHMS parashikon 1,043,000 mijë lekë si buxhet total për vitin 2022 dhe 2023, dhe 1,048,000 mijë lekë si buxhet total për vitin 2024;

▪ Sa i takon fushës së Investimeve, buxheti në vitin 2021 është 3,561,700 mijë lekë, ku 2,451,700 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 1,110,000 mijë lekë me financim të huaj. Në PBA 2022-2024, MSHMS parashikon 2,061,700 mijë lekë si buxhet total për vitin 2022, ku 1,301,700 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 760,000 mijë lekë me financim të huaj. Për vitet 2023 dhe 2024, MSHMS parashikon 3,011,700 mijë lekë si buxhet total ku është e përbërë nga 1,901,700 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 1,110,000 mijë lekë me financim të huaj.

Tabela nr./2 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2022-2024 të hartuar nga MSHMS, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2021), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Emërtimi i programit	Fakti 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,534,148	380,200	405,600	408,966
7220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	8,421,690	8,198,332	8,003,000	7,991,000
7330	Shërbimet e Kujdesit Dytësor	31,938,573	31,023,019	31,178,633	32,136,349
7450	Shërbimet e Shëndetit Publik	7,016,121	3,640,827	3,804,895	3,844,900
7460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	289,775	387,100	512,100	522,100
10430	Përkujdesi Social	28,215,775	25,299,260	26,159,260	26,259,260
1190	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	945,121	1,043,000	1,043,000	1,048,000
Totali		78,361,202	69,971,738	71,106,488	72,210,575

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shuma e planifikuar prej 69,971,738 mijë lekë për vitin 2022 në PBA është më e ulët krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2021 në shumën 78,361,202 mijë lekë, ose **me një ulje në masën prej 11%**, fakt i cili tregon se përgjatë planifikimit të PBA 2022-2024, nuk është kryer një analizë e mirëpërcaktuar nga ana e MSHMS për t'iu referuar vlerave faktike të paraqitura gjatë realizimit të buxhetit të vitit 2021 dhe cilat kanë qenë shkaqet të cilat kanë shfaqur këto diferenca midis planit të vitit 2022 në PBA dhe buxhetit faktik të vitit 2021. E njëjta situatë shfaqet edhe për vitet 2023 dhe 2024.

Analizë nga ana e Grupit të Auditimit në lidhje me Investimet

Investimet viti 2021

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2021, grupi i auditimit krahasoi këto projekte me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, në **tabelën nr.1** aneksi V.1 paraqiten ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2021 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm.

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përsa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2021 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2021-2023, nga ku u konstatua se për 41 projekte (të listuara në tabelën më sipër) në shumën 393,529,023 lekë, janë realizuar gjatë vitit 2021 por nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2021-2023.

Investimet viti 2022

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2022, grupi i auditimit krahasoi këto projekte me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, në **tabelën nr.2** aneksi V.1 paraqiten ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2022 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm.

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përsa i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024, nga ku u konstatua se për 45 projekte (të listuara në tabelën më sipër) në shumën 250,909,423 lekë, janë realizuar gjatë vitit 2022 por **nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2022-2024**.

Sa më sipër, projektet e çelura në fillim të vitit me Ligjin e Buxhetit rezultojnë të pa përfshira në listën e investimeve të miratuara në PBA dhe janë miratuar me ligj pa kaluar procedurat e përgatitjes së kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm, duke reflektuar kështu ndryshimet që ka pësuar plani i financimit të projekteve nga momenti i miratimit të PBA-së deri në ligjin e buxhetit.

Disa nga projektet me tejkalim të buxhetit faktik në raport me parashikimet që janë kryer gjatë programeve buxhetore afatmesme.

Projekti nr.20AB701- “Ndërtim i godinës së re për akomodimin e qsh 1, Njvksd dhe kl.stomatologjike Durrës”, në programin 07220 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”

PBA 2021-2023				PBA 2022-2024			Diferenca/tejkallim 2021
Fakt viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Fakti 2021	Viti 2022	Viti 2023	
-	12,000,000	48,000,000	-	17,399,165	69,597,000	-	-5,399,165

Nga auditimi konstatohet se Projekti “Ndërtim i godinës së re për akomodimin e qsh1, njvksd dhe kl. stomatologjike Durrës”, gjatë hartimit të PBA 2021-2023 nga ana e MSHMS-së është parashikuar që për vitin 2021 të financohet shuma prej 12,000,000 lekë por nga verifikimi i të dhënave rezulton se realizimi i këtij projekti gjatë vitit 2021 është më shumë se fondi parashikuar në PBA 2021-2023 me një tejkallim në vlerën 5,399,165 lekë, situatë kjo e cila tregon se nga ana e MSHMS-së nuk janë marrë në konsideratë tavanet buxhetore, të jetë respektuar disiplina buxhetore si dhe fishat e financimit gjatë hartimit të programeve buxhetore afatmesme.

Projekti nr.18BB057- “Rikonstruksion i godinës së pediatriisë sp.Elbasan”, në programin 07330 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”

PBA 2021-2023				PBA 2022-2024			Diferenca/tejkallim 2021
Fakt viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Fakti 2021	Viti 2022	Viti 2023	
-	66,627,000	140,505,000	126,003,000	125,627,000	43,141,000	164,367,000	-59,000,000

Nga auditimi konstatohet se Projekti “Rikonstruksion i godinës së pediatriisë sp.Elbasan”, gjatë hartimit të PBA 2021-2023 nga ana e MSHMS-së është parashikuar që për vitin 2021 të financohet shuma prej 66,627,000 lekë por nga verifikimi i të dhënave rezulton se realizimi i këtij projekti gjatë vitit 2021 është më shumë se fondi parashikuar në PBA 2021-2023 me një tejkallim në vlerën 59,000,000 lekë, situatë kjo e cila tregon se nga ana e MSHMS-së nuk janë marrë në konsideratë tavanet buxhetore, të jetë respektuar disiplina buxhetore si dhe fishat e financimit gjatë hartimit të programeve buxhetore afatmesme.

Projekti nr.18BB059- “F.V pajisje hotelerie dhe mjekësore për pediatriinë e sp.Elbasan”, në programin 07330 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”

PBA 2021-2023				PBA 2022-2024			Diferenca/tejkallim
Fakt viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Fakti 2021	Viti 2022	Viti 2023	
-	-	-	50,000,000	27,000,000	-	50,000,000	-27,000,000

Nga auditimi konstatohet se Projekti “F.V pajisje hotelerie dhe mjekësore për pediatriinë e sp.Elbasan”, gjatë hartimit të PBA 2021-2023 nga ana e MSHMS-së nuk është parashikuar asnjë fond për vitin 2021 por nga verifikimi i të dhënave rezulton se kemi një realizim të këtij projekti gjatë vitit 2021 në shumën 27,000,000 lekë duke mos patur asnjë fond të parashikuar si dhe me një tejkallim të vlerës së plotë të projektit të parashikuar, situatë kjo e cila tregon se nga ana e MSHMS-së nuk janë marrë në konsideratë tavanet buxhetore, të jetë respektuar disiplina buxhetore si dhe fishat e financimit gjatë hartimit të programeve buxhetore afatmesme.

Titulli i Gjetjes:	Projekte të çelura për MSHMS pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm.
Situata	Nga auditimi u konstatua se për 41 projekte investimi të realizuara në vitin 2021 me një vlerë prej 393,529,023 lekë, si dhe për 45 projekte

	<p>investimi të realizuara në vitin 2022 me vlerë 250,909,423 lekë, projekte të çelura, pa kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të investimeve publike sikundër përcakton VKM nr.185, datë 29.03.2018, “Për menaxhimin e investimeve publike” aneksi 1, pasi, këto projekte, nuk kanë kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, pika 21 ku përcaktohet se projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së, dhe duhet të jenë në përputhje me prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qendrore.</p> <p>Gjithashtu, u konstatuan projekte investimi në tejkalim të planifikimit në Programin Buxhetor Afatmesëm, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekti i investimit me kod 20AB701- “Ndërtim i godinës së re për akomodimin e qsh1, Njvksd dhe kl.stomatologjike Durrës” është parashikuar në PBA 2021-2023 në shumën 12,000,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 17,399,165 lekë, me një diferencë prej 5,399,165 lekë në tejkalim të planifikimit; - Projekti i investimit me kod 18BB057 - “Rikonstruksion i godinës së pediatrikë spitali Elbasan” është parashikuar në PBA 2021-2023 në shumën 66,627,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 225,379,036 lekë, me një diferencë prej 158,752,036 lekë në tejkalim të planifikimit; - Projekti i investimit me kod 18BB059- “F.V pajisje hotelerie dhe mjekësore për pediatrikë e sp.Elbasan” është parashikuar në PBA 2021-2023 në shumën 0 lekë, dhe është realizuar në shumën 27,000,000 lekë, me një diferencë prej 27,000,000 lekë në tejkalim të planifikimit; - Projekti i investimit me kod 18BB008 – “Rikonstruksion i godinës së QKT Gjakut Tiranë” është parashikuar në PBA 2022-2024 në shumën 54,046,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 88,059,200 lekë, me një diferencë prej 34,013,200 lekë në tejkalim të planifikimit. <p>Situata e mësipërme tregon se nga ana e MSHMS-së nuk janë marrë në konsideratë tavanet buxhetore, të jetë respektuar disiplina buxhetore si dhe fishat e financimit gjatë hartimit të programeve buxhetore afatmesme.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Veprime në kundërshtim me:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr.40 ku citohet “e drejta për të kryer shpenzime”; -Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr.64; -Ligjin nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”. -VKM nr.185, datë 29.03.2018 “Për menaxhimin e investimeve publike”, Aneksi 1- “Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike” ku citohet se: <i>Diagrama e mëposhtme përshkruan fazat e Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike. Identifikimi i projektit është procesi i identifikimit e shqyrtimit të ideve për projekte investimi të bazuara në analizën e nevojave publike, ndërhyrjeve të qeverisë dhe përshatjes me</i>

	<i>strategjitë kombëtare dhe sektoriale. Hapi 5–Paraqitja e projekt-propozimit të investimit nga Institucionet Buxhetor Ministrisë përgjegjëse për Financat : Projekt-propozimet e investimeve përcillen në Ministrinë përgjegjëse për financat: -nëpërmjet paraqitjes normale të kërkesave për shpenzime sipas afateve të PBA-së/Buxhetit Vjetor; Hapi 7 Miratimi përfundimtar: Pas miratimit në KM të projekteve të investimeve në kuadër të PBA/buxhetit vjetor, lista e projekteve të investimeve paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë vetëm si tabelë shoqëruese e paketës së PBA/Buxhetit vjetor, por që nuk miratohet nga Kuvendi.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos respektim i disiplinës buxhetore për t’u dhënë prioritet projekteve të planifikuara në PBA.
Shkaku:	Detajimi i projekteve të reja të investimit publik gjatë vitit buxhetor pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike në hartimin e PBA-së.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	- Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2021

Në zbatim të Ligjit nr.137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr.141 prot., datë 12.01.2021 të MSHMS-së, ku është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente të vitit 2021 për MSHMS dhe të gjitha institucionet e varësisë, miratimi i detajimit sipas strukturave respektive është përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE me shkresën nr. 23724/143, prot., datë 20.01.2021.

Miratimi i detajimit për shpenzime kapitale është kryer nga Ministri i MFE-së me shkresën nr. 628/1, prot datë 22.01.2021.

Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023

Në mijë lekë

Emërtimi		Kërkesa PBA 2021-2023	Plani fillestar i miratuar 2021	Plani i rishikuar 2021	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
Shpenzime korrente (A)	Planifikim, Administrim, Menaxhim	374,688	376,687	1,580,267	-1,205,579
	Kujdesi Shëndetësor Parësor	7,964,000	9,164,000	8,113,290	-149,290
	Kujdesi Shëndetësor Spitalor	25,183,000	25,910,117	28,656,397	-3,473,397
	Shërbime të Shëndetit Publik	3,207,740	3,207,741	7,118,214	-3,910,474
	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	328,100	328,100	319,050	9,050
	Përkujdesi Social	24,549,260	27,869,260	28,553,904	-4,004,644
	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	1,050,000	1,035,000	1,035,200	14,800
Total (A)		62,656,788	67,890,905	75,376,322	-12,719,534
Shpenzime kapitale (B)	Investime	3,561,700	3,561,700	4,307,060	-745,360
Total (B)		3,561,700	3,561,700	4,307,060	-745,360
TOTAL (A)+(B)		66,218,488	71,452,605	79,683,382	-13,464,894

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Për vitin 2021, janë planifikuar në PBA 2021-2023, shuma prej 66,218,488 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2021, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 79,683,382 mijë nga MSHMS, pra 13,464,894 mijë lekë më shumë se plani në PBA.

Sipas PBA 2021-2023, **për shpenzimet korrente** është parashikuar për MSHMS-në dhe institucionet e varësisë shuma prej 62,656,788 mijë lekë. Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit paraqitet në shumën prej 75,376,322 mijë lekë, pra 12,719,534 mijë lekë më shumë se kërkesat e institucionit në PBA.

Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2021-2023, është parashikuar një buxhet prej 3,561,700 mijë lekë, dhe janë alokuar nga MFE, deri në fund të vitit 2021, vlera prej 4,307,060 mijë lekë, pra 4,052 mijë lekë më shumë.

Ndryshime në buxhet për vitin 2022

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022” dhe udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, dhe në përgjigje të shkresës nr.141 prot., datë 12.01.2021 të MSHMS-së ku është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente të vitit 2022 për MSHMS dhe të gjitha institucionet e varësisë, miratimi i detajimit sipas strukturave respektive është përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS me shkresën 26 , prot., datë 06.01.2022.

Miratimi i detajimit për shpenzime kapitale është kryer nga Ministri i MFE me shkresën nr. 22922/194, prot datë 31.01.2022.

Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024

Në mijë lekë

Emertimi		Kërkesa PBA 2022-2024	Plani fillestar i miratuar 2022	Plani i rishikuar 2022	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
Shpenzime korrente (A)	Planifikim, Administrim, Menaxhim	377,200	377,200	449,668	-72,468
	Kujdesi Shëndetësor Parësor	7,893,280	8,500,073	7,455,759	437,521
	Kujdesi Shëndetësor Spitalor	29,403,051	31,030,916	30,906,144	-1,503,093
	Shërbime të Shëndetit Publik	3,627,147	6,346,466	4,941,034	-1,313,887
	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	387,100	334,162	241,695	145,405
	Përkujdesi Social	25,179,260	26,698,130	29,666,831	-4,487,571
	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	1,043,000	1,035,991	1,031,755	11,245
Total (A)	67,910,038	74,322,938	74,692,886	-6,782,848	
Shpenzime kapitale (B)	Investime	2,061,700	2,752,944	2,859,089	-797,389
Total (B)		2,061,700	2,752,944	2,859,089	-797,389
TOTAL (A)+(B)		69,971,738	77,075,882	77,551,975	-7,580,237

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Për vitin 2022, janë planifikuar në PBA 2022-2024 shuma prej 69,971,738 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2022, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 77,551,975 mijë nga MSHMS, pra 7,580,237 mijë lekë më shumë se plani në PBA.

Sipas PBA 2021-2023, **për shpenzimet korrente** është parashikuar për MSHMS-në dhe institucionet e varësisë 67,910,038 mijë lekë. Krahasuar me buxhetin e alokuar për institucionin pas rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit paraqitet në shumën prej 74,692,886 mijë lekë, pra 6,782,848 mijë lekë më shumë se kërkesat e institucionit në PBA.

Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2022-2024, është parashikuar një buxhet prej 2,061,700 mijë lekë, dhe janë alokuar nga MFE, deri në fund të vitit 2022, 2,859,089 mijë lekë, pra 797,389 mijë lekë më shumë.

Titulli i Gjetjes:	Rishikimet e shpeshta të fondeve përgjatë vitit (shtesa, pakësime, rialokime).
Situata:	<p>Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga MSHMS është kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh, duke kërkuar lëvizje fondesh në projektet ekzistuese, si dhe duke shtuar projekte te reja gjatë vitit, të cilat nuk janë çelur pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm. Këto ndryshime kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve me impakt në buxhetin MSHMS, e cila konsiderohet me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.</p> <p>Një numër i konsiderueshëm i kërkesave për shtesë dhe pakësime fondesh nuk janë të shoqëruara me argumentet si: a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 71 ku citohet ... “Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat.” Dhe pika 75. “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;</p> <p>Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 71, pika 75. “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”; Udhëzimi plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”; Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedura standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Rishikimet e shpeshta të fondeve shkaktojnë impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit pasi numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore përbën një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit; Nuk mundësohet pasqyrimi real i situatës lidhur me nivelin e realizimit, pasi shtimi/pakësimi i fondeve kryhet sipas ecurisë dhe jo planifikimit real të institucionit.
Shkaku:	Rishikimet e shpeshta të fondeve që konsistojnë në shtime/pakësime për financimin e investimeve për shkak të problematikave në planifikim apo tavanet e miratuara, të cilat nuk mbulojnë kërkesat reale të institucioneve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me njësitë shpenzuese në varësi të saj dhe ekipet e ngritura për menaxhimin e programeve buxhetore të MSHMS, të marrin masatë nevojshme për rritjen

	e bashkëpunimit me tyre dhe kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucional, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta në buxhet të fondeve, situatë kjo me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.
--	--

Viti 2021

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2021, paraqitet si më poshtë vijon:

në mijë lekë

Kodi	Emri i Programit	Buxheti 2021	Fakti viti 2021	Realizimi %
01110	Planifikim Menaxhim Administrim	1,585,267	1,534,148	97%
07220	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	8,453,388	8,421,690	99.6%
07330	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	32,530,658	31,938,573	98.2%
07450	Shërbime të Shëndetit Publik	7,121,514	7,016,121	98.5%
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	333,050	289,775	87%
10430	Përkujdesi Social	28,624,304	28,215,775	98.6%
01190	Rehabilitimi i të përndjekurve politike	1,035,200	945,121	91.3%
Totali i shpenzimeve		79,683,381	78,361,202	98.3%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Në total shpenzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale paraqiten në vlerën 78,361 milion lekë, krahasuar me planin prej rreth 79,683 milion lekë (realizimi në masën 98.3%). Referuar programeve rezulton se për programin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” janë realizuar fondet në vlerën rreth 1,534 milion lekë krahasuar me planin prej 1,585 milion lekë (97%). Për programin 07220 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” janë realizuar fondet në vlerën rreth 8,421 milion lekë krahasuar me planin prej 8,453 milion lekë (99.6%). Për programin 07330 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” janë realizuar fondet në vlerën rreth 31,938 milion lekë krahasuar me planin prej 32,530 milion lekë. Për programin 07450 “Shërbime të Shëndetit Publik” janë realizuar fondet në vlerën rreth 7,016, milion lekë krahasuar me planin prej 7,121 milion lekë (98.5%). Për programin 07460 “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore” janë realizuar fondet në vlerën rreth 289 milion lekë krahasuar me planin prej 333 milion lekë (87%). Për programin 10430 “Përkujdesi Social” janë realizuar fondet në vlerën rreth 28,216 milion lekë krahasuar me planin prej 28,624, milion lekë (98.6%). Për programin 01190 “Rehabilitimi i të përndjekurve politike” janë realizuar fondet në vlerën rreth 945 milion lekë krahasuar me planin prej 1,035 milion lekë (91.3%).

Viti 2022

Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2022, paraqitet si më poshtë vijon:

në mijë lekë

Kodi	Emri i Programit	Buxheti 2022	Fakti viti 2022	Realizimi %
1110	Planifikim Menaxhim Administrim	452,668	446,138	98.6%
7220	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	7,526,671	7,692,563	102.2%
7330	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	33,654,001	33,465,117	99.4%
7450	Shërbime të Shëndetit Publik	4,954,714	4,869,954	98.3%
7460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore	241,695	232,995	96.4%
10430	Përkujdesi Social	29,690,471	29,486,505	99.3%
1190	Rehabilitimi i të përndjekurve politike	1,031,775	1,027,241	99.6%
Totali i shpenzimeve		77,551,994	77,220,512	99.6%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Në total shpenzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2022 paraqiten në vlerën 77,552 milion lekë, krahasuar me planin prej rreth 77,221 milion lekë (realizimi në masën 99.6%). Referuar programeve rezulton se për programin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” janë realizuar fondet në vlerën rreth 446 milion lekë krahasuar me planin prej 452 milion lekë (98.6%). Për programin 07220 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” janë realizuar fondet në vlerën rreth 7,693 milion lekë krahasuar me planin prej 7,527 milion lekë (102.2%), pasi nga ana e MSHMS kemi për këtë program në lidhje me investimet me financim të

huaj, kemi një planifikim në 0 lekë dhe realizim në shumën prej 147,059 mijë lekë për shpenzime kapitale. Për programin 07330 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” janë realizuar fondet në vlerën rreth 33,465 milion lekë krahasuar me planin prej 33,654 milion lekë. Për programin 07450 “Shërbime të Shëndetit Publik” janë realizuar fondet në vlerën rreth 4,870 milion lekë krahasuar me planin prej 4,955 milion lekë (98.3%). Për programin 07460 “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore” janë realizuar fondet në vlerën rreth 233 milion lekë krahasuar me planin prej 242 milion lekë (96.4%). Për programin 10430 “Përkujdesi Social” janë realizuar fondet në vlerën rreth 29,487 milion lekë krahasuar me planin prej 29,690 milion lekë (98.6%). Për programin 01190 “Rehabilitimi i të përndjekurve politike” janë realizuar fondet në vlerën rreth 1,027 milion lekë krahasuar me planin prej 1,032 milion lekë (99.6%).

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e raporteve të monitorimit për buxhetin e administruar nga aparati i MSHMS si njësi shpenzuese.
Situata	Nga auditimi u konstatua se aparati i MSHMS, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Nga MSHMS monitorimi është kryer për të gjithë programet e MSHMS pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65. Nga MSHMS nuk është hartuar një udhëzues, për përcaktimin e procedurave apo rregullave specifike që duhet të ndjekin njësitë e varësisë së qeverisjes qendrore për procesin e monitorimit të buxhetit si dhe përcaktimi i afateve për paraqitjen e dërgimin e tyre pranë institucioneve eprore, në zbatim të Udhëzimit të MFE-se nr. 22, datë 17.11.2016, pika 9.
Kriteri:	Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19; Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ”; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Udhëzimi plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”.
Ndikimi/Efekti:	Si rezultat i mungesës së raporteve të monitorimit të buxhetit për aparatin e MSHMS-së: <ul style="list-style-type: none"> ✓ nuk bëhet e mundur ndjekja e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, sipas deklaratës së politikës së programit, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. ✓ nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve të aparatit është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve. ✓ nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme. ✓ nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.
Shkaku:	Mungesa e raporteve të monitorimit të buxhetit për programet e menaxhuara

	nga aparati i MSHMS si njësi shpenzuese, por përfshirja e tyre në raportin përmbledhës për të gjitha programet e MSHMS-së.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Titullari i MSHMS të marrë masat, për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit 4-8-12 mujore për aparatin e MSHMS si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/45 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

- Sa i takon projekteve të investimit të realizuara në vitet 2021-2022, të cilat janë çelur pa kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të investimeve publike sipas përcaktimeve në VKM nr.185, datë 29.03.2018 “Për menaxhimin e investimeve publike”, sqarojmë se MSHMS çdo vit ka hartuar dokumentin e PBA. Bazuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 44, pika b citon ...“Rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore, miratohen nga Ministri i Financave”;

- Në lidhje me investimin “Ndërtim i godinës së re për akomodimin e qsh1, Njvksh dhe kl.stomatologjike Durrës”, ky produkt paraqitet me vlerë realizimi zero, pasi nuk është realizuar për disa arsye teknike;

- Në lidhje me investimin “Rikonstruksion i godinës së pediatriisë sp.Elbasan”, nisur nga tavanet e miratuara është bërë ndarja në përputhje me nenin 40 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, duke mos kaluar 20% të vlerës së plotë të projektit përkatës;

- Në lidhje me investimin “F.V pajisje hotelerie dhe mjekësore për pediatriinë e sp.Elbasan”, fondi është miratuar nga MFE me shkresën nr.9724/1 prot., datë 10.07.2021 dhe është realizuar brenda vitit 2021.

- Lidhur me konstatimin “Një numër i konsiderueshëm i kërkesave për shtesë fondesh nuk janë të shoqëruara me argumentet përkatëse”, sqarojmë se të gjitha shkresat janë të shoqëruara me argumentet përkatëse dhe sqarime mbi domosdoshmërinë e miratimit për ndryshim apo shtesë;

-Në lidhje me observacionin mbi Rekomandimin nr.3.1, ku keni vënë në dispozicion një email dëguar MFE-së, ku ju përcakton se për Raportet e Monitorimit duhet të zbatohet Udhëzimi nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me pretendimin tuaj mbi projektet e investimit të reja të realizuara sqarojmë se, nga ana e Grupit të Auditimit është theksuar fakti se për të gjitha ato projekte për investime të realizuara dhe të pa përfshira në PBA, duhet të ishin kryer në përputhje me VKM nr.185, datë 29.03.2018 “Për menaxhimin e investimeve publike”, Aneksi nr. 1- “Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike” ku citohet ... : “*Diagrama e mëposhtme përshkruan fazat e Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike. Identifikimi i projektit është procesi i identifikimit e shqyrtimit të ideve për projekte investimi të bazuara në analizën e nevojave publike, ndërhyrjeve të qeverisë dhe përshtatjes me strategjitë kombëtare dhe sektoriale. Hapi 5–Paraqitja e projekt-propozimit të investimit nga Institucionet Buxhetor Ministrisë përgjegjëse për Financat: Projekt-propozimet e investimeve përcillen në Ministrinë përgjegjëse për financat: - nëpërmjet paraqitjes normale të kërkesave për shpenzime sipas afateve të PBA-së/Buxhetit Vjetor; Hapi 7 Miratimi përfundimtar: Pas miratimit në KM të projekteve të investimeve në kuadër të PBA/buxhetit vjetor, lista e projekteve të investimeve paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë vetëm si tabelë shoqëruese e paketës së PBA/Buxhetit vjetor, por që nuk miratohet nga Kuvendi.”* Pra, në diagramën e mësipërme përshkruhet qartë se në cilat faza duhet të kalojë secili investim, me qëllim respektimin e procedurave të ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të investimeve publike. Gjithashtu, Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr.64 citon ... “*Nëse në listën e investimeve të detajuara nga njësitë e qeverisjes qendrore, ka objekte të reja nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të programit buxhetor afatmesëm, Nëpunësi i Parë Autorizues e përfshin në listën përfundimtare të detajimit vetëm kur objekti ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike, dhe ja paraqet për miratim përfundimtar Ministrisë përgjegjëse për Financat.”* Nga ana e MSHMS, këto projekte investimesh janë çelur pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm.

Për rrjedhojë nga ana e Grupit të Auditimit është theksuar fakti që për të gjitha ato projekte investimi të reja nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të PBA-ve duhet të kalonin procedurat e miratimit të investimeve publike, për rrjedhojë pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me pretendimin tuaj mbi investimin “Ndërtim i godinës së re për akomodimin e qsh1, Njvksh dhe kl.stomatologjike Durrës”, se ky objekt nuk paraqitet me vlerë realizimi në vitin 2021, sqarojmë se nga ana e Grupit të Auditimit analiza është kryer mbi materialet në format excel (PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024), ku

në “Formatin 2 – Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA”, në kodin e programit nr.07220 “Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor”, janë paraqitur vlerat e këtij objekti mbi të cilat ju është referuar Grupi i Auditimit.

20AB7	Rikonstrukcion i NJVKSH-ve			
Produkti	20AB701- Ndertim i godines se re per akomodimin e qsh1, njvksh dhe kl.stomatologjike Durres			
Përshkrimi i Produktit	Ndertim i godines se re per akomodimin e qsh1, njvksh dhe kl.stomatologjike Durres			
Njësia Matëse	m2			
	2021	2022	2023	2024
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	300	1740	0	0
Kosto totale (në lekë)	17,399,165	69,597,000	0	0
Kosto për njësi (në lekë)	57997.22	39998.28	0	0
Ndryshimi në % i Sasisë		4.8	-1	
Ndryshimi në % i koston totale		3	-1	
Ndryshimi në % i koston për njësi		-0.3103	-1	

Pra sipas të dhënave të formatit standard si më sipër plotësuar për PBA 2022-2024, objekti paraqitet me realizim në vitin 2021.

-Në lidhje me pretendimin tuaj mbi investimin “Rikonstrukcion i godinës së pediatriisë sp.Elbasan”, sqarojmë se nga ana e Grupit të Auditimit është trajtuar fakti i tejkalimit gjatë fazës së realizimit të vitit 2021 në raport me vlerën e planifikuar në PBA 2021-2023, pra për rrjedhojë nuk janë respektuar parashikimet si dhe shpërndarja e fondeve buxhetore për këtë investim ashtu siç është cilësuar në PBA 2021-2023 të plotësuar nga ana juaj.

-Në lidhje me pretendimin tuaj mbi investimin “F.V pajisje hotelerie dhe mjekësore për pediatriinë e sp.Elbasan”, nga ana e Grupit të Auditimit është cilësuar se në PBA-të respektive 2021-2023 dhe 2022-2024 nga ana juaj është parashikuar fondi prej 50,000,000 lekë për këtë investim për vitin 2023 dhe nuk ka qenë e planifikuar për tu kryer në vitin 2021. Pra nga Grupi i Auditimit nuk është cilësuar që nuk keni fonde në dispozicion por është cilësuar që jeni jashtë parashikimit të kryer po nga ana juaj gjatë PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024. Për rrjedhojë observacionet tuaja nuk merren në konsideratë.

-Në lidhje me pretendimin tuaj mbi konstatimin se një numër i konsiderueshëm i kërkesave për shtesë fondesh nuk janë të shoqëruara me argumentet përkatëse, sqarojmë se nga ana e Grupit të Auditimit nuk është cilësuar fakti i të drejtës për të kryer rishikime, por në akt konstatim është theksuar se numri i lartë i rishikimeve i kryer nga ana juaj lidhet drejtpërdrejt me performancën vjetore të Institucionit sipas Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 71 ku citohet. “Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat.” dhe pika 75. “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”.

-Në lidhje me pretendimin tuaj mbi raportet e monitorimit si dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, sqarojmë se periudha objekt auditimi ka qenë deri më 31.12.2022, ku sa i takon raporteve të monitorimit e buxhetit nuk është vepruar në përputhje me Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, paragrafin “Procedura për përgatitjen e raporteve katërmujore të monitorimit”, pikat nr.33 deri 48, ku përcaktohet qartë se si duhej vepruar nga struktura dhe nga GMS mbi hartimin e raporteve 4 mujore.

Për rrjedhojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit nr. 1178/1 Prot., datë 11.01.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare;
- PAGESA për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë viteve 2021-2022 mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimin të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe

pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimeve, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”* dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 janë në vlerën totale 2,993,506 mijë lekë;

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 janë në vlerën totale 1,584,545 mijë lekë.

Urdhër-shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”*, veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.

a. Auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, duke i analizuar dhe me regjistrimin në sistemin SIFQ, për vitet 2021 dhe 2022, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkalluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, pika 184 *“Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”*, si dhe Ligji nr.48/2014 *“Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”*, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.”

Tejkalimi i këtij afati ka krijuar detyrime të prapambetura për institucionin, ku sipas VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 *“Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”* dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 *“Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”*, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/ marrëveshje/ vendim gjykatë të formës së prerë, që mbeten të papaguara 60 ditë, pas datës së lëshimit të faturës nga operatori ekonomik.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ndikon në riskun e realizimit të investimeve të reja, si dhe blerjen e mallrave dhe shërbimeve të planifikuara, për t’u realizuar në periudhat e ardhshme, pasi një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga institucioni.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ka ardhur, ndër të tjera, edhe si rrjedhojë e si më poshtë:

- Mosidentifikimit të risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;
- Mungesës së kontabilizimit të plotë dhe të saktë të të gjitha detyrimeve, që nga koha e krijimit të tyre, si dhe regjistrimit të faturave në kohë në sistemin SIFQ;
- Mungesës së Planeve të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe planifikimit të fondeve të dedikuara për pagesat;
- Mosrespektimit të qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve.

Sa më lart në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184: Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7, VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 ‘Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e MSHMS, me datën e faturës tatimore, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për vitin 2021 dhe 2022, janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor.

Konkretisht, nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, u konstatuan se **46 urdhër shpenzime të vitit 2021 dhe 65 fatura të vitit 2022**, të cilat janë likuiduar mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore gjenden **Aneksi nr. 2/2 dhe 2/3**: “Urdhër shpenzimet e konstatuara në mosrespektim të afateve sa i takon likuidimit të faturave/” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 ku citohet... : “specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, si dhe Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7.

Titulli gjetjes:	Mbi tejkalimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave.
Situata:	Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor” si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7 në se 46 urdhër shpenzime të vitit 2021 dhe 65 urdhër shpenzime të vitit 2022 , duke sjellë: a. Tejkalim të afateve që parashikon Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 (ku specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), dhe si pasojë. b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura).
Kriteri:	Ligji nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 33; Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7
Ndikimi/Efekti	Mundësia e krijimit të detyrimeve të prapambetura
Shkaku:	Mungesë e fondeve buxhetore në dispozicion
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	MSHMS të marrë masat për një planifikim/programim sa më real dhe të besueshëm të buxhetit, duke u mbështetur në analizën e të dhënave që raportohet nga Sektori i Financës, si dhe të dhënave që gjenerohen nga sistemi SIFQ, me qëllim shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

b. Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga MSHMS, në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Argumentimin dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimin e APP-së, brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP <https://www.app.gov.al>.

Për periudhën objekt auditimi, MSHMS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK) ka kryer prokurime me procedurë:

- “Blerje me vlerë të vogël” për vitin 2021, në vlerën prej 5,258,784 lekë pa TVSH, ku “Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” zë vlerën 365,000 lekë, ose rreth 7% të totalit;
- “Blerje me vlerë të vogël” për vitin 2022, në vlerën prej 8,710,808 lekë pa TVSH, ku “Sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” zë vlerën 3,589,232 lekë, ose rreth 41% të totalit.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për të audituar procedurat blerje e vogël për blerje mallra/ shërbime, si më poshtë:

Periudha	Numri i procedurave të realizuara	Procedurat e zgjedhura	Vlera e kontratës pa TVSH
2021	15	13	6,322,413
2022	16	11	7,375,066
Totali	31	24	13,697,479

Për vitin 2021 dhe 2022, grupi i auditimit ka përzgjedhur për të audituar procedurat, të pasqyruara në Aneksin 2.3 “Procedurat për blerje mallra/shërbime të përzgjedhur për të audituar” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se:

PËR VITIN 2021

1. Për procedurën “Blerje bateri për automjete”

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 25, datë 30.08.2021 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **200,000 lekë pa TVSh** me objektin “Blerje bateri për automjete.”

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

- Nga ana e Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve është bërë kërkesa me anë të shkresës nr. 3577 prot., datë 25.08.2021 për blerjet me vlerë të vogël me objekt “Blerje bateri për automjete”, sipas preventivit bashkëngjitur kërkesës.

Nga verifikimi i procesverbalit të datës 30.08.2020, rezulton se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk ka reflektuar kryerjen e përlogaritjes së fondit limit, pasi ka vendosur të mos bëjë studim tregu duke qenë se është bazuar në çmimet e referencës të dërguara nga ABP.

Me anë të shkresës nr. 3577/2 prot., datë 30.08.2021, AK ka publikuar ftesën për ofertë me afatin për dorëzim ofertash datën 31.08.2021.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur nga Titullari i MSHMS me Urdhrin nr. 24, datë 18.01.2021, ka mbajtur procesverbalin e datës 13.09.2021 ku ka vlerësuar ofertat e paraqitura për këtë procedurë. Nga 23 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 5 OE për arsye se oferta e tyre ishte mbi fondin limit. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 134,000 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të cituar më sipër nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se

- Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është i plotë duke mos përmendur të dhënat dhe kushtet e plota në të cilat malli është marrë në dorëzim, numrin e fletëhyrjes në magazinë dhe faturës, etj.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimit nr. 916, datë 28.12.2021 në vlerën 160,800 lekë.

2. Për procedurën “Vlerësues për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga projekti i ndërtimit të spitalit Fier.”

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 6, datë 26.01.2021 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **800,000 lekë pa TVSh** me objekt “Vlerësues për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga projekti i ndërtimit të spitalit Fier.”

- Me anë të shkresës nr. 110 Prot., datë 11.01.2021, bazuar në Urdhrin nr.11, datë 11.01.2021 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin paraprak dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik të shpronësimit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga projekti për interes publik për ndërtimin e spitalit të ri Fier”, Titullari i AK në MSHMS ka miratuar që për nevoja të komisionit të vlerësimit për objektet e shpronësimit dhe masën e shpërblimit për secilin pronar privat, të përdoren vlerësues të jashtëm.

Me anë të shkresës me nr. 476/1 prot., datë 26.01.2021, AK ka publikuar ftesën për ofertë, ku afati për dorëzim i ofertave është data 25.01.2021.

Nga verifikimi i procesverbalit të datës 22.01.2021, konstatohet se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk ka reflektuar kryerjen e përlogaritjes së fondit limit, pasi ka vendosur të mos bëjë studim tregu.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur nga Titullari i MSHMS me Urdhrin nr. 24, datë 18.01.2021, ka mbajtur procesverbalin e datës 28.01.2021 ku ka vlerësuar ofertat e paraqitura për këtë procedurë. Nga 8 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 3 OE për arsye se oferta e tyre ishte mbi fondin limit. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 375,000 lekë.

Faza e lidhjes së kontratës

Me anë të shkresës nr.110/11 Prot., datë 28.01.2021 është lidhur kontrata e shërbimit midis palëve kontraktuese MSHMS si AK dhe G. H. (kontraktuesi) për “Vlerësimin për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private e cila preket nga projekti i spitalit Fier.”

Nga auditimi i dosjes së prokurimit u konstatua se në ftesën për ofertë, AK ka kërkuar kritere për operatorët ekonomikë, si vijon:

- Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme në lidhje me objektin e prokurimit;

- Licenca profesionale individuale të jetë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme: Për vlerësim të pasurive të paluajtshme (shkalla e dytë) në fushën “Ndërtesa dhe tokë truall”;

- Operatori ekonomik duhet të ketë eksperiencë në hartimin e planeve të rilevimit në bashkinë ku do të ndërtohet objekti.

- Operatori duhet të ketë njohuri mbi planin e përgjithshëm vendor të bashkisë si dhe në hedhjen mbi hartën treguese të regjistrimit, gjurmën e projektit, ku të evidentohen të gjitha pasuritë e prekura.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

-kontrata midis MSHMS si AK dhe kontraktorit është lidhur me datë 28.01.2021 dhe fatura është shlyer me 12.02.2021, duke tejkaluar afatin 5 ditë kalendarike nga momenti i lidhjes të vendosur në ftesën për ofertë;

- mungesa e procesverbalit të marrjes në dorëzim të mallrave;

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimit nr. 137, datë 13.04.2021 në vlerën 450,000 lekë.

3. Për procedurën “Materiale pastrimi”

Procedura “Materiale Pastrimi” u realizua me dy lote, përkatësisht nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 5, datë 18.01.2021 dhe Urdhrit të Prokurimit nr.5/1 datë 06.07.2021 është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **800,000 lekë pa TVSh** me objektin “Materiale pastrimi”.

Nga ana e Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve është bërë kërkesa me anë të shkresës nr. 312 Prot., datë 18.01.2021 dhe shkresën nr.2 923 Prot., datë 24.06.2021 për blerjet me vlerë të vogël me objekt “Materiale Pastrimi”, sipas preventivit bashkëngjitur kërkesës.

Për lotin e parë, nga 26 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 12 OE për arsye se oferta e tyre ishte mbi fondin limit. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 383,800 lekë.

Për lotin e dytë, nga 29 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 12 OE për arsye se oferta e tyre ishte mbi fondin limit. Pas vlerësimit të ofertave komisioni ka shpallur fitues OE me ofertën ekonomike 298,700 lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

Me anë të procesverbalit për kalimin tek OE i radhës, i mbajtur me datë 08.07.2021, komisioni i blerjeve të vogla në MSHMS ka verifikuar dokumentacionin sipas njoftimit në SEP, ku ka konstatuar se OE fitues B.L. me NIPT L...N ka një marrëveshje bashkëpunimi me një subjekt tjetër, dhe ka paraqitur certifikimin e OE me të cilin ka bashkëpunim.

OE i radhës i shpallur fitues është “XH. group”, subjekt i cili nuk posedon certifikatën ISO 14001-2015, por ka marrë një autorizim nga subjekti “A. D.” shpk me NIPT L...C. Veprimi i mësipërm është kryer në kundërshtim me kriteret e vendosura në ftesën për ofertë, pika 6, ku citohet: ...“ Vetë subjekti të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015.”

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimit nr. 514, datë 26.08.2021 në vlerën 460,560 lekë dhe nr. 516, datë 26.08.2021 në vlerën 358,440 lekë.

Për procedurën “Blerje program financiar “Financa 5”;

Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr.39, datë 16.12.2021, është miratuar procedura e prokurimit me vlerë **800,000 lekë pa TVSh** me objekt “Blerje sistemi financiar Financa 5.”

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të sipërcituar nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë konstatuar disa parregullsi të detajuara si më poshtë:

- Nga ana e Drejtorisë së Financës është bërë kërkesa me anë të postës elektronike për blerjet me vlerë të vogël me objekt “Blerje program financiar Financa 5”.

Nga verifikimi i procesverbalit të datës 16.12.2021, rezulton se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk ka reflektuar kryerjen e përlllogaritjes së fondit limit, pasi ka vendosur të mos bëjë studim tregu duke qenë se në kërkesë është dhënë vlera e miratuar nga MFE dhe e nxjerrë nga grupi i punës i cili ka bërë kërkesën për sistemin.

Për rrjedhoje, rezulton se nga ana e komisionit të blerjeve të vogla nuk është bërë përlogaritja e fondit limit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 34.

- Nëpërmjet shkresës nr.4656 prot., datë 12.11.2021, Sekretari i Përgjithshëm ka kërkuar transferim fondesh për investime në shëndetësi.

Nga auditimi rezultoi se kërkesa për transferim fondesh nuk është e shoqëruar me argumentet përkatëse duke përcaktuar arsyet pse kërkohet kjo shtesë fondesh për një investim të ri, gjithashtu rezulton se transferimi i fondeve është kryer pa kaluar fazat e planifikimit buxhetor, për rrjedhojë nuk është respektuar disiplina buxhetore si dhe nuk është hartuar një relacion i qartë ku të specifikoheshin nevojat se përse kërkohet ky fond i ri shtesë si dhe qëllimet e qarta se cilat do të ishin vlera e shtuar që do ti sillte Institucionit ky program i ri i specifikuar në objektin e prokurimit. Me shkresën 4656/1 prot., datë 01.12.2021 Ministri i MFE ka miratuar transferimin e fondeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me legjislacionin e buxhetit:

-Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr.40 ku citohet “e drejta për të kryer shpenzime”;

-Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr.64;

-Ligjin nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”;

-VKM nr.185, datë 29.03.2018 “Për menaxhimin e investimeve publike”, Aneksi 1- “Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike.”

Faza e lidhjes së kontratës

Me shkresën 5088/1 prot., datë 16.12.2021, AK ka publikuar ftesën për ofertë, ku afati për dorëzim i ofertave është data 17.12.2021.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i ngritur nga Titullari i MSHMS me Urdhrin nr. 24, datë 18.01.2021, ka mbajtur procesverbalin e datës 16.12.2021 ku ka vlerësuar ofertat e paraqitura për këtë procedurë, ku ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik “I.S.TD”, i cili paraqiti dokumentacionin e kërkuar dhe u shpall fitues me ofertën ekonomike 745,000 lekë pa TVSH.

Në datën 29.12.2021 është lidhur kontrata me nr. 5088/2 ndërmjet palëve MSHMS në cilësinë e AK, dhe operatorit ekonomik I.S.TD.

Në zbatim të kontratës me nr. 5088/2 datë 29.12.2021 është marrë në dorëzim sistemi Financa 5 me procesverbalin e datës 29.12.2021, ku citohet se pas lidhjes së kontratës OE ka instaluar dhe konfiguruar në dy kompjutera këtë program.

OE ka dorëzuar faturën nr.2995 datë 28.12.2021 dhe është bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr.32 datë 31.12.2021.

Nga auditimi i dokumentacionit të cituar më sipër nga ana e Grupit të Auditimit, rezulton se nuk kemi përputhje në kronologjinë e dokumenteve të dorëzuara dhe procesverbaleve të mbajtura, pasi:

- Fatura e dorëzuar nga ana e OE mban datën 28.12.2021, fakt i cili evidenton se është dorëzuar kjo faturë 1 (një) ditë para lidhjes së kontratës (e cila mban datë 29.12.2021), për rrjedhojë këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, pasi nga ana e MSHMS-së nuk duhej pranuar një faturë e cila është më përpara se dita e lidhjes së kontratës.

- Gjithashtu aktivi është bërë hyrje në magazinë në datën 31.12.2021, datë e cila përkon edhe me likuidimin e kryer për shërbimin e realizuar me Urdhër Shpenzimit nr.967, datë 31.12.2021. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se Programi Financiar është marrë në dorëzim vetëm nga një punonjës, veprim i cili është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30 datë 27.12.2021, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, pika 43 ku citohet se...: “Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të përgjegjës materiale.”

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara nga ana e AK në Ftesën për Ofertë.

AK ka likuiduar OE për shërbimin e realizuar me urdhër shpenzimit nr. 967, datë 31.12.2021 në vlerën 894,000 lekë me TVSH.

Titulli i Gjetjes:	Mangësitë e konstatuara tek procedurat e blerjeve me vlerë të vogël.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlerë të vogël u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - OE fitues nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë sipas kërkesave dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit në kundërshtim me nenin 92 pika 3 e LPP. Gjithashtu, nuk kanë të dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve duke mos mbajtur procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera sa i takon marrjes në dorëzim; - Për të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të audituara u konstatua se këto procedura në të gjitha rastet nuk ishin të inventarizuara e për pasojë të arkivuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”. - Nga auditimi i kryer i procedurës me objekt “Blerje sistemi financiar Financa 5” nga ana e grupit të auditimit u konstatuan mangësi që në parashikimin e fondit gjatë fazës së planifikimit buxhetor, mos përcaktimit të fondit limit, parregullsive në fazën e lidhjes së kontratës, dorëzimit të faturës para datës së hyrjes në fuqi të kontratës si dhe marrjes në dorëzim të aktivitetit pa specialistë të fushës, rezultoi se e gjithë procedura, është kryer në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. <p>Gjithashtu grupi i auditimit konstatoi se “Sistemi financiar Financa 5”, i prokuruar nga MSHMS, nuk është përdorur në asnjë moment nga Sektori i Financës, për të realizuar hedhjen e të dhënave të kontabilitetit, magazinës, inventarit etj, pasi të gjithë të dhënat nga Sektori i Financës i janë vënë në dispozicion Grupit të Auditimit në formatin Excel, dhe jo me Financa 5. Për rrjedhojë, qëllimi kryesor i kryerjes së kësaj procedure ka rezultuar i papërdorshëm.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr.40; -Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr.64; -VKM nr.185, datë 29.03.2018 “Për menaxhimin e investimeve publike”, Aneksi 1- “Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike.” - Ligji 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me nenin 12, pika 2,, i ndryshuar me LPP 162/2020 neni 21 pika 2; nenin 92 pika 3 - Udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018, pikën 7 dhe 14/a, i ndryshuar me Udhëzimin e APP nr. 5, datë 25.06.2021, pikën 15/a. - Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
Shkaku:	Mungesë gjurmë auditimi, për të verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore. Shpallja fitues e OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret e ftesës për ofertë si dhe objektin e prokurimit, ndikon në realizimin jo cilësor të shërbimit/mallit të prokuruar. Mungesa e vënies në përdorim e programit financiar Financa 5.
Ndikimi/Efekti:	Moszbatim i dispozitave ligjore e nënligjore. Mungesa e vënies në

	përdorim e programit financiar Financa 5 duke ndikuar në përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore të shpenzuara për blerjen e këtij programi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- Nga ana e MSHMS-së të merren masa në vijimësi për dokumentimin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, si dhe realizimin e inventarizimit të dosjeve, për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit si dhe shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit. -Nga ana e Sektorit të Financës të merren masa për vënien në punë të sistemit financiar Financa 5, me qëllim evidentimin në kohë dhe me besueshmëri të të dhënave të kontabilitetit, magazinës dhe inventarit.

II.1. Auditimi i procedurave të prokurimit “Blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar”

Autoriteti Kontraktor, në fillim të vitit buxhetor, ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) për blerjen e biletave i përbërë prej 3 anëtarë, bazuar në Udhëzimin e APP nr. 4, datë 09.01.2018 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike” (për sa kohë ishte në fuqi) dhe në pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 18.06.2021. Pas nxjerrjes së autorizimit për pjesëmarrje nga titullari/ ministri, titullari i AK/ personi i autorizuar prej tij, referuar pikës 4 të Udhëzimit ka nxjerrë Urdhrat e Prokurimit përkatës.

Komisioni, në zbatim të pikës 5-6 të Udhëzimit, ka realizuar procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

Nga auditimi i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar është konstatuar se:

Blerja e biletave është realizuar në kufijtë e datës së nisjes megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/ aktivitetit është dërguar disa javë para kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave. Kjo ka ardhur si pasojë e miratimit me vonesë të autorizimeve, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MSHMS në këto aktivitete. Një fenomen i tillë sjell si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë, kur prokurohet pak ditë para datës së nisjes, krahasuar me çmimet e tregut.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar.

Në të gjithë urdhër-shpenzimet e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të përzgjedhura për t’u audituar nga ana e Grupit të Auditimit, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, u konstatua *mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve*. Me anë të këtij dokumentacioni, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE datë 10.07.2013 “ Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011 “Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 4 dhe me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “*Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkaktun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative*”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

Titulli i Gjetjes:	Shpenzimet për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar në procedurat me sistem dinamik blerje.
Situata:	<p>Nga auditimi i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar është konstatuar se: Blerja e biletave është realizuar në kufijtë e datës së nisjes megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/ aktivitetit është dërguar disa javë para kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave. Kjo ka ardhur si pasojë e miratimit me vonesë të autorizimeve, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MSHMS-së në këto aktivitete. Një fenomen i tillë sjell si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë, kur prokurohet pak ditë para datës së nisjes, krahasuar me çmimet e tregut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar.</p> <p>Në të gjithë urdhër shpenzimet e përzgjedhura për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, nga ana e Grupit i Auditimit u konstatua mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve. Me anë të këtyre dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE datë 10.07.2013 “ Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011“Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 4 dhe me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkaku e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a. nenin 4, pika 26, nenin 2, pika 16;</p> <p>UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”;</p> <p>UMF nr.22 datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011“Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 4.</p>
Shkaku:	Blerje e biletave me çmim më të lartë kur prokurohet afër datës së nisjes krahasuar me çmimet e tregut. Mos dokumentimi i gjurmëve të auditimit.

Ndikimi/Efekti:	Mos menaxhimi në kohë i përgatitjes së dokumentacionit për fillimin e procedurës së prokurimit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-Titullari i institucionit të marrë masa që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet jo në datë të përfaqësuar (apo brenda ditës) me datën e nisjes.. - Sektori i Financës të marrë masa që në të gjitha praktikatat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave t'i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

2.3 Auditimi i llogarive vjetore.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2: Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5: Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7: Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve);
8. Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, situacione

këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2021 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën me shkresën nr. 1424, datë 28.03.2022 “Dërgimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2021”.

- për vitin 2022 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1455, datë 30.03.2023 “Dërgimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2022” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se:

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Auditimi i llogarive performancës financiare

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konfirmo rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2021 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 1,457 milionë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 1,460 milionë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 7.8 milionë lekë

Totali ii + iii = 0 lekë

Nga auditimi i zërave të shpenzimeve rezulton se në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës” është pasqyruar dhe reflektuar ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën prej (1,472,634) lekë, veprime në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika “Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve.

Konstatim:

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime”.
Situata:	Nga auditimi i llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” rezultoi se shumica e kontabilizuar në llogarinë 6020 “Materiale zyre e te pergjitheshme” në vlerën prej 21,274,365 lekë krahasuar me vlerën e paguar gjatë vitit 2022

	dhe me faturat e konstatuara dhe të cilat do të paguhen në vitin 2023 paraqitet si më poshtë:	
		<i>Në lekë</i>
	Paraqitur ne bilanc	21,274,365
1	Nga likuidimet me bankë (Kontabilizimi)	1,846,525
2	Nga blerja e mallrave e materialeve, (hyrjet ne magazine)	15,446,982
3	Detyrimet e prapambetura nga viti i kaluar (Evidenca)	3,451,518
4	Likuidimet e viteve te kaluara	529,341
	Sa më sipër konstatohet se shpenzimet në shumën prej 3,980,859.00 lekë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime në momentin e konstatimit dhe të ndodhjes së tyre, por janë njohur në një periudhë të më vonë të cilës nuk i përkasin, veprime në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. Kjo vlerë duhet të ishte reflektuar në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” vitin në të cilën kanë ndodhur.	
Kriteri:	Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.	
Ndikimi/Efekti:	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen.	
Shkaku:	Mospasqyrimi i drejte i llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.	
Rëndësia:	E ulët	
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së faturave për blerje mallra/shërbime/punë bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.	

Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrës së pozicionit financair vjetore rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 94% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 6% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra, të pasqyruara në **Aneksin 3.1** “Aktivet qarkulluese” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49:

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën në vlerën 55,889,752 lekë përfaqëson gjendjen e mjeteve në ruajtje (të

evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466) në shumën prej 27,194,542 lekë, dhe shuma prej 28,800,769 lekë si e ardhur e trashëguar nga MSHMS, nga të cilat të krijuara në vitin 2022 janë në vlerën 10,831,364 lekë.

Pika 50 e udhëzimit. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2022 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2022 reflekton me ulje prej vitit 2021 në vlerën 26,581,333 lekë.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2022, rezulton në vlerën 12,009,070 lekë. Në krahasim me vitin 2021 është ulur në vlerën 1,472,634 lekë, ku peshën më të madhe e zë ulja e zërit “Inventar i imët”, diferenca e cila është pasqyruar në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.

* Llogari të arkëtueshme:

- Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 2,656,636 lekë, përbëhet nga detyrimi i krijuar në vitet 2001- 2005, të cilat kanë të bëjnë me detyrime ndaj punonjësve të dalë nga auditimi i brendshëm dhe nga auditimi i KLSH-së.

Titulli i Gjetjes:	Llogari të arkëtueshme.
Situata:	<p>Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 308,932 lekë, e cila përbëhet nga detyrimi i krijuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ne vitin 2001 në vlerën prej 105,089 lekë, si dhe “Parapagime” në vlerën 3000 lekë; - Ne vitin 2005 në vlerën prej 108,900 lekë; - Ne vitin 2011 në vlerën prej 106,753 lekë, si dhe “Parapagime” në vlerën 8,810 lekë. <p>Nga ana Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tij, si rrjedhojë ky detyrim është i paarkëtueshëm, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në nenin 203 pika 1 Kodi i Punës “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115 Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në lidhje me parapagime” në vlerën 11,810 lekë, të krijuat në vitin 2001 dhe 2011, bazuar në Kodin Civil, neni 114 ”Afatet e parashkrimit” ku citon se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” ky detyrim është i parashkruar.
Kriteri:	Kodi i Punës, nenin 203 pika 1 “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet” si dhe Kodit Civil neni 115, 114 dhe 121.

Ndikimi/Efekti:	Detyrime të cilat nuk kanë shpresë arkëtim, pasi ka humbur fuqia ligjore për ti kërkuar.
Shkaku:	Mos marrja e hapave ligjor me kohë për të parandaluar parashkrimin tyre sipas përcaktimeve në Kodin civil dhe Kodin e punës.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkuara dhe të parkëtueshëm, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

- Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 2,368,704 lekë, e cila përbëhet nga detyrimi i krijuar në vitin 2014, si detyrim i lënë nga auditimi i KLSH-së, u konstatua se nga MSHMS nuk janë marrë hapat administrative për analizimin e këtij detyrimi dhe arkëtimin e saj.

*** Situata e Detyrimeve të Prapambetura:**

- Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në vlerën 26,256,378 lekë janë detyrime të lëna nga KLSH për subjektet të cilat kanë realizuar punime në MSHMS, për të cilët nuk ka asnjë informacion se çfarë masash janë marrë nga ana e Institucionit.

- Llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për investime në vlerën 3,225,558 lekë dhe për Rimbursim TVSH “Gj. H. e K.” në vlerën prej 225,960 lekë, ku si kundërparti kanë llogarinë, 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”.

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 486 “ <i>Shpenzime të periudhave të ardhshme</i> ”.
Situata:	Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se shumica e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. Sa më sipër, shumica e vendimeve gjyqësore duhet të ishte reflektuar në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në llogarinë 486 “ <i>Shpenzime të periudhave të ardhshme</i> ”.
Kriteri:	Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.
Ndikimi/Efekti:	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen.
Shkaku:	Mospasqyrimi i drejte i llogarive në pasqyrën e “ <i>Pozicionit financiar</i> ”.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 29,019,862 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MSHMS ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, si dhe vlera e faturave

të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2023. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436 dhe 467.

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” viti 2021.
Situata:	- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 634,356,074 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MSHMS ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2021, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore dhe për llogarinë 401 që ka të bëjë me komisionet e bonuseve të bebeve që i paguan MSHMS në vlerën 14,650,595 lekë, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në shumën prej 618,564,317 lekë., vlerë e cila ka të bëjë me fatura të viteve 2015; 2017; 2018 dhe 2020. Nga auditimi analitik i llogarisë konstatohet një diferencë prej 1,141,162 lekë e debituar në llogarinë 4342, vlerë e cila është e paargumentuar. Gjithashtu u konstatua se, në lidhje me memo kredinë e “Q. H.” është regjistruar vlere prej (2,240,650.8) në kontabilitet, ndërsa në SIFQ vlera është (224.065,80) lekë me një diferencë prej 2,000,000 lekë vlerë e cila është e paargumentuar, me efekt në rezultatin e pasqyrave financiare.
Kriteri:	Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Mospasqyrimi i saktë i llogarive në pasqyrën financiare jep një pamje jo të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit, me ndikim material në rezultatin e institucionit.
Shkaku:	Mospasqyrimi i drejte i llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Sektori i Financës të marrë masa që për diferencat e konstatuara dhe të paargumentuar të bëjë sistemimet kontabël, me qëllim paraqitjen e drejte të rezultatit financiar të institucionit.

Aktivitet afatgjatë

Në formatin nr. 1 “Aktivitet e Afatgjatë” në vlerën neto prej 2,032 milionë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktivitet Afatgjatë jo materiale” në vlerën neto 7,013,457 lekë dhe “Aktivitet Afatgjatë materiale” në vlerën neto 2,025 milion lekë, të pasqyruara në **Aneksin 3.2** “Aktivitet afatgjatë” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 7,013,457 lekë, përbërë nga vlera e transferuar nga Ish-Ministria e Mbrojtjes Sociale.

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 129,442,819 lekë, përbërë nga vlera e godinës së MSHMS Gjatë vitit 2022 nuk ka pësuar rritje.

- Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 9,870,336 lekë, e cila krahasuar me vitin 2021 nuk ka pësuar ndryshime.

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”.
Situata:	Nga auditimi i analitik i llogarisë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, u konstatua se në këtë llogari është regjistruar “Regjistri elektronik i ndihmës ekonomike” me kosto historike në shumën prej 71,400,000 lekë. Shuma prej 71,400,000 lekë është pasqyruar gabim në llogarinë kontabël 213, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare të institucionit. Veprime këto në kundërshtim me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik “ dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë

	09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” ; Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël).
Kriteri:	Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”; Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i vlerës së aktiveve, gjendje në institucion.
Shkaku:	Trashëguar në vite mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- Sektori i Financës së MSHMS të marri masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, duke debituar llogarinë 2140160 “Instalimi i sistemit te kompjuterëve” për shumën 71,400,000 lekë dhe kredituar llogarinë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, për të njëjtën vlerë.

- Llogaria 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 5,553,054 lekë, e cila krahasuar me vitin 2021 nuk ka pësuar ndryshime.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 0 lekë.

Gjatë vitit ka pësuar ndryshime nga “Kalimit kapital pa pagesë”:

- Rritje në vlerën 5,312,560 lekë të automjetit tip “Mitsubish” nga Instituti i Shëndetit Publik në MSHMS bazuar në Urdhrin e me nr. 44, datë 21.01.2022 prot. me nr. 247/2, datë 21.01.2022.

Me datë 21.01.2022 është mbajtur proces-verbal, midis përfaqësuesve të MSHMS dhe ISHP, mbi dorëzimin e automjetit, me personin e autorizuar nga MSHMS me autorizimin nr. 147/3, datë 21.01.2022. Nga MSHMS është bërë hyrje me FH nr. 1, datë 21.01.2022. Nga ISHP është bërë dalja me FD nr. 2, datë 21.01.2022.

Zvogëlim në vlerën 7,843,380 lekë

- Në vlerën prej 3,131,549 lekë të automjetit tip “Toyota”, nga MSHMS në Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore bazuar në Urdhrin e me nr. 75, datë 23.01.2018 prot. me nr. 583, datë 23.01.2018.

Me datë 12.02.2018 është mbajtur proces-verbal, midis përfaqësuesve të MSHMS dhe AKBPM, mbi dorëzimin e automjetit. Nga MSHMS është bërë dalja me FD 13/1 datë 12.02.2018.

Nga auditimi u konstatua se kalimi në pronësi i automjeteve nga MSHMS në AKBPM nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MSHMS deri në momentin e daljes nga pronësia. Në dosje nuk ka të bashkëngjitur autorizimin e personit për tërheqjen e mjetit, sikundër kërkohet në Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre”.

- Në vlerën prej 2,566,570 lekë të automjetit tip “Hyundai” dhe në vlerën prej 3,555,011 lekë të automjetit tip “Ford Everest” nga MSHMS në Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore bazuar në Urdhrin e me nr. 30, datë 21.01.2019 prot. me nr. 236/1, datë 23.01.2019.

Me datë 04.02.2019 është mbajtur proces-verbal, midis përfaqësuesve të MSHMS dhe AKBPM, mbi dorëzimin e automjetit, me personin e autorizuar nga AKBPM me autorizimin nr. 525/1, datë 23.01.2019. Nga MSHMS është bërë dalja me FH 2 datë 31.01.2019. FH në AKBPM me nr. 2, datë 04.02.2019.

Nga auditimi u konstatua se kalimi në pronësi i automjeteve nga MSHMS në AKBPM nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MSHMS deri në momentin e daljes nga pronësia.

- Në vlerën prej 1,156,820 lekë të automjetit tip “Wolkswagen” nga MSHMS në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të dhunës në familje, bazuar në Urdhrin e me nr. 19, datë 17.01.2021 prot. me nr. 322, datë 17.01.2019.

Me datë 04.02.2019 është mbajtur proces-verbal, midis përfaqësuesve të MSHMS dhe AKBPM, mbi dorëzimin e automjetit, me personin e autorizuar nga QKTVDHF me autorizimin nr. 59, datë 31.01.2019. Nga MSHMS është bërë dalja me FH 1 datë 31.01.2019. FH në QKVDHF me nr. 2, datë 04.02.2019.

Nga auditimi u konstatua se kalimi në pronësi i automjeteve nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MSHMS deri në momentin e daljes nga pronësia.

Nga AKBPM është kthyer mbrapsht automjetin në MSHMS në vlerën 2,566,570 lekë të automjetit tip “Hynday”. Bërë hyrje me FH 2 datë 04.02.2019.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 118,501,751 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat:

Kalimit kapital pa pagesë:

- Rritje në vlerën absolute në vlerën prej 1,240,560 lekë dhe në vlerën neto në vlerën prej 1,504,852 lekë.

- Zvogëlim në vlerën në vlerën 8,855,626 lekë.

- Si dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve në vlerën 26,644,550 lekë.

Shtesa prej 1,240,560 lekë janë dhurata nga C. Bank shoqëruar me kontratën e dhurimit nr. 23.11.2022 prot., nr. 4512, datë 23.11.2022, si dhe faturat fiskale të blerjes së pajisjeve. Bërë hyrje me FH nr. 24, datë 23.11.2022.

Lëvizja e aktiveve kapitale pa pagesë në 2021:

*** Zvogëlim:**

- Me Urdhrin e SP nr. 63, datë 01.02.2021 “Kalim kapitali të aktiveve afatgjata”, nga MSHMS në Njësitë vendore të kujdesit shëndetësorë në shumën 162,400 lekë për llogaria 218 “Inventar ekonomik”.

Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MSHMS deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së asetëve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit, shoqëruar me fletë-hyrjen e tyre.

- Me Urdhrin e SP nr. 71, datë 03.02.2021 “Kalim kapitali të aktiveve afatgjata”, nga MSHMS në Zyra Rajonale e Kujdesit Social Tiranë në shumën 72,000 lekë për llogaria 218 “inventar ekonomik”.

Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MSHMS deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon procesverbali i marrjes në dorëzim.

- Me Urdhrin e SP nr. 72, datë 03.02.2021 “Kalim kapitali të aktiveve afatgjata”, nga MSHMS në Qëndren Shëndetësore Dispanceri, në shumën 128,400 lekë për llogaria 218 “inventar ekonomik”.
Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MSHMS deri në momentin e daljes nga pronësia.

*** Rritje:**

- Me Urdhrin e SP nr. 77, datë 04.02.2021 “Kalim kapitali të aktiveve afatgjata”, nga AKBPM në MSHMS në shumën 126,240 lekë për llogaria 218 “inventar ekonomik” (Karrige, kolltuk dhe tavolina), nga MSHMS është bërë hyrje me FH nr. 5 datë, 24.02.2021.

Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur, dhe nga MSHMS është regjistruar vlera e koston historike të tyre. Gjithashtu mungon procesverbali i marrjes në dorëzim.

- Me shkresën e SP nr. 2119/1, datë 18.05.2021 është miratuar “Kalim kapitali të aktiveve afatgjata”, nga AKBPM në MSHMS në shumën 150,404 lekë për llogaria 218 “inventar ekonomik” (Printera, USP kompjuter dhe skaner), nga MSHMS është bërë hyrje me FH nr. 11 datë 18.05.2021.

Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur, dhe nga MSHMS është regjistruar vlera e kostos historike të tyre. Gjithashtu mungon procesverbali i marrjes në dorëzim.

- Nga MSHMS është bërë hyrje në magazine me FH 14/1, datë 05.07.2021 shuma prej 79,320 lekë (pajisjeve Monitor dhe UPS) , ku mungon gjithë dokumentacioni bashkëshoqërues, që nga Urdhri për “Kalim kapitali të aktiveve afatgjata”, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar, procesverbali i marrjes në dorëzim. i cili duhet të mbahet në prani të dorëzuesve (përfaqësues të AKBPM dhe marrësit në dorëzim (përfaqësues të MSHMS).

Titulli i Gjetjes:	Kalim kapitali pa pagesë i aktiveve gjatë viteve.
Situata:	Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, nga një subjekt në tjetrin mbështetur në Urdhrat për “Kalim kapitali pa pagesë” u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, ku nga MSHMS është regjistruar në kontabilitet vlera e kostos historike të tyre; Akt konfirmimi i njësisë pritëse dhe fletë-hyrja e regjistrimit të aktivitetit, si dhe në rastin e kalimit të mjeteve të transportit pa pagesë, autorizimin i personit për tërheqjen e mjeteve të transportit . Veprime në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin.
Kriteri:	Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.
Ndikimi/Efekti:	Mos llogaritje e vlerës së mbetur të aktivitetit, çon në regjistrimin e vlerës jo reale të aktivitetit. Mos paraqitja e flete hyrjeve ose fletë daljeve si dhe aktit të konfirmimit, lë të hapur ciklin e transferimit të kapitali.
Shkaku:	Mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- Sektori i financës të marrë masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose daljeve, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e reflektimit në kontabilitet të tyre.

Llogaria 28 “Caktime” janë pasqyruar Investimet për të tretët por që janë likuiduar nga MSHMS, si dhe donacionet për situatën pandemike Covid-19. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat:

- Shtesës prej 112,564,278 lekë, të 11 investimeve të kryera dhe të likuiduara nga MSHMS;
- shtesë nga donacionet për covid-19 në shumën prej 50,989,301 lekë.

Pakësime si rezultat:

- Kalimit të donacioneve institucioneve të varësisë në vlerën prej 85,034,915 lekë;
- Konfirmimi për rikonstruksionin e QSH në vlerën 80,545,135 lekë të vitit 2019-2020;
- Konfirmimi për rikonstruksionin e QSH në vlerën 41,540,239 lekë të vitit 2022;
- Si dhe shumën prej 3,963,131 lekë konfirmim nga projektin “Save the Children”.

Titulli Gjetjes:	i Llogaria 28 “Cakttime” për vitin 2021.																																																																																								
Situata:	Llogaria 28 “Cakttime” janë pasqyruar Investimet për të tretët, por që janë likuiduar nga MSHMS, si dhe donacionet për situatën pandemike Covid-19. Nga auditimi i analitik i kësaj llogarie si dhe duke marrë për bazë vlerësimin e bërë nga eksperti i kontraktuar për vlerësimin e aktiveve të ish- Ministrinë e Mirëqenies dhe Rinisë rezultoi se zëri 28 përbehet nga: <div data-bbox="446 346 1372 661" data-label="Table"> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Perberja e zerave te aktiveve ne proces</th> <th>Gjendja ne 01.01.2017 ne leke</th> <th>Shtesa gjate vitit 2017 ne leke</th> <th>Gjendja 31.12.2017 ne leke</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Rikonstruksion Ambjenteve te MMSR</td> <td>17,501,174</td> <td></td> <td>17,501,174</td> </tr> <tr> <td>Regjistri I PAK</td> <td>4,835,899</td> <td></td> <td>4,835,899</td> </tr> <tr> <td>Rikonstruksion Q.R Korce</td> <td>113,416,554</td> <td></td> <td>113,416,554</td> </tr> <tr> <td>Rikonstruksion Q.R Vlore</td> <td>12,028,577</td> <td></td> <td>12,028,577</td> </tr> <tr> <td>Shkolla e Mesme Golem (faza 1,2)</td> <td>9,892,753</td> <td></td> <td>9,892,753</td> </tr> <tr> <td>Sistemi I Sherbimit Social</td> <td>152,004,380</td> <td>37,000,000</td> <td>189,004,380</td> </tr> <tr> <td>Shtepia Polican(Rikonstruksion)</td> <td>164,496,000</td> <td></td> <td>164,496,000</td> </tr> <tr> <td>Shtepia Palase(Rikonstruksion)</td> <td>6,783,502</td> <td></td> <td>6,783,502</td> </tr> <tr> <td>Shtepia Shkoder(Rikonstruksion)</td> <td>60,000,000</td> <td>10,348,294</td> <td>70,348,294</td> </tr> <tr> <td>Shkolla Hoteleri Turizem</td> <td>18,615,353</td> <td>4,240,539</td> <td>22,855,092</td> </tr> <tr> <td>Shkolla Rakip Kryeziu</td> <td>74,336,000</td> <td>74,567,126</td> <td>148,903,126</td> </tr> <tr> <td>Shkolla Ali Myftiu Elbasan</td> <td>2,458,982</td> <td></td> <td>2,458,982</td> </tr> <tr> <td>Shkolla Kristo Isak</td> <td>35,000,000</td> <td></td> <td>35,000,000</td> </tr> <tr> <td>Shkolla Arben Broci</td> <td>12,000,000</td> <td></td> <td>12,000,000</td> </tr> <tr> <td>Shkolla Pavaresia Vlore</td> <td>34,878,616</td> <td>95,183,743</td> <td>130,062,359</td> </tr> <tr> <td>Shkolla Hamdi Bushati</td> <td>25,000,000</td> <td></td> <td>25,000,000</td> </tr> <tr> <td>TVSH e rimbursuar (Atelier 4)</td> <td>15,000,000</td> <td>69,943,915</td> <td>84,943,915</td> </tr> <tr> <td>TVSH e rimbursuar (2 I)</td> <td>1,075,645</td> <td>517,735</td> <td>1,593,380</td> </tr> <tr> <td>TVSH e rimbursuar (GIZ)</td> <td>7,784,853</td> <td>24,407,593</td> <td>32,192,446</td> </tr> <tr> <td>TVSH e rimbursuar (GIZ)</td> <td>4,757,094</td> <td>4,286,568</td> <td>9,023,662</td> </tr> <tr> <td>TOTALI</td> <td>771,845,582</td> <td>320,495,513</td> <td>1,092,341,095</td> </tr> </tbody> </table> </div>	Perberja e zerave te aktiveve ne proces	Gjendja ne 01.01.2017 ne leke	Shtesa gjate vitit 2017 ne leke	Gjendja 31.12.2017 ne leke	Rikonstruksion Ambjenteve te MMSR	17,501,174		17,501,174	Regjistri I PAK	4,835,899		4,835,899	Rikonstruksion Q.R Korce	113,416,554		113,416,554	Rikonstruksion Q.R Vlore	12,028,577		12,028,577	Shkolla e Mesme Golem (faza 1,2)	9,892,753		9,892,753	Sistemi I Sherbimit Social	152,004,380	37,000,000	189,004,380	Shtepia Polican(Rikonstruksion)	164,496,000		164,496,000	Shtepia Palase(Rikonstruksion)	6,783,502		6,783,502	Shtepia Shkoder(Rikonstruksion)	60,000,000	10,348,294	70,348,294	Shkolla Hoteleri Turizem	18,615,353	4,240,539	22,855,092	Shkolla Rakip Kryeziu	74,336,000	74,567,126	148,903,126	Shkolla Ali Myftiu Elbasan	2,458,982		2,458,982	Shkolla Kristo Isak	35,000,000		35,000,000	Shkolla Arben Broci	12,000,000		12,000,000	Shkolla Pavaresia Vlore	34,878,616	95,183,743	130,062,359	Shkolla Hamdi Bushati	25,000,000		25,000,000	TVSH e rimbursuar (Atelier 4)	15,000,000	69,943,915	84,943,915	TVSH e rimbursuar (2 I)	1,075,645	517,735	1,593,380	TVSH e rimbursuar (GIZ)	7,784,853	24,407,593	32,192,446	TVSH e rimbursuar (GIZ)	4,757,094	4,286,568	9,023,662	TOTALI	771,845,582	320,495,513	1,092,341,095
Perberja e zerave te aktiveve ne proces	Gjendja ne 01.01.2017 ne leke	Shtesa gjate vitit 2017 ne leke	Gjendja 31.12.2017 ne leke																																																																																						
Rikonstruksion Ambjenteve te MMSR	17,501,174		17,501,174																																																																																						
Regjistri I PAK	4,835,899		4,835,899																																																																																						
Rikonstruksion Q.R Korce	113,416,554		113,416,554																																																																																						
Rikonstruksion Q.R Vlore	12,028,577		12,028,577																																																																																						
Shkolla e Mesme Golem (faza 1,2)	9,892,753		9,892,753																																																																																						
Sistemi I Sherbimit Social	152,004,380	37,000,000	189,004,380																																																																																						
Shtepia Polican(Rikonstruksion)	164,496,000		164,496,000																																																																																						
Shtepia Palase(Rikonstruksion)	6,783,502		6,783,502																																																																																						
Shtepia Shkoder(Rikonstruksion)	60,000,000	10,348,294	70,348,294																																																																																						
Shkolla Hoteleri Turizem	18,615,353	4,240,539	22,855,092																																																																																						
Shkolla Rakip Kryeziu	74,336,000	74,567,126	148,903,126																																																																																						
Shkolla Ali Myftiu Elbasan	2,458,982		2,458,982																																																																																						
Shkolla Kristo Isak	35,000,000		35,000,000																																																																																						
Shkolla Arben Broci	12,000,000		12,000,000																																																																																						
Shkolla Pavaresia Vlore	34,878,616	95,183,743	130,062,359																																																																																						
Shkolla Hamdi Bushati	25,000,000		25,000,000																																																																																						
TVSH e rimbursuar (Atelier 4)	15,000,000	69,943,915	84,943,915																																																																																						
TVSH e rimbursuar (2 I)	1,075,645	517,735	1,593,380																																																																																						
TVSH e rimbursuar (GIZ)	7,784,853	24,407,593	32,192,446																																																																																						
TVSH e rimbursuar (GIZ)	4,757,094	4,286,568	9,023,662																																																																																						
TOTALI	771,845,582	320,495,513	1,092,341,095																																																																																						
Kriteri:	Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”; Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.																																																																																								
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i vlerës së aktiveve, gjendje në institucion.																																																																																								
Shkaku:	Trashëguar në vite mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet.																																																																																								
Rëndësia:	E mesme																																																																																								
Rekomandimi:	- Sektori i Financës së MSHMS të marrë masat për klasifikimin e zerave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, duke debituar llogarinë 212 “Ndërtime e Konstruksione” në shumën prej 22,337,073 lekë dhe llogarinë 2140160 “Instalimi i sistemit te kompjuterave” për shumën 277,912,554 lekë për regjistrin PAK dhe “Sistemi i Shërbimit Social” dhe duke kredituar llogarinë 28 “Cakttime” për shumën respektive.																																																																																								

Titulli i Gjetjes:	Mos klasifikimi i aktiveve sipas llogarive të përcaktuar në planin kontabël publik.
Situata:	Nga auditimi i zerave të pasqyrës së aktivitetit dhe regjistrimit për vitet 2021-2022 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i bërjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivitetet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.

	<p>- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e “pajisjeve elektronike” janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 218600 “pajisjeve elektronike”.</p> <p>Një pjesë e “Pajisjeve dhe instalimi i kondicionerëve” janë klasifikuar në llogarinë 218600 “Inventar ekonomik”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”.</p> <p>Një pjesë e pajisje “zyre orendi” janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 2187000 “Te tjera pajisje zyre”.</p> <p>Sa më sipër veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Klasa 2 “Aktive afatgjata”.</p> <p>Nga auditimi i llogaritjes së amortizimit u konstatua se amortizimi vjetor i aktiveve “Kompjuterat, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni” është përlllogaritur me 20% dhe jo me 25%;</p> <p>Si dhe për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, e transferuar nga Ish-Ministria e Mbrojtjes Sociale, amortizimi vjetor është llogaritur mbi vlerën e mbetur dhe jo me metodën lineare, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36; Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.</p> <p>Nga auditimi analitik i llogarive 218 “Inventar ekonomik”, u konstatua se:</p> <p>Me Urdhrin e NA nr. 305, datë 16.05.2022 është ngritur komisioni “Për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata”, i cila ka bërë nxjerrjen jashtë përdorimi të:</p> <p>- Aktiveve si pajisje kompjuterike, fotokopje dhe pajisje elektronike me vlerë fillestare 18,807,408 lekë, të cilat janë konsideruar për riciklim, dhe do të ruhen në një ambient të përshtatshëm deri në organizimin e ankandit, ku do të peshohen dhe do të bëhen hyrje në magazine si materiale të riciklueshme. MSHMS në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022 këto vlera i ka hequr fare nga pasqyrat në regjistrin e aktiveve veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109. Aktivet kalojnë në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo te tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero. Për vitin 2022, në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” (me koston historike) duhet të ishin reflektuar këto aktive si nxjerrje jashtë përdorimi, duke debituar llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në vlerën neto, por pa ndikim në rezultatin financiar të vitit 2022.</p>
Kriteri:	Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109.

Ndikimi/Efekti:	Mos evidentimi i saktë i vlerës neto të aktiveve që disponon institucioni, e cila ndikon në mos Planifikimi e saktë të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.
Shkaku:	Trashëguar në vite mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- Sektori i Financës së MSHMS të marri masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve. - Sektori i Financës së MSHMS të marri masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/44 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Konstatimi nga Grupi Auditues për mos shoqërimin e daljeve të automjeteve me kartelën e Llogaritjes së amortizimit të akumuluar sqarohet se: Dalja e këtyre automjeteve të ish MMSR është kryer para hartimit të Pasqyrave Financiare të ish MMSR (Mars 2021) për rrjedhojë nga Sektori i Financës në momentin e bërjes dalje nuk ka patur informacion për amortizimin e akumuluar.

**Në lidhje me klasifikimin jo të saktë të aktiveve në llogarinë 214; 218 si dhe klasifikimin jo të drejte në llogarinë 28 të vlerës të Regjistrimit PAK dhe të "Sistemit të shërbimit Social theksojmë se ky klasifikim është bërë nga eksperti që ka punuar për mbylljen e llogarive vjetore të ish MMSR (Mars 2021).*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observimi juaj nuk merret në konsideratë, për të cilat grupi i auditimit ka lënë rekomandimet për sistemimin dhe marrjen e masave nga MSHMS në vijimësi.

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2022, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 88,576 mijë lekë, të pasqyruara në **Aneksin 3.3** “Pasivet Afatshkurtra” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën prej 3,131,072 lekë përfaqëson vlerën e çeqeve për bebet për vitin 2022.

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 9,339,173 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2022, që paguhen në janar të vitit 2023.

- Llogaria 431 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 1,028,697 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në Janar të vitit 2021.

- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 1,994,579 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 1,340,130 lekë të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në muajin Janar 2023.

- Llogaria 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 28,913,014 lekë përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa-arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari përbëhet nga saldo debitorë të llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” dhe të llogarisë 468 “Debitore të ndryshëm”.

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën prej 27,194,543 lekë përfaqëson 5% e garancisë së mbajtur të “Rikonstruksionit të dhomës së serverit”.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto, të pasqyruara në Aneksin 3.4 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i Gjetjes:	Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto.
Situata:	<p>Nga auditimi i “<i>Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto</i>” dhe rakordimi me pasqyrimin e vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C ka një pasqyrim jo të drejtë të vlerave në pasqyrë.</p> <p>Vlera e pasqyruar në llogarinë 12 “<i>Nga Rezultatet e mbartura(+,-</i>” në shumën prej 1,472,634 lekë është dubluar, pasi kjo vlerë është e reflektuar në llogarinë 85 “<i>Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)</i>”.</p> <p>Ky pasqyrim është bërë gabim dhe në vitin 2021, ku vlera 5,935,118 lekë e ndryshimit të gjendjes së inventarit është dubluar duke e pasqyruar dhe në llogarinë 12 “<i>Nga Rezultatet e mbartura(+,-</i>” dhe në llogarinë 85 “<i>Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)</i>”.</p> <p>Llogaria 85 “<i>Rezultati i ushtrimit nga funksioni</i>” përfaqësohet si rubrikë me vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor, ku në fund të vitit ushtrimor, paraqitej me vlerën e ndryshimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>Nga auditimi i pasqyrës “<i>Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)</i>” për vitin 2021, për zërin kompjuter nga institucioni është përlllogaritur amortizim vjetor më i lartë se vlera e aktiveve, ku si rrjedhojë vlera e amortizimit të akumuluar është më e lartë se vetë kostoja historike e aktiveve. Në kontabilitet është përlllogaritur vlera negative për këto aktive në shumë prej -19,291,624 lekë vlerë e cila është zbritur nga gjendja e aktiveve, duke ndikuar dhe në pasqyrimin jo real të gjendjes së tyre në kontabilitet dhe pasqyrim jo të drejtë të <i>ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto</i>. Ky veprim kontabël është bërë dhe për vitin 2022 për një grup aktivesh.</p> <p>Veprimi mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “<i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>” paragrafi 2.3 “<i>Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik</i>”. Klasa 2 “<i>Aktivët Afatgjata</i>”, <i>me ndikim material në fondet neto të institucionit</i>.</p>
Kriteri:	Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “ <i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i> ” paragrafi 2.3.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i llogarive me efekt material në pasqyrën financiare.
Shkaku:	Keq klasifikim të llogarive.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimin në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

c) Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011

“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës... ”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2022. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit në tetor të 2022 për vitin 2021 **dhe jo çdo vit siç** parashikuar në Paragrafi nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionon se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik".

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik".

Më konkretisht:

a) Inventarizimi fizik

Titulli i Gjetjes:	Komisioni i Inventarizimit.
Situata:	<p>Nga auditimi i procesit të inventarizimit u konstatua se: Procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer nga komisioni i ngritur sipas urdhrin të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS “Për krijimin e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve” me nr. 304, datë 16.05.2022, i ndryshuar me urdhrin me nr. 304/1, datë 22.07.2022 me përbërje të: - S. Ç., Kryetar; - V. Dh., anëtar; - R. S., anëtar; - V. S., anëtar; - T.H., anëtar.</p> <p>Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i sektorit të financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se “Komisioni nuk duhet të jete më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/ përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi ,,,” si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22 “veprimtaria e kontrollit” pika 3. b “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë

	15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika 3 dhe neni 22, pika 3/b.
Ndikimi/Efekti:	Konflikti i interesit.
Shkaku:	Moszbatimi i përcaktimeve ligjore.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vazhdimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat mund ta vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

Në urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS “*Për krijimin e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve*” me nr. 304/1, datë 22.07.2022 në pikën 2 të urdhrin citohet se inventarizimi i aktiveve do të bëhet nga data 01.01.2021 dhe 31.07.2022 dhe afati i kryerjes së inventarit imët është deri me datën 30.09.2022.

Para fillimit të inventarit, me datën 30.07.2022 nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbal, ku është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, sipas përcaktimit të paragrafit 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa më sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr. 26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011.

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkuara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur raportin mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve në përdorimi, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Në relacion komisioni është shprehur se nuk ka diferenca midis gjendjes kontabël dhe asaj fizike.

b) Vlerësimi i aktiveve

Me Urdhrin nr. 372 datë 26.08.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur komisioni “*Për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata*”, për aktivet e identifikuar në relacionin e inventarizimit të vitit 2020.

Me anë të shkresës nr.3608/1 prot., datë 10.09.2021 komisioni i vlerësimin të aktiveve ka mbajtur relacionin mbi përfundimin e procedurës së vlerësimin për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të Aparatit të MSHMS, ku kanë evidentuar listën e aktiveve jashtë përdorimi për llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 21,139,362 lekë, për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 5,505,188 lekë dhe për llogarinë 32 “Materiale konsumi” në vlerën 1,561,013 lekë. Në relacionin e vlerësimin është relatuar procedura e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprime në përputhje me paragrafin 106 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Në fund të procesit të vlerësimin, komisioni i vlerësimin për aktivet e institucionit ka mbajtur procesverbalin e datës 10.09.2021, për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, ku janë përcaktuar shkaqet e daljes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve, vlera e mbetur e tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime në përputhje me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

c) Nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve

Me Urdhrin e NA nr. 305, datë 16.05.2022 është ngritur komisioni “*Për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata*” e përbërë nga 5 anëtarë, e cila ka përbërje tjetër nga komisioni i

vlerësimit të aktiveve, sipas përcaktimit të parashikuar paragrafit 97, të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve pajisje dhe materiale ka një vlerë fillestare prej 28,239,543 lekë dhe vlerë të mbetur 1,660,627 lekë, e cila është bërë sipas përcaktimit të parashikuar në paragrafin 109, Kreu IV të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

- Aktivitet si pajisje kompjuterike, fotokopje dhe pajisje elektronike me vlerë fillestare 18,807,408 lekë janë konsideruar për riciklim, dhe do të ruhen në një ambient të përshtatshëm deri në organizimin e ankandit, ku do të peshohen dhe do të bëhen hyrje në magazine si materiale të riciklueshme.

-Aktivitet si orendi zyre dhe materiale konsumi me vlerë fillestare 9,432,135 lekë janë asgjësuar me depozitimin e tyre pranë vend depozitimit të mbetjeve të Sharrës Tiranë. Procesi i asgjësimit është dokumentuar në proces verbalit nr. I, datë 17.5.2022 të komisionit të shoqëruar me pamje fotografike dhe dokumentacionin e depozitimit.

2.4 Prokurimet e fondeve publike

Grupi i auditimit, për të realizuar qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë në lidhje me prokurimet e fondeve publike, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore të:

- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM-së nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”;
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Auditimi i procedurave të prokurimit të kryera nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Regjistri i parashikimeve;
- Regjistri i realizimeve;
- Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve;
- Argumentimin dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
 - Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
 - Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

1. Regjistri i parashikimeve

- Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar, në Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 “Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”, të cilat janë dërguar me nr. 298, datë 18.01.2021 dhe nr. 444, datë 26.01.2022,

Sa më sipër regjistrat nuk janë përgatitur, sipas afatit të përcaktuar Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 pika 3 ku citohet se “Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit duhet të përgatitet nga AK jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës”.

- Ligji i buxhetit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” është botuar në fletoren zyrtare nr.221 datë 17.12.2020.

- Ligji i buxhetit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është botuar në fletoren zyrtare nr.197 datë 21.12.2021.

- Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar në formë elektronike, në faqen e APP <https://www.app.gov.al>.

2. Regjistri i realizimeve

Në lidhje me regjistrin e realizimit të vitit 2021- 2022 u konstatua se në përgjithësi nuk është paraqitur me formën dhe mënyrën që është parashikuar, kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 dhe nenit 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes:	Mangësitë e konstatuara tek regjistrat/ SPE.
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrat e realizimit nuk janë të plotë. - Nga njësia përgjegjëse për SPE nuk është realizuar arkivimi i dosjeve të prokurimit në sistem, të cilat nuk janë pasqyruar as në regjister si të realizuara. Në vitin 2022, nga MSHMS është realizuar procedura “B3-Blerje barna të ndryshme për përdorim spitalor”, ndarë në 40 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 628,100,541.73 (gjashtëqind e njëzet e tetë milion e njëqind mijë e pesëqind e dyzet e një.73) Lekë pa TVSH”, <i>e cila nuk figuron e realizuar në regjistrin e prokurimeve për vitin 2022.</i> Grupi i auditimit nuk e ka audituar si procedurë. <p>Referuar procedurave të prokurimit për B1 dhe B2 “Blerje barna të ndryshme për përdorim spitalor”, për të cilën janë nënshkruar marrëveshjet respektive nr.1532/128 prot., datë 26.07.2022 dhe 1533/152 prot., datë 19.07.2022 konstatohet se realizimi në SPE është në totalin e fondit limit. Për 20 lote të procedurës B1 si dhe për 7 lote të procedurës B2 ku konstatohet diferenca mes fondit limit dhe ofertave fituese, mundësia e realizimit me fond limit siç parashikohet në draft marrëveshjet kuadër të nënshkruara çon në përdorim pa efikasitet dhe efikasitet të fondeve publike në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në regjistrin e realizimit nuk janë futur si të realizuar të gjitha Lot-et e procedurave të prokurimit të barnave për B1 dhe B2, ndërsa procedura B3 nuk figuron e realizuar, ku kjo procedurë është mbyllur në 2022. <p>Sa më sipër mos arkivimi i dosjeve të prokurimit dhe mos pasqyrimi i tyre në regjistrin e realizimit janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 30.07.2021 “Për Mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike” pika 3.11. “Arkivimi i procedurës së prokurimit në SPE”, “Pas publikimit në sistem të njoftimit të lidhjes së kontratës së nënshkruar, faza e radhës</p>

	<p>që shfaqet tek skedari “Detyrat e Mbetura” për nëpunësi i autorizuar “Arkivo Tenderin”, me Manual Teknik “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër dhe krijimin e minikontratave në sistem” me Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 Kreu II “Regjistri i realizimit të procedura të prokurimeve publike” pika 1, si dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit, e cila informon mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; • Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; • Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; etj nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi (çdo procedure prokurimi). <p>- Në regjistrin e vitit 2021 dhe 2022 mungon element, tipi i kontratës: mall/shërbim punë/marrëveshje kuadër, i cili është kërkuar sipas udhëzimit Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021.</p> <p>- Nga AK nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit të gjitha kategoritë e mallrave e shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë, pavarësisht se këto procedura nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.</p> <p>-Procedura, të cilat janë realizuar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara dhe nga MSHMS janë lidhur kontratat e realizimit të mallrave/shërbimeve nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit veprime në kundërshtim kreut II Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021, pika 2. Grupi i auditimit i konstatoj këto vlera të realizuar dhe të pa pasqyruara në regjistrin e prokurimeve nga analiza e shpenzimeve në ditarin e bankës, për periudhën objekt auditimi.</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 ”Për hartimin e parashikimit të regjistrin të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”, pika 1; 2 dhe 3;</p> <p>Udhëzimin nr. 7, datë 30.07.2021 “Për Mënyrën e zhvillimit të procedurave të procedurave të prokurimit me mjete elektronike” pika 3.11.</p> <p>VKM-ja nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78, pika 4.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mungesë gjurmë auditimi, për të verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore.
Shkaku:	Moszbatim dhe mosnjohje e dispozitave ligjore dhe SPE.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga personat përgjegjës për prokurime në MSHMS të merren masat e arkivimit të procedurave të prokurimit në SPE, si dhe përditësimin e regjistrin të parashikimit dhe të realizimit të procedurave të prokurimit me të gjithë elementet e parashikuara.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi personat përgjegjës për njësisë së prokurimit të ngarkuar me këtë detyrë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/51 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si

më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

Personat përgjegjës në MSHMS/Spektori i Prokurimeve rithekson faktin se Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në të cilin bën pjesë ky sektor, nuk ka në varësi dhe as ndonjë lidhje hierarkike me strukturat e tjera në MSHMS, që marrin pjesë në procesin e planifikimit financiar buxhetor (detyrë funksionale e këtyre strukturave).

Për këtë arsye Spektori i Prokurimeve, mban komunikime me këto struktura duke i njoftuar lidhur me afatet ligjore për hartimin dhe më pas publikimin e Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike në SPE, por nuk mund të jetë përgjegjës për veprimet/mosveprimet e tyre.

Serish, sqarojmë se Spektori i Prokurimeve nuk e disponon detajimin e buxhetit për shpenzimet ashtu dhe investimet, si dhe nuk ka në detyrat funksionale planifikimin financiar buxhetor.

Risjellim në vëmendjen tuaj se në sistemin e prokurimeve elektronike veprohet në bazë të një akti administrativ dhe jo sipas iniciativës së personave përgjegjës. Përsa kohë nuk ka pasur një akt administrativ, pra rregjistri i parashikimeve të prokurimit publik nuk ka qenë i miratuar, nuk ka qenë e mundur të publikohej ky dokument. Me miratimin e tij nga Titullari i Institucionit është proceduar me ngarkimin e tij në sistem.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi argumentimi juaj nuk është i bazuar në bazë ligjore. Është Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve që ka për detyrë hartimin dhe dërgimin e regjistrimit të parashikimeve brenda afateve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.

Pretendimi i Subjektit:

4. Përlllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër bahet, si më poshtë vijon:

Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përlllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Në rastin kur, autoriteti/enti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t'u referohet, për atë sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përlllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër." Gjithashtu bazuar në pikën 1.3 neni 1 të Marrëveshjes Kuadër, ku përdorimi i këtij drafti është detyrë për gjithë AK-të, përcaktohet se:

"1.3 Shumat e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin/Entin Kontraktor t'i blejë ato. autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara."

Sa me sipër, vlera e ofertuar dhe sasi të parashikuara janë vetëm për qëllime orientimi dhe AK mund të blejë me pak ose më shumë se këto sasi çka nënkupton se realizimi mund të jetë dhe me i lartë se vlera totale e ofertuar nga OE por brenda vlerës (fondit limit) të Marrëveshjes Kuadër.

Bazuar në legjislacionin në fushën e Prokurimeve publike, Marrëveshja Kuadër përfundon në dy raste:

- 1. Në rastin e përfundimit të afatit të vlefshmërisë së saj;*
- 2. Në rastin kur ezaurohet i gjithë fondit i Marrëveshjes Kuadër.*

Ku fondit i MK është vlera limit e përcaktuar që në DT.

Ritheksojmë faktin se Agjencia e Prokurimit Publik edhe me miratimin e legjislacionit të ri të prokurimit publik, ka vazhduar të mbajë të njëjtin qëndrim lidhur me vlerën e marrëveshjes kuadër, pasi edhe në DST e reja të publikuara me ndryshimet e fundit të Tetorit të vitit 2022, vazhdon të jetë parashikimi i mëposhtëm:

"1.3 Shumat e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin/Entin Kontraktor t'i blejë ato. autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara."

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi siç është trajtuar dhe në PRA dhe në akt konstatimet Për 20 lote të procedurës B1 si dhe për 7 lote të procedurës B2 është konstatuar diferenca mes fondit limit dhe ofertave fituese, ku kontrata nuk është lidhur me vlerën e ofertës fituese por me vlera e përcaktuara në fondin limit të cilat kanë qenë shumë më të larta se oferta fituese. Argumentimi që AK mund të blejë më pak ose më shumë brenda fondit limit të Marrëveshjes Kuadër tregon mosplanifikim të saktë të nevojave duke shkaktuar mospërdorim me efikasitet dhe efikasitet të fondeve publike në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Lidhur me sqarimin tuaj se spitalet janë informuar nuk provohen me shkresa njoftimet përkatëse.

Pretendimi i Subjektit:

Lidhur me sa konstatohet, Njësia përgjegjëse arkivon çdo procedurë pasi ngarkon si dokument të fundit para arkivimit, Formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar. Për Procedurën e përmendur (B3), Ministria e Shëndetësisë luan rolin e Organit Qendror Blerës që ka kryer procedurën e prokurimit ndërsa lidhjet e minikontratave kryhen nga Autoritet Kontraktore (Spitalet) që disponojnë fondet.

Sqarojmë se AK përfituese bazuar në nenin 7 pika 5 të RRPP ku:

"Autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim, njoftimin e fituesit, në përputhje me parashikimet e nenit 97, të LPP-së, dhe njoftimin e lidhjes së kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Në rastin e prokurimit të përqendruar, autoriteti/enti/enti kontraktor/e përfituese duhet të dërgojnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë organit qendror blerës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Organi

qendror blerës dërgon për publikim, njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e delegimit të prokurimit, autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e duhet të dërgojë/jnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë autoritetit kontraktor, i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Ky i fundit dërgon për publikim njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti kontraktor.” kane detyrimin ligjor qe brenda 5 ditëve te dërgojnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë organit qendror blerës, detyrim te cilin nuk e kane respektuar. Sa më lart, ky qëndrim nuk pranohet sipas adresimit të KLSH së.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi është përgjegjësi e OQB që të finalizojë marrëveshjen kuadër në SPE duke e arkivuar atë dhe spitalet lidhin minikontrata me OE fitues.

Pretendimi i Subjektit

Përsa i përket përditësimit të regjistrimit të realizimit me të gjithë elementët e parashikuara, shpjegojmë se kategorizimi i procedurave në mall/shërbime në regjistrin e realizimeve krijohet automatikisht dhe nuk është një fushë (qelizë) që personat përgjegjës mund të ndërhyjnë pasi vete krijimi i regjistrimit të realizimeve krijohet automatikisht në një nyje të veçantë në sistemin e APP me rolin e njësisë. Rrjedhimisht nga ana e Njësisë apo personave përgjegjës është teknikisht e pamundur ndërhyrja për plotësim.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi argumentimi juaj nuk qëndron, Në platformën e SPE personi përgjegjës për krijimin e regjistrimit i mundësohet zgjedhja e qelizës për llojin e procedurës mall/shërbim ose punë.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

1. Për vitin **2021** janë kryer 4 procedura prokurimi, nga të cilat:

- Procedurë Prokurimi “E Hapur e thjeshtuar”, në total 1 procedurë, me vlerë kontrate 2,787,000 lekë pa tvsh;

- Procedurë Prokurimi “E Hapur” në total 1 procedurë, me vlerë kontrate 12,800,000 lekë pa tvsh;

- Procedurë Prokurimi “E Hapur” mbi kufirin e lartë monetar në total 2 procedurë përkatësisht me vlerë kontrate 492,000,000 lekë pa tvsh dhe me vlerë kontrate 416,029,540 lekë pa tvsh.

2. Për vitin **2022** janë kryer 7 procedura prokurimi, nga të cilat:

-Procedurë Prokurimi “E Hapur”, në total 3 procedurë, me vlerë kontrate 214,129,515 lekë pa TVSH.

- Procedurë Prokurimi “E Hapur e thjeshtuar”, në total 1 procedurë, me vlerë ekonomike 462,306 lekë pa TVSH.

- Procedurë Prokurimi “Shërbim konsulence”, në total 1 procedurë, me vlerë ekonomike 5,381,160 lekë pa TVSH.

- Procedurë Prokurimi “E Hapur” mbi kufirin e lartë monetar në total 3 procedurë “Blerje barna të ndryshme për përdorim spitalor” - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” 9,038,998,701 lekë.

Nga këto procedura prokurimi, grupi i auditimit përzgjedhi për auditim 10 kontrata me vlerë totale 9,554,025 mijë lekë, ose 94% të fondit të përgjithshëm të prokuruar.

Viti	Vlera e kontratës së nënshkruar	Numëri i prokurimeve	Dosje të audituara/Vlera pa TVSH	Dosje të audituara ne numër	Mbulimi ne vlere me auditim %
2021	923,616,540	4	923,616,540	4	100%
2022	9,258,509,376	7	8,630,408,835	6	93%
Totali	10,182,125,916	10	9,554,025,375	10	94%

Burimi: MSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e prokurimit të përzgjedhura nga grupi i auditimit për vitet 2021-2022 u konstatuan:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt "Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore”, Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ndarë në lote, (një OE të vetëm të

suksesshëm për secilin lot), parashikuar për 24 muaj. Fondi limit në total për tre lotet: 416,597,685 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH", konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore"			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF- 91257-03-26-2021 Urdhri nr. 178, datë 24.03.2021	1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese Urdhri nr. 66, datë 01.02.2021/ L. P. O. A. A. Q.	2 Njësia e Prokurimit A. P. L. P. E. L.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr 178/1 datë 24.03.2021 S. K. F. S. L. A.
4. Fondi Limit (pa tvsh) Lot1 216,843,471 lekë Lot2 178,438,321 lekë Lot3 21,315,893 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) Lot1 216,842,640 lekë Lot2 177,871,200 lekë Lot3 21,315,700 lekë		6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lot1 831 lekë Lot2 561.721 lekë Lot2 193 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Data 14.05.2021	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit		9. Operatorët Ekonomike a) Lot1 Pjesëmarrës në tender BOE Lot2 Pjesëmarrës në tender 1 OE Lot3 Pjesëmarrës në tender 1OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 24 muaj			
10. Ankimime	11. Përgjigje Ankesës AK me:	12. Përgjigje .	
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit			
13. Lidhja e kontratës: MK mes AK/ OQB MSHMS - Për Lot1 me fitues BOE "H. L." Sh.p.k dhe "S. M." Sh.p.k. me nr. 1546/10 prot., datë 18.06.2021. - Për Lot2 me fitues "M." me nr. 1546/7 prot., datë 15.06.2021. - Për Lot3 me fitues "B.E.k" me nr. 1546/9 prot., datë 17.06.2021.			

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me urdhrin e prokurimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, urdhërohet të kryhet prokurimi "Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore" Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ndarë në lote, (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot), parashikuar për 24 muaj. Fondi limit në total për tre lotet: 416,597,685 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Objekti dhe fondin limit i loteve:

-Lot.1 "Mirëmbajtja e përqendruar "full risk" e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips" me fond limit 216,843,471 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

- Lot 2 "Mirëmbajtja e përqendruar "full risk" e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Siemens" - me fond limit 178,438,321 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzetë e një) lekë pa TVSH.

- Lot 3 "Mirëmbajtja e përqendruar "full risk" e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Toshiba" - me fond limit 21,315,893 (njëzetë e një milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

NJP me datën 24.03.2021 ka mbajtur procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike veprime në përputhje me Neni 61 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 2 "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me

kapacitetin teknik, specifkimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të **argumentohet teknikisht dhe ligjërish**, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Në pikën 3.3 Kapaciteti teknik pika 3 nga AK është kërkuar “Të ketë të paktën një inxhinier për mirëmbajtjen e aparaturave objekt te këtij prokurimi. Për këtë duhet të paraqiten CV e specialistit dhe certifikatat/dëshmitë e trajnimit lëshuar nga kompania prodhuese”.

Sa më sipër kriteri i vendosur është i pa plotë pasi nga AK nuk është vendosur profili i inxhinierit që AK kërkon/pranon e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton profilin e inxhinierit veprime jo në përputhje me përcaktimet e nenit 28 “Kontratat e shërbimeve” pika 2 ku citon se...”Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Në pikën 3.3 Kapaciteti teknik pika 8 nga AK është kërkuar “Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import, eksport, tregtim të pajisjeve mjekësore dhe mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Kërkesa e mësipërme “...për import, eksport, tregtim...” nuk përputhet me objektin dhe natyrën e kontratës.

Bashkëngjitur dokumentacionit të tenderit është dhe shkresa e datës 25.03.2021 për përkthimin e materialit të DST në 2 kopje, e cila konsiston në 108 faqe kompjuterike prej 2200 karakteresh (238239 karaktere), ku tarifa e shpërblimit për përkthim është 1200 lekë me TVSH për faqe kompjuterike.

Nga auditimi u konstatua se procedura e përkthimit nuk është realizuar me procedure prokurimi blerje e vogël.

Konstatimi:

Përkthimi i dokumentacionit është bërë pa realizuar asnjë procedurë paraprake blerje të vogël por është bërë blerje e drejtpërdrejtë në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” neni 1 pika 2 “Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike”, neni 3 pika 2 “Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën” dhe neni 7 ku specifkohet përjashtimet e veçanta.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

KVO në procesverbalin e vlerësimit të ofertave mbajtur me datën 21.05.2021 citon se:

Lot.1 “Mirëmbajtja e përqendruar “full risk” e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips” me fond limit 216,843,471 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, në të cilin ka marrë pjesë BOE “H.L.t” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k., me përfaqësues “H. & L.” Sh.p.k: “H. & L.” Sh.p.k ku pas shqyrtimit të ofertave në SPE rezultoi se BOE Shtojca 3 “Formulari i sigurimit të ofertës”, Sigurim është i vlefshëm për periudhën 150 ditë, dhe jo 180 ditë siç është e specifikuar në DT. Nga KVO është kërkuar sqarim BOE, me shkresën, e cila nuk ka numër protokolli dhe datë, për sqarim në lidhje me sigurimin e

ofertës ku i është lënë afat deri me datën 21.05.2021. Edhe në SPE nuk gjendet kërkesa e drejtuar OE për sqarim.

- Mosarkivimi fizik i dosjeve të prokurimit me fletë inventarizuese referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë neni 58 “*Inventarët përbëhen nga kapaku, numri rendor i inventarit, lloji i dokumenteve të përfshira në inventar, treguesi i lëndës, artikujt përshkrues, fleta vërtetuese me numrin e fletëve të inventarit e të njësisve të ruajtjes (me shifra dhe me fjalë) dhe me emrin, mbiemrin e nënshkrimit e hartuesit.....*”, neni 59 “*Për çdo njësi ruajtjeje hartohet inventari i brendshëm (Mod. 8) i dokumenteve që përmban njësia (në tekst, grafik, fotografi etj)*” si dhe “Rregullorja e njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.

Sa më sipër veprimet janë kundërshtim dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhër nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit, e cila informon mbi:

- Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit;
- Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund;
- Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; etj.

nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi (çdo procedure prokurimi).

Anëtarët e KVO S. K. dhe F. S. e kanë kualifikuar BOE me argumentimin se është devijim i vogël që nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DT, duke e konsideruar si ofertë të suksesshme.

Me datën 19.05.2021 është sjellë nga **BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k.**, dokument sqarimi, e cila është pa numër protokolli dhe pa datë, se kur është administruar nga MSHMS, ndërsa sigurimi i ofertës është lëshuar me datën 20.05.2021, shkresë e cila nuk përkon me sqarimet e kërkuar nga AK, pasi me datën 21.05.2021 kur është mbajtur procesverbali nga KVO nuk ka qenë dokument i administruar.

Pas vlerësimit të ofertave nga KVO është ka hartuar raportin përmbledhës nr. 1546/3, datë 10.06.2021, miratuar procedura nga titullari i AK znj. G. P.

Raporti përmbledhës është hartuar që nga faza e argumentimit të specifikimeve deri tek kualifikimi i OE, të cilët kanë marrë pjesë ne tender.

Veprime në kundërshtim me nenin 84 “*Raporti përmbledhës*” ku përcaktohet:

“*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor*”.

Pika 2 Raporti përmbledhës duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- përshkrimin e punëve/ mallrave/shërbimeve;
- respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave;
- çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës;
- korigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla);
- të dhënat e ofertuesve të skualifikuar, ofertën ekonomike dhe arsyet e skualifikimit;
- të dhënat e ofertuesve të kualifikuar, ofertën ekonomike të tyre;
- informacion për hedhjen e shortit (nëse ka pasur oferta me vlerë të njëjtë);
- të dhënat e ofertuesit fitues;
- informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar:

- Për Lot 1 me fitues BOE “**H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k.** me nr. 1546/5 prot., datë 10.06.2021, i korigjuar me nr.1546/8 datë 15.06.2021.

- Për Lot 2 me fitues “M.” me nr. 1546/6 prot., datë 10.06.2021.
- Për Lot 3 me fitues “B. E.” me nr. 1546/4 prot., datë 10.06.2021.

Mes AK dhe OE fitues është lidhur marrëveshja kuadër

Për Lot1 me fitues BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k. me nr. 1546/10 prot., datë 18.06.2021.

- Për Lot 2 me fitues “M.” me nr. 1546/7 prot., datë 15.06.2021.
- Për Lot 3 me fitues “B. E.” me nr. 1546/9 prot., datë 17.06.2021.

MSHMS si Organ Qendror Blerës me shkresën nr. 1546/11, datë 24.06.2021 dërgon Spitalëve Rajonale dokumentacionin në lidhje me shërbimin e mirëmbajtjes mes AK dhe OE të shpallur të suksesshëm, për vijimin e zbatimit të procedurave ligjore për lidhjen dhe zbatimin e kontratave brenda marrëveshjeve kuadër.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/49 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Ne piken 3.3 Kapaciteti teknik pika 3 sqarojmë se kërkesa për kapacitetin teknik ka si qellim garantimin e ofrimit të shërbimit në përputhje me kërkesat e shërbimit objekt të kësaj procedure prokurimi. Kërkesa lidhet me profesionin e stafit teknik të kërkuar, i cili duhet të jete Inxhinier për shkak se pajisjet mjekësore objekt i kësaj procedure janë komplekse që kërkojnë njohuri inxhinierike njohuri që përbejnë bazën e nevojshme për trajnime të mëtijshme specifike që lidhen me pajisjet si skanera, rezonanca, angiografid (duke konsideruar edhe faktin që ne Shqipëri nuk ka ende një dege të inxhinierisë biomjekësore që është specifike për pajisjet mjekësore). Për këtë arsye është kërkuar që stafi të jete inxhinier, pra të paraqitet diploma e inxhinierit si dhe është kërkuar paraqitja e certifikatave apo dëshmimeve për trajnime apo kualifikime të kryera me pajisjet e sipërcituara nga prodhuesi i pajisjeve, për të garantuar kualifikimet e këtyre inxhinierëve për mirëmbajtjen e pajisjeve specifike objekt të kësaj procedure prokurimi.

- Ne piken 3.3 Kapaciteti teknik pika 8 sqarojmë se në me certifikimin ISO, ky shërbim kompleks, duhet të garantojë mirëmbajtjen preventive, atë korrigjuese por dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të cilat importohen nga jashtë dhe sipas rastit, kur ato paraqesin defekte dhe janë brenda garancisë, duhet të eksportohen dhe të importohen përsëri si tubi i rrezeve X për pajisjet përkatëse, gjeneratorët, të gjitha pjesët e këmbimit të nevojshme për funksionimin e pajisjeve, furnizimi me helium (për rezonancat magnetike), pajisjet UPS të pajisjeve, gazin SF6 (për akseleratorin), cilleri (për akseleratorin). Për sa me sipër ofertuesi duhet të garantojë kryerjen e veprimeve të import eksportit në kohe të shpejte për furnizimin e rezonancës me helium apo instalimin e pjesëve të ndryshme të pajisjeve me qellim që pajisjet të rezultojnë në një kohe sa me të shkurtër jashtë shërbimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Observimi juaj nuk merret në konsideratë pasi kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e nenit 28 “Kontratat e shërbimeve” pika 2 si dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës.

Zbatimin e kontratave:

Titulli i Gjetjes:	Zbatimi i kontratës “Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore”
Situata:	Nga auditimi në terren të zbatimit të kontratës “Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore”, lidhur marrëveshje kuadër me nr. 1546/10, datë 18.06.2021, midis AQP/MSHMS dhe BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k., me përfaqësues “H. L.” Sh.p.k. me vlerën 216,842,640 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSH, rezultoi se: - Nga verifikimi i kontratës së lidhura nga Spitali Rajonal Shkodër dhe BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k. me nr. 1537, datë 05.07.2021 për vlerën 10,200,960 Lekë pa TVSH për 24 muaj 2021-2023 për pajisjen “Skaner”, rezultoi se: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve dhe procesverbaleve të mbajtura nga komisioni i marrjes në dorëzim pajisja ka qenë jashtë funksionit nga data 14.02.2023 deri me datën 09.03.2023, pra më shumë se 10 ditë pune.

	<p>- Nga verifikimi i kontratave të Lidhura nga Spitali Lezhe dhe BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k, me nr. 470/1 prot., datë 02.07.2021 për fondin 10,200,960 Lekë pa TVSH për 24 muaj (2021-2023) për pajisjet “Skaner” u konstatua se me procesverbalin e mbajtur me datë 25.09.2022, komisioni ka cituar që skaneri është jashtë funksionit, për shkak të mosfunksionimit së një llampë, i cili është vënë në funksion dhe riparuar nga OE me datën 26.10.2022.</p> <p>Në kriteret e veçanta të kualifikimit në ”specifikimet teknike” <i>shtojca 9 citohet se....”Kontraktuari duhet të sigurojë që pajisjet të mos qëndrojnë të difektuara për më shumë se 10 ditë zyrtare pune në vit”</i>.</p> <p>Sa më sipër veprimet janë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në DT dhe kontratës së lidhur neni 6 “Specifikimet teknike”.</p> <p>-Nga verifikimi i kontratës së lidhura nga Spitali Rajonal Shkodër dhe BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k me nr. 1538, datë 05.07.2021 për fondin 1,689,870 lekë pa TVSH me afat lëvrimi të nga data 05.07.2021-31.12.2021 dhe kontratës me nr. 580, datë 15.03.2022 për vlerën 2,731,956.5 Lekë pa TVSH me afat lëvrimi nga data 15.03.2022-31.12.2022, për pajisjet Angiograf/Hemodinamika, rezultoi se:</p> <p>- Për muajt 01.01.2022-15.03.2022 dhe 01.01.2023-01.03.2023 AK nuk ka pasur kontratë të lidhur me OE për mirëmbajtjen e pajisjeve, veprime në kundërshtim me Marrëveshjen kuadër me nr. 1546/10, datë 18.06.2021 e cila ka të bëjë me mirëmbajtjen 24 muaj të pajisjes pa shkëputje. Nga Spitali Rajonal Shkodër nuk ka shpenzime të tjera të paguara për këtë shërbim dhe asnjë procesverbal apo dokumentacion që të vërtetoje nëse pajisja ka funksionuar për këtë periudhë dhe nëse janë realizuar shërbimet e mirëmbajtjes nga OE sipas kushteve të marrëveshjes kuadër.</p> <p>Nga auditimi në terren të zbatimit të kontratës Lot 2: Pajisje mjekësore të prodhuesit Siemens “Mirëmbajtja e përqendruar “full risk” e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Siemens” me fond limit 178,438,321 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzetë e një) lekë pa TVSH. lidhur marrëveshje kuadër me nr. 1546/7 datë 15.06.2021, midis OQB/MSHMS dhe OE “M.” shpk rezultoi se:</p> <p>Nga verifikimi i kontratës së lidhura nga Spitali Shkodër dhe OE “M.” shpk, me nr. 1539, datë 05.07.2021 për vlerën 10,152,000 Lekë pa TVSH me afat lëvrimi të nga data 05.07.2021-04.07 për periudhën 26.11.2022-02.02.2023 2023 për pajisjen Magnetom Essenza/ Siemens nuk është mbajtur asnjë akt kolaudim. Nga Spitali Rajonal Shkodër nuk ka shpenzime të tjera të paguara për këtë shërbim dhe asnjë procesverbal apo dokumentacion që të vërtetoje nëse pajisja ka funksionuar për këtë periudhë dhe nëse janë realizuar shërbimet e mirëmbajtjes nga OE sipas kushteve të kontratës.</p>
Kriteri:	<p>- Dokumentet e tenderit;</p> <p>-Marrëveshje kuadër me nr. 1546/10, datë 18.06.2021 midis AQP/MSHMS dhe BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k</p> <p>Marrëveshje kuadër me nr. 1546/7 datë 15.06.2021, midis OQB/MSHMS dhe OE “M.”.</p>
Ndikimi/Efekti:	S’ka gjurmë nëse pajisja ka qenë në funksion.
Shkaku:	Mosplotësimi i kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen kuadër dhe specifikimeve të përcaktuar në DT.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masat në vijimësi

<p>që për marrëveshjet kuadër të lidhura për Spitalet Rajonale në përfundim të afatit të marrëveshjes të kërkojë nga njësitë raportet e monitorimit të zbatimit dhe të mbarëvajtjes së këtyre kontratave, me qëllim që minikontratat e lidhura nga këto njësi të mbulojnë të gjithë afatin kohor të parashikuara në këtë kontratë. Për mangësitë e konstatuara nga zbatimi i tyre si rrjedhojë e mosmarrjes së masave konkrete nga Spitalet Rajonale, MSHMS të ngarkojë me përgjegjësi personat, të cilët nuk kanë zbatuar kushtet e marrëveshjes dhe specifikimeve të përcaktuara në DT.</p>

Zbatimi i kontratës në Spitalin Rajonal Vlorë

Kontratat "Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore", Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ndarë në lote, (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot), parashikuar për 24 muaj” ku marrëveshja kuadër është lidhur nga AQP Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Pajisje mjekësore të prodhuesit Philips Lot 1, lidhur marrëveshje kuadër me nr. 1546/10, datë 18.06.2021, midis MSHMS dhe BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k., me përfaqësues “H. L.” Sh.p.k me vlerën **216,842,640 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSH.**

Nga verifikimi i kontratave të Lidhura nga Spitali Vlorë dhe BOE “H. L.” Sh.p.k. dhe “S. M.” Sh.p.k, me nr. 2435, datë 05.07.2021 për vlerën 10,200,960 Lekë pa TVSH për 24 muaj 2021-2023 për pajisjet “Skaner” dhe në vlerën 23,256,960 lekë për pajisjet “Rezonancë”, ku çdo muaj është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimit nga komisioni i ngritur nga titullari Institucionit me nr. 50, datë 08.01.2021 dhe nr. 1, datë 05.01.2022.

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se: Të gjithë urdhër shpenzimin kishin të bashkëlidhur akt kolaudimin dhe procesverbalet e mbajtura nga komisioni i ngritur nga Titullari për monitorimin dhe zbatimin e kontratës.

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve dhe procesverbaleve të mbajtura nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit u konstatua se:

Spitali Rajonal Vlorë me email-in e datës 17.03.2023 ka raportuar se ka patur probleme me funksionimin e kompjuterit të rezonancës, për të cilin OE ka kryer shërbimin e mirëmbajtjes brenda të njëjtës ditë. Gjithashtu në kërkesën me email-in e datës 29.03.2023, SRV ka raportuar se pajisja e skanerit CT ka probleme në funksionim, për të cilën operatori ekonomik ka kryer mirëmbajtjen brenda te njëjtës ditë.

Veprimet e mësipërme janë kryer në përputhje me **kriteret e veçanta të kualifikimit në “specifikimet teknike”** shtojca 9 citohet se...”*Kontraktuari duhet të sigurojë që pajisjet të mos qëndrojnë te difektuara për më shumë se 10 ditë zyrtare pune në vit*”.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje mjekësore për QKTRF”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje pajisje mjekësore për QKTRF”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” REF-06331-09-24-2021 Urdhri nr. 409, datë 21.09.2021.	1.1 Grupi i hartimit kriterëve kualifikuese Urdhri nr 149/1 datë 26.08.2021 prot. në MSHMS me nr. 3698, datë 07.09.2021 nga QKTRF.	2 Njësia e Prokurimit E. L. O. Dh. L. A.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr 409/1 datë 21.09.2021 J. J. L. P. E. H.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 4,989,366.67 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 2,787,000 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,202,367 lekë	

7/1 Data e hapjes së tenderit Data 24.09.2021	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 35 ditë		
10. Ankimime S'ka	11. Përgjigje Ankesës	12. Përgjigje .
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit		
13. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata mes QKTRF dhe "M." shpk datë 22.11.2021.	Zbatimi i kontratës: Nga QKTRF.	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me urdhrin e prokurimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 4,989,366.67 lekë pa TVSH, me objekt *"Blerje pajisje mjekësore për QKTRF"* dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga z. E. L., z. O. Dh. dhe znj. L. A.. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga znj. J. J., znj. L. P. dhe z. E. H.

Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Me urdhrin nr. 166, datë 07.09.2021 nga Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët është bërë kërkesë pranë MSHMS (prot., nr. 3698, datë 07.09.2021) për realizimin e procedurës *"Blerje pajisje mjekësore për QKTRF"*.

Bashkëngjitur është procesverbali i mbajtur me datën 01.09.2021 nga komisioni i ngritur në bazë të urdhrin nr. 149/1, datë 26.08.2021, ku janë përcaktuar specifikimet teknike të pajisjeve mjekësore objekt prokurimi, si dhe fondi limit në vlerën prej 4,989,366.37 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se përllogaritja e fondit limit është bërë për 8 artikuj mjekësore, nga ofertat e tre OE. QKTRF ka dërguar ftesën për ofertën e 5 OE për 11 artikuj. Nga titullari i MSHMS ka dalë urdhri i prokurimit nr. 409 datë 21.09.2021 prot., me nr.3896, datë 21.09.2021.

Kërkesa për blerje është bërë nga Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, ku kanë përcaktuar specifikimet teknike të pajisjeve mjekësore objekt prokurimi, si dhe fondi limit. NJ e ngritur nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS ka mbajtur procesverbalin me datën 24.09.2021, ku janë bërë ndryshime të specifikimeve teknike për artikullin:

Ishte

Body composition analyser (Peshore për matjen e indekseve trupore):

Kapaciteti: 300 kg, Gradimi: 100g.

Pajisur me të paktën dy ekran LCD.

Bëhet

Kapaciteti: 150 kg ose me shume, Gradimi: 100g.

Pajisur me të paktën një ekran LCD.

Sa më sipër NJP nuk ka marrë konfirmimin, nga QKTRF nëse specifikimet e rishikuara/modifikuara përmbushin qëllimin për të cilin nevojitet objekti i prokurimit i kërkuar veprime me nenin 67, pika 9 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*.

Pas ndryshimit të specifikimeve teknike të artikullit "Body composition analyser (Peshore për matjen e indekseve trupore)" NJP duhet të kishte bërë ripërllogaritjen e fondit limit.

NjP me datën 27.09.2021 ka mbajtur procesverbalin e argumentimit dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

Njoftimi i kontratës është bërë me shkresën nr. 3896/2, datë 24.09.2021, ku afati i hapjes së ofertave është data 07.10.2021.

AK në lidhje me Kapaciteti teknik kërkon:

Në shtojcën 5 *"Formulari i Specifikimeve Teknike"* të DST nga AK janë kërkuar "Specifikimi i

Materialeve” për 11 artikuj.

Ndërsa në shtojcën 6 “*Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit*”, numri i artikujve të kërkuar është tetë.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Shoqëria	Oferta Leke PA TVSH	Kualifikuar
1	M. shpk	2,787,000	Kualifikuar
2	B. A. shpk	3,970,000	Kualifikuar
3	E. shpk	4,285,215	S’Kualifikuar
4	A. shpk	0	S’Kualifikuar

Në zbatim të nenit 93 të LPP “Oferta anomalisht e ulët”, me shkresën nr. 3896/3, datë 13.10.2021 një anëtar i KVO-së i dërgon OE “M.” shpk sqarime në lidhje me ofertën dhe justifikimin e çmimeve, duke qenë se nga vlerësimi rezulton anomalisht e ulët, për të cilën nga KVO nuk është firmosur një procesverbal.

Nga dokumentacion fizik u konstatua se

Oferta e OE fitues ka qenë “Oferta anomalisht e ulët”, ku në zbatim të nenit 93 të LPP me shkresën nr. 3896/3, datë 13.10.2021 një anëtar i KVO-së i ka dërguar OE “M.” shpk sqarime në lidhje me ofertën dhe justifikimin e çmimeve, pas sqarimeve të marra nga OE, KVO i ka marrë si të argumentuara sqarimet dhe e ka shpallur fitues. Dokumentacioni i u vu ne depoziton grupit të auditimit pas konstatimit të situatës, pasi në dosjen fizike dhe në SPE nuk ka të bashkëngjitur kërkesa dhe sqarimi nga OE për ofertën anomalisht të ulët.

- Në dosje mungonte procesverbali i vlerësimit të ofertave të mbajtur nga KVO, i cili është dërguar nga KVO me observimin e datës 15.05.2023.

- Me raportin përmbledhës nr. 3896/4, datë 18.10.2021, miratohet procedura nga titullari i AK znj. G. P., ku është shpallur fitues OE “M.” shpk.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me datën 19.10.2021, prot., nr 3296/5, datë 19.10.2021.

MSHMS me shkresën nr. 3896/6, datë 28.10.2021 i dërgon dokumentacionin për lidhjen e kontratës QKTRF.

APP me shkresën nr. 7423/1, datë 06.12.2021, prot në MSHMS 3896/8, datë 09.12.2021, kthen përgjigje se njoftimi i kontratës së nënshkruar duhet të dërgohet në APP në SPE.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/50 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Ndryshimet e ndodhura ne pajisjen “Body composition analyser (Peshore për matjen e indekseve trupore)” është totalisht i papërfillshëm, përse i përket ndikimit të tij në fondin limit të procedurës, prandaj nuk ka pasur arsye për kryerjen e rillogaritjes së fondit limit.*

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka vepruar në cilësinë e Organit Qendor Blerës, por në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta për kryerjen e procedurës së prokurimit, për shkak të mungesës së kapaciteteve të institucionit, i cili ka fondet në dispozicion, pra QKTRF.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observimi juaj nuk merret në konsideratë. MSHMS është OQB dhe jo AK në këtë rast pasi buxheti është planifikuar nga QKTRF, specifikimet janë bërë nga QKTRF dhe kontrata është lidhur nga QKTRF.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “*F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore”.			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur” REF-07218-10-05-2021 Urdhri nr. 426, datë 04.10.2021.	1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese Urdhri nr 401 datë 15.09.2021 F. S.; R. M.; L. A. i ndryshuar me urdhërin 401/1 datë 21.09.2021 shtohet E. R. specialist fushe.	2 Njësia e Prokurimit A. A. E. Ll. F. S. E. R.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr 426/1, datë 04.10.2021, i ndryshuar me 426/2 datë 29.10.2021 O. Dh. N. C. O.A.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 18.760,000 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 12,800,000 lekë		6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,960,000 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Data 06.10.2021	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 6 b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 6 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 35 ditë			
10. Ankimime “S. M.” me shkresën nr. 4073/8 datë 08.11.2021.	11. Përgjigje Ankesës AK me shkresën nr. 4073/10 datë 22.11.2021, kthen përgjigje.		12. Përgjigje .
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit			
13. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata mes OE dhe “F.” shpk datë 19.11.2021.	Zbatimi i kontratës:		

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me urdhrin e prokurimit nr. 426, datë 04.10.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 18,760,000 lekë pa TVSH, me objekt “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore” dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga znj. A. A., z. E. Ll., znj. F. S. dhe z. E. R..

Komisioni i ngrituri titullari i AK përbëhet prej 4 anëtarësh, veprim në kundërshtim të VKM-së nr. 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” **pika 2** “Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor K.... njësinë e prokurimit. Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.....”.

Komisioni i vlerësimit të ofertave i ngritur me urdhrin nr. 426/1, datë 04.10.2021, i ndryshuar me urdhrin nr. 426/2 datë 29.10.2021 përbëhet nga z. O. Dh., znj. N. C. dhe z. O. A..

Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Me urdhërin nr. 401, datë 15.09.2021, i ndryshuar me urdhrin 401/1, datë 21.09.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS është ngritur grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit, përcaktimin e specifikimeve teknike, sasive, afatet e lëvrimit si dhe shpërndarjen për objektin “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore”.

Me shkresën nr. 3798/2 datë 21.09.2021 grupi i punës bën kërkesë për informacion në lidhje me nevojat e institucioneve për densitometrinë kockore.

Më shkresën nr. 3798/3, datë 24.09.2021 SP i kthen përgjigje grupit të punës se MSHMS ka çelur në investime për vitin 2021 zërin “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore” **bazuar në kërkesat e institucioneve:**

- Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1 Tiranë;
- Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 3 (Poliklinika Qendrore);
- Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.2, Tiranë;

- Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 4 Tiranë.

Me shkresën me nr. 3798/4, datë 24.09.2021 AK dërgon 6 OE kërkesën për paraqitjen e ofertave në lidhje me mallin, që do të prokurohet duke cituar dhe specifikimet teknike, me qëllim përlllogaritjen e fondit limit të procedurës.

Përcaktimi i “**Specifikimeve teknike: DEXA**” nuk është e dokumentuar se nga kush janë hartuar. Nga 6 OE të cilëve është dërguar oferta, vetëm 5 OE kanë kthyer përgjigje.

Nga grupi i punës me datën 29.09.2021 është mbajtur procesverbali i përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Çmimi për njësi i artikujve është përlllogaritur në vlerën 4,690,000 lekë pa tvsh.

Nga auditimi i dosjes fizike konstatohet se mungon deklaraten e konfliktit të interesit të grupi të punës veprime në kundërshtim me VKM-në 285 neni 13 “*Studimi paraprak i tregut*” pika 5 ku citohet se “*Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaraten për situatën e konfliktit të interesit*”.

MSHMS me shkresën nr. 3629, datë 30.08.2021 kërkon MEF transferimin e fondeve për blerjen “*F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore*” me arsyetimin se kjo pajisje është mungesë për poliklinikat e Tiranës dhe deri më sot ky shërbim është realizuar nga klinikat private.

MFE me shkresën nr. 15098/1, datë 16.09.2021 miraton transferimin e fondit për shpenzime kapitale të shumës 25 milion lekë nga projektet me kod 18BA610 “Rikonstruksioni i qendrave shëndetësore në qytete/njësi administrimi” dhe kod M133831 “Tvsh dhe detyrime doganore për projektin Cooperacionit Zviceran Grant”.

SP të MSHMS, me shkresën nr. 3876/1, datë 20.09.2021 miraton transferimin e shumës 25 milion lekë nga projektet e planifikuara në kod 18BA610 “Rikonstruksioni i qendrave shëndetësore në qytete/njësi administrimi” dhe kod M133831 “Tvsh dhe detyrime doganore për projektin Cooperacionit Zviceran Grant” të fondeve të investimeve 2021-2023, bazuar në shkresën e miratimit nga MFE.

Me shkresën nr. 15098/2, datë 04.10.2021 thesari i kthen përgjigje MSHMS për autorizimin e pakësimit dhe shtesës në zërin “Shpenzime Kapitale” të cilat duhet të bëhen në muajin përkatës.

- Urdhri i prokurimit ka dalë me datën 04.10.2021, ndërsa regjistrimi në SIFQ është bërë me datën 28.12.2021 veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” pikat 36-38; Udhëzimit nr.9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-155.

NJP me datën 06.10.2021 ka mbajtur procesverbalin e argumentimit dhe miratimit e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Njoftimi i kontratës është bërë me shkresën nr. 3896/2 datë 24.09.2021, ku afati i hapjes së ofertave është data 22.10.2021.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Shoqëria	Oferta Leke PA TVSH	Kualifikuar
1	F.sh.p.k	12,800,000	Kualifikuar
2	S. sh.p.k	14,120,000	Kualifikuar
3	B. A. sh.p.k	14,775,000	Kualifikuar
4	M. D. sh.p.k	14,900,000	Kualifikuar
5	B. E.sh.p.k	15,395,000	Kualifikuar
6	E. sh.p.k	16,490,000	Kualifikuar

Pas vlerësimit të ofertave u konstatua se nga KVO nuk është mbajtur procesverbal i vlerësimit të ofertave. Grupit të auditimit pas konstatimit dhe komunikimit KVO ju vu në dispozicion një procesverbal i cili ishte i pafirmosur nga grupi.

- Me raportin përmbledhës nr. 4073/6, datë 02.11.2021, miratohet procedura nga titullari i AK znj. G. P., ku është shpallur fitues OE “F.” shpk.

Raporti përmbledhës është hartuar që nga faza e argumentimit të specifikimeve deri tek kualifikimi i OE, të cilët kanë marrë pjesë në tender.

Veprime në kundërshtim me nenin 84 “Raporti përmbledhës” ku përcaktohet:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor”.

Pika 2 Raporti përmbledhës duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- përshkrimin e punëve/ mallrave/shërbimeve;
- respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave;
- çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës;
- korigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla);
- të dhënat e ofertuesve të s’kualifikuar, ofertën ekonomike dhe arsyet e s’kualifikimit;
- të dhënat e ofertuesve të kualifikuar, ofertën ekonomike të tyre;
- informacion për hedhjen e shortit (nëse ka pasur oferta me vlerë të njëjtë);
- të dhënat e ofertuesit fitues;
- informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me datën 02.11.2021, prot., nr. 4073/7, datë 02.11.2021.

“S. M.” me shkresën nr. 4073/8 datë 08.11.202, kërkon një sqarim nga KVO nëse OE fitues e plotëson kriterin e specifikimit teknik:

2D fan bean dhe HL7, pasi çmimi i ofruar nga OE është për pajisjen e vjetërsuar “Pencil Bean”.

AK me shkresën nr. 4073/10, datë 22.11.2021 kthen përgjigje OE “S. M.” me arsyetimin se janë kualifikuar të gjithë OE të cilët kanë marrë pjesë, dhe duke mos pasur asnjë ankesë në lidhje me vlerësimin brenda afateve ligjore oferta më e ulët është shpallur fitues, i cili plotëson të gjitha specifikimet teknike.

Me datën 12.11.2021 nga KVO është mbajtur procesverbali i pranimit të dokumentacionit.

Mes AK dhe OE fitues “F.” shpk është lidhur kontrata me nr. 4073/9 datë 19.11.2021, ku është tjetërsuar destinacioni i pajisjeve objekt prokurimi.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar është firmosur me shkresën nr. 4073/12, datë 26.11.2021 dhe ngarkuar me darën 01.12.2021.

Zbatimi i kontratës:

Mes AK dhe OE fitues “F.” shpk është lidhur kontrata me nr. 4073/9 datë 19.11.2021, ku është tjetërsuar destinacioni i pajisjeve objekt prokurimi.

Procedura e prokurimit është realizuar për blerjen e “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore” mbi bazën e të kërkesave të paraqitura nga

- Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1 Tiranë;
- Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 3 (Poliklinika Qendrore);
- Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.2, Tiranë;
- Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 4 Tiranë.

Përpara lidhjes së kontratës mes OE dhe AK nga një e-mail i dërguar më 16.11.2021 është kërkuar nga Kabineti ndryshimi i destinacionit të pajisjeve nga qendrat e mësipërme për:

- Spitalit Rajonal Shkodër
- Spitalit Rajonal Vlorë
- QSH Specialisteve nr. 3 (Poliklinika Qendrore) Tiranë
- QSUT “Nënë Tereza” Tiranë

Sa më sipër veprime në kundërshtim me:

- Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Neni 3 ku citohet ... “Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Funkionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetence drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.”

- DST Shtojca 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”.

- Udhëzimit nr. 9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 64, si dhe paragrafi III ‘Procedurat për kryerjen e shpenzimeve’, pasi këto njësi nuk e kanë pasë të planifikuar nevojën për këto aparatura dhe s’ka as kërkesë të bërë nga këto spitale për nevojat për këtë pajisje.

Me urdhër nr. 503, datë 26.11.2021 (prot., 4073/11, datë 26.11.2021) AK ka ngritur grupin për mbikëqyrjen e kontratës “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore” në përbërje të të cilit janë :

- znj. L.P.

- z. H. T.

- znj. R. M.

MSHMS me shkresën nr. 4073/13, datë 26.11.2021 ka dërguar për zbatim kontratën e lidhur me OE, “F.” shpk drejtuar:

- Spitalit Rajonal Shkodër

- Spitalit Rajonal Vlorë

- QSH Specialisteve nr. 3 (Poliklinika Qendrore) Tiranë

- QSUT “Nënë Tereza” Tiranë

Me urdhër shpenzimin nr. 966, datë 31.12.2021 është bërë likuidimi i OE për faturën nr.199/2021, datë 22.12.2021 në shumën prej 15,360,000 lekë.

- QSUT “Nënë Tereza” shkresën me nr. 3037/6, datë 29.12.2021 (prot., 4073/15, datë 29.12.2021) ka dërguar materialin e marrjes në dorëzim “të pajisjes për matjen e densitometrisë kockore” të marrë nga grupi i ngritur me urdhrin e Drejtorit të QSUT nr. 600, datë 14.12.2021.

Pajisja është marrë në dorëzim me datën 22.12.2021, bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 174, datë 22.12.2021.

- Spitalit Rajonal Shkodër shkresën me nr. 2860/4, datë 22.12.2021 (prot., 4073/16, datë 28.12.2021) ka dërguar materialin e marrjes në dorëzim “Të pajisjes për matjen e densitometrisë kockore” të marrë nga grupi i ngritur me urdhrin e Drejtorit të Spitalit nr. 210, datë 21.12.2021.

Pajisja është marrë në dorëzim me datën 22.12.2021, bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 9, datë 22.12.2021.

- QSH Specialisteve nr. 3 (Poliklinika Qendrore) Tiranë me shkresën me nr. 315, datë 22.12.2021 (prot., 4073/18, datë 28.12.2021) ka dërguar materialin e marrjes në dorëzim “të pajisjes për matjen e densitometrisë kockore” të marrë nga grupi i ngritur me urdhrin e Drejtorit me nr. 11, datë 22.12.2021. Pajisja është marrë në dorëzim me datën 22.12.2021, bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 32, datë 22.12.2021.

- Spitali Rajonal Vlorë ka marrë në dorëzim pajisjen “DEXA Model primus SN: M2100121 Prodhues O. C., Kore” me procesverbalin e datës 22.12.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim të ngritur me urdhër të titullarit të Spitalit Rajonal Vlorë me nr. 4916, datë 02.12.2022 pajisja është bërë hyrje me fletë hyrjen nr.3 datë 22.12.2021 në vlerën 3,840,000 lekë.

Titulli i Gjetjes:	F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore”.
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit <i>F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore</i> ” u konstatua se: - Urdhri i prokurimit për realizimin e procedurës ka dalë me datën 04.10.2021, ndërsa regjistrimi në SIFQ është bërë me datën 28.12.2021 veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” pikat 36-38;

	<p><i>“Institucionet buxhetore, te cilat operojnë direkt ne SIFQ, regjistrojnë ne sistem çdo vlere prokurimi te përcaktuar ne planin e miratuar te prokurimeve te institucionit dhe pasi marrin numrin unik te regjistrimit ne SIFQ, procedojnë me dërgimin ne Agjencinë e Prokurimeve Publike. Te gjithë urdhrat e prokurimit që nxirren gjate vitit për mallrat, shërbimet dhe investimet duhet te paraqiten ne degën e Thesarit, se bashku me ftesën për prokurim, te cilat duhet: (i) t'i përmbahen listës se prokurimeve te dorëzuar ne Thesar. (il) te kontrollohen për përputhshmëri me regjistrin e prokurimeve dhe te vulosen nga dega e Thesarit, përpara procedimit, sipas rregullave te prokurimit publik” dhe Udhëzimit nr.9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-155.</i></p> <p>- Përpara lidhjes së kontratës mes OE dhe AK nga një e-mail i dërguar më datë 16.11.2021 është kërkuar nga Kabineti ndryshimi i destinacionit të pajisjeve nga qendrat e përcaktuara në DT për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Spitalit Rajonal Shkodër - Spitalit Rajonal Vlorë - QSH Specialisteve nr. 3 (Poliklinika Qendrore) Tiranë - QSUT “Nënë Tereza” Tiranë <p>Sa më sipër veprime në kundërshtim me:</p> <p>- Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Neni 3 ku citohet ... <i>“Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike te ministrisë. Funksionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetence drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.”</i></p> <p>- DST Shtojca 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”.</p> <p>- Udhëzimit nr. 9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 64, si dhe paragrafi III ‘<i>Procedurat për kryerjen e shpenzimeve</i>’, pasi këto njësi nuk e kanë pasë të planifikuar nevojën për këto aparatura dhe nuk ka as kërkesë të bërë nga këto spitale për nevojat për këtë pajisje.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 162/2020 “<i>Për prokurimin publik</i>” i ndryshuar, neni 93. - VKM-së nr.285 datë 19.5.2021“<i>Për miratimin e rregullave të prokurimit</i>”, i ndryshuar neni 82; - Dokumentet e tenderit; - Procesverbalet e KVO-së.
Ndikimi/Efekti:	<p>Mosplotësimi i nevojave të njëjësive sipas kërkesave të bërë dhe të planifikuar. Shkelja e ligjeve dhe udhëzimeve për planifikim dhe zbatim buxheti.</p> <p>Kërkesa për ndryshim destinacioni është bërë nga person, të cilët nuk kanë kompetence drejtuese ose administrative.</p>
Shkaku:	<p>Në DT është vënë një paragraf ku thuhet se përpara lidhjes së kontratës mund të ndryshojë destinacioni i pajisjeve.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandimi:	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Njësia përgjegjëse për prokurimet të marrë masë në vijimësi që përpara realizimit të çdo procedurë prokurimi, të regjistrojnë ne sistem SIFQ çdo vlere prokurimi te përcaktuar ne planin e miratuar te prokurimeve te institucionit dhe pasi marrin numrin unik te regjistrimit ne SIFQ, të fillojë me procesin e prokurimit.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masë në vijimësi që destinacioni final i mallrave/shërbimeve dhe punëve që prokurohen të</p>

	<p>jetë në përputhje me DT dhe me kërkesat të cilat janë planifikuar që në PBA dhe në planin vjetor nga njësitë.</p> <p>Nëse për kërkesa emergjente kërkohet ndryshimi i destinacionit, të merren masa për argumentimin me dokumentacione bashkëngjitur, si dhe miratimi i ndryshimit të bëhet nga NA i Institucionit dhe jo nga persona që s'kanë "asnjë kompetence drejtuese ose administrative mbi stafin ministror".</p>
--	--

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe marrja në dorëzim të pajisjes, nga Spitalet Rajonale Shkodër dhe Vlorë.

Titulli i Gjetjes:	Zbatimi i kontratës "F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore".
Situata:	<p>Nga auditimi në terren të zbatimit të kontratave me nr. 4073/9, datë 19.11.2021 "F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore" lidhur mes AK/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe OE "F." shpk, për procedurën e prokurimit <i>F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore</i> në spitalin Rajonal Shkodër u konstatua se:</p> <p>Spitali Rajonal Shkodër ka marrë në dorëzim pajisjen "DEXA Model primus SN: M2100121 Prodhues O. C., K." me procesverbalin e datës 22.12.2022, nga komisioni i marrjes në dorëzim të ngritur me urdhër të titullarit të Spitalit Rajonal Shkodër me nr. 210, datë 21.12.2022. pajisja është bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 22.12.2021 në vlerën 3,840,000 lekë.</p> <p><i>Nga verifikimi në vend i pajisjes rezultoi se:</i></p> <p>Në referencat që kishte pajisja e montuar citohej se</p> <ul style="list-style-type: none"> - X-Ray Generation prodhues ishte "P. Co., Ltd." i cili është jo në përputhje me dokumentacionet e dorëzuara nga OE në ofertë në të cilën ka marrë autorizimin e prodhuesit të pajisjeve nga "O.Co., Ltd" dhe katalogu i paraqitur është për Primus po nga i njëjti prodhues. - Ray Tube "Maximume tube current" ishte 30mA, ndërsa nga OE në katalogun e dorëzuar në ofertë ky kriter "Maximume tube current" ishte 25mA. - Printeri i marrë nga OE "HP DeskJet 2320 All-in-One Printer (7WN42B)" ishte në kapacitete të vogla printimi "Duty cycle (monthly, A4): Up to 1000 pages" , si dhe "Print speed: Print speed up to 7.5 ppm (black) and 5.5 ppm (colour) 2" dhe " Scan resolution, optical: Up to 1200 dpi" ishte shumë i vogël për të pas një ndërlidhje optimale me DEXA-an. - Referuar DT, në pikën 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 11 "Vetëdeklarate" ku kërkohet që OE "Merr përsipër trajnimin e dy personave (mjekë dhe teknikë) për çdo pajisje" nga auditimi u konstatua se nga Spitali Rajonal Shkodër nuk kishte të dokumentuar me procesverbal trajnimin e stafit nga OE për përdorimin e aparaturës së marrë në dorëzim. Pikë e parealizuar nga OE. - Pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore ishte e instaluar në "Poliklinikën e Shkodrës". <p>Transferimi kapital i pajisjes nga Spitali Shkodër në Poliklinikën e Shkodrës nuk kishte dokumentacion transferimi, veprim në kundërshtim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>" pika "<i>Transportimi i aktiveve</i>".</p> <p>Nga auditimi fizik i pajisjes së vendosur në Spitalin Rajonal Vlore për të njëjtën kontratë me nr. 4073/9, datë 19.11.2021 të lidhur nga NSHMS dhe</p>

	OE, u konstatuan të njëjtat problematike në lidhje me referencat që kishte pajisja e montuar dhe Printeri i marrë nga OE “HP DeskJet 2320 All-in-One Printer (7wN42B)”.
Kriteri:	- Dokumentet e tenderit; - Kontrata me nr. 4073/9, datë 19.11.2021 e lidhur mes AK/Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe OE “F.” Shpk.
Ndikimi/Efekti:	Mos verifikimi e elementeve të pajisjes, të cilat rezultojnë jo në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DT dhe kontratë mund të ndikojë në cilësinë e shërbimit që ajo ofron.
Shkaku:	Mosplotësimi i specifikimeve dhe kriterëve të përcaktuar në DT.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa në vijimësi, që përpara se të japë aprovimin për likuidimin e kontratave të mallrave/shërbimeve/punëve të cilat merren në dorëzim nga njësitë e vartësisë, të kërkohet që nga grupi i mbikëqyrjes ngritur me urdhrin e NA të MSHMS, të dokumentohet verifikimi fizik se mallrat/shërbimet/punët e marra nga njësitë e vartësisë janë në përputhje me kontratat e lidhura dhe me specifikimet e përcaktuara në DT.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/52 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Përcaktimi i “**Specifikimeve teknike: DEXA**” është hartuar nga një grup ad hoc të cilat janë përpiluar duke respektuar rregullat e LPP, nisur nga kërkesat klinike të patologjive që diagnostikohen nga DEXA.
2. Në lidhje me deklaratën e konfliktit të interesit nuk kanë qene të aksesueshme në datën e zhvillimit të tenderit, pasi janë publikuar nga APP me udhëzimin nr. 1, datë 21.01.2022.
3. Bazuar në Njoftimin e përbashkët të MFE dhe APP me nr 23177/1 prot., datë 28.12.2021 dhe nr.7951 prot, datë 29.12.2021, drejtuar Autoriteteve Kontraktore, në eëë.app.gov.al, nga data 01.02.2022 do të vijoje procesi integritetit të SPE me AFMIS për AK sipas listës bashkëlidhur.
4. Në material është cituar kushti :AK rezervon të drejtën të rishikojë vendodhjen e objektit të kontratës deri në momentin përpara lidhjes së kontratës” vendosur dhe në shtojcën 6 të DST.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Observimi juaj nuk merret në konsideratë pasi nuk ka asnjë gjurmë auditimi se ku është bazuar vendosja e specifikimeve teknike për aparaturën, studimi që është bërë nga ana juaj që këto specifikime plotësojnë kërkesat e shërbimit nga aparatura.
2. Observimi juaj nuk merret në konsideratë, pasi konflikti i interesit është detyrim ligjor bazuar në ligjin e konfliktit të interesit si dhe të ligjit të prokurimit publik.
3. Observimi juaj nuk merret në konsideratë, pasi veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 5, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” pikat 36-38; Udhëzimit nr.9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-155.
4. Observimi juaj nuk merret në konsideratë pasi: planifikimi për blerje është bërë mbi bazat e një studimi dhe nevojave të qendrave, Ndryshimi është bërë mbi bazën e një e-mail i dërguar më 16.11.2021, i cili është kërkuar nga Kabineti i cili është në kundërshtim të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Titulli i Gjetjes:	Përkthimi i dokumenteve të tenderit.
Situata:	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, për të cilat AK ka hartuar dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht, u konstatua se: - Përkthimi i dokumentacionit është bërë pa realizuar asnjë procedurë paraprake blerje të vogël por është bërë blerje e drejtpërdrejtë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” neni 1 pika 2 “Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të

	mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike”, neni 3 pika 2 “Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën” dhe neni 7 ku specifikohen përjashtimet e veçanta.
Kriteri:	Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” neni 1 pika 2 dhe neni 3 pika 2; neni 56 pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Kufizim pjesëmarrje të personave të licencuar.
Shkaku:	Nga AK/MSHMS ky shërbim është vlerësuar si ndihmë juridike.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit pranë MSHMS të marrë masa në vazhdimësi për planifikimin e shërbimit të përkthimit në regjistrin e procedurave të prokurimit, kur nga AK ka të planifikuar procedura të cilat janë mbi kufirin e lartë monetar dhe që kërkohet hartimi i dokumenteve të tenderit në anglisht, si dhe të realizojë procedure prokurimi për përzgjedhjen e përkthyesit.

Titulli i Gjetjes:	Mangësitë në dokumentacionin e NJP.
Situata:	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt:</p> <p>- <i>“Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore”</i> u konstatua se:</p> <p>Kriteret në lidhje me Kapacitetet teknik në pikën 3.3 pika 3 nga AK është kërkuar <i>“Të ketë të paktën një inxhinier për mirëmbajtjen e aparaturave objekt te këtij prokurimi. Për këtë duhet të paraqiten CV e specialistit dhe certifikatat/dëshmitë e trajnimit lëshuar nga kompania prodhuese”</i>.</p> <p>Sa mësipër kriteri i vendosur është i pa plotë pasi nga AK nuk është vendosur profili i inxhinierit që AK kërkon/pranon e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton profilin e inxhinierit veprime jo në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenit 28 “Kontratat e shërbimeve” pika 2 ku citon se...”<i>Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”</i>.</p> <p>Në pikën 3.3 Kapaciteti teknik pika 8 nga AK është kërkuar <i>“Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import, eksport, tregtim të pajisjeve mjekësore dhe mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”</i>. Kërkesa e mësipërme <i>“....për import, eksport, tregtim..”</i> nuk përputhet me objektin dhe natyrën e kontratës.</p> <p>- <i>“Blerje pajisje mjekësore për QKTRF”</i> u konstatua se:</p> <p>NJP e ngritur nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS ka mbajtur</p>

	<p>procesverbalin me datën 24.09.2021, ku janë bërë ndryshime të specifikimeve teknike për artikullin: Ishte: Body composition analyser (Peshore për matjen e indekseve trupore) : <i>Kapaciteti: 300 kg, Gradimi: 100g.</i> <i>Pajisur me të paktën dy ekran LCD.</i> Bëhet: Kapaciteti: 150kg ose me shume, Gradimi: 100g. <i>Pajisur me të paktën një ekran LCD.</i> Sa më sipër NJP nuk ka marrë konfirmimin, nga QKTRF nëse specifikimet e rishikuara/modifikuara përmbushin qëllimin për të cilin nevojitet objekti i prokurimit i kërkuar, veprime në kundërshtim me nenin 67, pika 9 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Pas ndryshimit të specifikimeve teknike të artikullit “Body composition analyser (Peshore për matjen e indekseve trupore)”. NJP nuk ka rishikuar përlllogaritjen e fondit limit. - “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore” u konstatua se: - Përcaktimi i “Specifikimeve teknike: DEXA” nuk është e dokumentuar se nga kush janë hartuar. - Nga auditimi i dosjes fizike konstatohet se mungon deklaratën e konfliktit të interesit të grupi të punës veprime në kundërshtim me VKM-në 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 13 “<i>Studimi paraprak i tregut</i>” pika 5 ku citohet se “<i>Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësishtë çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit</i>”. - Komisioni i ngrituri titullari i AK përbëhet prej 4 anëtarësh, veprim në kundërshtim të VKM-së nr. 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “<i>Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit</i>” pika 2 “<i>Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor K.... njësinë e prokurimit. Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.....</i>”. - “<i>B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike</i>” u konstatua se: Komisioni i ngrituri titullari i AK përbëhet prej 4 anëtarësh, veprim në kundërshtim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “<i>Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit</i>” pika 2 “<i>Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor K.... njësinë e prokurimit. Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.....</i>”.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 28 pika 2 dhe 26, pika 5. VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Neni 67, pika 9.</p>

	Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e gjurmëve të auditimit, e cila informon mbi: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; etj nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi (çdo procedure prokurimi).
Shkaku:	Dokumentimi i procedurave jo në përputhje me parashikimet e LPP dhe VKM-së " <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ".
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve/punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në dokumentimin e saktë të veprimtarisë së KVO gjatë shqyrtimit të ofertave.
Situata:	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt:</p> <p><i>"Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore"</i> u konstatua se:</p> <p>Nga KVO është kërkuar sqarim BOE, me shkresën, e cila nuk ka numër protokollit dhe datë, për sqarim në lidhje me sigurimin e ofertës ku i është lënë afat deri me datën 21.05.2021. Edhe në SPE nuk gjendet kërkesa e drejtuar OE për sqarim. Me datën 19.05.2021 është sjellë nga BOE "H. L." Sh.p.k. dhe "S. M." Sh.p.k., dokument sqarimi, e cila është pa numër protokollit dhe pa datë, se kur është administruar nga MSHMS, ndërsa sigurimi i ofertës është lëshuar me datën 20.05.2021, shkresë e cila nuk përkon me sqarimet e kërkuar nga AK, pasi me datën 21.05.2021, kur është mbajtur procesverbali nga KVO nuk ka qenë dokument i administruar, pasi anëtarët e KVO janë shprehur se BOE nuk e plotëson këtë kriter.. Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO është që nga faza e argumentimit të specifikimeve deri tek kualifikimi i OE, të cilët kanë marrë pjesë ne tender. Veprime në kundërshtim me nenin 84 "<i>Raporti përmbledhës</i>" ku përcaktohet: "<i>Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor</i>".</p> <p>- "<i>F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore</i>" u konstatua se:</p> <p>Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO është që nga faza e argumentimit të specifikimeve deri tek kualifikimi i OE, të cilët kanë marrë pjesë ne tender. Veprime në kundërshtim me nenin 84 "<i>Raporti përmbledhës</i>" ku përcaktohet: "<i>Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor</i>".</p>
Kriteri:	Ligji nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar; VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit

	publik”, neni 28 pika 2 dhe 26, pika 5. VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Neni 67, pika 9.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e gjurmëve të auditimit, e cila informon mbi, përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit.
Shkaku:	Dokumentimi i procedurave jo në përputhje me parashikimet e LPP dhe VKM-së “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

4. “*BI-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezë Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut*”, ndarë në 113 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 4,363,587,524 (katër miliard e treqind e gjashtëdhjetë e tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e katër) Lekë pa TVSH.

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Me urdhrin nr. 480, datë 05.11.2021, nr.4539 prot., të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS-së është ngritur grupi i punës “Për përlloraritjen e vlerës së pritshme të kontratave dhe përcaktimin e mënyrës dhe afateve që do ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqëndruara të prokurimit publik për barna për llogari të spitaleve publike për mbulimin e nevojave 24 mujore nga organi qendror blerës”, i ndryshuar me urdhrin nr. 115, datë 15.02.2022, “Për një ndryshim në urdhrin nr.480” ku ngarkohet grupi i punës të aplikojë çmimin CIF të miratuar për vitin 2022 sipas rastit a) çmimin e miratuar nga KÇB për barnat që janë alternative e vetme e pajisur me autorizim për tregtim në territorin e Republikës së Shqipërisë, b) çmimin mesatar për barnat e tjera me më shumë se një regjistrim c) çmimin mesatar të autorizimeve të importit të lëshuara në vitet 2019-2020-2021 për barnat e paregjistruara duke shtuar marzhin e tregtimit bazuar në vendimin nr.143 datë 18.02.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e marzhit të fabrikimit dhe tregtimit të barnave” për secilin bar me formë dozën përkatëse, si dhe urdhërin nr, 402, datë 07.07.2022, ku ndryshohet z. K. D. me znj. B. H. e pas pikës 11 në Urdhrin nr. 480, datë 05.11.2021 (protokolluar me nr. 4539 Prot., date 05.11.2021) i ndryshuar, shtohet pika 12 me përmbajtje si vijon: *Grupi i punës, përpara se të fillojë në procedurë të re prokurimi, analizon shkaqet që çuan në dështimin e procedurës/ave dhe nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim nga grupi i punës”.*

Në pikën 8-të të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS-së nr. 480, date 05.11.2021 është përcaktuar si afat përfundimtar për dërgimin e relacionit përmbledhës nga grupi i punës, data 10 Dhjetor 2021.

Rezultoi se Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", nuk kishte dërguar kërkesat për materiale mjekimi brenda afatit. Për këtë arsye grupi i punës ishte pengua në vijimin e zbatimit të detyrave të cituara në pikën 4 të urdhrit dhe me konkretisht për:

- përcaktimin dhe miratimin e listës pasi nuk kishte ende planifikimin e QSUT, institucionit kërkesat e te cilit zënë peshën specifike me të madhe ne artikuj.
- përlloraritjen e fondit limit pasi në mungesë të planifikimit të QSUT si institucionit që zë peshën specifike me te madhe ne sasi dhe fond, nuk mund te konkludojmë mbi nevojat totale sasiore për 24 muaj për materiale mjekimi.

Te ndodhur në këto kushte, ju lutemi na udhëzoni për vijim e mëtejshëm të punës për përlogaritjen në vlerave të pritshme të kontratave të furnizimit për mbulimin e nevojave 24 mujore për materiale mjekimi për llogari të spitaleve publike.

Nga grupi i punës i përbërë nga znj. F. B., znj. N. A., z. K. D. është mbajtur procesverbali datë 17.03.2022 prot., 788/32, datë 18.03.2022 ku është përcaktuar lista e barnave që prokurohet dhe çmimi për njësi i tyre.

Me shkresën e SP të znj. G. P. me nr. 788/32 prot., datë 18.03.2023 drejtuar sektorit të prokurimeve i kërkohet marrja e masave të menjëhershme për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Sekretari i Përgjithshëm me datë 14.02.2022 nënshkroi kontratën nr.793 prot., me z. Th.K., person fizik me NUIS L.....A bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave nr.3165 datë 12.05.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët. Me urdhrin nr. 166 datë 01.03.2022 nr.793/1 prot., urdhërohet përkthimi i dokumenteve standarde të procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar gjatë vitit 2022 në gjuhën angleze. Përkthimi i tyre është bërë pa u zhvilluar më parë një procedurë prokurimi.

Konstatimi:

Përkthimi i dokumentacionit është bërë pa realizuar asnjë procedurë paraprake blerje të vogël por është bërë blerje e drejtpërdrejtë në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” neni 1 pika 2 “*Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike*”, neni 3 pika 2 “Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën” dhe neni 7 ku specifikohen përjashtimet e veçanta.

- “B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut”, ndarë në 113 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 4,363,587,524 (katër miliard e treqind e gjashtëdhjetë e tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e katër) Lekë pa TVSH.

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut”, ndarë në 113 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 4,363,587,524 (katër miliard e treqind e gjashtëdhjetë e tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e katër) Lekë pa TVSH.

1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufijtë e lartë monetarë” nr.203/3, datë 28.04.2022	2. Grupi i hartimit të përlogaritjes e vlerës së pritshme të kontratave Urdhri nr.480 datë 05.11.2021 F. B., K. D., N. A.,	3.Njësia e Prokurimit Urdhër nr.203 datë A. A., E. L., L.A., K. D. V. Dh. e ndryshuar me L. C..	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.203/2, datë 14.04.2022, i ndryshuar me Urdhërin nr. 203/6 datë 16.05.2022 M. K. E. H. M. K.
5. Data e hapjes së Ofertave Data 30.06.2022	6. Fondi Limit (pa tvsh) 4,363,587,524 lekë 113 Lote		
7. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit			

Me urdhrin nr.203/2 , datë 14.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, caktohet komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga znj. J. D. - kryetar, z. E. H. - anëtar, znj. M. K. – anëtar i cili me urdhrin nr. 203/6 datë 16.05.2022 ndryshoi dhe kryetar u emërua znj. M. K..

Nga auditimi i Dokumenteve të Procedurës nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Njësia e Prokurimit me datën 29.04.2022 ka mbajtur procesverbalin e argumentimit dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për 113 lote, ku një prej anëtarëve nuk i ka nënshkruar.

Njoftimi i kontratës është bërë me shkresën nr. 1532/4 prot., datë 29.04.2022, ku afati i hapjes së ofertave është data 03.06.2022. Njoftimet është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 59, datë 09.05.2022 fq.19 e vijuese. DST është publikuar në gjuhë shqip dhe anglisht.

Me njoftimin nr.1532/30 prot., datë 02.06.2022 është realizuar ndryshimi i dokumenteve të procedurës për Lot 21, 40, 71.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Grupi i auditimit përzgjodhi për auditim 6 lote bazuar në vlerën më të lartë të fondit limit të përlogaritur si dhe ku oferta kishte diferencë të madhe me fondin limit.

Procedura u hap me datë 03.06.2022. Me shkresën nr.1532/81 datë 15.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm është miratuar raporti përmbledhës i Komisioni të Vlerësimit të Ofertave.

Nga auditimi i tyre u konstatua si vijon:

- **Lot 3 “OXYGEN”** gaz, Gaz për përdorim mjekësor, i kompresuar x 100%, sasia e planifikuar 8,414,179 litra, REF-26428-04-26-2022, me fond limit 290,794,011 lekë pa tvsh.

Në procedurë ka marrë pjesë vetëm BOE:

BOE: G.G.T.Sh.sh.p.k me NUIS J...B dhe me adresë Fabrika Qelqit, Tiranë, M. A. shpk me NUIS K...F dhe me adresë Tiranë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 4.5 me përfaqësues me prokurë të posaçme BOE G.-G. T. Sh. sh.p.k, vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 290,289,175.5 (dyqind e nëntëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë.5) lekë pa TVSH i cili rezultoi se i plotësonte kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

Me shkresën nr.1532/75 datë 08.07.2022 është hartuar njoftimi i fituesit pas afatit të ankimit.

- **Lot 4 “OXYGEN”** lëng, Gaz për përdorim mjekësor, i lëngshëm x 100% , sasia e planifikuar 12,774,552 litra, REF-26430-04-26-2022, me fond limit 1,624,926,540 lekë pa tvsh.

Në procedurë ka marrë pjesë vetëm BOE:

BOE: G.-G. T. Sh. sh.p.k me NUIS J.....B dhe me adresë Fabrika Qelqit, Tirane, M.A. shpk me

NUIS K...F dhe me adresë Tiranë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 4.5 me përfaqësues me prokurë të posaçme BOE G.-G. T. Sh. sh.p.k, vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme): 1,622,368,104 (një miliard e gjashtëqind e njëzetë e dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e katër) lekë pa TVSH i cili rezultoi se i plotësonte kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

Me shkresën nr.1532/75 datë 08.07.2022 është hartuar njoftimi i fituesit pas afatit të ankimit.

- **Lot 12 “Cefepime”** 1 gr, Flakon/ Flakon + ampule (hollues) , sasia e planifikuar 86,338 flakona, REF-26446-04-26-2022, me fond limit 61,250,210 lekë pa tvsh.

Në procedurë kanë marrë pjesë dy BOE:

1. **BOE I. shpk** me NUIS K...T dhe me adresë Tiranë Vaqarr LALM Zona Kadastrale ..., Nr. pasurie ...ND dhe, **C. P. shpk** me NUIS K...U dhe me adresë Tiranë Kashar Mezez, Rruga Pavarësia, Ndërtesa nr 1, dhe **E. – F. shpk** me NUIS K...T dhe me adresë Tiranë Ish Kombinati Josif Pashko, Laprake, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga I... shpk ofertuar në vlerën 60,868,290.00 (gjashtëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh i cili rezultoi se i plotësonte kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.
2. **R. F. shpk** me NUIS J...U dhe me adresë Tiranë Vorë Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, (pranë nënkallimit të autostradës), nr.1 ofertuar në vlerën 61,040,966.00 (gjashtëdhjetë e njëmilion e dyzet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh i cili rezultoi se i plotësonte kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

Me shkresën nr.1532/86 datë 15.07.2022 është hartuar njoftimi i fituesit pas afatit të ankimit ku fitues shpallet BOE I. shpk me NUIS K...T, C. P. shpk e E. – F. shpk me NUIS K...T.

- **Lot 15 “Ceftriaxone”** 1 gr, Flakon/ Flakon + ampule (hollues), sasia e planifikuar 1,048,411 flakona, REF-26452-04-26-2022, me fond limit 302,132,979 lekë pa tvsh.

Në procedurë kanë marrë pjesë tre operatorë ekonomikë:

1. **M. S. shpk** me NUIS K...C dhe me adresë Lagjia Katund i Ri, Njësia Administrative Kashar, Rr ".....", Godina Nr....., Kashar, Tirana ofertuar në vlerën 156,213,239.00 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa tvsh. **Skualifikuar** bazuar në nenin 81 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 "Rregullore e Prokurimit Publik" datë 19.05.2021 të ndryshuar ku citohet "*Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi*".
2. **BOE M. shpk** me NUIS K...V dhe me adresë Tiranë Kashar Autostrada Tirane Durrës, Km 6, Ndërtesa dy katëshe nr. 5, kati i I i ndërtesës, pranë Poseidon, **T. shpk** me NUIS K...J dhe me adresë Tirane Kashar KASHAR Autostrada "Tiranë -Durrës", Km 10, Zone Kadastrale ..., Nr.Pasurie dhe **I. shpk** me NUIS K...T dhe me adresë Tiranë Vaqarr LALM Zona Kadstrale, Nr. pasurie ...-ND dhe ... përfaqësuar e prokurë të posaçme nga M ... shpk ofertuar në vlerën 292,506,669.00 (dyqind e nëntëdhjetë e dy milion e pesëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh. **Skualifikuar** bazuar në nenin 81 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 "Rregullore e Prokurimit Publik" datë 19.05.2021 të ndryshuar ku citohet "*Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi*".
3. **M. shpk** me NUIS J...F dhe me adresë Tiranë Farkë, Rruga e Elbasanit, Mjull Bathore, Nr.4, perballe TEG, ofertuar në vlerën 302,131,081.98 (treqind e dy milion e njëqind e tridhjetë e njëmijë e tetëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Gabim matematikor i operatorit të vetëm të kualifikuar M. shpk është pranuar dhe korigjuar nga operatori ekonomik me shkresën nr.349 datë 30.06.2022.

Autorizimi i prodhuesit nga A. SA lëshuar me datë 30.05.2022 si dhe autorizimi i A. H. lëshuar me datën 27.05.2022 për “M.” shpk me shkresën nr.1532/105 datë 15.07.2022 është hartuar

njoftimi i fituesit pas afatit të ankimit M. shpk me NUIS J.....F.

- **Lot 32 “Metronidazole”** 500 mg/100 ml - 100 ml, sasia e planifikuar 762,942 flakona, REF-26487-04-26-2022, me fond limit 104,058,130 lekë pa tvsh.
Në procedurë kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomikë si më poshtë:
- 1. **E. shpk** me NUIS L.....J dhe me adresë Tiranë Rruga Sami Frashëri, Nr. Pasurie ...- N1, Zona Kadastrale ..., Vol. ..., faqe 155. ofertuar në vlerën 40,969,985.40 (dyzet milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë pikë katër) lekë pa tvsh.
- 2. **R. F. shpk** me NUIS J... dhe me adresë Tiranë Vorë Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, (pranë nënkalimit të autostradës), nr.1 ofertuar në vlerën 51,651,173.40 (pesëdhjetë e një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre pikë katër) lekë pa tvsh.
- 3. **I. shpk** me NUIS K.....T dhe me adresë Tirane Vaqarr. Zona Kadastrale, Nr. pasurie-ND dhe ofertuar në vlerën 54,931,824.00 (pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh.
- 4. **ALDOSCH – F. shpk** me NUIS K...V dhe me adresë Tiranë Rruga Myslym Keta, Ish - Antibiotiku ofertuar në vlerën 60,272,418.00 (gjashtëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.
- 5. **F. shpk** me NUIS K....N dhe me adresë Tirane Rruga Qazim Vathi, Nr..... ofertuar në vlerën 62,561,244.00 (gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet e katër) lekë pa tvsh
- 6. **P. P. shpk** me NUIS L.....A dhe me adresë Tiranë Prona ZK. ..., vol ..., faqe 203, numri i pasurisë ..., (truall ... m2+ndertese 386 m2), Prona ZK. ...,vol ..., faqe 234, numri i pasurisë ..., (ndërtesë 119 m2), Rr.Rrapo Hekali, Ndërtese Private, afër Njësisë administrative Nr.13 ofertuar në vlerën 74,463,139.20 (shtatëdhjetë e katërmilion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë dy) lekë pa tvsh.
- 7. **M. shpk** me NUIS J...R dhe me adresë Tiranë Kavajë .80,108,910.00 (tetëdhjetë milion e njëqind e tetëmijë e nëntëqind e dhjetë) lekë pa tvsh. **Skualifikohet** pasi ka paraqitur sigurimin e ofertës për një periudhë 150 ditë kjo në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT në të cilat është përcaktuar se kohëzgjatja e sigurimit të ofertës duhet të jetë 180 ditë.
- 8. **E. – F. shpk** me NUIS K...T dhe me adresë Tiranë Ish Kombinati Josif Pashko, Laprakë, ofertuar në vlerën 102,997,170.00 (njëqind e dymilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.

E. shpk me NUIS L...J me shkresën nr.055 prot., datë 30.06.2022 ka përcjellë sqarimet mbi ofertën anomalisht e ulët të cilat janë pranuar nga Komisioni i vlerësimit të Ofertave.

Me shkresën nr.1532/94 datë 15.07.2022 është hartuar njoftimi i fituesit pas afatit të ankimit ku fitues është shpallur E. shpk me NUIS L.....J.

Operatori ekonomik E. shpk është fitues edhe për LOT 1, LOT 70, LOT 71, LOT 97, LOT 113. Tabela si më poshtë:

Nr	Lot/Principi aktiv	Formë - doza	Njësia	Sasi e planifikuar për 24 Muaj	Fondi limit 24 muaj (vlera e pritshme e kontratave) Lek pa TVSH
1	Lot1 Fentanyl	50 mcg/ml - 10ml	Ampule	62,716	13,187,399
2	Lot70 Ibuprofen	400mg/4ml	Flakon	21,660	11,386,211
3	Lot71 Ibuprofen	800mg/8ml	Flakon	3,260	3,427,428
4	Lot97 Propofol	10 mg/ml - 20 ml	Ampule	116,568	27,758,650
5	Lot113 Tinzaparine sodium	4.500 anti-Xa IU/0.45ml - 0.45 ml	Shiringe e parapërgatitur	91,443	38,350,280

Për Lot 1 Fentanyl, REF-26423-04-26-2022: E. shpk me ofertën me vlerë 13,107,644.00 (trembëdhjete milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë pa tvsh.

Për Lot 70 Ibuprofen REF-26563-04-26-2022: E. shpk me ofertën në vlerë 11,384,496.00

(njëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Për Lot 71 Ibuprofen REF-26565-04-26-2022: E. shpk me ofertën në vlerën 3,427,238.00 (tre milion e katërqind e njëzet e shtatë milion e dyqind e tridhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Për Lot 97 Propofol REF-26619-04-26-2022: E. shpk me ofertën në vlerë 27,603,302.40 (njëzet e shtatë milion e gjashtëqind e tre mijë e treqind e dy pikë katër) lekë pa tvsh.

Për Lot 113 Tinzaparine sodium REF-26652-04-26-2022: E. shpk me ofertën me vlerë 38,342,049.90 (tridhjetë e tetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e dyzet e nëntë pikë nëntë) lekë pa tvsh.

- **Lot 100 “Sevoflurance”** 100 % - 250 ml , sasia e planifikuar 11,346 flakona, REF-26625-04-26-2022, me fond limit 125,970,069 lekë pa tvsh

Në procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomikë si më poshtë:

1. **BOE I. shpk** me NUIS K....T dhe me adresë Tiranë Vaqarr, Zona Kadastrale, Nr. pasurie ...-ND dhe ..., **F. N. A. shpk** me NUIS K...V dhe me adresë Tiranë Njësia Bashkiake nr 8, Rruga Siri Kodra, ndërtesë 2-katëshe , me zone kadastrale dhe nr pasurie, kati 1, përfaqësuar me prokurë të posacme nga I. shpk ofertuar në vlerën 124,794,654.00 (njëqind e njëzet e katër milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.
2. **F. sha** me NUIS J...N dhe me adresë Tiranë Rruga "Nikolla Zoraqi", Ndërtesa 19, Hyrja 1, Njësia Bashkiake nr.3 ofertuar në vlerën 113,233,080.00 (njëqind e trembëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e tetëdhjetë) lekë pa tvsh. **Skualifikuar** pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin provues që bari i ofertuar është i regjistruar sipas kriterit në DT.
3. **M. shpk** me NUIS J...F dhe me adresë Tiranë Farkë Rruga e Elbasanit, Mjullë Bathorë, Nr.4, përballë TEG ofertuar në vlerën 126,082,425.00 (njëqind e njëzet e gjashtëmilion e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e njëzet e pesë) lekë pa tvsh. **Skualifikuar** pasi oferta është mbi fondin limit si dhe nuk është paraqitur sigurimi i ofertës për këtë lot.

Grupi i auditimit konstatoi se në njoftimin e fituesit për Lotin 100 OE F.... me ofertën më të ulët është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin provues që bari i ofertuar është i regjistruar sipas kriterit në DT, ndërsa në procesverbalin e vlerësimit (nuk korrespondon me njoftimin e fituesit) citohet që s’kualifikohet për afatin e sigurimit të ofertës. Me shkresën nr.1532/92 datë 15.07.2022 është hartuar njoftimi i fituesit pas afatit të ankimit. BOE I. shpk me NUIS K....T dhe F. N. A. shpk me NUIS K...V.

Grupi i auditimit nga verifikimet në SPE konstatoi se operatori ekonomik F. sha me NUIS J...N shpallur fitues për dy lote pa plotësuar kriterin e vendosur në DT që bari i ofertuar është i regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore konkretisht:

Nr	Lot/Principi aktiv	Formë - doza	Njësia	Sasi e planifikuar për 24 Muaj	Fondi limit 24 muaj (vlera e pritshme e kontratave) Lek pa TVSH
1	Lot83 Flumazenil	0.1 mg/ml - 5 ml	Ampule	1,090	1,082,379
2	Lot104 Valproic Acid + Sodium valproate	145 mg + 333 mg	Tablete	114,227	1,923,801

Lot 83 Flumazenil, REF-26590-04-26-2022: F. sha me NIPT J...N dhe me adresë Tirane Rruga "N... Z....", Ndërtesa .., Hyrja 1, Njësia Bashkiake Nr.3, ofertuar në vlerën 1,073,650.00 (një milion e shtatëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Lot 104 Valproic Acid + Sodium valproate , REF-26633-04-26-2022:F... sha me NIPT J...N dhe me adresë Tirane Rruga "N... Z....", Ndërtesa ..,Hyryja 1,Njesia Bashkiake Nr.3, ofertuar në vlerën 1,919,013.60 (një milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e trembëdhjetë pikë gjashtë) lekë pa tvsh.

Argumentimi nga takimi me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se për barnat e paregjistruar autorizohet importi i tyre sipas përcaktimeve në ligjin nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" neni 11 pika 1 ku citohet "*Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave*".

Ky përcaktim ligjor nuk i është komunikuar operatorëve ekonomike të interesuar që nga shpallja e kontratës duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë të sanksionuar në nenin 3 pika 1 e LPP nr.162/2020 "*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale*".

E njëjta gjë si më sipër konstatohet edhe tek Lot 96 Phenytoin sodium REF-26617-04-26-2022 ku fitues është shpallur OE/F.. N..A.. shpk me NUIS K...V ofertuar në vlerën 6,337,500.00 (gjashtë milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh. Vlera anomalisht e ulët është argumentuar me shkresën e OE datë 30.06.2022.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/53 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Grupi i auditimit citon që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhej ti komunikonte OE përcaktimet ligjore të ligjit 105/2014. Ligji është një rregull që vendoset nga organi më i lartë i pushtetit shtetëror dhe që është detyrueshëm për të gjithë organet shtetërore dhe për të gjithë shtetasit për tu zbatuar. Ligji "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" është shpallur me dekretin nr. 8680, datë 15.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Që me hyrjen në fuqi të këtij ligji të gjithë OE të cilët marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik janë të detyruar për ti zbatuar këto akte ligjore me përpikmëri. Nuk është detyrë e AK që të diktojë ligjet apo VKM operatorëve ekonomikë për sa kohë këto akte ligjore janë bërë publike dhe në bazë të tyre funksionojnë të gjithë AK si dhe OE. Mosnjohja e ligjit nuk të shkarkon nga përgjegjësia, pra çdo operator ekonomik i interesuar ka për detyrë dhe përgjegjësi që të gjithë dokumentacionin e paraqitur prej tij, ta dorëzojë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, si dhe legjislacionin specifik të objektit të prokurimit, në rastin konkret Ligjin për barnat. Konstatimi nga ana juaj se përcaktimet ligjore në ligjin për barnat, janë detyrim i AK për njoftim në shpalljen e kontratës, është plotësisht pasaktë, pasi ligjet bëhen të detyrueshme për zbatim me publikimin e tyre në fletoren zyrtare, një website publik zyrtar, i cili është i aksesueshëm nga të gjithë. Sa më lart ky konstatim nuk pranohet.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Grupi i auditimit, në kushtet që nga ana e subjektit nuk janë sjellë dokumentacione justifikuese shtesë që të argumentojë, do të vijojë ta reflektojë konstatim të pandryshuar në raportin perfundimtar të auditimit pasi njësia e prokurimit në shpalljen e kontratës nuk ia ka bërë me dije mënyrën e plotësimit të këtij kriteri siç parashikohet në ligjin e barnave.*

Titulli i Gjetjes:	Kualifikimi dhe skualifikimi OE me dy standarte nga KVO.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit "<i>BI-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut</i>" për:</p> <ul style="list-style-type: none"> Lot 100 "<i>Sevoflurancë</i>" u konstatua se: <p>Në njoftimin e fituesit OE/ F. sha, me ofertën më të ulët është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur <i>dokumentacionin provues që bari i ofertuar është i regjistruar sipas kriterit në DT</i>, ndërsa në procesverbalin e vlerësimit (nuk korrespondon me njoftimin e fituesit), pasi citohet që skualifikimi është për afatin e sigurimit të ofertës.</p> <p>Ndërsa për lotet Lot83 "<i>Flumazenil</i>" dhe Lot104 "<i>Valproic</i>", OE/ F. sha është shpallur fitues pa plotësuar kriterin e vendosur në DT që bari i ofertuar të jetë i regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.</p> <p>OE/F. N. A. shpk është shpallur fitues për Lot 96 "<i>Phenytoin</i>" pa plotësuar</p>

	<p>kriterin e vendosur në DT që bari i ofertuar të jetë i regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.</p> <p>Për Lot83; Lot104 dhe Lot 96, KVO argumenton se për barnat e paregjistruar autorizohet importi i tyre sipas përcaktimeve në ligjin nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" neni 11 pika 1 ku citohet "Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave".</p> <p>Ky përcaktim ligjor dhe argumentim nuk është bërë nga KVO në vlerësimin e ofertave në Lot 100 "Sevoflurancë", duke s'kualifikuar OE të renditur të parin me ofertë në shumën prej 113,233,080 lekë me një diferencë më pak se me ofertën fituese prej 11,561,574 lekë.</p> <p>Sa më sipër KVO ka vepruar në kundërshtim të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar neni 2 pika d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik" dhe nenin 3 pika 1, ku citon se "Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale". VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit", i ndryshuar, neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2.</p>
Kriteri:	<p>Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar neni 2 nenin 3 pika 1; neni 92.</p> <p>VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit", i ndryshuar neni 82 pika 2.</p> <p>"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2.</p> <p>- Dokumentet e tenderit</p>
Ndikimi/Efekti:	Mos vlerësim i saktë i operatorëve ekonomik.
Shkaku:	Vlerësim i ofertave jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë vlerësimit të ofertave të procedurave prokurorese, të merren masa të pranohen oferta kur përputhen plotësisht specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 82 si devijime të vogla, të cilat të specifikohen në raportet përmbledhëse të procedurave prokurorese, duke mbajtur në konsideratë parimet e ekonomicitetit dhe eficiensës, bazuar kriterëve të vlerësimit të çmimit më të ulët.

4.1 "B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike", ndarë në 128 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj".

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “”/			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur” REF-25052-04-14-2022 Urdhri nr. 204, datë 01.04.2022	1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese Urdhri nr 480 datë 05.11.2021 F. B., K. D., N. A., ndryshuar me urdhërin 401/1 datë 21.09.2021 shtohet E. R. specialist fushe.	2 Njësia e Prokurimit A.A. E. Ll. L. A. K. D.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr 204/2, datë 13.04.2022, i ndryshuar me Urdhërin nr. 204/3 datë 16.05.2022 M. K. E. H. M.K.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 4,987,413,937 lekë 128 Lote	5. Oferta fituese (pa tvsh) 4,047,310,636 lekë; 102 lote		
7/1 Data e hapjes së tenderit Data 03.06.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit		
7/2 Kohëzgjatja e kontratës, MK 2 vjet			

- Me urdhrin e prokurimit nr. 204, datë 01.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 4,987,413,937 lekë pa TVSH, me objekt “*“B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike ”, ndarë në 128 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”* dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga znj. A. A., z. E.Ll., znj. L. A. dhe z. K. D.

Komisioni i ngrituri titullari i AK përbëhet prej 4 anëtarësh, veprim në kundërshtim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “*Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit” pika 2 “Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor K.... njësinë e prokurimit. Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.....”*.

Me shkresën e SP znj. J.D me nr. 1677, datë 12.04.2023, ndryshon planifikimin për barin Crisantaspase për sasinë 250 flakonë në vlerën 38,695,830 lekë, e cila do të prokurohet nga vetë QSUT për faktin se ky bar kërkohet vetëm nga ky institucion dhe ka nevoja emergjente për të, ku me shkresën nr. 1677/1 datë 12.04.2022 i delegohet AK /QSUT prokurimi i këtij bari.

Me shkresën e SP nr. 789, datë 22.04.2023, ndryshon planifikimin për barin “tinzaparine”, për të cilin është bërë një rishikim të çmimit/njësi. Si dhe në pikën dy të shkresës bëhet një saktësim të bari oksigjen kalimi nga 84,000 oksigjen lëng në 84,000 oksigjen gaz.

Me shkresën me nr. 1913, datë 28.04.2022 të MSHMS bëhet delegimi i realizimit të procedurës së prokurimit Operatorit të shërbimit të kujdesit Shëndetësore për “*Blerjen e barnave dhe materialeve mjekimi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore gjatë sezonit të verës dhe qendrave shëndetësore që bllokohen gjatë sezonit të dimrit për një periudhë 12 mujore”*.

Me shkresën nr. 3445/3 prot., datë 26.09.2022 të MSHMS është bërë delegimi në spitalet rajonale të realizimit të procedurave për barna, të cilat nuk janë të përfshirë në listën e barnave në procedurën me prokurim të përqendruar në MSHMS.

- Me urdhrin e prokurimit nr. 204, datë 01.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 4,987,413,937 lekë pa TVSH, me objekt “*“B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike ”, ndarë në 128 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”*

dhe ngarkohet njësi e prokurimit e përbërë nga znj. A. A., z. E. Ll., znj. L. A. dhe z. K. D.
Komisioni i ngrituri titullari i AK përbëhet prej 4 anëtarësh, veprim në kundërshtim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “*Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësi e prokurimit*” **pika 2** “Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor K... njësinë e prokurimit. Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.....”.

Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Nga NJP me datën 13.04.2022 është mbajtur procesverbali i argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, për 128 lote.

Me urdhrin nr. 1 datë 13.04.2023 prot., nr. 1533/1, datë 13.04.2022 nga AK është bërë ndryshimi nga 129 lote në 128 lote, ku fondi limit vlera e pritshme është 4,987,413,937 lekë pa tvsh. Ndryshimi ka ndodhur te vlera e pritshme e kontratave të AK/QSUT, e cila është bërë në vlerën 2,763,340,343 lekë pa tvsh nga 2,807,036,173 lekë, që ishte planifikuar në urdhrin nr. 204, datë 01.04.2022 .

Njoftimi i kontratës është bërë me shkresën nr. 1533/3, datë 15.04.2022, ku afati i hapjes së ofertave është data 19.05.2022.

Njoftimet është publikuar në Buletin e Njoftimeve Publike me nr. 53, datë 26.04.2023.

Me shkresën nr. 1533/13, datë 28.04.2022 është bërë “*formulari i njoftimit të anulimit*” të “Lot98 Tinzaparine sodium” me arsyetimin se është bërë një saktësim i çmimit/njësi të barit “Tinzaparine sodium 4.500 anti-Xa IU/0.45ml - 0.45 ml”. Anulimi është bërë bazuar në nenin 98 të ligjit 162/2020pika 1/c “*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme*”.

Me shkresën nr. 1533/55, datë 20.05.2022 është bërë ndryshimi i dokumentit të tenderit mbështetur në vendimet e KPP-së.

Lot/Principi Aktiv	Referenca
Lot17 Gemcitabine	REF-25106-04-14-2022
Lot22 Methotrexate	REF-25117-04-14-2022
Lot23 Mitoxantrone	REF-25119-04-14-2022
Lot47 Progesterone	REF-25171-04-14-2022
Lot48 Somatostatin	REF-25173-04-14-2022
Lot49 Betamethasone	REF-25175-04-14-2022
Lot109 Atorvastatine	REF-25302-04-14-2022
Lot119 Insulin Isophane	REF-25324-04-14-2022

Afatet e lëvrimit:

Ishte: Përveç QSUT e cila do të lidhë kontratat në bazë të nevojave të saj.

Përfundimisht këtij përcaktimi, autoritetet kontraktore mund të lidhin kontratë për çdo nevojë për barna të listës së planifikuar, që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Bëhet:

Përveç QSUT e cila do të lidhë kontratat në bazë të nevojave të saj.

Përfundimisht këtij përcaktimi, autoritetet kontraktore mund të lidhin kontratë për çdo nevojë për barna të listës së planifikuar, që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për QSUT në raste të veçanta, sipas nevojave të argumentuara, për disa barna të lejohet që sasitë të cilat konsumohen për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, afati skadencës të jetë sa dyfishi i kohës së llogaritur për konsum.

Shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave:

Ishte:

19/05/2022 ora 10:00

Bëhet:

03/06/2022 ora 10:00

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Pas vlerësimit të ofertave grupi i auditimit konstatoi se nga KVO është mbajtur procesverbal i vlerësimit të ofertave.

- Me raportin përmbledhës nr. 1533/116, datë 08.07.2022, miratohet procedura nga titullari i AK znj. J.D , përfundimi dhe shpallja e fituesve për 89 lote.

- Me raportin përmbledhës nr. 1533/159, datë 22.07.2022, miratohet procedura nga titullari i AK znj. J.D , përfundimi dhe shpallja e fituesve për 5 lote.

- Me raportin përmbledhës nr. 1533/160, datë 22.07.2022, miratohet procedura nga titullari i AK znj. J.D , përfundimi dhe shpallja e fituesve për 13 lote, ku janë miratuar edhe 5 lotet e raportit raportin përmbledhës nr. 1533/159, datë 22.07.2022.

Me shkresën nr. 1533/179, datë 26.09.2022 është shpallur fitues për Lot 111 “Calcium gluconate”, F. shpk, pas vendimit të KPP-së me nr.842/2022, prot., me nr. 1214/5, datë 31.08.2022, miratuar nga titullari i AK me raportin përmbledhës nr. 1533/180, datë 26.07.2022.

Nga MSHMS si OQB janë lidhur marrëveshjet kuadër me OE fitues për lotet përkatëse dhe janë dërguar në Spitalet Rajonale bashkë me dokumentacionin bashkëngjitur për lidhjen e kontratave sipas nevojave të planifikuara.

• **Lot32** “Trastuzumab Biosimilar ose origjinator”

Në procedurë ka marrë pjesë BOE:

“M. shpk, “E.– F.” shpk dhe “R. F.” shpk përfaqësuar me prokurë nga “M. shpk, ku vlera e ofruar/ totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 180,667,920 lekë pa TVSH.

Në ofertën e paraqitur nga BOE është cituar se MAH/ Prodhuesi: P../M... Ire/ R.. P../ H... ltd, C.. H..

Nga auditimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga BOE dhe atij në SPE u konstatua se:

Autorizimi i prodhuesit nga P.. për “M. shpk është lëshuar me datën 06.05.2022. Për kompaninë “E. F.“ është lëshuar prokurë nga H. C.

Autorizimi i prodhuesit nga V. për “R. F.” shpk lëshuar me datën 06.05.2022 nuk është paraqitur si MAH/ Prodhuesi, si dhe nuk është e cituar nëse është kompani prodhuese apo distributor, si dhe nuk është i autorizuar nga AKBPM.

Autorizimi nga F. H.-La R. Ltd, G...e 124, CH-4070 Basel, Switzerland për R. F..” shpk ka afat “This Authorization is valid for the period 2022-2023”, në kundërshtim me DST që është kërkuar 2022-2024..

Sa më sipër BOE nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në DT, dhe në njoftimin e fituesit nuk është cituar se produktet nga MAH/ F. H..-La R.. Ltd, autorizimi i dorëzuar nga OE nuk plotëson kushtet e përcaktuar në DT.

Në njoftimin e fituesit citohet se:

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë .

Lot32: Trastuzumab Biosimilar ose origjinator, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse:

1. BOE M. shpk me NIPT J...F; E.. – F. shpk me NIPT K.T dhe R. F. shpk me NIPT J...U përfaqësuar me prokurë nga M.. shpk. Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 180,667,920.00 (njëqind e tetëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Për sa i përket autorizimit të prodhuesit nga V.. dhe jo M.. S.A.S ju sqarojmë se M.. S.A.S është pjesë e kompanisë V.. gjë lehtësisht e vërtetueshme në faqen zyrtare ..<https://www.v.....r-story> Sa më lart ky konstatim nuk pranohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsiderate observimin tuaj, Sqarimet e dhëna nuk përkojnë me gjetjen. Jemi në kushtet e mosplotësisimit të kriterëve të DT. KVO në procesverbalin e mbajtur dhe Raport nuk është dhënë asnjë sqarim në lidhje me këtë fakt të konstatuar nga grupi.

- **Lot3 “Bortezomib”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë BOE “M. shpk, “D. P. – AL” shpk, “T.” shpk. Përfaqësuar me prokurë të posaçme nga M. shpk vlera totale për lot3: 105,520,000 lekë pa TVSh. Në ofertën e paraqitur nga BOE është cituar se MAH/ Prodhuesi: P.. e/Dr. R../ Z.. KS. Autorizimi i prodhuesit nga P.....për “M.” shpk është lëshuar me datën 13.05.2022.

- **Lot27 “Rituximab Biosimilar ose origjinator”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE,

- BOE “E. – F.” shpk dhe “D. P. – AL” shpk, përfaqësuar me prokurë nga “E. – F.” shpk, ku vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 11,132,000 lekë pa TVSH.

- “M.” shpk pa ofertë ekonomike, e cila është skualifikuar.

BOE “E.– F.” shpk dhe “D. P. – AL” shpk është i identifikuar si i suksesshëm për këtë procedurë. Autorizimi i “P.” për “E. – F.” shpk lëshuar me datën 19.05.2022 nuk është përcaktuar afati i vlefshmërisë, sipas përcaktimeve të DST, e cila është 2022-2024.

“E. – F.” shpk ka prokurë nga C... H.. H., e cila nuk është regjistruar në AKBPM për këtë bar.

D.. P... - AL shpk ka dorëzuar Autorizimi nga S.... GmbH, Austri, në AKBPM është regjistruar 100 mg/ 10ml dhe 500 mg, e cila nuk është në përputhje me DT, 10 mg/ml-10 ml.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Pegasus për Edna-Farma citon:....ne procedurën e prokurimit që do të zhvillohet ne datë 19.05.2022 nga Autoriteti Kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

Duke qenë se ky OE është i autorizuar për këtë procedurë do të thotë që janë të përfshirë edhe afatet e përcaktuara në DT. Dokumenti i lëshuar nga kompania C... për E.. P... është një dokument i cili është i ka të gjitha elementet e sigurisë, si firmë, vulë, njehsuar më origjinalin nga zyra noteriale dhe sipas të gjitha afateve të përcaktuara në DT. Nga sa më lart KVO e ka konsideruar të vlefshëm këtë dokument. Ndërsa lidhur me konstatimin që OE D... P.. ka ofertuar me f/d 100mg/10ml ku në DT kërkohet 10mg/ml, ju sqarojmë se në DST është përcaktuar edhe paketimi , i cili është 10ml pra 10mg për 1 ml, duke bërë konvertimin për vial x 10ml është i barabartë me 100mg/10ml. (Këtë sqarim e kemi dërguar me email dhe në zyrën tuaj). Sa më lart ky konstatim nuk pranohet. Gjithashtu, lidhur me këtë pretendim të grupit të auditimit, KVO ju drejtua AKBPM-së e cila me email zyrtar konfirmon ekuivalencën e formë/dozave Të dy formulimet Rituximab 10mg/ml, flakon prej 10ml dhe Rituximab 100mg/10ml, flakon prej 10ml përmbajnë gjithsej 100 mg lëndë aktive Rituximab në flakon 10ml. Përsa i përket vetëm totale të lëndës. aktive këto barna janë ekuivalente. (bashkëlidhur përgjigja me -email e AKBPM).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsiderate observimin tuaj, Sqarimet e dhëna nuk përkojnë me gjetjen, autorizimi nuk ka të përcaktuar në përmbajtjen e tij afatin sipas kërkesave të kërkuara, si i tillë observacioni nuk merret në konsideratë do vijojë të jetë i pandryshuar në raport. Edhe ndryshimi i dozës sipas përcaktimeve të bëra nga ju nuk përkojnë me atë të ofertuar 10 mg/ml-10 ml.

KVO në procesverbalin e mbajtur dhe Raportin përmbledhës nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me këtë fakt të konstatuar nga grupi.

- **Lot18 “Goserelin acetate”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE:

- R. F. shpk, Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 28,003,200 lekë pa TVSH.

- T. shpk, Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 60,272,000 lekë pa TVSH.

R. F. shpk është i identifikuar si i suksesshëm për këtë procedurë, me ofertën më të ulët ekonomike. Kualifikimi i OE si i suksesshëm është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4

ku citon se “Pas korrjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur”.

Fondi limit është 66,976,074 lekë, ku ulja e 25%, e këtij fondi është 16,744,018.5 lekë, ndërsa ulja e ofertës fituese është në vlerën 38,972,874 lekë. Në dosje dhe në SPE nuk gjendet **asnjë dokument kërkesë për sqarim dhe sqarimi nga OE i argumentuar pse vlera është kaq e ulët.**

Më pas nga kërkesa drejtuar KVO nga grupi i auditimit na u vu dispozicion sqarimi nga OE/R..... F.....datës 15.06.2022 ku në shkresë nuk jepet argumentimi në lidhje me ofertën anomalisht më të ulët por, sqarohet vetëm se ky OE siguron dhe Garanton furnizimin e mallit 100% sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi i OE nuk është në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4 ku citohet se “ Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

Autorizimi për barin “Goserelin acetate” është në proces miratimi nga AKBPM për atë që prodhohet në Britaninë e Madhe.

Në momenti e hapjes së ofertave bari “Goserelin acetate” i ofertuar nga “R. F.” shpk është marrë autorizimi nga “A..... AB, a company incorporated in Sweden distributor”. Në ofertë dhe në deklaratën e origjinës është vënë nga Britania e Madhe, e cila është e autorizuar si bar dhe nga AKBPM dhe jo nga distributori i autorizuar. Autorizimi i AKBPM dorëzuar nga OE është jashtë afatit pasi mban datën 10.03.2017 dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE është data 17.05.2022. Sa më sipër jemi në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të DST.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Për sa i përket autorizimit nga kompania A.... Suedi, dhe ky bar është i regjistruar nga A.... UK, sqarojmë se të dyja këto kompani janë pjesë të së njëjtës kompani të cilat janë të vendosura në vende të ndryshme. Lidhur me certifikatën e regjistrimit e cila është e vitit 2017, pra i ka kaluar afati i vlefshmërisë, nga ana e kompanisë është paraqitur vërtetim nga AKBPM që dosja e këtij bari i ka kaluar të gjitha procedurat për regjistrim dhe është bërë propozimi për urdhrin e Ministrit. AKBPM është institucion në varësi MSHMS, i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe inspektimin e veprimtarisë në fushën farmaceutike. Urdhri i Ministrit është një hallkë procedurale e procesit të regjistrimit të barit, pas verifikimit dhe konfirmimit nga AKBPM. Sa më lart ky konstatim nuk pranohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me certifikatën e regjistrimit e cila është e vitit 2017, pra i ka kaluar afati i vlefshmërisë, grupi ka verifikuar dokumentacionin e SPE dhe atë të dhënë fizikisht ku nuk ka asnjë provë për atë që ju pretendoni. OE ndodhet në kushtet e mosplotësimit të kriterëve në DT. KVO nuk ka asnjë sqarim në procesverbalet e mbajtura dhe Raportin përmbledhës për këtë fakt të konstatuar.

- **Lot60 “Eptacog Alfa (Activated)” (1mg/ml after reconstitution)**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, “R. F.” shpk, ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 130,146,580 lekë pa TVSH.

Në ofertën e paraqitur nga BOE është cituar se MAH/ Prodhuesi: N. N... A/S / V.. P.. F..

Autorizimi i prodhuesit nga N... No...A/S për “R.... F.....” shpk lëshuar me datën 18.05.2022.

Autorizimi nga prodhuesi V... P... F...nuk është i bashkëngjitur dokumentacionit në SPE siç është paraqitur në ofertën ekonomike.

Në njoftimin e fituesit nuk është përcaktuar se OE fitues duhet të lidhë kontratën vetëm për Autorizimi i prodhuesit nga N... No...A/S.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me autorizimin e prodhuesit, ju sqarojmë se në regjistrin e AKBPM-së për këtë bar, janë disa prodhues si:

1. N... N...K A/S (Bagsvaerd) - DANIMARKË;

2. N... N... A/S (Kalundborg) DANIMARKË;

3. N... N... A/S (Gentofte) -DANIMARKË;

4. V... P...-F.. (Ravensburg) — GJERMANI.

Kjo nuk do të thotë që duhet të merret autorizim prej të gjithë prodhuesve për më tepër, N...N.. SA DANIMARKE përveç se është prodhues është edhe MAH, që do të thotë se ka të gjitha të drejtat ekskluzive për këtë bar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsiderate observimin tuaj.

KVO ka vepruar me dy standarde në vlerësimin e ofertave. Në momentin që një OE nuk ka sjellë një autorizim për një nga kompani për të cilën ka ofertuar e ka cituar në raportin përmbledhës se kontrata me OE do lidhet vetëm për produktet të cilat OE ka sjellë autorizimin.

• **Lot14 “Filgastrim”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE,

- D. P.- AL shpk, ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 16,964,064 lekë pa tvsh.

- M. shpk, ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 18,894,270 lekë pa tvsh.

- P. shpk, ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 24,417,750 lekë pa tvsh.

Kualifikimi i OE **D. P.– AL** me vlerën 16,964,064 lekë pa TVSH, si i suksesshëm është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4 ku citon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.”

Totali i tre ofertave është në shumën 60,276,084 lekë, mesatarja e tre ofertave është në shumën 20,092,028 lekë dhe 85% e mesatares së ofertave të vlefshme është në shumën 17,078,224 lekë pa tvsh. Në dosje dhe në SPE nuk gjendet **asnjë dokument kërkesë për sqarim dhe sqarimi nga OE i argumentuar pse vlera është kaq e ulët.**

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Të gjitha kërkesat për oferta anomalisht të ulëta janë realizuar nëpërmjet SPE ku po nga ky sistem janë administruar edhe përgjigjet. Gjithashtu pas kërkesës së grupit të auditimit ky dokument është marrë nga sistemi SPE dhe i është dorëzuar fizikisht në zyrë. Sa më lart ky konstatim nuk pranohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsiderate observimin tuaj,

Sa i përket vënies në dispozicion grupit për dokumentacionin e kërkuar janë reflektuar të gjitha ato që janë vënë në dispozicion që në momentin e auditimit në terren dhe janë cituar dhe në akt konstatimet. Kjo kërkesë nuk gjendej as në SPE dhe as nuk është vënë fizikisht në dispozicion grupi.

• **Lot25 “Paclitaxel”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE, nga të cilët janë F. sha, M. shpk pa ofertë ekonomike.

R. F. shpk është i identifikuar si i suksesshëm për këtë procedurë, me ofertën më vlera totale

12,717,723 lekë.

Kualifikimi i OE “R. F.” shpk me vlerën 16,964,064 lekë, si i suksesshëm është në kundërshtim me neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4 ku citon se “Pas korrëgjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.”

Totali i tre ofertave është në shumën 63,789,230 lekë, mesatarja e tre ofertave është në shumën 15,942,303 lekë dhe 85% e mesatares së ofertave të vlefshme është në shumën 13,555,207 lekë pa tvsh. Në dosje dhe në SPE nuk gjendet asnjë dokument kërkesë për sqarim dhe sqarimi nga OE i argumentuar pse vlera është kaq e ulët.

Më pas nga kërkesa drejtuar KVO nga grupi i auditimit na u vu dispozicion sqarimi nga OE/R.... F.....datës 15.06.2022 ku në shkresë nuk jepet argumentimi në lidhje me ofertën anomalisht më të ulët por, sqarohet vetëm se ky OE siguron dhe Garanton furnizimin e mallit 100% sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi i OE nuk është në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4 ku citohet se “ Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

Autorizimin e ka marrë nga F... K..., Austri GMBH, ndërsa ai i ofertuar në ofertë është nga India dhe Gjermania.

Në ofertë është ofertuar dhe nga W... Hungari; P... Ltd, M... laboratory Hungary W. GMBH Gjermani, për të cilën R..... F.....nuk ka paraqitur asnjë autorizim. Në njoftimin e fituesit nuk është përcaktuar se OE fitues duhet të lidhë kontratën vetëm për Autorizimi i prodhuesit të dorëzuar.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me autorizimin e prodhuesit, ju sqarojmë se, ky autorizim është marrë nga MAH F... K.. D..LAND GMBH — GJERMANI. Ky bar ka edhe prodhuesit e mëposhtëm:

1.F... K... O... LIMITED - INDI;

2.F... K... D... GMBH - GJERMANI;

3.W... H... Kft. - HUNGARI,

4.P... Ltd. M... LABORATORY - HUNGARI;

5.W... GmbH — GJERMANI pra është prodhues dhe MAH e cila te cdo te drejte mbi barin.

Ju sqarojme se F.. K.. D...AND GMBH — GJERMANI, përveç se prodhues është edhe MAH dhe ka të gjitha të drejtat mbi barin Paclitaxel.

Të gjitha kërkesat për oferta anomalisht të ulëta janë realizuar nëpërmjet SPE ku po nga ky sistem janë administruar edhe përgjigjet. Bazuar ne Farmakopenë Evropiane përkatësisht nw fq 90 (bashkëlidhur) si dhe Direktiven e Bashkimit Evropian 75/31 8/EEC pranohet devijimi i përmbajtjes së substancave aktive 5%.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsiderate observimin tuaj,

Sa i përket vënies në dispozicion grupit për dokumentacionin e kërkuar janë reflektuar të gjitha ato që janë vënë në dispozicion që në momentin e auditimit në terren dhe janë cituar dhe në akt konstatimet. Nga grupi është shprehur se **në shkresë nuk jepet argumentimi në lidhje me ofertën anomalisht më të ulët por, sqarohet vetëm se ky OE siguron dhe Garanton furnizimin e mallit 100% sipas specifikimeve teknike’ dhe nga KVO nuk është bërë asnjë sqarim shtese në procesverbal dhe në raportin Përmbledhës në lidhje me këtë konstatim.**

- **Lot120 “Magnesium sulphate”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE:

A. - F. shpk ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 17,930,503.20 lekë pa TVSH.

M. shpk, ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 18,177,111.84 lekë pa TVSH.

Kualifikimi i OE A. - F. shpk, me vlerën 17,930,503 lekë, si i suksesshëm është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4 ku citon se “*Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur*”.

Fondi limit është 24,747,830 lekë, ku ulja e 25%, e këtij fondi është 21,035,655 lekë, ndërsa ulja e ofertës fituese është në vlerën 17,930,503 lekë. Bashkëngjitur nuk ka anjë dokument të argumentuar pse vlera është kaq e ulët. Në dosje dhe në SPE nuk gjendet **asnjë dokument kërkesë për sqarim dhe sqarimi nga OE i argumentuar pse vlera është kaq e ulët.**

Më pas nga kërkesa drejtuar KVO nga grupi i auditimit na u vu dispozicion sqarimi nga OE/A...F.. datës 15.06.2022 ku në shkresë jepet argumentimi në lidhje me ofertën anomalisht më të ulët bashkëlidhur dhe oferta e marrë nga P.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Të gjitha kërkesat për oferta anaomalisht të ulëta janë realizuar nëpërmjet SPE ku po nga ky sistem janë administruar edhe përgjigjet. Gjithashtu pas kërkesës së grupit të auditimit ky dokument është marrë nga sistemi SPE dhe i është dorëzuar fizikisht në zyrë. Sa më lart ky konstatim nuk pranohet.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsiderate observimin tuaj, Sa i përket vënies në dispozicion grupit për dokumentacionin e kërkuar janë reflektuar të gjitha ato që janë vënë në dispozicion që në momentin e auditimit në terren dhe janë cituar dhe në akt konstatimet. Kjo kërkesë nuk gjendej as në SPE dhe as nuk është vënë fizikisht në dispozicion grupi.

- **Lot109 “Atorvastatine”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, ku është skualifikuar Ca. A. shpk pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas kërkesave të DT.

T. shpk ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 1,525,650 lekë pa TVSH.

A. – F. shpk ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 610,260 lekë pa TVSH.

Kualifikimi i OE **A. - F. shpk**, me vlerën 610,260 lekë, si i suksesshëm është në kundërshtim me neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4 ku citon se “*Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur*”.

Fondi limit është 2,053,768 lekë, ku ulja e 25%, e këtij fondi është 1,745,703 lekë, ndërsa ulja e ofertës fituese është në vlerën 610,260 lekë, vlerë e cila ka kaluar në blerje të vogël.

Në dosje dhe në SPE nuk gjendet asnjë dokument kërkesë për sqarim dhe sqarimi nga OE i argumentuar pse vlera është kaq e ulët.

Vetëm “P.” e ka për këtë bërë autorizimin nga AKBPM.

A. - F. shpk nuk ka autorizim nga P.. për shitjen e këtij produkti, duke mos plotësuar kriteret e DT.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Të gjitha kërkesat për oferta anomalisht të ulëta janë realizuar nëpërmjet SPE ku po nga ky sistem janë administruar edhe përgjigjet. Gjithashtu pas kërkesës së grupit të auditimit ky dokument është marrë nga sistemi SPE dhe i është dorëzuar fizikisht në zyrë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsiderate observimin tuaj.

Sa i përket vënies në dispozicion grupit për dokumentacionin e kërkuar janë reflektuar të gjitha ato që janë vënë në dispozicion që në momentin e auditimit në terren dhe janë cituar dhe në akt konstatimet.

- **Lot104 “Iodine x 300mg/ml”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE:

D. P. - AL shpk ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 3,515,876 lekë pa tvsh.

F. shpk ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 6,374,940 lekë pa tvsh.

F. sha pa ofertë ekonomike.

Kualifikimi i OE D. P.- AL, me vlerën 3,515,876 lekë, si i suksesshëm është në kundërshtim me neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4 ku citon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur”.

Fondi limit është 9,284,078 lekë, ku ulja e 25%, e këtij fondi është 6,684,536 lekë, ndërsa ofertës fituese është në vlerën 3,515,876 lekë.

Në dosje dhe në SPE nuk gjendet *asnjë dokument kërkesë për sqarim dhe sqarimi nga OE i argumentuar pse vlera është kaq e ulët.*

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Të gjitha kërkesat për oferta anomalisht të ulëta janë realizuar nëpërmjet SPE ku po nga ky sistem janë administruar edhe përgjigjet. Gjithashtu pas kërkesës së grupit të auditimit ky dokument është marrë nga sistemi SPE dhe i është dorëzuar fizikisht në zyrë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsiderate observimin tuaj, sa i përket vënies në dispozicion grupit për dokumentacionin e kërkuar janë reflektuar të gjitha ato që janë vënë në dispozicion që në momentin e auditimit në terren dhe janë cituar dhe në akt konstatimet.

- **Lot28 “Rituximab Origjinator”**

Ka marrë pjesë një OE “M.” shpk ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 25,592,820 lekë pa tvsh.

Autorizimi i prodhuesit nga R... P... lëshuar me datën 29.04.2022 dhe formë doza e autorizuar është **Rituximab vial 100mg/10ml dhe Rituximab vial 500mg/50ml.**

AKBPM ka lëshuar autorizimin për “Rituximab Origjinator” është për 10mg/1ml me mbajtës autorizuese R... P..., Zvicër, ndërsa në DST është kërkuar 10mg/50ml.

Autorizimi i lëshuar nuk përmbush kushtet e DST.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje konstatimin se ska përputhje të f/d midis asaj në DT dhe asaj të ofertuar, sqarojmë se duke parë që është përcaktuar flakoni 50 ml ath bëjmë konvertimin dhe del 500mg/50 ml pra është plotësisht e

saktë dhe sipas kërkesave të DT.. Sa më lart ky konstatim nuk pranohet. Gjithashtu lidhur me pretendimin jemi drejtuar dhe AKBPM, me e-mail zyrtar konfirmon ekuivalencën e dozës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observimin tuaj, sqarimet në lidhje me konvertimet dhe përputhshmërinë e barit të kërkuar dhe atë të ofertuar duhet të ishin reflektuar në procesverbalin dhe raportin përmbledhës të KVO, për të cilat nuk ka asnjë sqarim dhe dokumentacion bashkëngjitur që vërteton këtë përputhshmëri. Konfirmimi që kanë marrë nga AKBPM nuk ka dokumentacion bashkëngjitur as në dosje dhe as nuk është cituar në raportin përmbledhës nga KVO.

- **Lot29 “Rituximab Origjinator”**

Ka marrë pjesë një OE “M.” shpk ku Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 5,124,120 lekë pa tvsh.

Autorizimi i prodhuesit nga R... P... lëshuar me datën 29.04.2022 dhe formë doza e autorizuar është **Rituximab vial 100mg/10ml dhe Rituximab vial 500mg/50ml.**

AKBPM ka lëshuar autorizimin për “Rituximab Origjinator” është për 10mg/1ml me mbajtës autorizuese R.. P..., Zvicër, ndërsa në DST është kërkuar 10mg/10ml

Autorizimi i lëshuar nuk përmbush kushtet e DST.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje konstatimin se ska përputhje të f/d midis asaj në DT dhe asaj të ofertuar, sqarojmë se duke parë që është përcaktuar flakoni 10 ml, bëjmë konvertimin dhe del 100mg/10 ml pra është plotësisht e saktë dhe sipas kërkesave të DT. Sa më lart ky konstatim nuk pranohet. Gjithashtu lidhur me pretendimin jemi drejtuar dhe AKBPM, me e-mail zyrtar konfirmon ekuivalencën e dozës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observimin tuaj, sqarimet në lidhje me konvertimet dhe përputhshmërinë e barit të kërkuar dhe atë të ofertuar, duhet të ishin reflektuar në procesverbalin dhe raportin përmbledhës të KVO, DST është kërkuar 10mg/10ml dhe nëse bëni konvertimin nuk del kjo dozë. Konfirmimi që kanë marrë nga AKBPM nuk ka dokumentacion bashkëngjitur as në dosje dhe as nuk është cituar në raportin përmbledhës nga KVO.

- **Lot52 “Alteplase”**

Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 1 OE: **T. shpk**, ku vlera e ofruar/ totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 55,165,000 lekë pa TVSH.

Ky bar është i pa regjistruar në AKBPM.

Subjekti ka sjellë një deklaratë që bari është i regjistruar në Agjencinë Rregullatore për barnat dhe pajisjet në Londër. Autorizimi nga prodhuesi nuk ka asnjë specifik që prodhon këtë bar me këtë specifikime të përcaktuara në DST.

KVO ka kualifikuar OE, por në dokumentacionin e dorëzuar si dhe në procesverbalin e mbajtur nga KVO nuk është cituar se si është verifikuar që bari që do sillet është brenda specifikime të përcaktuara.

Pas shpalljes së fituesit dhe të lidhjes se MK, OE T. shpk me shkresën drejtuar MSHMS me nr.1533/185, datë 14.11.2022, sqaron se ka të pamundur përmbushjen e kushteve të kontratës MK për Lot52 “Alteplase” me orgjinë nga Mbretëria e Bashkuar dhe Austria, për shkak të kërkesës së madhe për këtë produkt dhe ndikimit të luftës në Ukrainë.

MSHMS me shkresën nr. 1533/186, datë 25.11.2022 njofton Spitalet Rajonale për prishjen e marrëveshjes kuadër me nr. 1533/152 prot., datë 19.07.2022 bazuar në nenin 62 pika 7 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për barin Alteplase me OE dhe vijon MK për të tjerat.

Me shkresën nr. 1533/188 datë 13.12.2022 është bërë formulari i anulimit të kontratës.

Me shkresën nr. 1533/187 MSHMS autorizon Spitalet Rajonale që të prokurojnë vetë “Alteplase 50mg” për mbulimin e nevojat 24 mujore nga data e përfundimit të MK të fundit.

Në lidhje me zbatimin e minikontratave të lidhura nga Spitalet rajonale për Lot 52- “Alteplase” të merren masat se

Furnizimi:

Me fletë hyrjen nr. 1381, datë 13.09.2022 është bërë hyrje në magazinë sasia prej 4 flakon, vlera 236,000 lekë, sipas Kontratës së furnizimit nr. 1911, datë 12.09.2022 midis Spitalit Rajonal Shkodër dhe OE “T.” Shpk. Sasia që subjekti duhet të furnizonte sipas DST për 4-mujorin e parë është në sasinë 80 flakon (200*40%) bazuar dhe në marrëveshjes kuadër me nr. 1533/152 prot., datë 19.07.2022.

Titulli i Gjetjes:	Zbatimi i minikontratave të lidhura për Lot52 “Alteplase”.
Situata:	<p>Nga auditimi i minikontratës së furnizimit nr. 1911, datë 12.09.2022 midis Spitalit Rajonal Shkodër dhe OE “T.” Shpk për barin “Alteplase” bazuar në Marrëveshjen Kuadër të lidhur mes OQB/MSHMS dhe OE “T.” shpk u konstatua se sasia që subjekti duhet të furnizonte sipas DST për 4-mujorin e parë është në vlerën 80 flakon (200*40%).</p> <p>Me fletë hyrjen nr. 1381, datë 13.09.2022 është bërë hyrje në magazinë sasia prej 4 flakon, vlera 236,000 lekë, sipas Kontratës së furnizimit nr. 1911, datë 12.09.2022 midis Spitalit Rajonal Shkodër dhe OE “T.” Shpk. Sasia që subjekti duhet të furnizonte sipas DST për 4-mujorin e parë dhe minikontratën është në vlerën 80 flakon (200*40%) bazuar dhe në marrëveshjen kuadër me nr. 1533/152 prot., datë 19.07.2022.</p> <p>Spitali Rajonal Shkodër për mosfurnizimin në kohë të sasisë sipas minikontratës së lidhur nuk është mbajtur asnjë penalitet ose garanci e kontratës me arsyetimin se: MSHMS me shkresën nr. 1533/186, datë 25.11.2022 ka njoftuar Spitalet Rajonale për prishjen e marrëveshjes kuadër me nr. 1533/152 prot., datë 19.07.2022 bazuar në nenin 62 pika 7 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Spitali Rajonal Shkodër ka paguar OE me urdhër shpenzimit nr.610 datë 17.10.2022 dhe nuk është marrë asnjë masë ndaj subjektit për mosplotësimin e minikontratës, veprime në kundërshtim me nenin 36 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.</p>
Kriteri:	<p>- Dokumentet e tenderit;</p> <p>- Minikontrata e lidhur;</p> <p>-VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 36.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mungesë e plotësimit të nevojave të spitaleve për barna.
Shkaku:	Prishja e marrëveshjes kuadër me nr. 1533/152 prot., datë 19.07.2022 të lidhur mes OQB/MSHMS dhe OE fitues.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të kërkoj nga Spitalet Rajonale, që për minikontratat e lidhura deri në prishjes e marrëveshjes kuadër me datën 25.11.2022 dhe e perealizuara për furnizimet, sipas minikontratës nga OE “T.” shpk, që të mbahet sigurimi i kontratës.

• **Lot 9 “Docetaxel”**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 OE, nga të cilët 2 OE janë skualifikuar se nuk kanë paraqitur ofertën ekonomike, ndërsa 1 OE s’ka sigurimin e ofertës.

M.shpk është i identifikuar si i suksesshëm për këtë procedurë, me ofertën ekonomike 7,280,280 lekë. Autorizimi i prodhuesit nga A... H.. Ltd për “M.” shpk është lëshuar me datën 12.05.2022. Në DST është kërkuar 20 mg/ml - 4 ml dhe ky bar nga ky prodhues dhe i autorizuar nga AKBPM është 80mg/4ml, të cilat sipas observime janë ekuivalente.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/46 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor K.... njësinë e prokurimit. Lidhur me procedurën e prokurimit të sipërcituar për shkak të vetë numrit të madh të loteve, është një procedurë voluminoze dhe për këtë arsye nga ana e autoritetit kontraktor është gjykuar e arsyeshme përfshirja e 4 personave (e të gjithë personave përgjegjës të MSHMS) në njësinë e prokurimit. Gjithashtu, sqarojmë se materiali për prokurim është hartuar nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër nga Titullari i AK-së, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga anëtari specialist fushe (anëtar i njësisë së prokurimit), në përputhje me pikën 4 të nenit 74 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Observimi juaj nuk merret në konsideratë pasi jemi në kundërshtim të përcaktimeve ligjore të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 74 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit" **pika 2** "Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor K.... njësinë e prokurimit. Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.....".

Pretendimi i subjektit

Në pikën 1 të nenit 36 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se "Sigurimi i kontratës garanton autoritetin/entit kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet ti dorëzojë autoritetit/entit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se afati për përfundimin e garancisë së punëve/shërbimit/mallrave, kur një gjë e tillë parashikohet në kontratë." Sa më lart, në kuptim të nenit 36 të VKM nr. 285/2021, sigurimi i kontratës është një mjet me anë të së cilit garantohej autoriteti kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Pra, në përputhje me këtë nen, përse kohë gjatë zbatimit të kontratave, konkretisht gjatë zbatimit të mini-kontratave të lidhura nga Autoritetet Kontraktore Përfituese (Spitalet), ka shkelje të kontratës/mosrealizime të saj, AK palë në kontratë duhet të veprojë në përputhje me parashikimet ligjore dhe ato kontraktuale. Ky konstatim pranohet vetëm për sa i takon lajmërimin të AK përfituese palë në MK për të vepruar në përputhje me nenin 36 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për rastin në fjalë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, në lidhje me këtë pikë do të ngarkojë Spitalin Rajonal për mbajtjen e Garancisë së kontratës në rastet kur është lidhur minikontrata dhe nuk është zbatuar ajo sipas kushteve të saj. MSHMS duhet vetëm ti njoftojë për mbajtjen e kësaj garancie.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/43 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në Lidhje me rekomandimin 21.1; 22.1 dhe 23.1 të projekt raportit të auditimit nuk i pranojmë duke ripërsëritur arsyetimet e dërguara për secilin lot.

Grupi i auditimit: Observimi juaj nuk e merr në konsideratë observimin tuaj, ku për secilin lot janë arsyetuar dhe argumentuar konstatimet tona.

KVO në procesverbalin e mbajtur dhe Raportin përmbledhës nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me ndryshimin e formë dozës, sipas përcaktimeve të bëra DT dhe ato te ofertuara, edhe nëse sipas konvertimeve ato kanë qënë të njëjta, nuk është dhënë asnjë detaj. Në dosje dhe procesverbalin e mbajtur dhe Raportin përmbledhës mungojnë argumentimet kur KVO ka marrë konfirmimet nga AKBPM, e cila ju ka dhënë dakortësinë e ekuivalencës së formë dozave të ofertuara me ato të kërkuara në DT.

KVO ka vepruar me dy standarde në vlerësimin e OE ku:

- për mungesë të një autorizimi nga prodhuesi për disa Lote e ka cituar në procesverbalin e mbajtur dhe Raportin përmbledhës, si dhe në njoftimin e fituesit, se OE nuk e plotëson kushtin, ndërsa për lote të tjera nuk e ka cituar dhe as nuk ka dhënë arsyen se pse është marrë e mirëqënë.

- për OE për të cilët nuk kanë pasur të shënuar afatin kohor në autorizimi, KVO e ka përfshirë OE në paraqitjen e barnave nga ky prodhues të cilën e ka argumentuar në raportin përmbledhës dhe në Njoftimin e fituesit, ndërsa për disa lot të tjera për të njëjtën mangësi nuk është bërë vepruar me të njëjtën mënyrë. (trajtuar me hollësisht në materialin më sipër).

Titulli i Gjetjes:	Vlerësim të pabarabartë të ofertave nga KVO.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike”, ndarë në 128 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” u konstatua se për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lot32 “Trastuzumab Biosimilar ose origjinator” Autorizimi i prodhuesit nga Viatrix për “R. F.” shpk lëshuar me datën 06.05.2022 nuk është paraqitur si MAH/ Prodhuesi, si dhe nuk është e cituar nëse është kompani prodhuese apo distributor, si dhe nuk është i autorizuar nga AKBPM. Autorizimi nga F. H...-La R... Ltd, Grenzacherstrasse 124, CH-4070 Basel, Switzerland për “R. F.” shpk ka afat “This Authorization is valid for the period 2022-2023”, në kundërshtim me DST që është kërkuar 2022-2024. Sa më sipër BOE nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në DT, dhe në njoftimin e fituesit nuk është cituar se produktet nga MAH/ F. H...-La R.. Ltd, autorizimi i dorëzuar nga OE nuk plotëson kushtet e përcaktuar në DT. • Lot27 “Rituximab Biosimilar ose origjinator” BOE “E.- F.” shpk dhe “D.P.- AL” shpk është i identifikuar si i suksesshëm për këtë procedurë. Autorizimi i “P..” për “E. - F.” shpk lëshuar me datën 19.05.2022 nuk është përcaktuar afati i vlefshmërisë, sipas përcaktimeve të DST, e cila është 2022-2024. “E.- F.” shpk ka prokure nga C. H.. Hungari, e cila nuk është regjistruar në AKBPM për këtë bar. D. P.- AL shpk ka dorëzuar Autorizimi nga S... Gmbh, Austri, ku në AKBPM është regjistruar 100 mg/ 10ml dhe 500 mg, e cila nuk është në përputhje me DT, 10 mg/ml-10 ml. • Lot18 “Goserelin acetate” Autorizimi për barin “Goserelin acetate” është në process miratimi nga AKBPM për atë që prodhohet në Britaninë e Madhe. Në momenti e hapjes së ofertave bari “Goserelin acetate” i ofertuar nga “R. F.” shpk është marrë autorizimi nga “A. AB, a company incorporated in Sweden distributor”. Në ofertë dhe në deklaratën e origjinës është vënë nga Britania e Madhe, e cila është e autorizuar si bar dhe nga AKBPM dhe jo nga distributori i autorizuar. Autorizimi i AKBPM dorëzuar nga OE është jashtë afatit pasi mban datën 10.03.2017 dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE është data 17.05.2022. Sa më sipër jemi në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të DST. • Lot60 “Eptacog Alfa (Activated)” (1mg/ml after reconstitution) Në ofertën e paraqitur nga BOE është cituar se MAH/ Prodhuesi: N... No...A/S / V... P.. F.... Autorizimi i prodhuesit nga N... No...A/S për “R.... F.....” shpk lëshuar me datën 18.05.2022. Autorizimi nga prodhuesi V... P... F... nuk është i bashkëngjitur dokumentacionit në SPE siç është paraqitur në ofertën ekonomike. Në

njoftimin e fituesit nuk është përcaktuar se OE fitues duhet të lidhë kontratën vetëm për Autorizimi i prodhuesit nga N... No...A/S.

- **Lot25 “Paclitaxel”**

Autorizimin e ka marrë nga Fresenius Kabi, Austri GMBH, ndërsa ai i ofertuar në ofertë është nga India dhe Gjermania.

Në ofertë është ofertuar dhe nga W... Hungari; P... Ltd, M.. laboratory Hungary W.. GMBH Gjermani, për të cilën “R. F.” nuk ka paraqitur asnjë autorizim.

Në njoftimin e fituesit nuk është përcaktuar se OE fitues duhet të lidhë kontratën vetëm për Autorizimi i prodhuesit të dorëzuar.

- **Lot109 “Atorvastatine”**

A. - F. shpk i shpallur fitues nuk ka autorizim nga P..... për shitjen e këtij produkti, duke mos plotësuar kriteret e DT.

- **Lot28 “Rituximab Origjinator”**

Autorizimi i prodhuesit nga R.. P.. lëshuar me datën 29.04.2022 dhe formë doza e autorizuar është **Rituximab vial 100mg/10ml dhe Rituximab vial 500mg/50ml.**

AKBPM ka lëshuar autorizimin për “Rituximab Origjinator” është për 10mg/1ml me mbajtës autorizuese R. P., Zvicër, ndërsa në DST është kërkuar 10mg/50ml. Autorizimi i lëshuar nuk përmbush kushtet e DST.

- **Lot29 “Rituximab Origjinator”**

Autorizimi i prodhuesit nga R.. P..lëshuar me datën 29.04.2022 dhe formë doza e autorizuar është **Rituximab vial 100mg/10ml dhe Rituximab vial 500mg/50ml.**

AKBPM ka lëshuar autorizimin për “Rituximab Origjinator” është për 10mg/1ml me mbajtës autorizuese R. Pharma, Zvicër, ndërsa në DST është kërkuar 10mg/10ml. Autorizimi i lëshuar nuk përmbush kushtet e DST.

- **Lot52 “Alteplase”**

Subjekti ka sjellë një deklaratë që bari është i regjistruar në Agjencinë Rregullatore për barnat dhe pajisjet në Londër. Autorizimi nga prodhuesi nuk ka asnjë specifikim që prodhon këtë bar me këtë specifikime të përcaktuara në DST. KVO ka kualifikuar OE, por në dokumentacionin e dorëzuar si dhe në procesverbalin e mbajtur nga KVO nuk është cituar se si është verifikuar që bari që do sillet është brenda specifikime të përcaktuara të DT.

Për sa më sipër nga auditimi i loteve të procedurës B2 konstatohet se KVO për konstatimet e evidentuara nga grupi i auditimit për këto lotet e sipërcituara ka bërë s’kualifikimin e OE në rastin kur “*autorizimi nuk ka qenë për periudhën e përcaktuar ne DST*” ose “*...në njoftimin e fituesit e ka shpallur fitues OE vetëm për produktet që autorizimet kanë qenë në përputhje me DT*”.

Sa mësipërm është vepruar në kundërshtim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 2 pika d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik” dhe nenin 3 pika 1 e ku citon se “*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale*” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, neni 82

	“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2.
Kriteri:	Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 dhe 3. VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, neni 82, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Kualifikimi dhe shpallja fitues e subjektit në mungesë të plotësisht të të gjitha kriterëve për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Shkaku:	Moszbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë vlerësimit të ofertave të procedurave prokuruese, të merren masa të pranohen oferta kur përputhen plotësisht specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 82 si devijime të vogla, të cilat të specifikohen në raportet përmbledhëse të procedurave prokuruese, duke mbajtur në konsideratë parimet e ekonomicitetit dhe eficiencës, bazuar kriterëve të vlerësimit të çmimit më të ulët.

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në dokumentimin e saktë të veprimtarisë së KVO gjatë shqyrtimit të ofertave.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lot14 “Filgastrim” - Lot109 “Atorvastatine” - Lot104 “Iodine x 300mg/ml” u konstatua se në dosje (por dhe në SPE) nuk janë administruar kërkesat e KVO-së për ofertën anomalisht të ulët/korrigjimin e gabimeve aritmetike siç parashikohet në nenin 80 të VKM-së nr.285 datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, “Hapja e ofertave”, pika 4 “Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave”, neni 82 pika 4 “Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së”, si dhe neni 2 pika 1 & 2 germa d e j. <p>Dhe në rastin e Lot18 “Goserelin acetate” dhe Lot25 “Paclitaxel”, ku në dosje dhe në SPE nuk gjendet asnjë dokument kërkesë për sqarim dhe sqarimi nga OE i argumentuar pse vlera është kaq e ulët dhe pas kërkesës drejtuar KVO nga grupi i auditimit i u vu dispozicion sqarimi nga OE/, në të cilën nuk jepet argumentimi në lidhje me ofertën anomalisht më të ulët por, sqarohet vetëm se ky “...OE siguron dhe Garanton furnizimin e mallit 100% sipas specifikimeve teknike”, veprim në kundërshtim me neni 82 pika 4, ku citon se “... Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së”.</p>
Kriteri:	- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 93. - VKM-së nr.285 datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar neni 82;

	- Dokumentet e tenderit; - Procesverbalet e KVO-së.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në dokumentimin e saktë të veprimtarisë së KVO gjatë shqyrtimit të ofertave, duke sjellë mungesën e gjurmëve të auditimit mbi: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; • Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; • Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesi.
Shkaku:	Me arsyetimin se janë në SPE dhe nuk ka nevojë të dokumentohen.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	KVO të marrin masat e nevojshme për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas kuadrit ligjor dhe rregullator të prokurimeve. Procesverbalet dhe raportet përmbledhëse të hartuara nga KVO duhet të jenë të argumentuara me: <ul style="list-style-type: none"> - Arsyet e s'kualifikimit të OE: - Në rastin e procedurave të prokurimit të barnave, me dokumentacione bashkëshoqëruese për ndryshimet që kanë formë dozat e barit të ofertuar nga OE me atë të kërkuar në DT dhe të regjistruara në AKBPM.

Nga grupi i auditimit për lotet e barnave të audituara ka bërë verifikim në terren të zbatimit të minikontratave të lidhura nga Spitali Rajonal Shkodër, Lezhe dhe Vlorë, për të cilat nuk u konstatua problematika.

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve", konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve"			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF-80581-12-01-2020 Urdhri nr. 646, datë 24.11.2020	1.1 Grupi i hartimit kriterëve kualifikuese Urdhri nr 637 datë 19.11.2020 prot. në MSHMS me nr. 5142/1, datë 19.11.2020.	2 Njësia e Prokurimit A. P. E. L. F. B.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.646/1 datë 24.11.2020 S. K. L. Sh. L. A.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 496,000,000 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 492,000,000 lekë		6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,000,000 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Data 02.12.2020 ndryshuar me urdhrin nr. 5250/12, datë 13.01.2021	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 12 muaj			
10. Ankimime "N.. E.. T.." me datën 09.12.2020; Me datë 18.12.2020	11. Përgjigje Ankesës AK me: Kthim përgjigje "N.. E.. T.." me shkresën nr. 5250/5, datë 14.12.2020. AK ne shkresën nr. 5250/8, datë 22.12.2020		12. Përgjigje Ankesës nga KPP KPP del me vendimin nr. 5/2021, datë 08.01.2021.
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit			
13. Lidhja e kontratës Është lidhur lidhur marrëveshjen kuadër me nr. 5250/16, datë 11.02.2021 mes OE fitues "E." shpk dhe AK.	Zbatimi i kontratës: - Me urdhër shpenzimin nr. 783, datë 17.11.2021 AK/MSHMS ka likujduar OE/... shpk për faturën nr. 4937, datë 01.10.2021. - Me urdhër shpenzimin nr. 784, datë 17.11.2021 AK/MSHMS ka likujduar OE/... shpk për faturën nr. 5879, datë 19.10.2021. - Me urdhër shpenzimin nr. 926, datë 2/8.12.2021 AK/MSHMS ka likujduar OE "...." shpk për		

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me urdhrin e prokurimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 496,000,000 lekë pa TVSH, me objekt *“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve”* dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga: A. P., E. L. dhe F. B.. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga S. K., L. Sh. dhe L. A..

Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:

Specifikimet teknike për mallra dhe përlloraritja e fondit limit është hartuar nga OSHKSH dhe është përcjellë me shkresën nr. 1772/8, datë 17.11.2020, prot. në MSHMS me nr. 3849/4, datë 17.11.2020.

Me datën 20.10.2020, Komiteti i Përkohshëm Teknik ka vendosur përdorimin e testeve të shpejta.

MSHMS bazuar në vendimin e Komiteti i Përkohshëm Teknik me shkresën nr. 3849/2, datë 12.11.2020 kërkon informacion nga ISHP në lidhje me situatën epidemiologjike, si dhe domosdoshmërinë e testimit masiv të popullsisë. Me shkresën nr. 1325/2 datë 13.11.2020 dërguar nga ISHP prot. në MSHMS me nr. 3849/3 datë 13.11.2020, shprehen qartë se përdorimi i antigeneve të shpejtë është shumë eficient.

MSHMS në datën 02.11.2020 i kërkon OSHKSH-së të përllorarisë sasinë e nevojshme për teste për një periudhë 12 mujore, specifikimet teknike, fondin limit si dhe afatet dhe grafikun e lëvrimet.

Nga drejtori i OSHKSH-së, me urdhrin nr. 95, datë 06.11.2020 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve, termat e referencës, sasinë, si dhe fondit limit të nevojshëm për zhvillimin e procedurës *“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-v”*.

Grupi i punës nga OSHKSH referuar informacionit të dërguar nga AKBMP në lidhje me listën e testeve të shpejta miratuar nga OBSH dhe certifikatën e regjistrimit të këtij testi, ka dërguar ftesën për ofertë tre OE, si vijon:

1-E. shpk, shkresa nr. 1772/4 datë 11.11.2020;

2-P. shpk, shkresa nr. 1772/3 datë 11.11.2020;

3-R. F. shpk, shkresa nr. 1772/2 datë 11.11.2020.

Afati për dorëzimin e ofertës ka qenë ora 14:00, datës 12.11.2020.

Nga tre OE që ju është dërguar ftesën për ofertë, vetëm OE “E.” shpk ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1772/5, datë 12.11.2020 për çmimin për njësi 1,240 lekë pa tvsh.

Nga OSHKSH është përlloraritur një sasi prej 500,000 teste për periudhën 12 mujore.

Nga Grupi i Punës në OSHKSH është mbajtur procesverbali me nr. 1772/6 prot., datë 12.11.2020, në të cilën janë përcaktuar specifikimet, termat e referencës, sasinë, si dhe fondit limit, i cili është përcjellë në MSHMS me shkresën nr. 1772/8 prot., datë 17.11.2020, dhe protokolluar në MSHMS me nr. 3849/4, datë 17.11.2020.

Me urdhrin nr. 637, datë 17.11.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS është ngritur grupi i punës për miratimin e specifikimeve, termat e referencës, sasinë, si dhe fondit limit të nevojshëm për zhvillimin e procedurës *“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-v”* dhe *“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-v për një periudhë 12 mujore”*.

Me shkresën nr. 5142/2 prot., datë 23.11.2020 nga grupi i ngritur me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS nr. 637, datë 19.11.2020 është përcjellë procesverbali i miratimit të fondit limit dhe i specifikimeve teknike të përcjella nga OSHKSH.

Konstatim:

Në datën 24.11.2020 është mbajtur procesverbali nga Njësia e Prokurimit e ngritur me urdhrin nr. 646/1, datë 24.11.2020, në të cilën janë përcaktuar dhe argumentuar kriteret e veçanta të kualifikimit dhe vendosja e specifikimeve teknike, të cilat janë të njëjta me ato të përcaktuara në DT të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me REF-79766-11-24-2020.

Në pikën nr.2 të urdhrin nr. 637, datë 17.11.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS znj. G. P., përcaktohet se grupit të punës i caktohet miratimi i specifikimeve, termat e referencës, sasinë, si dhe fondit limit të nevojshëm për dy procedura të përcaktuara në pikën 1/germën a dhe b.

Grupi i lihet një afat tre ditor për përgatitjen e relacionit në lidhje me këto dy procedura.

NJP ka hartuar dhe miratuar dokumentet e tenderit procedurë “E hapur” (mbi kufirin e lartë monetar) me objekt *“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve”* marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, për një periudhë 12 mujore, me të njëjtat kriteret si në DT e

procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me REF-79766-11-24-2020.

Duke qenë procedurë mbi kufirin e lartë monetar, AK ka hartuar dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht, si dhe përmbledhje e njoftimit të kontratës është botuar në gazetën “Financial Time”.

Konstatimi:

Përkthimi i dokumentacionit është bërë pa realizuar asnjë procedurë paraprake blerje të vogël por është bërë blerje e drejtpërdrejtë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” neni 1 pika 2 “Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike”, neni 3 pika 2 “Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën” dhe neni 7 ku specifikohen përjashtimet e veçanta.

- Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike janë marrë identike nga procedura e mëparshme e realizuar në muajin Nëntor “procedurë negocim pa shpallje paraprake”.

AK në lidhje me Kapaciteti teknik kërkon:

- Në pikën 2.3.9. Certifikatën e regjistrimit të testit antigen pranë AKBPM sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.

10. Operatori duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Tenderi është ndërkombëtar pasi edhe DST është publikuar në anglisht dhe njoftimi i kontratës është botuar në një gazetë ndërkombëtare.

Nëse një OE i huaj që duhet të merrte pjesë në tender do të plotësonte këto dy kushte të vëna nga AK pasi për tu certifikuar pranë AKBPM, ku ka një afat minimumi 30 ditë.

Operatori për të marrë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore” të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” ka afat ligjor, e cila nuk realizohet brenda një afati kaq të shkurtër kohor.

Nga “N. E. T.” ShPK me shkresën nr. 237 prot., datë 09.12.2020, (prot MSHMS me nr. 5250/3, datë 09.12.2020), është bërë ankesë kundër dokumenteve të tenderit në lidhje me shtojcën 9, kapacitet teknike pika 2.3.1 “Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 198,000,000 Lekë, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara”.

Me urdhrin nr. 5250/4, datë 10.12.2020 është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit dhe është përcjellë për shqyrtim tek Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i ngritur me urdhrin nr. 646/1, datë 24.11.2020 me përbërje: z. S. K., znj. L. Sh. dhe znj. L. A..

Me shkresën nr. 5250/5 prot., datë 14.12.2020, KSHA i drejtohet OE për plotësimin e ankesës sipas Shtojcës 20 “Formati i ankesave pranë AK” të DST.

➤ Nga “N. E. T.” ShPK me shkresën protokolluar në MSHMS me nr. 5250/6, datë 18.12.2020, është ribërë ankesa kundër dokumenteve të tenderit në lidhje me shtojcën 9, për kapacitet teknike pika 2.3.1, ku ngre pretendimin si vijon:

Kriteri i lartpërmendur vjen në kundërshtim të plotë dhe flagrant jo vetëm me parimet kryesore dhe qëllimet e kuadrit rregullator në fuqi (neni I dhe 2 i LPP parashikon nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike, nxitje të konkurrencës ndërmjet tyre, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues, integritet, besim publik dhe transparencë, etj) por edhe me rrethanat faktike që kanë kushtëzuar dhe diktuar nevojën e kryerjes së kësaj procedure prokurimi publik. Kështu, duke ju referuar objektit të DST, bëhet fjale për blerje testesh për SARS-COV 2, një fenomen negativ i zhvilluar dhe përhapur në vend prej jo më pak se një vit. Ndërkohë që masat e ndërmarra kundër këtij fenomeni në Shqipëri, si ato me natyrë parandaluese ashtu edhe ato me natyrë kuruese kanë qenë shumë dinamike në zhvillimin e tyre, përfshirë edhe kahe diametralisht të kundërt të këtij zhvillimi. Rrjedhimisht, vetëm në Nëntor është zhvilluar një procedurë e ngjashme me procedurën

në fjalë dhe, sikundër kuptohet lehtësisht, do të ishte teorikisht dhe praktikisht i pamundur plotësimi i kriterit të lartpërmendur nga një game operatorësh të udhëhequr nga mosdiskriminimi, pjesëmarrja e gjerë në tender, transparenca, etj. Një kriter i tillë rezulton ekstremisht kufizues dhe faktor thelbësor për paracaktimin e operatorit fitues, duke rezultuar kështu në kundërshtim thelbësor dhe flagrant si me parimet e prokurimit publik, ashtu edhe me rregullat që duhet të ndiqen në zhvillimin e këtyre procedurave. Bazuar dhe referuar sa më lart, ne vlerësojmë të nevojshme heqjen e këtij kriteri si një kriter me natyrë diskriminuese, jo transparente dhe në kundërshtim të plotë me interesat publike, që ne lidhje me procedurën në fjalë kanë rëndësi jetike. Mbetemi në dispozicion dhe të angazhuar maksimalisht për t'iu siguruar çdo informacion/dokumentacion që mund të rezultojë i nevojshëm në procesin e konsultimit dhe zgjidhjes së ankesës tonë, në mënyrë që të sigurohet një mbarëvajtje e kësaj procedure në pajtueshmëri të plotë me parimet dhe kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm për zhvillimin e procedurave të prokurimit.

➤ **KSHA** pas shqyrtimit të ankesës nga “N. E. T.” ShPK del me Vendimin nr. 5250/7, datë 22.12.2020 të mos pranimit të ankesës, me arsyetimin se:

AK me shkresën nr. 5250/8, datë 22.12.2020 i kthen përgjigje subjektit, pretendimi juaj nuk qëndron. Nga “N. E. T.” ShPK me shkresën protokolluar në MSHMS me nr. 5250/9, datë 06.01.2021, është bërë ankesë kundër dokumenteve të tenderit pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

KPP del me vendimin nr. 5/2021, datë 08.01.2021, protokolluar në MSHMS me nr. 5250/11, datë 13.01.2021, ku vendosi mos marrjen në konsideratë të ankesës me arsyetimin e kalimit të afatit ligjor të ankimimit referuar nenit 26 pika 3/a të vendimit të KPP-së 596/201/8, datë 19.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të prokurimit Publik”.

Nga AK me shkresën me nr. 5250/12 prot., datë 13.01.2021 është bërë modifikimi i DST duke ndryshuar afatin për dorëzimin e ofertave në sistemin elektronik.

Ishte: 18.01.2021

Bëhet: 21.01.2021, ora 10:00.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE me ofertat si më poshtë:

Në euro

Nr.	Shoqëria	Oferta Leke PA TVSH	Kualifikuar
1	C. SRL – me Part.IVA:IT	1,596,000	S’Kualifikuar
2	E. shpk	492,000,000	Kualifikuar
3	S. shpk	496,000,000	Kualifikuar
4	K.	0	S’Kualifikuar

Pas vlerësimit të ofertave, KVO ka mbajtur procesverbalin me datën 28.01.2021.

Nga KVO janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. C. S. – me Part.IVA:IT ...** dhe ofertë ekonomike 1,596,000 euro. Adresa: Via Dell’Arte Bianca Molfetta (Ba).
- 2. K. shpk me NIPT K....A – pa ofertë ekonomike.**

Me arsyet si mëposhtme:

1. Shoqëria, **K. shpk**- me **NIPT K....A** – nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të vecanta për kualifikim. Gjithashtu kjo shoqëri nuk kanë dorëzuar ofertë ekonomike. Rrjedhimisht oferta e kësaj shoqërie rezulton si jo e plotë dhe e parregullt.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE **C. SRL – me Part.IVA:IT ...** rezultoi se: Në lidhje me pikën 2 *Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST pika 2.1.a Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)*; Operatori ekonomik nuk e ka plotësuar formularin sipas *Shtojcës 1 të DST*, ku oferta e paraqitur rezulton në Euro dhe gjithashtu nuk është pasqyruar fakti nëse oferta e ka të përfshirë TVSH-në në çmimin e ofertuar apo jo.

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST, konkretisht me Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “*Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme*”.

- Konkretisht Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, 2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se 198,000,000 Lekë, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. **Në lidhje me këtë kriter rezulton se OE nuk ka paraqitur asnjë kontratë.**

- Në DST pika 2.3.3 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për artikullin e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shënohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe). Në lidhje me këtë kriter rezulton se katalogët teknikë për artikullin e ofertuar nuk janë të plotë dhe nuk përmbajnë instruksione përdorimi. Gjithashtu nuk rezulton të jenë të markuar sipas kërkesave në DST.

- 2.3.5 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import, eksport, tregtim të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. OE nuk ka paraqitur dokumenta që vërtetojnë plotësimin e këtij kriteri.

- 2.3.9 Çertifikatën e regjistrimit të testit antigen pranë AKBPM sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi. Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri rezulton që ky OE nuk ka paraqitur çertifikatën e regjistrimit të testit antigen, por vetëm një formular jo formal.

- 2.3.10 Operatori duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk rezulton që të jetë paraqitur një dokumentacion i tillë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me përmbushjen e specifikimeve teknike rezulton që nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST.

Konkretisht kërkohet:

- “Testet e antigenit të jenë të aprovuara dhe të renditen në listën e OBSH-së (WHO)” – Pas verifikimeve rezulton se artikulli i ofertuar nuk është i aprovuar në listën e OBSH-së. Shiko linkun: https://extranet.who.int/pqweb/sites/default/files/documents/201215_EUL_SARS-CoV-product_list.pdf

- “Testi të jetë i regjistruar pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” - OE nuk e ka sjellë një certifikatë që provon këtë specifikim.

- “Të kryhet në mostra të hundës, faringut ose nazofaringealit” – vetëm nasale.

- “Të ketë specifikim klinik > 99% per SARS-CoV-2” – e ka 97.32%.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE “E.” shpk, nga grupi i auditimit u konstatua se: “E.” shpk ka ofertuar se produktet do të jenë nga prodhuesit, R.. D....GmbH, / SD B....., A....Rapid Diagonka.

Dokumentacioni i dorëzuar për të plotësuar kriterin **2.3.3 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për artikullin e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shënohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe) dhe 2.3.8 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/ të artikujve të ofruar. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë” të DST noterizuara dhe të përkthyer janë në emrin e shoqërisë “P.”, pasi është ky OE, i cili ka autorizimin e prodhuesit “A. R. Diagnostics J.. GmbH” për tregtimin e këtij produkti të tenderuar. Ndërsa për produktin SD B..... katalogë teknikë për artikullin e ofertuar nuk ka të numrin e “CAT number 99COV30D” por vetëm referencën 9901-NCOV-01G si dhe R.... order number: 09327592.**

OE/ S. shpk. i cili ka marrë pjesë dhe ka ofertuar të njëjtat produkte, në katalogun e dorëzuar për produktet e SD B..... është i përcaktuar CAT number sipas rregullave të përmbajtjes së një katalogu.

Pikën 2.3.7 kërkohet ”Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregtimit të artikujve të tij”.

OE E. shpk ka autorizim nga R.. D....GmbH, të lëshuar në 12.12.2019 si distributor për produktet e prodhuara nga R.D.

E. shpk nuk ka paraqitur autorizim nga distributori ”R.. D....GmbH”, ku SD B... me autorizimin e datës 06.11.2020 autorizon R.. D....GmbH të shpërndajë shesë dhe të ofrojë suport për produktet e autorizuar, i cili është i vlefshëm deri me datë 31.12.2022.

- OE E. shpk është distributor për produktet e prodhuara nga SD B... për produktet sars Cov 2 antigen Rapid Test dhe control me ref: 9901-NCOV-01G dhe 9901-C-NCOV-01G lëshuar me datën 25.11.2020, si dhe për regjistrimin e tij në AKPBM me reference 9901-NCOV-01G CAT number 99COV30D, **në të cilën nuk është përcaktuar afati nëse ky autorizim është brenda realizimit të kontratës.**

OE/ S. shpk ka paraqitur po autorizimin e prodhuesit SD B. të lëshuar me datën 20.01.2021, në të cilin ka përcaktuar dhe afatin kohor deri me datë 31.12.2021.

Sa më sipër pika 2.3.7 e DT nuk plotësohet.

E. shpk ka një autorizim për tender nga “P.” shpk me datën 12.01.2021, ku jep garancinë për furnizimi dhe dorëzim të produkteve “A. R. D.J. GmbH”(411FK10 Panbio Covid-19 rapid test device), **në të cilën nuk është përcaktuar afati i vlefshmërisë së këtij autorizimi.** “P.” i ka lëshuar autorizimin për të marrë pjesë në të njëjtën procedurë dhe subjektit S. shpk.

Certifikata, deklaratat e konfirmimit, Autorizimin e datës 14.01.2021, zbatimi i akteve të pajisjeve mjekësore, katalogu i përkthyer i produktit që do të ofertohej nga prodhuesi Abbott janë të lëshuar për shoqërinë “P.”.

Vetëdeklarata për aprovimin dhe renditjen në listën e OBSH-së (WHO) E. Shpk shprehet se:

“Materialet mjekësore të ofertuar nga (teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-CoV-2 të prodhuara nga A... R...D... J.. GmbH dhe SD B...r, Inc me mbajtës të autorizuar R.. D....GmbH), janë të aprovuara dhe të renditura në listën e OBSH, me saktësisht në linkun: [201125_EUL_SARS-CoV-2_product_list.pdf \(who.int\)](https://www.who.int/publications/m/item/201125_eul_sars-cov-2_product_list.pdf)”.

Certifikata e regjistrimit të testit antigen pranë AKBPM për të plotësuar kriterin Certifikatën e regjistrimit të testit antigen pranë AKBPM sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi” është lëshuar në emër të “P.”. Për produktin SD B., Inc është lëshuar për E. shpk.

AK me shkresën nr. 5250/15 datë 08.04.2021 nëpërmjet njoftimit të OE të suksesshëm në marrëveshjen kuadër, informon OE “E.” shpk si ofertë e suksesshme, ku kërkon paraqitjen e garancisë së kontratës brenda 5 ditëve nga marrja e publikimit.

AK ka lidhur marrëveshjen kuadër me nr. 5250/16, datë 11.02.2021 me OE fitues “E.” shpk.

OE ka plotësuar dokumentacionin vetëm për një produkt nga prodhuesi “A... R... D... J.. GmbH” të cilat janë lëshuar në emër të OE “P.” shpk.

Bashkëpunimi midis OE “E.” shpk dhe “P.” është bërë vetëm me një autorizim për të shitur produktet pa përcaktuar afatet për të cilin ky autorizim është i vlefshëm, i cili është i pashoqëruar nga kontrata e bashkëpunimi midis 2 OE.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/48 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Në përputhje me Urdhrin Nr. 637 datë 19.11.2020 (Nr. 5142/1 Prot., datë 19.11.2020) “Për ngritjen e grupit të punës për miratimin e specifikimeve teknike, termave të referencës, sasive, si dhe fondit limit të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të prokurimit me objekt “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për Sars-Cov-2 për nevoja emergjente të NJVKSH-ve” dhe “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për Sars-Cov-2 për nevoja të NJVKSH-ve për një periudhë 12 mujore” grupi i punës ka dorëzuar materialin për prokurimin për kryerjen e

procedurës emergjente (procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit), si dhe njëkohësisht materialin për prokurimin për një periudhë 12 mujore (procedura e hapur, mbi kufirin e lartë monetar). Pra, grupi i punës ka paraqitur të gjithë materialin e nevojshëm për prokurim me specifikimet teknike dhe fondin limit (për secilën procedurë prokurimi). Kriteret e veçanta të kualifikimit janë vendosur në proporcion me objektin e prokurimit sipas RRPP dhe LPP.

2. Në pikën 2 dhe 8 të nenit 43 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 52 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore për marrjen e ofertave, të parashikuara në pikat 2 e 5 të këtij neni, për procedura të hapura, mund të shkurtohen 7 ditë, ndërsa afatet kohore për marrjen e kërkesës për pjesëmarrje, të parashikuara në shkronjat "a" e "b" të pikës 3 dhe në shkronjat "a" e "b" të pikës 6 dhe të pikës 6/1 të këtij neni, për procedurat e kufizuara, shërbim konsulence, konkurs projektimi dhe me negociim, mund të shkurtohen 5 ditë." Pra, duke u bazuar në legjislacionet e mësipërme, rezulton se cdo operator ekonomik i interesuar shqiptar ose i huaj, ka pasur gjithë kohën e mundur për të plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në DST.

3. Në përmbushje të këtij kriteri në katalog Të gjithë elementët e kërkuar janë të pasqyruar në katalogun e paraqitur nga OE E... shpk, pra kjo do të thotë se katalogu është i konfirmuar për saktësinë dhe plotësimin e cdo kërkesë të DST. Gjithashtu, risjellim në vëmendjen tuaj se me të njëjtën referencë është regjistruar ky produkt edhe pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) e provuar me dokumentin Certifikata Regjistrimit të ngarkuar në SPE. Po ashtu edhe autorizimi nga prodhuesi SD B... si për R.. D..., ashtu edhe për OE E... shpk, është për të njëjtin produkt me Ref Number 9901-NCOV-01G dhe me R.. Reference Number 09327592190, shoqëruar edhe me një deklaratë në lidhje me ekuivalencën mes produktit Sars Cov2 Rapid Antigen Test të prodhuar për R... Diagnostics me ref number 9901-NCOV-01G catalog number 99COV30D dhe testit Standard Q Covid -19 Ag Test, me ref number Q-NCOV-01G cat 09COV30D (i cili është produkti i ofertuar nga OE Swissmed).

4. Ndryshe nga sa është konstatuar, rezulton se OE E. shpk ka paraqitur autorizim si nga prodhuesi – SD B..., i cili konfirmon OE E.. shpk si distributor për Shqipërinë, ashtu edhe nga R.. D.. që është caktuar nga SD B..... si distributor dhe MAH global (dokumentacioni i përmendur do ta gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese). -OE E. shpk ka paraqitur edhe Autorizimin e marrë nga R.. D.. te datës 12.12.2019, i cili përcakton se E.. shpk është distributor i vetëm për produktet R.. D.. në Shqipëri (produkti Sars Cov2 Rapid Antigen Test me Ref Number 9901-NCOV – 01G është produkt i prodhuar nga SD B... për R.. D...) Pra, ky autorizim provon se duke filluar nga data 01.01.2020, (duke mos u vendosur një afat i caktuar si moment përfundimi të këtij autorizimi), E... shpk është distributor i vetëm në RSH për të gjitha produktet R.. D... ekzistuese në datën e lëshimit të autorizimit dhe ato që bëhen pjesë e portofolit të R.... në vijim, siç është produkti në fjalë, për sa kohë, ky autorizim nuk revokohet nga vetë R..., si dhe për sa kohë zgjat autorizimi që R.... ka nga prodhues të tjerë.

5. Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik të Krieteve të Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 9 të DST, sqarojmë se në përmbushje të kërkesës së vendosur në këto dokumente, pra të provohet lidhja e distributorit me prodhuesin, është paraqitur edhe autorizimi i prodhuesit A... për distributorin P... i datës 14.01.2021. (dokumentet e përmendura më lart do ti gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese). Pasi është provuar lidhja e distributorit me prodhuesin (P... shpk me A...) dhe më pas e distributorit me ofertuesin (P..s shpk me E... Shpk), çdo dokumentacion i dorëzuar nga ofertuesi OE E... shpk, siç janë konstatuar nga KLSH: certifikata, deklaratat e konformitetit, autorizimi i datës 14.01.2021, etj. është konform dhe në përmbushje të krieteve të përcaktuara nga AK/MSHMS në këto DST.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

- Observimi juaj nuk merret në konsideratë pasi përgatitja 3 ditore e specifikimeve dhe të vlerës së mallit të blerë për të cilin nuk është bërë studim i mëtejshëm për çmimet dhe për specifikimet por janë marrë identike nga procedura e mëparshme e realizuar në muajin Nëntor “procedurë negociim pa shpallje paraprake” e realizuar në kushte emergjente.

- Observimi juaj nuk merret në konsideratë, pasi specifikimet e vendosura duhet të jenë të plotësueshme në kohë nga OE që marrin pjesë pasi siç është cituar dhe akt konstatim “Nëse një OE i huaj që duhet të merrte pjesë në tender do të plotësonte këto dy kushte të vëna nga AK pasi për tu certifikuar pranë AKBPM, ku ka një afat minimumi 30 ditë. Operatori për të marrë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore” të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” ka afat ligjor, e cila nuk realizohet brenda një afati kaq të shkurtër kohor.

- Observimi juaj nuk merret në konsideratë katalogë teknikë për artikullin e ofertuar nuk ka të numrin e “CAT number 99COV30D”, me të cilin verifikohet dhe miratimi i këtij malli tek WHO. “Product code(s)”.

- Observimi juaj nuk merret në konsideratë pasi E. shpk nuk ka paraqitur autorizim nga distributori ”R.. D...GmbH”, për produktet të cilat nuk i prodhon vete, si dhe autorizimi nga prodhuesi SD B..... për produktet sars Cov 2 antigen Rapid Test dhe control me ref: 9901-NCOV-01G dhe 9901-C-NCOV-01G lëshuar me datën 25.11.2020, si dhe për regjistrimin e tij në AKBPM me reference 9901-NCOV-01G CAT number 99COV30D, **në të nuk është përcaktuar afati nëse ky autorizim është brenda realizimit të kontratës.** Gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga OE mban datën 25.11.2020, e cila përkon me procedurën e fituar të negociimit pa shpallje të Rapid testeve.

- Problematika e konstatuar nga grupi është afati i vlefshmërisë së autorizimit pasi kemi të bëjmë me marrëveshje kuadër, ku vlefshmëria e autorizim duhet të sigurojë besueshmërinë realizimit të kontratës si dhe i pashoqëruar nga

kontrata e bashkëpunimi midis 2 OE. Në lidhje me kriteret e vendosura në fakt kjo duhet të jetë përgjegjësi dhe e grupit të hartimit të kriterëve të cilët duhet ta kishte cituar.

Titulli i Gjetjes:	Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk janë të argumentuar dhe mundësisht të plotësueshme nga OE që duan të marrin pjesë. Kualifikimi dhe shpallja fitues e subjektit në mungesë të plotësisht të të gjitha kriterëve për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt <i>“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve”</i> u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me urdhrin nr. 637, datë 17.11.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS është ngritur grupi i punës për miratimin e specifikimeve, termat e referencës, sasitë, si dhe fondit limit të nevojshëm për zhvillimin e procedurës <i>“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-v”</i> dhe <i>“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-v për një periudhë 12 mujore”</i>. <p>Nga Njësia e Prokurimit e ngritur me urdhrin nr. 646/1, datë 24.11.2020, në datën 24.11.2020 është mbajtur procesverbali, në të cilën janë përcaktuar dhe argumentuar kriteret e veçanta të kualifikimit dhe vendosja e specifikimeve teknike, <i>të cilat janë të njëjta me ato të përcaktuara në DT të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me REF-79766-11-24-2020.</i></p> <p><i>Sa më sipër për procedurën mbi kufirin e lartë monetar nuk është bërë asnjë studim i mëtejshme i çmimeve të tregut dhe nuk janë rishikuar specifikimet teknike të vendosura, të cilat duhet të ishin sa më të argumentuar dhe mundësisht të plotësueshme nga OE që duan të marrin pjesë.</i></p> <p>Në specifikimet teknike është përcaktuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në pikën 2.3.9. Certifikatën e regjistrimit të testit antigen pranë AKBPM sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi. <p>10. Operatori duhet të paraqesë <i>“Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”</i>, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 <i>“Për pajisjet mjekësore”</i>.</p> <p>Tenderi është ndërkombëtar pasi edhe DT është publikuar në anglisht dhe njoftimi i kontratës është botuar në një gazetë ndërkombëtare.</p> <p>Nëse një OE i huaj që duhet të merrte pjesë në tender, duhet të plotësonte këto dy kushte të vëna nga AK por:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për tu certifikuar pranë AKBPM ka një afat minimumi 30 ditë, sipas përcaktimeve të ligjit Ligjit 89/2014 <i>“Për pajisjet mjekësore”</i> neni 13 <i>“Procesi i regjistrimit”</i> pika 2 - Operatori ekonomik për të marrë <i>“Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”</i> të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 <i>“Për pajisjet mjekësore”</i> neni 21, ka afat ligjor, e cila nuk realizohet brenda një afati kaq të shkurtër kohor. <p>Kjo ka ardhur si rrjedhojë e urdhrin nr. 637, datë 17.11.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS znj. G. P., ku në pikën nr. 2 citon se <i>“...grupit të punës i caktohet miratimi i specifikimeve, termat e referencës, sasitë, si dhe fondit limit të nevojshëm për dy procedura të përcaktuara në pikën 1/germën a dhe b. Grupi i lihet një afat tre ditor për përgatitjen e relacionit në lidhje me këto dy procedura”</i>.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE fitues rezultoi se: Dokumentacioni i dorëzuar për të plotësuar kriterin 2.3.3 <i>“Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për artikullin e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull”</i>. <p><i>Katalogë teknikë për artikullin e ofertuar për produktin SD B..... nuk ka të numrin e “CAT number 99COV30D, i cili është numri i “Product code(s)”, të aprovuara dhe të renditura në listën e OBSH, me saktësisht në linkun: 201125_EUL_SARS-CoV-2_product_list.pdf (who.int)”</i>.</p>

	<p>Pikën 2.3.7 kërkohet ”Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregtimit të artikujve të tij”.</p> <p>OE ka dorëzuar autorizim nga R.. D....GmbH, të lëshuar në 12.12.2019 si distributor për produktet e prodhuara nga R.... D..., por nuk ka paraqitur autorizim nga distributori ”R.. D....GmbH”, ku SD B..... me autorizimin e datës 06.11.2020 autorizon R.. D....GmbH të shpërndajë shesë dhe të ofrojë suport për produktet e autorizuara, i cili është i vlefshëm deri me datë 31.12.2022.</p> <p>- OE E. shpk është distributor për produktet e prodhuara nga SD B..... për produktet sars Cov -2 antigen Rapid Test lëshuar me datën 25.11.2020, në autorizim nuk është përcaktuar afati nëse është brenda realizimit të kontratës.</p> <p>- OE fitues ka një autorizim për tender nga “P.” shpk me datën 12.01.2021, ku jep garancinë për furnizimi dhe dorëzim të produkteve “A... R... D.. J.. GmbH”(411FK10 Panbio Covid-19 rapid test device), në të cilën nuk është përcaktuar afati i vlefshmërisë së këtij autorizimi, duke qenë se jemi në kushtet e një marrëveshje kuadër 12-mujore.</p> <p>Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT, konkretisht me Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.</p> <p>Si dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 3.</p>
Kriteri:	<p>- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 55, pika 3.</p> <p>- VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 3.</p> <p>- VKM-së nr.285 datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar neni 82,pika2.</p> <p>- Dokumentet e tenderit.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Specifikimet teknike nuk kanë mundësuar trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit Mos studimi i tregut për çmimin e mallrave që po prokurohen, duke ndikuar në një përdorim pa efektivitet, eficence, ekonomicitetet e fondeve publike. Dokumentacioni i dorëzuar nga OE është i paplotë, i cili nuk jep siguri të arsyeshme nëse malli që do ofertojë do të jetë gjatë gjithë periudhës 12 mujore të Marrëveshjes Kuadër.</p>
Shkaku:	<p>Si rrjedhojë e urdhrin nr. 637, datë 17.11.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS ku citohet se “Grupi i lihet një afat tre ditor për përgatitjen e relacionit në lidhje me këto dy procedura”. Specifikimet teknike dhe cmimim janë hartuar duke marrë identike si të procedurës negocim pa shpallje paraprake.</p>
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Titullari i AK/MSHMS të marrë masa në vijimësi që për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe - procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik nga komisionet e vlerësimit të ofertave, me qëllim rritjen e eficencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në

përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara në plotësimin e nevojave të AK.
--

Zbatimi i kontratës:

Mes AK dhe OE fitues “E.” shpk është lidhur marrëveshja kuadër me nr. 5250/16, datë 11.02.2021, “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve” për një periudhë 12 mujore, për sasinë 400,000 teste.

Me urdhërin nr 384, datë 07.09.2021 është bërë “Ngritja e komisionit për dhënien dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës” me anëtar F.B.; H.T. dhe N.A..

Në DST është përcaktuar që afatet e lëvrimit:

Me qellim mbulimin në kohë dhe pa vonesa për sigurimin e testimin të pandërprerë dhe për menaxhimin sa më efikas të nevojave dhe burimeve financiare në dispozicion, sasi të dhe afatet e lëvrimit për **periudhën 12 mujore do të jenë:**

- 10% e sasisë totale të mallit të lëvrohet brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës;
- 30% e sasisë totale të mallit të lëvrohet brenda 3 mujorit të parë nga nënshkrimi i kontratës;
- 30% e sasisë totale të mallit të lëvrohet brenda 3 mujorit të dytë nga nënshkrimi i kontratës;
- 30% e sasisë totale të mallit të lëvrohet brenda 3 mujorit tretë nga nënshkrimi i kontratës.

Nga auditimi i lidhjes së minikontratave është konstatuar se ato janë lidhur në muajt Tetor dhe Dhjetor, mbas 7 muajve me vonesë.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Neni 52 “Marrëveshjet kuadër” pika 3 “Kur një marrëveshje kuadër lidhet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Për dhënien e këtyre kontratave, autoritetet ose entet kontraktore i kërkojnë operatorit ekonomik palë në marrëveshjen kuadër ofertën e tij, sipas nevojës’.

Procedura është realizuar për plotësimin e kërkesave, të cilat kanë qenë emergjente për përballimin e situatës pandemike Covid-19.

Në dosje nuk ka asnjë dokument ku të argumentohet se kush është arsyeja e lidhjes me vonesë të këtyre minikontratave.

Me urdhrin nr. 384, datë 07.09.2021 “Për ngritjen e komisionit për dhënien dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës/ave të bazuar në marrëveshjen kuadër objekt “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve” për një periudhë 12 mujore sipas listës së miratuar nga OBSH” marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

OSHKSH me shkresën nr. 2337, datë 31.08.2021 prot., në MSHMS me nr. 3641, datë 31.08.2021 bën kërkesë për marrjen e masave për furnizim me teste antigen të njësisë të shërbimit të kujdesit shëndetësorë. MSHMS me shkresën nr 3708/1prot., datë 09.09.2021 fton “E.” shpk për të paraqitur ofertën për sasinë 94,850 copë Rapid Test Sars Cov-2, brenda datës 10.09.2021.

E. shpk me shkresën prot., në MSHMS me nr. 3708/2 datë 10.09.2021 dorëzon ofertën ekonomike në vlerën prej 1230 lekë/njësi.

MSHMS dhe OE E. shpk kanë lidhur kontratën e furnizimit me nr. 3708/3 datë 01.10.2021, bazuar në marrëveshjen kuadër nr. 5250/16, datë 11.02.2021 në nenin 5 të kontratës është përcaktuar, që 10% e sasisë së mallit duhet të lëvrohet menjëherë me lidhjen e kontratës dhe 90% e saj brenda muajit nga nënshkrimi i minikontratës.

Njoftimi i lidhjes së kontratës së nënshkruar është bërë me shkresën nr. 3708/5, datë 01.10.2021.

MSHMS me shkresën nr. 3708/4, datë 01.10.2021, njofton OSHKSH marrjen e masave për realizimin e minikontratës dhe ngritjen e grupeve të punës nga Drejtoria Qendrorë e OSHKSH për marrjen në dorëzim të mallit.

Me urdhër shpenzimin nr. 783, datë 17.11.2021 AK/MSHMS ka likuiduar OE/E. shpk për faturën nr. 4937, datë 01.10.2021.

Nga OSHKSH me shkresën nr. 2680/2 prot., datë 01.10.2021 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 9485 teste antigen në bazë të kontratës nr. 7308/3, datë 01.10.2021. DQOSHKSH ka bërë hyrjen e sasisë prej 9485 teste në shumën prej 13,99,9,860 lekë, me fletë hyrje nr. 16 datë 01.10.2021. Malli i dorëzuar nga OE është i markës “R.. D...GmbH”.

Me urdhër shpenzimin nr. 784, datë 17.11.2021 AK/MSHMS ka likuiduar OE /E. shpk për faturën nr. 5879,

datë 19.10.2021.

Nga OSHKSH me shkresën nr. 2680/3, datë 19.10.2021 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 85,365 teste antigen në bazë të kontratës 7308/3, datë 01.10.2021, nga të cilat janë magazinuar 30,000 testera pranë DQOSHKSH dhe 55,365 testera u magazinuan në ruajtje pa tarifë magazinimi, pranë magazinave të OE "E." shpk.

Sa më sipër DQOSHKSH ka bërë hyrjen e sasisë prej 85,365 teste në shumën prej 125,998,740 lekë, me fletë hyrje nr. 17 datë 19.10.2021. Malli i dorëzuar nga OE është i markës "Roc174"

Me urdhër shpenzimit nr. 926, datë 2/8.12.2021 AK/MSHMS ka likuiduar OE "E." shpk për faturën nr. 9402, datë 21.12.2021 në vlerën prej 44,280,000 lekë.

Nga OSHKSH me shkresën nr. 2680/8, datë 21.12.2021 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 30,000 teste antigen në bazë të kontratës 7308/8, datë 21.12.2021. DQOSHKSH ka bërë hyrjen e sasisë prej 30000 teste në shumën prej 44,280,000 lekë, me fletë hyrje nr. 22, datë 21.12.2021. Malli i dorëzuar nga OE është i markës "R.. D...GmbH".

Me urdhër shpenzimit nr. 927, datë 28.12.2021, AK/MSHMS ka likuiduar OE "E." shpk për faturën nr. 9472, datë 23.12.2021, në vlerën prej 398,520,000 lekë.

Nga OSHKSH me shkresën nr. 2680/10, datë 23.12.2021 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të 270,000 teste antigen në bazë të kontratës 7308/8, datë 21.12.2021. të cilat janë magazinuar pranë në ruajtje pa tarifë magazinimi, pranë magazinave të OE "E." shpk.

Sa më sipër, DQOSHKSH ka bërë hyrjen e sasisë prej 270,000 teste në shumën prej 398,520,000 lekë, me fletë hyrje nr. 23 datë 23.12.2021.

Malli i dorëzuar nga OE është i markës "R.. D...GmbH" dhe 150,000 teste të markës "About".

"R.. D...GmbH" nuk është prodhues i testeve antigen, është distributor i SD B.... dhe malli i dorëzuar nuk duhet të jetë i markuar në emrin e R.. D...GmbH.

Nga auditimi u konstatua se MSHMS, për vitin 2021 ka marrë donacionet nga OBSH në lidhje me produktin "Covid-19 AG RAPID Devica 25T" në sasinë 18,000 copë bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 2, datë 15.01.2021 dhe sasinë 182,000 copë bërë hyrje nr. 5 datë 02.03.2021.

Sasi e transferuar e testeve donacion në vitin 2021 është në sasinë 184,250 copë, bërë dalje me fletë daljen nr. 2, datë 27.01.2021 në Qendrën e Kujdesit Shëndetësore në sasinë 18,000, me fletë daljen nr. 9, datë 11.03.2021 në OSHKSH Tiranë në sasinë 182,000 copë, me fletë daljen nr. 50, datë 07.08.2021 në Q.K.U. Mjekësorë Tirane në sasinë 2500 copë dhe me fletë daljen nr. 51, datë 14.09.2021 në OSHKSH Tiranë në sasinë 163,750 copë. Pra një total prej 366,250 copë.

Sa më sipër, AK/MSHMS ka pasur gjendje "antigenet rapid teste", të cilat kanë ardhur nga donacionet, nga ku konstatohet se sasia e prokuruar dhe minikontratave të furnizimit bazuar në marrëveshjen kuadër është bërë në kushtet, kur AK ka pasur në dispozicione antigen të marrë nga donacionet.

Sa më sipër grup i auditimit konkludoi se:

Lidhja e minikontratave është bërë në muajt Tetor dhe Dhjetor, mbas 7 muajve që nga lidhja e marrëveshja kuadër.

Lidhja minikontratave mbas 7 muajve me vonesë, kur procedura është realizuar për plotësimin e kërkesave, të cilat kanë qenë emergjente për përballimin e situatës pandemike Covid-19, janë veprime në kundërshtim me Ligjin 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 52 "Marrëveshjet kuadër" pika 3 "Kur një marrëveshje kuadër lidhet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Për dhënien e këtyre kontratave, autoritetet ose entet kontraktore i kërkojnë operatorit ekonomik palë në marrëveshjen kuadër ofertën e tij, sipas nevojës".

Në dosje nuk ka asnjë dokument ku të argumentohet se kush është arsyeja e lidhjes me vonesë të këtyre minikontratave.

- Nga auditimi i urdhër shpenzimeve të likuidimit të minikontratave dhe nga procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallrave nga OSHKSH, u konstatua se një pjesë e mallit të marrë në dorëzim nga ana dokumentare me procesverbale dhe fletë hyrje është magazinuar në ruajtje pa tarifë magazinimi, pranë magazinave të OE. Konkretisht:

- Sasia e marrë në dorëzim prej 55,365 teste me datën 19.10.2021
- Sasia e marrë në dorëzim prej 270,000 teste me datën 23.12.2021

- Nga procesverbal e marrjes në dorëzim të mallrave nga OSHKSH, sipas minikontratave të lidhura nga MSHMS, cilësohet se malli i dorëzuar nga OE është i markës “R.. D...GmbH”.

Malli i marrë në dorëzim nuk përputhet me dokumentacionin e dorëzuar në DT pasi “R.. D...GmbH” nuk është prodhues i testeve antigen, është distributor i SD B..... dhe malli i dorëzuar nuk duhet të jetë i markuar në emrin e “R.. D...GmbH”. Veprime në kundërshtim me marrëveshjen kuadër me nr. 5250/16, datë 11.02.2021 dhe specifikimeve të DT.

- Gjithashtu u konstatua se nga MSHMS, për vitin 2021 janë marrë donacionet nga OBSH në lidhje me produktin “Covid -19 AG RAPID Devica 25T” në sasinë 18,000 copë bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 2, datë 15.01.2021 dhe sasinë 182,000 copë bërë hyrje nr. 5 datë 02.03.2021, sasi gjendje “antigenet rapid teste” për të cilën nga AK nuk janë marrë në konsideratë, duke ndikuar në fryrjen e nevojave të institucionit për këto teste.

Rrjedhimisht:

- Realizimi i procedurës për plotësimin e nevojave emergjente nuk përputhet me nevojat faktike që ka institucioni, duke prokuruar nevoja për mallra pa një planifikim të saktë të tyre.

- Nevojat për “Rapid test” kanë qenë të paargumentuara nga institucioni, pasi janë marrë në dorëzim dhe nuk ka pasur hapësirë fizike për t’i magazinuar mallrat e prokuruar.

Kthim përgjigje për të gjitha Observimet të cilat kanë të bëjnë me konstatimin e shpenzimeve të përkthimit.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/43-53 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë: Pretendimi i subjektit: . Përkthimi është bërë në zbatim të ligjit 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” bazuar në nenin 6 pika 1 dhe në nenin 11 “Tarifat e shërbimit”. Duke qene se tarifat janë të përcaktuara në bazë të nenit ato janë të pandryshueshme në zbatim të ligjit 162/2020 të LPP neni 1 pika 2 dhe 3 dhe neni 7 pika 1 “Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit për.....” dh) shërbime përmbartimi dhe shërbime të tjera ligjore, të cilat lidhen, qoftë edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar; sqarojmë se ky përkthim është ndihmë juridike.

Grupi i auditimit: Observimi juaj nuk merret në konsideratë pasi kemi të bëjmë me një shërbim të realizuar dhe në asnjë moment ligji nuk e përcakton se duhet të jete i përjashtuar nga prokurimi publik. Nga MSHMS është shmangur konkurrenca duke i dhënë të drejtën e përkthimit vetëm një personi të kontraktuar, i cili është përzgjedhur pa asnjë procedurë. Grupi i auditimit nuk ka folur në asnjë moment për tarifat e kontraktuara pasi ato janë të mirëpërcaktuara. Ky është një shërbim i cili duhet të ishte reflektuar në regjistrin e planifikimit të procedurave të prokurimit si blerje e vogël ose si marrëveshje kuadër. Ky shërbim nuk përbën ndihmë juridike në asnjë moment është shërbim i realizuar.

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: “Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare Transfuzionit të Gjakut Tiranë”, viti 2022, fond limit 158,972,395 lekë pa Tvsh, konstatohet:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i godinës së QKT Gjakut Tiranë” 2022			
1. Lloji/ Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur” REF-20266-02-22-2022	2. NjP UP nr. 03 datë 07.01.2022 1. A. P. 2. E. L. 3. Ing. D. K.	3. KVO Urdhri nr. 03/2 datë 18.02.2022 1. S.K. 2. V. H. 3. E. H.	3.1 KSHA Urdhri nr. 03/3 datë 29.04.2022 1. O.A. 2. V. Dh. 3. E.A.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 158,972,395 lekë	5. Oferta fituese 116,869,692 lekë Operatori Fitues: “A. C.” sh.p.k	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 42,102,703 lekë ose zbritur 26.4 % nga F.L	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 16.03.2022 ndryshohet 23.03.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 18 OE b) S’kualifikuar 16 OE, c) Kualifikuar 2 OE	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga			

dorezimi i sheshit		
10. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP	11. Përgjigje Ankesës nga AK:	12. Përgjigje Ankesës

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:

Dokumentacioni i nevojshëm dhe projekti është përcjellë nga QKTGJ me nr. 286/1 prot. Date 16.12.2021 me objekt “Kërkesë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i godinës së QKT Tiranë”. Me Urdhrin e Prokurimit nr. 03, date 07.01.2022. Me procesverbalin e datës 28.02.2022, njësia e prokurimit ka argumentuar kriteret e veçanta kualifikuese, duke argumentuar ato në përputhje me projekt-preventivin.

Titulli i Gjetjes	Në procedurën e prokurimit: “ <i>Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare Transfuzionit të Gjakut Tiranë</i> ” Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave.
Situata:	<p>Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 20.04.2022, me fond limit 158,972,395 lekë pa TVSH, referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, ka kualifikuar 2 (dy) B/OE nga 18 pjesëmarrës dhe ka shpallur fitues OE “A. C.” shpk me ofertë 116,869,692 lekë pa TVSH. Nga auditimi i dokumentacionieve të operatorëve ekonomik konstatohet se OE ED K. shpk me ofertë 131,940,465 lekë pa TVSH, është s’kualifikuar padrejtësisht pasi nga KVO është konstatuar se oferta e tij ka gabime në preventivin e paraqitur nga ky operator ka një ndryshim volumi përkatësisht në vlerën e volumit nga vlera 0.002 ton në vlerën 0.00 ton. Nga auditimi i ofertës së OE “ED K.” shpk, konstatohet se oferta e tij nuk ka gabime, ku në dukje sasia e rrumbullakosur është 0.00, por shumëzimi me çmimin do rezultonte vlera prej 460 lekë dhe për këtë arsye ky operator nuk duhej të ishte s’kualifikuar. Nga auditimi i dokumentacioni i operatorit të shpallur fitues “A.C.” shpk konstatohet disa pasaktësi si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.11.b. Të paraqiten katalogët për të gjitha pajisjet sipas pikës 2.3.10. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të verdhë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara. Kondicioner split mural, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 2.0/2.7kW, prurja e ajrit Vmes=528m3/h. Nga dokumentacioni në SPE konstatohet se kapacitetin në ftohje/ngrohje është 2.2/2.4 kw dhe prurja e ajrit Vmes = 525 m3/h (Modeli MDV-D22G/N1-S). 2. Kondicioner split mural, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 2.5/3.4 kW, prurja e ajrit Vmes=546m3/h. Nga dokumentacioni i hedhur në sistem kapaciteti ne ftohje/ngrohje 2.8/3.2kW dhe prurja e ajrit Vmes = 525 m3/h (Modeli MDV-D28G/N1-S). 3. Njësi e jashtme e përshtatshme për lidhje VRF, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 66.3/77.2kW. Nga dokumentacioni i hedhur në sistem kapaciteti ne ftohje/ngrohje 67/75kW (Modeli MV5-X670W/V2GN1). 4. Kondicioner split mural, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 7.1/8.2kW, prurja e ajrit Vmes=960m3/h. Nga dokumentacioni i hedhur në sistem kapaciteti ne ftohje/ngrohje 7.1/8kW (Modeli MDV-D71G-R3/N1Y). 5. Operatori nuk plotëson pikën 2.3.11.a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.10, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto

pajisje. Nga dokumentacioni i hedhur në sistem, ky operator ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania “G.R A..” shpk për zërat 8 “Njësi ventilimi e balancuar, me rikuperim të nxehtësisë, prurja e ajrit 1900m³/h, fuqia motorike 2x350W, dim.1230x1700x490mm”, zëri 9 “Njësi ventilimi e balancuar, me rikuperim të nxehtësisë, prurja e ajrit 2306m³/h me ventilator te tipit 'Plug Fan' për presione të larta, fuqia motorike 2x350W, dim.1230x1700x490mm” dhe zëri 10, “Njësi ventilimi e balancuar, me rikuperim të nxehtësisë, prurja e ajrit 700-1000m³/h me ventilator te tipit 'Plug Fan' për presione të larta, fuqia motorike 2x147W, dim.860x1150x385mm”. Nga auditimi i kompanisë “G.R A..” shpk konstatohet se “Objekti i veprimtarisë së kësaj kompanie është “Tregtim, prodhim dhe instalim i pjesëve të aparateve për ventilim, filtrimin e kondicionimin e ajrit, import eksport, artikuj të ndryshëm, elektroshtepiake, konfeksione, materiale inerte për ndërtim”. Pra konstatohet se kjo kompani nuk prodhon pajisjen ose njësinë e ventilimit të ajrit (e cila ka elektromotorin etj) por vetëm pjesë këmbimi të tyre si llamarina, kapakë, grila, filtra etj. Kjo kompani nuk është prodhuese por assembluese e njësive të kondicionimit dhe ventilimit. Referuar edhe faqes zyrtare në internet <https://gandr.al/>, konstatohen produktet e kompanisë, ku operatori ekonomik ka paraqitur autorizimin e prodhuesit.

Sa më sipër nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet:

Së pari në lidhje me s’kualifikimin e Operatorit ekonomik “P. G.” shpk, “Ndërtim Montim Patos” sh.a, “S.” 2F shpk, arsyeja e s’kualifikimit mbi gabimin në sasinë e ofertës, referuar edhe vendimit të KPP 550/2020, KVO duhet të mbante fillimisht në konsideratë legjislacioni e Prokurimit Publik, nenin 82 VKM-në nr. 285 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”; pika 2 dhe Pika 3. Sipas ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, përcaktohet se Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme. Sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 1 përcakton se “Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”. Pika 2. “Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet”.

Së dyti, sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 përcakton se “...Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”. Gjithashtu bazuar edhe sipas VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave”; pika 4, citohet se “Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe

	<p><i>vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Pra KVO mund të konsideronte devijim të vogël jo në përputhjen e vlerave të katalogut në atë të përkthyer, për pajisjet e rekuperatorëve të ajrit.</i></p> <p><i>Së treti, KVO ka kryer s'kualifikim të padrejtë të OE "E.K."shpk, pasi oferta e tij rezultoi pa gabime. Referuar VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 45 pika 3, kucitohet se: "Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave." Duke parë rëndësinë e një oferte ekonomike më të mirë ekonomikisht të OE "P.G.", në lidhje me artikujt ku mund të mungonte dokumentacion, nga KVO duhej të kërkohej sqarime të mëtejshme nga ky OE dhe mos të përbëhej arsye për s'kualifikim, pasi nuk cënonte aspak realizimin e kontratës me sukses. Referuar ligjit mbi prokurimin publik mbi Kualifikimin e ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.</i></p> <p><i>Referuar nenit 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", me qëllim rritjen e efijencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirëpërdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është "Çmimi më i leverdishëm", për të bërë të mundur minimalisht shmangien e blerjes së mallit me një vlerë të konsiderueshme me të lartë ekonomike në disfavor të buxhetit të shtetit. Sipas VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 45 pika 3, ku citohet se: "Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave." Në kushtet e mësipërme KVO ose duhet të vijonte me OE e mbetur në garë ose midis OE me mangësi të vlerësonte kriterin kryesor "Çmimi më i favorshëm", kjo për të shmangur keqmenaxhim të fondeve të prokuruar në kundërshtim me ligjin 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, me nenin 3 "Parimet e përzgjedhjes", neni 76 "Kriteret detyruese për s'kualifikim", neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", si dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi i ofertave", neni 67 "Klasifikimi i ofertave", neni 83 "Njoftimi i fituesit".</i></p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës "Punë Publike" dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik".
Ndikimi/Efekti:	Mos rritje e efijencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit.
Shkaku:	Mos mbajta në konsideratë gjatë vlerësimit të Nenit 53 Pika 4 e LPP, nenin

	3 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi i ofertave”, neni 67 “Klasifikimi i ofertave”, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandime:	AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s’kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/54 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/8 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mosplotësimin e disa parametrave teknik të operatorit fitues, nga KVO citohet se devijimi në ngrohje nga 8.2 KW në 8KW nuk përbën çënim të cilësisë të kushteve të ruajtjes së gjakut dhe për pasojë nga KVO janë konstatuar si devijime të vogla. Në lidhje me autorizimin e prodhuesit në DST nuk është përcaktuar vendi i assemblimit të pjesëve dhe për sa kohë pajisja i plotëson specifikimet teknike në DT, atëherë KVO ka gjykuar se vendi i assemblimit nuk përbën kusht s’kualifikimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar nga KVO, pretendimet tuaja referuar rastit konkret nga AK nuk është konsideruar apo dokumentuar fakti nëse mangësitë e konstatuara në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: “Projekt Preventiva zbatimi për rikonstruksionin e QSH-ve dhe AMB-ve për vitin 2023-2024, ndarë në dy lote me fond limit 5,397,473 lekë pa TVSH”, konstatohet:

Lot 1 “Projekt Preventiva zbatimi për rikonstruksionin e QSH-ve dhe AMB-ve për Rajonet Shkodër dhe Vlorë me fond 2,826,173 lekë pa TVSH. Lot 2 “Projekt Preventiva zbatimi për rikonstruksionin e QSH-ve dhe AMB-ve për Rajonet Tiranë dhe Elbasan me fond 2,571,300 lekë pa TVSH.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Projekt Preventiva zbatimi për rikonstruksionin e QSH-ve dhe AMB-ve për vitin 2023-2024, ndarë në dy lote me fond limit 5,397,473 lekë pa TVSH		
1. Lloji/ Urdhri i Procedurës së Prokurimit Nr. 573 datë 11.10.2022 “Shërbim Konsulence” Lot1 REF-46066-10-14-2022 Lot1 REF-46068-10-14-2022	2. NjP UP 573 datë 11.10.2022 1. A. P. 2. D. K. 3. E. L. 4. L. A..	3. KVO Urdhri nr. 573/1 datë 11.10.2022 1. B. M. 2. V. H. 3. Zh. M. ndryshon me D. Ll.
4. Fondi Limit (pa tvsh) Lot1 2,826,173 lekë Lot2 2,571,300 lekë	5. Oferta fituese Lot1 2,826,160 lekë OE Lot2 2,555,000 lekë OE	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lot1 13 lekë OE Lot2 16,300 lekë OE
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 27.10.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga dorezimi i sheshit		

10. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP	11. Përgjigje Ankesës nga AK:	12. Përgjigje Ankesës
---	--------------------------------------	------------------------------

a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:

Me urdhrin e titullarit nr. 251 datë 14.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e detyrës së projektimit, përcaktimin e fondit limit për rishikimin e projekt preventivave egzistuese, që janë hartuar në vitin 2015 për qendrat shëndetsore dhe ambulancat që do të rikonstruktohen për vitet 2023, 2023”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se projektet e vitit 2015, nuk pasqyronin realitetin me preventiva të cilët nuk përputheshin me planimetritë dhe me mungesë të theksuar të zërave të punimeve ku nuk di të riparohej suvatimi apo ndrime të dyerve e dritareve. Në disa projekte të 2015 për disa QSH janë konstatuar mungesa e punimeve elektrike dhe hidraulike. Objekti i prokurimit nuk ka realizuar procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të Investimeve Publike, sic përcakton VKM nr. 185 datë 29.03.2018 “Për menaxhimin e Investimeve Publike” Aneksi 1. Ky projekt nuk ka kaluar në procesin ligjor të miratimit të PBA (Programi Buxhetor Afatmesëm) i cila bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor të RSH”, pika 21. Me shkresën përcjellëse të kryetarit të grupit të punës nr. 1735/1 prot. Datë 10.10.2022 në zbatim të urdhrin nr. 251 datë 14.04.2022, përcillen tabelat përmbledhëse e QSH-ve dhe AMB-ve, Detyra e projektimit për projekt-preventivat dhe përlllogaritja e fondit limit. Grupi i punës bazuar në përcaktimin e listës së objekteve të QSH-ve, përcaktoi qendrat shëndetsore dhe ambulancat në total 58 objekte. Referua VKM nr. 354 janë marrë përqindjet si më poshtë për 58 objekte në 4 rajone. Referuar përlllogaritjeve sipas grupit tarifor përkatës rezulton vlera prej 6,476,967 lekë me TVSH dhe 5,397,473 lekë pa TVSH.

Me procesverbalin e datës 14.10.2022, njësia e prokurimit ka përcaktuar kriteret kualifikuese për të dyja lotet. Si kriteret kualifikuese në fazën e I, janë përcaktuar kriteret kualifikuese për projekttime të ngjashme, janë kërkuar projektues arkitekt, konstruktor, instalator, gjeodet, gjeolog me licensa përkatëse bazuar në termat e referencës. Është kërkuar staf si drejtues teknik dhe mbështetës të përfshirë në listëpagesë muajin e fundit. Sipas procesverbalit datë 04.11.2022 faza I “Shprehja e Interesit dhe parakualifikimi. Loti I parakualifikohen në short list 3 operatorë ekonomik, OE “I.” shpk, OE “T.” Shpk dhe OE “I. D.-Alb” shpk. Loti II parakualifikohen në short list 2 operatorë ekonomik, OE “T.” Shpk dhe OE “I. D.-Alb” shpk, ku s’kualifikohet OE “D.” shpk pasi nuk plotëson pikën 3.2, pasi sigurimi i ofertës ka periudhë vlefshmërie 150 ditë. Ftesat për propozim janë realizuar me nr. 3943/4 prot. Datë 16.11.2022. Me procesverbalin përmbledhës të KVO datë 05.12.2022, KVO realizoi propozimet teknike dhe ekonomike për kandidatët e kualifikuar në fazën I, ku vendos:

Lot 1 OE “I.” shpk me pikë total 85.3 me ofertë 2,826,160 lekë pa TVSH. Lot 2 OE “T.” shpk me pikë total 91.2 me ofertë 2,555,000 lekë pa TVSH. Formulari i njoftimit të fituesit është 3943/6 prot. Datë 05.12.2022 dhe raporti përmbledhës miratohet me nr. 3943/8 prot. Datë 13.12.2022. (Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 5, datë 08.05.2023, dorëzuar me protokoll në MSHMS).

8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: “Rikonstruksion i farmacisë dhe dispancerisë për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, viti 2022, fond limit 33,662,277 lekë pa Tvsh, konstatohet:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i farmacisë dhe dispancerisë për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” 2022		
1. Lloji/ Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur” REF- 36374-14-07-2022	2. NjP UP nr. 3135 datë 14.07.2022 1. S... B.. (Përgjegjëse prokurimet) 2. A... D.. (Juriste) 3. L.. V... (Përgjegjëse e Farmacisë) 4. F... D.. (Inxhinier) 5. A... F... (Inxhinier)	3. KVO Urdhri nr. 3136 datë 14.07.2022 1. J... Ll..(Ekonomiste) 2. L.. N.. (Juriste) 3. R.. M... (Inxhiniere)

4. Fondi Limit (pa tvsh) 33,662,277 lekë	5. Oferta fituese 32,960,561 lekë Operatori Fitues: "A.-CO"	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 701,716 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data : 02.08.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 90 ditë		
10. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP	11. Përgjigje Ankesës nga AK:	12. Përgjigje Ankesës

a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:

Në kuadrin e përmirësimit të kushteve të ambienteve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit, nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë janë porositur projekte rikonstruksionesh të ambienteve. Investimi në rikonstruksionin e farmacisë përfshinë hollin e pritjes, depon e farmacisë, dispancerinë, zyrën e personelit, farmaci, dhomë frigoriferike, kabinete, magazinë dhe tualete. Projekti, specifikimet teknike dhe fondi limit i rikonstruksionit është realizuar nga shoqëria projektuese "R." shpk, me administrator Ing. R. N. Nga njësia e prokurimit janë argumentuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese, duke argumentuar ato në përputhje me projekt-preventivin, nevojën e punëve ngjashme, stafit, licensimet dhe makineritë.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar formularit paraprak të njoftimit të fituesit Datë 09.08.2022. KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	A.-... C.. shpk	32,960,561	Kualifikuar/ Fituesi
2	A... shpk	33,469,918	S'kualifikuar
3	Sh... shpk	33,469,281	S'kualifikuar

Referuar njoftimit të fituesit, janë s'kualifikuar Operatorët Ekonomik, për këto arsye:

1. A. shpk, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për pagesën e detyrimeve vendore për vitet 2020, 2021 dhe janar - mars 2022 deri ditën e tenderit të leshuar nga cdo njësi vendore ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetin e tij duke iu referuar ligjit Nr. 9632, dt. 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur licensat profesionale për ekzekutimin e punëve të kontratës. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në formularin e vetedeklarimit numrin e punonjësve që duhen për zbatimin e kontratës. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontratës furnizimi dhe autorizim nga prodhuesi/ ditributori për materialet të pasqyruara në preventiv si: Tuba HDPE dhe PVC; Boje Hidroplastike. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Certifikatat e cilësisë; ISO 9001-2015, ISO 14001-2015; OHSAS 18001 ose/ ISO 45001:2018/ose ekuivalent. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi për mjete dhe pajisjet që ka në dispozicion për zbatimin e kontratës. Operatori ekonomik nuk ka kontrate furnizimi dhe autorizim nga prodhuesi/ ditributori për pajisjet mjekesore të pasqyruara në preventiv. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur grafikune punimeve.

2. Sh. shpk, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur bilancet vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për pagesën e detyrimeve vendore për vitet 2020, 2021 dhe janar-mars 2022 deri ditën e tenderit të leshuar nga cdo njësi vendore ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetin e tij duke iu referuar ligjit Nr. 9632, dt. 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontrate furnizimi dhe autorizim nga prodhuesi/ ditributori për materialet të pasqyruara në preventiv si: Tuba HDPE dhe PVC; Boje Hidroplastike. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Certifikatat e cilësisë; ISO 9001-2015, ISO 14001-2015; OHSAS 18001 ose/ ISO 45001:2018/ose ekuivalent. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi për mjete dhe pajisjet që ka në dispozicion për zbatimin e kontratës. Operatori ekonomik nuk ka kontrate furnizimi dhe autorizim nga prodhuesi/ ditributori për pajisjet mjekesore të pasqyruara në preventiv. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur grafikun e

punimeve. Operatori ekonomik nuk ka kryer vizite në objekt. Procedura nuk kishte ankesa dhe me nr. 3586 prot. Datë 18.08.2022, miratohet nga titullari raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit, ku operatori ekonomik A.-2A CO shpk, kualifikohet dhe shpallet fitues i procedurës së prokurimit.

c. Mbi zbatimin e kontratës.

- Objekti i kontratës " Rikonstruksion i farmacisë dhe dispanserisë për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë ", është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3633 prot. Datë 22.08.2022, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Vlorë dhe OE "A. C." shpk. Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 3581 datë 18.08.2022, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Vlorë dhe OE "R." shpk. Afati i përfundimit të punimeve sipas kontratës, është përcaktuar 90 ditë. Me Vendimin nr. 592 datë 13.09.2022 të Bashkisë Vlorë, miratohet deklarata për kryerjen e punimeve. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, akti i piketimit dhe procesverbali i fillimit të punimeve, janë mbajtur midis palëve më datë 14.09.2022. Njoftimi i fillimit të punimeve është mbajtur me anë të shkresës nr. 3897 prot. Datë 14.09.2022. Njoftimi i përfundimi i punimeve është realizuar me anë të shkresës nr. 5150 prot. Datë 09.12.2023, brenda afateve kontraktuale. Për kolaudimin e projektit është lidhur kontrata nr. 4128 prot. Datë 28.09.2022, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Vlorë dhe OE "K." shpk. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 15.12.2022 ku fillon edhe periudha e garancisë prej 12 muaj. Gjatë zbatimit të punimeve është kërkuar nga kontraktori datë 26.09.2022, ndryshime të tipit të soletës për shkak të lehtësimit të strukturës. Nga mbikëqyrësi i punimeve dhe AK është miratuar ndryshimi i tipit të strukturës, ku janë paraqitur analiza të cmimeve dhe është negociuar cmimi mbi zërin e ri të punimeve sipas shkresës nr. 4141 prot. Datë 28.09.2022. Nga verifikimet e dokumentacioneve teknike të zbatimit, përgjithësisht janë të plota ku përfshihen (Libreza e masave, korrespondenca, ditarë, certifikatat e materialeve, procesverbale të ndryshme, Akt kontrole dhe raporte ecurie, analizat e materialeve, prova e teste të ndryshme etj). Pasqyra e realizimit të punimeve mbi sasi të ose volumet e likuiduara nga sipërmarrësi është e njëjtë me volumin e preventivit të punimeve sipas projektit përfundimtar të azhurnuar të ripunuar. Nga verifikimi në terren konstatohet se punimet në rikonstruksionin e Farmacisë, janë përgjithësisht punime të mira duke respektuar projektin, standardet dhe pajisjet e vendosura sipas specifikimeve teknike.
(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 8, datë 08.05.2023, dorëzuar me protokoll në MSHMS).

9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: "Furnizim vendosje pajisje mobilimi për farmacinë dhe dispanserinë te spitalit rajonal Vlorë gjithsej 2 lote", viti 2022, fond limit 2,985,600 lekë pa Tvsh, konstatohet:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Furnizim vendosje pajisje mobilimi per farmacine dhe dipanserine te spitalit rajonal vlore		
1. Lloji/ Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur e thjeshtuar" Lot 1 REF-37222-07-27-2022 Lot 2 REF-37225-07-27-2022	2. NjP UP nr. 3283 datë 26.07.2022 1. S. B. (Përgjegjëse prokurimet) 2. A. D. (Juriste) 3. L. V. (Përgjegjëse e Farmacisë)	3. KVO Urdhri nr. 3303 datë 26.07.2022 1. J. Ll. (Ekonomiste) 2. A. B. (Ekonomiste) 3. L. N. (Juriste)
4. Fondi Limit (pa tvsh) Lot 1 1,585,600 lekë Lot 2 1,400,000	5. Oferta fituese Lot 1 1,399,917 lekë "R..." shpk Lot 2 1,400,000 lekë "I..." shpk	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lot 1 185,683 lekë, Lot 2 0 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data : 08.08.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Lot 1 Numër 2 OE c) Kualifikuar 2 OE a)Pjesëmarrës në tender Lot 2 Numër 1 OE c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë		
10. Ankimime AK-s'ka	11. Përgjigje Ankesës nga AK:	12. Përgjigje Ankesës

a-Nga shqyrtimi i dokumentove të tenderit konstatohet:

Në kuadrin e Rikonstruksionit të ambienteve të Farmacisë dhe Dispanserisë, nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë janë hartuar specifikimet teknike për mobilimin e farmacisë. Nga njësia e prokurimit janë argumentuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese, duke argumentuar në përputhje me projektin e furnizimit të mallrave sipas specifikimeve teknike.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit për lotin I, kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar raportit përmbledhës nr. 3638 prot. Datë 23.08.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	R....shpk	1,399,917	Kualifikuar/ Fituesi
2	B.... shpk	1,518,000	Kualifikuar

Referuar kriterëve vlerësues, nga KVO, kualifikohen të dy operatorët ekonomik duke shpall fitues ofertën ekonomike më të ulët, atë të "R." shpk me vlerë 1,399,917 lekë pa TVSH dhe kontrata e furnizimit nënshkruhet me nr. 3912 prot. Datë 15.09.2022. Në procedurën e prokurimit për lotin II, ka marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar raportit përmbledhës nr. 3529 prot. Datë 15.08.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	I.... shpk	1,400,000	Kualifikuar/ Fituesi

Referuar kriterëve vlerësues, nga KVO, kualifikon operatorët ekonomik duke shpall fitues ofertën ekonomike më të ulët, atë të "I." shpk me vlerë 1,400,000 lekë pa TVSH dhe kontrata e furnizimit nënshkruhet me nr. 4135 prot. Datë 28.09.2022.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 8, datë 08.05.2023, dorëzuar me protokoll në MSHMS).

10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: **"Rikonstruksion i Urgjencës së Spitalit Rajonal Vlorë"**, viti 2022, fond limit 29,054,225 lekë pa Tvsh, konstatohet:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Urgjencës së Spitalit Rajonal Vlorë" 2022		
1. Lloji/ Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur" UP 5010 prot. Datë 24.11.2022 REF- 51565-11-30-2022	2. NjP UB nr. 4991 datë 23.11.2022 1. A... B.. (Përgjegjëse prokurimet) 2. A... D...(Juriste) 3. F... D... (Inxhinier)	3. KVO Urdhri nr. 5011 datë 29.11.2022 1. J.. Ll. (Ekonomiste) 2. A. F. (Inxhiniere) 3. R. M. (Inxhiniere) 4. S. B. (Ekonomiste) 5. E. S. (Juriste)
4. Fondi Limit (pa tvsh) 29,054,225 lekë	5. Oferta fituese 28,565,408 lekë Operatori Fitues: "A." shpk	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 488,817 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data: 27.12.2022	8. Burimi Financimit - Buxheti i Shtetit 24,054,225 lekë pa TVSH; - Ardhurat dytësore 5,000,000 lekë	9. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj		
10. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP	11. Përgjigje Ankesës nga AK:	12. Përgjigje Ankesës

a-Nga shqyrtimi i dokumentove të tenderit konstatohet:

- Me shkresën përcjellëse të Spitalit Vlorë nr. 4649 prot. Datë 31.10.2022, dërgohet në MSHMS fisha e investimit për Rikonstruksionin e shërbimit të Urgjencës. Rikonstruksioni i Urgjencës do të financohet një pjesë nga kooperacioni Italian AICS, një pjesë nga të ardhurat dytësore të spitalit Vlorë dhe pjesa tjetër nga Buxheti i Shtetit. Bazuar në kontratën e ardhur nga kooperacioni fondi

i akorduar do të mbulojë vlerën pa TVSH dhe vlera e TVSH në masën 7,300,000 lekë do të mbulohet nga Buxheti i Shtetit që do akordohet për vitin 2023. Investimi është i nevojshëm pasi shërbimi spitalor i urgjencës kryhet në disa ambiente jo të përshtatshme si nga ana funksionale ashtu edhe e hapësirës, ku rikonstruksioni i fundit është kryer në vitin 2002. Rikonstruksioni do të përfshijë repartin e urgjencës në katin përdhe të godinës. Me shkresën e titullarit të MSHMS nr. 4298/2 prot. Datë 17.11.2022, dërgohet miratimi i transferimit të fondeve për vitet 2022-2024. Me Urdhrin e Prokurimit 5010 prot. Datë 24.11.2022, ngrihet njëسيا e prokurimit e përbërë nga A. B. (Përgjegjëse prokurimet), A. D. (Juriste) dhe F. D. (Inxhinier).

Nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve/enteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), sa i takon autoritetit kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë (në vijim AK) rezulton se, ndërmjet të tjerash është shpallur edhe procedura me REF-51565-11-30-2022, me objekt “Rikonstruksion i Urgjencës së Spitalit Rajonal Vlore”, me fond limit 29.054.225.00 lekë pa TVSH. Nga APP jepen rekomandime në lidhje me kriteret kualifikuese duke sqaruar se kur nga AK konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i dokumenteve të tenderit, përfshirë këtu edhe kriteret për kualifikim, mbështetur në përcaktimet e nenit 75, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor nuk duhet të anultojë procedurën, por mund të bëjë ndryshime përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion operatorëve ekonomikë, në Dokumentet Standarde të Tenderit të publikuara në SPE. Me urdhrin e titullarit të Spitalit Vlorë nr. 5145 prot. Datë 09.12.2022, pezullohet procedura deri në shqyrtimin e rekomandimeve të APP. Me shtojcën e datës 12.12.2022, njëسيا e prokurimit ka modifikuar DST sipas rekomandimeve të APP, duke argumentuar ato në përputhje me projekt-preventivin, nevojën e punëve ngjashme, stafit, licensimet dhe makineritë. Me urdhrin e titullarit të Spitalit Vlorë nr. 5164 prot. Datë 12.12.2022, hiqet pezullimi i procedurës, duke marrë parasysh ndryshimet e pasqyruara në shtojcën për modifikim sipas rekomandimeve të APP.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar formularit paraprak të njoftimit të fituesit Datë 16.01.2023. KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	BOE A... & K... & U... shpk	28,439,570	Kualifikuar/ Fituesi
2	A.....shpk	28,565,408	S'kualifikuar
3	Sh..... shpk	28,966,001	S'kualifikuar

Referuar njoftimit të fituesit, janë s'kualifikuar Operatorët Ekonomik, për këto arsye:

Janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “A.” shpk, nuk ka paraqitur vërtetim për detyrimet vendore, nuk ka paraqitur listëpagesat për 3-muj dhe nuk janë të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.
2. “Sh.” shpk, nuk ka paraqitur dokumente të kriterëve të përgjithshme.

Procedura nuk kishte ankesa, ku, kualifikohet dhe shpallet fitues i procedurës së prokurimit Bashkimi i Operatorëve ekonomik “A. & K.” shpk & “U.” shpk, me ofertë 28,439,570 lekë pa TVSH.

c. Mbi zbatimin e kontratës.

- Objekti i kontratës "Rikonstruksion i Urgjencës së Spitalit Rajonal Vlorë", është kryer sipas kontratës i për punë publike nr. 528 prot. Datë 08.02.2023, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Vlorë përfaqësuar nga znj. B. M. dhe BOE “A. & K. shpk & “U.” shpk, përfaqësuar nga administratorët z. N. Sh. dhe z. K. A., me vlerë kontrate 11,297,045 lekë me TVSH. Kontrata II për punë publike nr. 1360 prot. Datë 30.03.2023, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Vlorë përfaqësuar nga znj. B. M. dhe BOE “A. & K. shpk & “U.” shpk, përfaqësuar nga administratorët z. N. Sh. dhe z. K. A., me vlerë kontrate 22,385,768 lekë me TVSH. Ndarja në II kontrata është berë për efekt të realizimit të Investimit një pjesë nga Buxheti i Shtetit dhe një pjesë

nga të ardhurat. Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 547 datë 08.02.2023, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Vlorë përfaqësuar nga znj. B. M. dhe BOE "I." shpk & "M.", përfaqësuar nga administratori Ing. A. N. dhe Ing. P. M. Afati i përfundimit të punimeve sipas kontratës, është përcaktuar 2 muaj. Fillimi i punimeve është më datë 08.02.2023 për kontratën nr. 528 prot. Datë 08.02.2023. Deri në periudhën e auditimit kontrata ishte në proces punimesh, ku ishte realizuar vetëm një pagesë "Situacioni Nr. 1" në vlerë 9,795,081 lekë me TVSH, e cila i takon periudhës 08.02.2023 deri më 29.03.2023, ku është realizuar 95 % e punimeve të cilat përputhen me librezat e masave pjesore për situacionin Nr.1.

11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023)" me fond limit 103,918,778.40 (njëqind e tre milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë .40) Lekë pa TVSH"*, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>"Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023)" me fond limit 103,918,778.40 (njëqind e tre milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë .40) Lekë pa TVSH"</i>			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF-23748-04-01-2022 Loti 1 - REF- 23750-04-01-2022 Loti 2 - REF- 23752-04-01-2022 Urdhri nr. 199, datë 30.03.2022	1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese A. P. E. L. Ing.D. K.	2 Njësia e Prokurimit A.P. E.L. Ing. D. K.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 199/1, datë 30.03.2022, prot.nr 1487/1, datë 30.03.2022. S. K. V. H. E. H. E. A. L. A.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 103,918,778.40 lekë Lot1: 65,694,983.16 Lot2: 38,223,795.24	5. Oferta fituese (pa tvsh) 55,835,085 lekë		6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 9,859,898.16 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit Data 19.04.2022, ndryshohet 04.05.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 13 b) S'kualifikuar 10 OE, c) Kualifikuar 3 OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Me urdhrin e prokurimit nr. 199, datë 30.03.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 103,918,778.4 lekë pa TVSH, me objekt *"Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023)" me fond limit 103,918,778.40 (njëqind e tre milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë .40) Lekë pa TVSH"* e ndarë në 2 lote. Procedura është mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga grupi i punës me urdhrin nr. 505, datë 24.11.2021, prot nr. 4601/2, datë 24.11.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për përzgjedhjen e Qendrave Shëndetësore/Ambulancave, që do të rikonstruktohen gjatë vitit 2022-2023, dhe ndarjen në lote", sipas shkresave prot. nr. 460/1, datë 28.12.2021 me objekt "Mbi zbatimin e Urdhrit të Titullarit të MSHMS nr. 505, datë 24.11.2021 me objekt "Mbi përzgjedhjen e QSH/Ambulancave për ndërhyrje në 2022-2023", si dhe shkresës nr. 784/26 datë 28.03.2022 "Përcjellje e preventivit pas oponencave nga Instituti i Ndërtimit". Komisioni i vlerësimit të ofertave i ngritur me Urdhri nr. 199/1, datë 30.03.2022, prot.nr/ 1487/1, datë 30.03.2022 përbëhet nga z. S. K., kryetar; znj. V. H.; z. E. H.; z. E. A.dhe znj. L. A.. Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi: Me shkresën nr. 1487/2, datë 31.03.2022 është bërë njoftimi i shkurtuar i kontratës. NjP me datën

01.04.2022 ka mbajtur procesverbalin e argumentimit dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Me shkresën nr. 1487/3, datë 01.04.2022 është bërë njoftimi i shkurtuar i kontratës, ku afati i hapjes së ofertave është data 19.04.2022. Procedura është publikuar në APP në buletinin me nr. 46, datë 11.04.2022. Me shtojcën e hedhur në SPE 26.04.2022 procedura shtyhet, ku afati i hapjes së ofertave bëhet 04.05.2022. Me datën 05.04.2022 App ka dhënë rekomandimet për specifikimet në lidhje me

Loti 1: Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Tiranë dhe Shkodër (13 objekte)” me fond limit 65,694,983.16 (gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre .16) lekë pa TVSH:

Pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të **Lotit 1** për të cilin konkurron.

Bëhet:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të Lotit 1 për të cilin konkurron.

III. Në preventivin e punimeve të DST, bëhet ndryshimi referuar markës/prodhuesit, si më poshtë: Ishte: Markës/prodhuesit “Armofleks”, “Mapej” “Importi , Cilësi e I-rë. Bëhet: Pas Markës /prodhuesit, si “Armofleks”, “Mapej” “Importi, shtohet fjala: ose ekuivalent. (“Cilësi e I-rë” hiqet). Në bazë të “kërkesës për sqarim” datë 05.04.2022 në lidhje me pikën 3.1. Seksionin 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike, në pikën 3.1 Sigurimi i ofertës, 3.1 Sigurimi i ofertës: *(e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël)*. Ishte: Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 – 764,475.9 Lekë

Loti 2 –1,313,889,7 Lekë

Bëhet: Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 – 1,313,889,7 Lekë

Loti 2 – 764,475.9 Lekë

Me shkresën nr. 1487/4, datë 07.04.2022 është bërë njoftimi i ndryshimit të DT. OE/ M.shpk me kërkesën për sqarim të datës 08.04.2022 kërkon nga MSHMS sqarimin në lidhje me:

2. Objektiv: Lagjia Brigadave 17 sulmuese për kapitullin E. Furnizim pajisjesh Zëri (An. F. Shuars me bombo me shkume) njësia Kg. 4. Objektiv: QSH Blerimas II. Punime Ndërtimi Zëri me nr. 2.209 njësia m2. Me shkresën nr. 1487/5, datë 11.04.2022 është bërë njoftimi i ndryshimit të DT për zërat Objektiv: Lagjia Brigadave 17 sulmuese për kapitullin E. Furnizim pajisjesh Zëri (An. F. Shuars me bombo me shkume) njësia Kg bëhet copë. 4. Objektiv: QSH Blerimas II. Punime Ndërtimi

Zëri me nr. 2.209 njësia m2 bëhet ml. Me shkresën nr. 1487/6, datë 26.04.2022 është bërë njoftimi i ndryshimit të DT për zërat preventivit dhe është bërë shtyrja e afatit të hapjes së ofertave deri me datën 04.05.2022.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 13 OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Shoqëria	Oferta Leke PA TVSH	Kualifikuar
1	N... shpk	44,589,114.88	S’Kualifikuar
2	BOE 2... I... GROUP V.... GROUP	51,884,540.5	S’Kualifikuar
3	S ... shpk	52,222,222	S’Kualifikuar
4	G... shpk	54,427,193	S’Kualifikuar
5	K... A shpk	55,680,906.90	S’Kualifikuar
6	C... R... shpk	55,835,085	Kualifikuar
7	S... shpk	59,045,627.22	S’Kualifikuar

8	A.... shpk	60,389,001	Kualifikuar
9	P... G.... shpk	61,207,869.93	S'Kualifikuar
10	L. shpk	61,246,704	S'Kualifikuar
11	A...A K...	62,915,725	Kualifikuar
12	J... shpk	63,116,553	S'Kualifikuar
13	D... J...	Pa ofertë	S'Kualifikuar

Me datën 24.05.2022 nga KVO është mbajtur procesverbali i pranimit të dokumentacionit.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. N. shpk për arsyet e mëposhtme:

a. Ka ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së çmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT.

KVO si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve në ofertë, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d: dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji “*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale*” ka skualifikuar OE.

2. BOE: K. shpk; I. Group shpk dhe V. G. shpk, me vlerën 51,884,540.50 lekë pa TVSH, pasi KVO pas shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE ka konstatuar se Sigurimi i ofertës nuk është paraqitur sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në dokumentat e tenderit. Bashkimi i Operatorëve ka dorëzuar në dokumentet e paraqitura për Lot.1 “*Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Tiranë dhe Shkodër (13 objekte)*”, Formularin e Sigurimit të Ofertës për Lot.2 “*Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)*”, (i cili është gjithashtu i një vlere më të vogël në krahasim me vlerën e sigurimit të kërkuar për Lotin 1). Lidhur me përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme sipas përqindjes në bashkëpunim, I. Group shpk nuk plotësonte vlerën e kontratave. Mbështetur në praktikën e Komisionit të Prokurimit Publik në vendimin Nr. 611/2020 i datës 30.12.2020, sqarohet se: “*Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë pune publike, por duhet parë në lidhje me të gjithë zërat konkretë të punimeve të kryera. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat janë punë publike me objekte të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave nuk ka patur punime të ngjashme me një pjesë të rëndësishme të punimeve objekt prokurimi. Gjithashtu, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit*”. Sipas ndarjes së bashkëpunimit operatori I. Group shpk ka paraqitur punë të ngjashme në një vlerë prej 12,696,869.52 lekë, ku sipas përqindjes së bashkëpunimit duhet të kishte realizuar punë të ngjashme në një vlerë prej 15,438,321.04 lekë. Në bazë të Kreut XI, Udhëzimit nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 88, Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 3 ku përcaktohet: *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

3. S. ofertuar më vlerën 52,222,222.00 lekë pa TVSH, për arsyet e mëposhtme:

a. Ka ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së çmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT. KVO si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve në ofertë, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d: dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji “*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale*” ka s'kualifikuar OE. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

4. G. shpk me vlerën 54,427,193.00 lekë pa TVSH, me vlerë ofertë të korrigjuar 53,954,113.34 lekë pa TVSH, për arsyet e mëposhtme:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik G. Shpk., në përmbushje

të kërkesave për kualifikim sipas pikën 2.3.7, kishte mospërputhje të punonjësve të Shtojcës 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit) me listëpagesën e dorëzuar.

Bazuar në praktikën e Komisionit të Prokurimit Publik vendimi nr. 480/2020 i datës 29.10.2020, si edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, i cili parashikon listën kombëtare të profesioneve, të cilët identifikohen me anë të kodeve në listëpagesë. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi. Në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 3 shkronja ë parashikon: *“Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:*

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

5. K. shpk me vlerën 55,680,906.90 lekë pa TVSH, për arsyet e mëposhtme:

a. Ka ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së cmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT. KVO si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve në ofertë, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d: dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji *“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale”* ka skualifikuar OE.

6. S. shpk me vlerën 59,045,627.22 lekë pa TVSH

Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga KVO ka rezultuar se: inxhinieri pjesë e stafit kryesor njëkohësisht drejtues teknik dhe për të cilin është deklaruar se do të jetë gjatë gjithë kohës në kantier ishte i dy punësuar. Kjo në kundërshtim me deklaratën e vetë operatorit ekonomik, por edhe në kundërshtim me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* Kreu IV, Drejtuesi Teknik i Shoqërisë dhe Papajtueshmëria me Këtë Detyrë, përcaktohet: 2. *Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit.*

7. P. G. shpk me vlerën 61,207,869.93 lekë pa TVSH

Në dokumentacionin e paraqitur nga operator lidhur me plotësimin e kapaciteteve sipas pikës 2.3.9, të kapacitetit teknik, duhej të dëshmoj nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit, për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operator, ka rezultuar mos përcaktimi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 8 e DST) sasia e mjeteve/pajisjeve teknike (të cilat i ka në pronësi ose me qira), duke e bërë të pamundur verifikimin e plotësimit apo jo të kriterit të DST pika 2.3.9 e Shtojcës 7.

8. I. shpk me vlerën 61,246,704.00 lekë pa TVSH.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operator ekonomik, lidhur me Formularin e Sigurimit të Ofertës ka rezultuar se nuk është në përputhje me DST ku *Periudha e vlefshmërisë së ofertës është 180 (shprehur në ditë)* ndërsa Operatori ekonomik në Formularin e Sigurimit të Ofertës të dorëzuar, si periudhë vlefshmërie të sigurimit është afati prej 150 ditë. Kjo në kundërshtim dhe me pikën 3 të nenit 30 *“Sigurimi i ofertës”* të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjatë verifikimit ka rezultuar se inxhinieri pjesë e stafit kryesor njëkohësisht drejtues teknik është i dy punësuar. Kjo në kundërshtim me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

9. J. shpk me vlerën 63,116,553.00 lekë pa TVSH.

a. Ka ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së çmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT. KVO si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve në ofertë, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d: dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji “Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale” ka s’kualifikuar OE. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, nëpërmjet Shtojcës 8 të DST, KVO ka konstatuar se operator nuk i ka deklaruar inxhinierët sipas kërkesave të vendosura në DST në pikën 2.3.6.

10. D. J. shpk, pa ofertë ekonomike.

Janë kualifikuar si të suksesshme ofertat e mëposhtme:

1. C. R. shpk, me vlerën 55,835,085 lekë pa TVSH.

2. A. shpk, me vlerën 60,389,001lekë pa TVSH, me vlerë ofertë të korrigjuar të ofertës 59,763,296.67 lekë pa TVSH.

3. A. K. shpk, me vlerën 62,915,725 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 1487/7, datë 07.06.2022 është bërë “Formulari i njoftimit të fituesit paraprak” për Lotin 1 për OE “C.R. shpk”, me vlerën 55,835,085 lekë pa TVSH.

Nga KVO për Loti 1 është përgatitur raporti përmbledhës me nr. 1487/9, datë 16.06.2022.

Me shkresën nr. 1487/10, datë 16.06.2022 është bërë “Formulari i njoftimit të fituesit”. Ankesa nuk ka patur. Midis AK dhe OE fitues “C. R. shpk” është lidhur kontrata me nr. 1487/12 datë 28.06.2022, me afat 8.5 muaj nga data e nënshkrimit të procesverbalit të fillimit të punimeve (për objektin e parë). Me urdhër nr. 391, datë 30.06.2022, prot. nr, 1487/15, datë 30.06.2022 është bërë “Për caktimin e drejtuesit të projektit për monitorimin e zbatimit të kontratës së furnizimit me nr. 1487/12 datë 28.06.2022”. Me shkresën nr.1487/16 datë 04.07.2022 është hartuar plani I zbatimit të kontratës.

b. Mbi vlerësimin e ofertave lot 2

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 10 OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Shoqëria	Oferta PA TVSH	Kualifikuar
1	N... shpk	26,652,152	S’Kualifikuar
2	2... shpk	26,933,026	S’Kualifikuar
3	BOE. K...; I... G... shpk & V... GROUP	32,130,802	Kualifikuar
4	F.. shpk	32,278,037	S’Kualifikuar
5	BOE A...C shpk; B... shpk &	32,877,712.52	S’Kualifikuar
6	S ...shpk	33,333,333	Kualifikuar
7	A... K.. shpk	34,379,249	Kualifikuar
8	M.. K.. & R... E.. shpk	37,990,012.47	S’Kualifikuar
9	A.. shpk	60,389,001	S’Kualifikuar
10	D... J...shpk	Pa ofertë	S’Kualifikuar

Më datën 24.05.2022 nga KVO është mbajtur procesverbali i vlerësimit të procedurës. Më datën 01.06.2022 nga KVO është mbajtur procesverbali i rivlerësimit të procedurës, pas verifikimit të dokumtacionit të dorëzuar dhe atij të dorëzuar në SPE të OE N. shpk.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. N. shpk me vlerën 26,652,152.00 lekë pa TVSH, për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka vënë re se ka mospërputhje lidhur me Listëpagesën e dorëzuar për Muajin Shkurt. Në DST, Shtojca 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në pikë 2.3.4

kërkohet: 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën Shkurt 2022 të jetë jo më i vogël se 45 punonjës në muaj (përfshirë dhe stafin drejtues teknik dhe stafin me certifikate IQT ose e barasvlershme), të vërtetuar me pikën a. Vërtetimi të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Shkurt 2022. b. Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shkurt 2022. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Pra sipas DST, lidhur me kriterin e mësipërm, do të konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator në SPE, rezultojnë që OE “N.” Shpk, të ketë dorëzuar në SPE përveç Shtojcës 8 për vetëdeklarimet, edhe Listëpagesën për Muajin Shkurt të kësaj shoqërie. Në momentin e dorëzimit të dokumenteve fizike pranë AK sipas njoftimit të marrë nga KVO-ja, gjatë shqyrtimit të tyre, vërehen mospërputhje të dhënash midis Listëpagesës së Muajit Shkurt të dorëzuar në SPE (pra dorëzuar në sistem para afatit për hapjen e ofertave) dhe Listëpagesës së Muajit Shkurt të dorëzuar fizikisht pranë AK-së pas njoftimit të klasifikimit (pra në datën 03.06.2022). Nisur nga kjo mospërputhje të dhënash në listëpagesën e dorëzuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është gjendur në kushtet kur nuk mund të vazhdojë me procesin e verifikimit të dokumenteve të këtij operatori pasi ka dyshimi lidhur me vërtetësinë e tyre. Në vijim të komunikimeve me Drejtorinë e Tatimeve Tiranë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lidhur me dokumentet e paraqitura nga OE “N.” Shpk, ka arritur në këtë konkluzion: Gjatë verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga ky operator, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vënë re se ka mospërputhje lidhur me Listëpagesën e dorëzuar për Muajin Shkurt. Në DST, Shtojca 7.

2. 2. shpk vlerën 26,933,026.00 lekë pa TVSH

a. Ka ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së çmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT. KVO si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve në ofertë, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d: dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji *“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale”* ka s’kualifikuar OE.

3. F. shpk me vlerën 32,278,037.00 lekë pa TVSH.

a. Ka ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së çmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT. KVO si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve në ofertë, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d: dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji *“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale”* ka s’kualifikuar OE.

4. BOE A. C. shpk; B. shpk me përfaqësues të këtij bashkimi OE “A. CO” shpk me vlerën 32,877,712.52 lekë pa TVSH. a. Ka ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së çmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT. KVO si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve në ofertë, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d: dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji *“Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale”* ka skualifikuar OE. Së dyti, në rastet kur oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, sipas kërkesave të DST kërkohet: *“Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit”*. Në marrëveshjen e bashkëpunimit të paraqitur nga ky bashkim, rezultojnë që:

- B. shpk ka deklaruar se do të realizojë 57.3% të punimeve. Sipas % së deklaruar ky operator duhet të kishte minimalisht Një teknik ndërtimi, Një punonjës elektrikist, Një punonjës hidraulik/mekanik, Një punonjës murator, Një punonjës bojaxhi, Një suvatues, Një punëtor d/alumini, Një punëtor cmontimi d/yer, dritare. Gjithashtu OE B. shpk ka 2 motogjeneratorë nga 3

që duhet të kishte minimalisht 2 matrapikë nga 3 që duhet të kishte minimalisht 1 kamion nga 2 që duhet të kishte minimalisht. Bazuar në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik” të ndryshuar, *Kreun XI, Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”*, pika 3. Si rrjedhojë, operatorët ekonomik pjesë e bashkimit nuk përmbushnin kriteret e veçanta të kualifikimit sipas DST, lidhur me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim.

5. M. K. & R. E. shpk me vlerën 37,990,012.47 lekë pa TVSH. a. Ka ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së çmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT. Ndryshimet e volumeve e bëjnë ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë. Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d.

6. A. shpk me vlerën 60,389,001.00 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij operatori ekonomik, rezulton të ketë probleme me dokumentacionin e paraqitur, pasi një pjesë e tyre janë për *Lotin 1 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Tiranë dhe Shkodër (13 objekte)” me fond limit 65,694,983.16 (gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre .16) lekë pa TVSH*, (ku gjithashtu ka marrë pjesë), dhe jo për *Lot.2 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)” me fond limit 38,223,795.24 (tridhjetë e tetë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë .24) lekë pa TVSH*, loti aktual për të cilin ka dorëzuar dokumente. Gjithashtu, Formulari i Ofertës Ekonomike (sipas *Shtojcës 1 dhe 2 të DST*) është dorëzuar ai për Lotin 1 dhe jo për Lotin 2, duke sjellë një ofertë më të lartë nga fondi limit i Lotit 2 dhe preventive të gabuar (*pasi është preventiv i Lotit 1*).

7. D. J.shpk, pa ofertë ekonomike.

Janë kualifikuar si të suksesshme ofertat e mëposhtme:

1. BOE Z K. shpk; I. Group shpk dhe V. G. shpk me vlerën 32,130,802.00 lekë pa TVSH, me vlerë të korrigjuar të ofertës 31,931,653.85 lekë pa TVSH.

2. S. shpk, me vlerën 33,333,333.00 lekë pa TVSH, *me vlerë të korrigjuar të ofertës 33,161,319.95 lekë pa TVSH*.

3. A. K. shpk, me vlerën 34,379,249.00 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 1487/13, datë 28.06.2022 është bërë “Formulari i njoftimit të fituesit paraprak” për Lotin 2 për BOE 2Z K.. shpk; I. G. shpk dhe V. G. shpk, me vlerën 31,931,653.85 lekë pa TVSH. Nga KVO për Loti 2 është përgatitur raporti përmbledhës me nr. 1487/17, datë 07.07.2022. Me shkresën nr. 1487/18, datë 07.07.2022 është bërë “Formulari i njoftimit të fituesit”. Ankesa nuk ka patur.

Midis AK dhe fituesit BOE “Z K. shpk; I. Group shpk dhe V. G. shpk” është lidhur kontrata me nr. 1487/19, datë 14.07.2022, me afat 4.6 muaj nga data e nënshkrimit të procesverbalit të fillimit të punimeve (për objektin e parë). Me urdhër nr. 391/1, datë 19.07.2022, prot. nr, 1487/21, datë 19.07.2022 është bërë “Për caktimin e drejtuesit të projektit për monitorimin e zbatimit të kontratës së furnizimit me nr. 1487/12 datë 28.06.2022”. Me shkresën nr.1487/22, datë 19.07.2022 është hartuar plani i zbatimit të kontratës. Me urdhër nr. 391, datë 30.06.2022, prot. nr, 1487/15, datë 30.06.2022 është bërë “Për caktimin e drejtuesit të projektit për monitorimin e zbatimit të kontratës së furnizimit me nr. 1487/12 datë 28.06.2022”. Me shkresën nr.1487/23 datë 25.07.2022 është dërguar “Plani i zbatimit të kontratës”. BOE Z K. shpk; I. G. shpk dhe V. G. shpk me vlerën 32,130,802.00 lekë pa TVSH, me vlerë të korrigjuar të ofertës 31,931,653.85 lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Sa më sipër nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet:

Së pari në lidhje me s’kualifikimin e Operatorit ekonomik me arsyen e s’kualifikimit mbi gabimin në sasinë e ofertës, referuar edhe vendimit të KPP 550/2020, KVO duhet të mbante fillimisht në konsideratë legjislacioni e Prokurimit Publik, nenin 82 VKM-në nr. 285 “***Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave***”; pika 2, citohet se “*nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik,*

nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”. Pika 3 “Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a. Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi **i çmimit të njësisë me sasinë**, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. b. Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

c. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se **2%** e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

Sipas ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 87 “**Kriteret për shpalljen e ofertës fituese**”,

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi.

Sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 “**Shqyrtimi i ofertave**”, pika 1 përcakton se “Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”. Pika 2. “Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet”.

Së dyti, sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 “**Shqyrtimi i ofertave**”, pika 3 përcakton se “...Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”. Gjithashtu bazuar edhe sipas VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 “**Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**”; pika 4, citohet se “Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.”

Pra KVO mund të konsideronte devijim të vogël mospërputhjen e vlerave të katalogut në atë të përkthyer, për pajisjet e rekuperatorëve të ajrit.

Referuar VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 45 pika 3**, ku citohet se: “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.”.

Duke parë rëndësinë e një ofertave ekonomike më të mira ekonomike, nga KVO duhej të kërkohej sqarime të mëtejshme nga Operatorët Ekonomik dhe mos të përbëhej arsye për s’kualifikim, pasi nuk cënonte aspak realizimin e kontratës me sukses.

Referuar ligjit mbi prokurimin publik mbi Kualifikimin e ofertuesve, gjykohet se kriteret për

kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Si konkluzion, referuar nenit 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirëpërdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është “Çmimi më i leverdisshëm”, për të bërë të mundur minimalisht shmangien e blerjes së mallit me një vlerë të konsiderueshme me të lartë ekonomike në disfavor të buxhetit të shtetit. Sipas VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 pika 3, ku citohet se: “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.”.

Titulli i Gjetjes	Në procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023) e ndarë në 2 Lote” Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave.
Situata:	<p>Me urdhrin e prokurimit nr. 199, datë 30.03.2023, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 103,918,778.4 lekë pa TVSH, me objekt “Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023)” me fond limit 103,918,778.40 Lekë pa TVSH” e ndarë në 2 lote. Procedura është mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga grupi i punës me urdhrin nr. 505, datë 24.11.2021, prot nr. 4601/2, datë 24.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përzgjedhjen e Qendrave Shëndetësore / Ambulancave, që do të rikonstruktohen gjatë vitit 2022-2023. Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 24.05.2022, në lidhje me s’kualifikimin e Operatorëve ekonomik, arsyeja e s’kualifikimit mbi gabimin në sasinë e ofertës, referuar edhe vendimit të KPP 550/2020, nuk është mbajtur në konsideratë neni 82 VKM-në nr. 285 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”; pika 2, citohet se “nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”. Pika 3 “Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:</p> <p>c. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar; - shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi. <p>Sipas ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë</p>

kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi. Sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 1 përcakton se “Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”. Pika 2. “Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet”. Sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 përcakton se “...Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”. Gjithashtu bazuar edhe sipas VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave”; pika 4, citohet se “Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.

Pra KVO mund të konsideronte devijim të vogël mospërputhjen e vlerave të njëjësive matëse duke korrigjuar ato. Referuar VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 pika 3, ku citohet se: “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.”

Duke parë rëndësinë e një ofertave ekonomike më të mira ekonomike, nga KVO duhej të kërkohej sqarime të mëtejshme nga Operatorët Ekonomik dhe mos të përbëhej arsye për s’kualifikim, pasi nuk cënonte aspak realizimin e kontratës me sukses.

Referuar ligjit mbi prokurimin publik mbi Kualifikimin e ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Si konkluzion, referuar nenit 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirëpërdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është “Çmimi më i leverdisshëm”, për të bërë të mundur minimalisht shmangien e realizimit të

	punës me një vlerë të konsiderueshme me të lartë ekonomike në disfavor të buxhetit të shtetit. Sipas VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 45 pika 3, ku citohet se: "Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave".
Kriteri:	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës "Punë" dhe dokumentet e tenderit. - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik".
Ndikimi/Efekti:	Mos rritje e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit.
Shkaku:	Mos mbajta në konsideratë ofertën më të leverdishme dhe mos zbatim i rregullave për vlerësimin e ofertave.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s'kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit".

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 1178/6 Prot., datë 09.06.2023, protokolluar në MSHMS me Nr. Prot. 225/42, datë 13.06.2023 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 225/47 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1178/7 prot., datë 13.07.2023, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Disa nga operatorët ekonomik kanë ofertuar duke ndryshuar volumet e preventivave, në bazë të nenit 92 "shqyrtimi i ofertave" të LPP shprehet se AK duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike. Sikurse dhe ligji shpreh në mënyrë shteruese, KVO mund të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike dhe në asnjë mënyrë të ndërhyjë duke korrigjuar ofertën. Ndryshimet e volumeve nuk mund të konsiderohen gabime aritmetike pasi nuk ka gabime në veprime por janë ndryshuar kërkesat e vendosura nga AK të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar, referuar nenit 92 dhe 91 të LPP. Gjithashtu në nenin 30 "Veprimtaria e KPP, sqaron se vendimet e marra nga komisioni janë administrative përfundimtare.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me bazën ligjore të paraqitura në observacion të vlerësimit të ofertave, merren pjesërisht në konsideratë, por referuar nenit 1 të LPP, qëllimi kryesor i ligjit është rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit duke siguruar mirëpërdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, ku KVO duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është "Çmimi më i leverdisshëm", për të bërë të mundur minimalisht shmangien e realizimit të punës me një vlerë të konsiderueshme me të lartë ekonomike në disfavor të buxhetit të shtetit.

ZBATIMI I KONTRATAVE

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: "Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan", viti 2020, konstatohet:

Projekti i Rikonstruksionit të disa QSH-ve në qarqet Berat, Elbasan Korçë, parashikon rikonstruksionin e 30 qendrave shëndetësore dhe ambulanca, të cilat në vetvete kanë preventivin dhe projektin e tyre, ku shtrirja gjeografike e këtyre qendrave është në distanca të konsiderueshme me njëra-tjetrën. Rikonstruksionet kanë të bëjnë kryesisht me punime sipërfaqësore, si punime prishjeje, punime tarrace, punime shtresash, punime suvatimi, dyer e dritare, të jashtme, furnizimi me ujë, KUZ dhe punime elektrike. Objekti i kontratës "Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet

Berat, Korçë dhe Elbasan" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1076/43 prot. datë 08.06.2020, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësuar nga zj. G. P. dhe BOE "B." shpk dhe "B." shpk, përfaqësuar nga "B." shpk me administrator z. B. U. sipas Akt marrëveshjes nr.1261 REP, nr. 410 Kol datë 28.03.2020. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar *nenit 27.3* të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës, ku kontraktori paguhet me sasinë e punës e realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Vlera e kontratës është 118,583,332 lekë pa TVSH ose 142,299,999 lekë me TVSH.

Me urdhër e titullarit Ak nr. 463 – 463/6 datë 07.08.2020 “caktohen personat përgjegjës që do merren me ndjekjen në terren të kontratave për Lot2”, me detyra që të vendosin në dispozicion sheshin e ndërtimit, ndjekjen periodike të punimeve, konfirmim të situacioneve dhe certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve.

Delegimi i detyrave për ndjekjen, konfirmimin e situacioneve të këtij grupi, nuk është në përputhje me nenin 7 ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, ku citohet në mënyrë eksplicite: *Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, **gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse.***

Grupet e ngritura, nuk janë ekspertë të fushës, ku mbi të gjitha nuk kanë licence. Detyrat e tyre janë të mirëpërcaktuar në kontratën e mbikëqyrjes, bazuar nenit 8 të kontratës së mbikëqyrjes “Detyrimet e veçanta të kontraktuesit”. Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 2769/9prot. datë 07.08.2020, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësuar nga zj. G. P.dhe operatorit ekonomik "N. s." sh.p.k, përfaqësuar nga drejtuesit ligjor Ing. E. N. Afati i përfundimit të punimeve sipas kontratës, është përcaktuar 185 ditë nga procesverbali i fillimi i punimeve.

Aktet e dorëzimit të shesheve të ndërtimit është mbajtur më datë 24.09.2020. Njoftimet dhe Procesverbalet e fillimit të punimeve, akti i piketimit janë mbajtur nga 19.08.2020 deri më datë 24.09.2020 sipas QSH. Në dosje disponohen ndryshimet e zërave, miratimet përkatëse nga mbikëqyrësi dhe përdorimi i fondit rezervë në tabelën e lëvizjeve të volumeve të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Njoftimi dhe procesverbali i përfundimit të punimeve janë realizuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi është me shkresën nr. 908/1 datë 22.02.2021.

- Për kolaudimin e punimeve është kontraktuar operatori ekonomik "G. L. C." shpk, përfaqësuar nga drejtuesit ligjor Ing. L. H. dhe Akti i kolaudimit është realizuar më datë 02.04.2021. Marrja në dorëzim e punimeve janë realizuar nga grupet e QSH më datë 09.04.2021.

Titulli i Gjetjes	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “ <i>Rikonstrukcion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan</i> ”, nga kontraktori BOE "B." shpk dhe "B." shpk.
Situata:	Nga verifikimi i strukturës së preventivit dhe pagesës në situacionin përfundimtar dhe disa Qendrave shëndetësore në terren u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon: 1. Në situacionin përfundimtar të QSH Pajovë, kapitulli e punimeve e dyer dritareve zëri nr. 6, nr. Anal. 2.413 “ <i>F.V zgara dekorative hekuri me figuracion mesatare</i> ”, me vlerën 5,158 lekë nuk ishte vendosur në objekt. Në total për QSH Pajovë rezulton vlera prej <u>5,158 lekë</u> .

2.a. Në situacionin përfundimtar të QSH Gjergjan, kapitulli e punimeve çatie zëri nr. 5, nr. Anal. 2.206 “kasetë shkarkimi me llamarinë xingat”, me vlerën 4,260 lekë nuk ishin vendosur në objekt.

2.b. Në situacionin përfundimtar të QSH Gjergjan, kapitulli e punimeve suvatimi dhe lyerje nr. 4, nr. Anal. 2.35 “suva xokoli me granil e çimento”, situacioni përfundimtar mban sasinë 33 m² dhe librezja e masave mban sasinë 33 m². Nga verifikimi në objekt u konstatua se xokoli nuk kishte lartësi më të madhe se 30 cm, ndërkohë në librezën e masave është llogaritur me lartësi 65 cm, rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej 15 m² me çmimin 434 lekë rezulton vlera prej 6,510 lekë. Gjithashtu referuar projektit, lartësia e QSH Gjergjan është 3 m, e cila është përlogaritur në sasinë e suvatimit të jashtëm, ku nuk është zbritur sasia e sipërfaqes së xokolit.

2.c Në situacionin përfundimtar të QSH Gjergjan, kapitulli e punimeve suvatimi dhe lyerje zëri nr. 2, nr. Anal. 2.331 “Suva e zakonshme fasade me tulle h-8m”, situacioni përfundimtar mban sasinë 152 m², në librezën e masave është përlogaritur se është suvatuar e gjithë fasada në sipërfaqe 152m², kur ndërkohë është veshur me kapotë në sipërfaqe 143 m², me çmimin 1,953 lekë/m². Zëri i suvatimit të jashtëm është i mbivendosur sistemit kapotë i cili është realizuar me grafiato. Sistemi kapotë është llogaritur sipas zërit “Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva” me nr. Anal. 2.358/b, siç është në shumë qendra shëndetësore (Pajovë, Belsh, Gjocaj, 18 tetori, Skrapar, Kuçove etj.) me të njëjtin çmim prej 1,953 lekë/m². Pra në thelb zëri i “Veshje muri me polisterol (sistemi kapote)” është i njëjtë me zërin “Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva” dhe sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Rrjedhimisht suvatimi i jashtëm në vlerën 89,984 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi. Në total për QSH Gjergjan rezulton vlera prej 100,754 lekë (89,984 + 6,510 + 4,260).

3. Në situacionin përfundimtar të QSH “Tafil Skendo + 11 shkurti” Kuçovë, kapitulli e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 8, nr. 2.358/b “Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva” me çmimin prej 1,953 lekë/m². Sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet Grafiato për suva. Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 6, nr. anal 2.308/a “Suvatim me grafiato” me çmimin sipas VKM prej 1,057 lek/m² (në përlogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga BOE “B.” shpk & “B.” shpk me 719 lekë/ m², i cili është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Gjithashtu referuar përlogaritjeve në librezën e masave “Suvatimi me grafiato”, ndodhet në të njëjtat sipërfaqe të veshjes me sistem kapotë. Rrjedhimisht për sa më sipër, zëri i “Suvatim me grafiato”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasinë prej 367.36 m² me çmimin 719 lekë/m², ku rezulton vlera prej 264,132 lekë.

Njësoj si në QSH “Tafil Skendo + 11 shkurti”, në situacionin përfundimtar të QSH “Qendër Kolonjë”, kapitulli e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 4, nr. anal An1 “Veshje fasadë me kapotë”, me çmimin 1,953 lekë (njësoj si zëri Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete

+ suva” me nr. Anal. 2.358/b) është llogaritur në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet Grafiato për suva.

Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 2, nr. anal 2.308/a “*Suvatim me grafiato*” me çmimin e ofertuar nga kontraktori me 719 lekë/ m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Rrjedhimisht për sa më sipër, zëri i “*Suvatim me grafiato*”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasinë prej 60 m² me çmimin 719 lekë/m², ku rezulton vlera prej 43,176 lekë.

5. Njësoj si në QSH “Tafil Skendo + 11 shkurti”, në situacionin përfundimtar të AMB “Fshati Pojan”, kapitulli e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 4, nr. anal An1 “*Veshje fasadë me kapotë*”, me çmimin 1,953 lekë (njësoj si zëri Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva” me nr. Anal. 2.358/b) është llogaritur në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet Grafiato për suva.

Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 2, nr. anal 2.308/a “*Suvatim me grafiato*” me çmimin e ofertuar nga kontraktori me 719 lekë/ m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Rrjedhimisht për sa më sipër, zëri i “*Suvatim me grafiato*”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasinë prej 59.95 m² me çmimin 719 lekë/m², ku rezulton vlera prej 43,105 lekë.

6. QSH “Fshati Vithkuq”, në situacionin përfundimtar të kapitulli e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 4, nr. anal An1 “*Veshje fasadë me kapotë*”, ka sasinë prej 271.39 m². Libreza e masave ka sasinë 271.39 m², e cila ka përlllogaritur lartësinë e objektit prej 3.35m. Nga verifikimi i projektit kjo QSH ka lartësinë 3.1 m. Duke përlllogaritur me lartësinë 3.1 m, rezulton sipërfaqe prej 248 m². Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasinë prej 23 m² (271.39 – 248.09 m²) me çmimin 1,953 lekë/m², ku rezulton vlera prej 45,504 lekë.

7. Në situacionin përfundimtar të AMB Togëz, kapitulli e punimeve suvatimi dhe lyerje zëri nr. 8, nr. Anal. 2.331 “*Suva e zakonshme fasade me tulle h-8m*”, situacioni përfundimtar mban sasinë 115.7 m², në librezën e masave është përlllogaritur se është suvatuar e gjithë fasada në sipërfaqe 115.7 m², kur ndërkohë është veshur me kapotë në sipërfaqe 115.7 m². Zëri i suvatimit të jashtëm është i mbivendosur sistemit kapotë i cili është realizuar me grafiato. Referuar specifikimeve teknike për ambulancën Togëz citohet “*Suvatimet e jashtme nuk janë prekur për faktin se ato do vishen me polisterol jeshil e me rrjete e suvatohen rishtas. është parashikuar dhe veshje me grafiato*. Rrjedhimisht suvatimi i jashtëm në vlerën 68,494 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

Si përfundim, nga kontraktori BOE “B.” sh.p.k & “B.”, është përfituar padrejtësisht punime të mbivendosura, në vlerën 570,323 lekë pa TVSH

	(5,158 + 100,754 + 264,132 + 43,176 + 43,105 + 45,504 + 68,494) ose 684,387 lekë me TVSH.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Shkaku:	Pasaktësi nga mbikëqyrësi i punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	MSHMS, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej 684,387 lekë nga kontraktori BOE "B." shpk dhe "B." shpk, për punime të mbivendosura dhe të likuiduara por të pa realizuara.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: **“Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier”**, viti 2020, konstatohet: Projekti i Rikonstruksionit të disa QSH-ve në qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier parashikon rikonstruksionin e 28 qendrave shëndetësore dhe ambulanca, të cilat në vetvete kanë preventivin dhe projektin e tyre, ku shtrirja gjeografike e këtyre qendrave është në distanca të konsiderushme me njëra-tjetrën. Rikonstruksionet kanë të bëjnë kryesisht me punime sipërfaqësore, si punime prishjeje, punime tarrace, punime shtresash, punime suvatimi, dyer e dritare, të jashtme, furnizimi me ujë, KUZ dhe punime elektrike. Objekti i kontratës *“Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier”* është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3681/31 prot. datë 02.11.2020, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësuar nga zj. G. P.dhe OE "C." shpk, përfaqësuar nga administratori znj. D. L. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar *nenit 27.3* të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës, ku kontraktori paguhet me sasinë e punës e realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Vlera e kontratës është 89,487,258 lekë pa TVSH ose 107,384,709 lekë me TVSH. Me urdhër e titullarit Ak “caktohen personat përgjegjës që do merren me ndjekjen në terren të kontratave Lot 4”, me detyra që të vendosin në dispozicion sheshin e ndërtimit, ndjekjen periodike të punimeve, konfirmim të situacioneve dhe certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve.

Delegimi i detyrave për ndjekjen, konfirmimin e situacioneve të këtij grupi, nuk është në përputhje me nenin 7 ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”* i ndryshuar, ku citohet në mënyrë eksplicite *Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse. Grupet e ngritura, nuk janë ekspertë të fushës, ku mbi të gjitha nuk kanë licence. Detyrat e tyre janë të mirëpërcaktuara në kontratën e mbikëqyrjes, bazuar nenit 8 të*

kontratës së mbikëqyrjes “Detyrimet e veçanta të kontraktuesit”. Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 2769/25 prot. datë 22.12.2020, të lidhur midis Autoritetit Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësuar nga zj. G. P. dhe operatorit ekonomik "T." sh.p.k, përfaqësuar nga drejtuesit ligjor Ing. D. Q. Afati i përfundimit të punimeve sipas kontratës, është përcaktuar 155 ditë nga procesverbali i fillimi i punimeve. Aktet e dorëzimit të shesheve të ndërtimit është mbajtur më datë 18.01.2021. Njoftimet dhe Procesverbalet e fillimit të punimeve, akti i piketimit janë mbajtur më datë 18.01.2021. Në dosje disponohen ndryshimet e zërave, miratimet përkatëse nga mbikëqyrësi dhe përdorimi i fondit rezervë në tabelën e lëvizjeve të volumeve të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Amendimi nr. 1 me nr. 1271/5 prot. Datë 21.06.2021, me objekt zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve prej 30 ditësh deri më datë 21.07.2021. Amendimi nr. 2 me nr. 3192/3 prot. Datë 21.07.2021, me objekt zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve prej 30 ditësh deri më datë 21.08.2021, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Njoftimi i përfundimit të punimeve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve janë pa protokoll më datë 20.08.2021.

Për kolaudimin e punimeve është kontraktuar operatori ekonomik "G. L. C." shpk, përfaqësuar nga drejtuesit ligjor Ing. L. H. dhe Akti i kolaudimit është realizuar më datë 04.10.2021. Marrja në dorëzim e punimeve janë realizuar nga grupet e QSH më datë 30.11.2021.

Titulli i Gjetjes	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruktion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier” nga kontraktori "C." shpk.
Situata:	<p><i>Nga verifikimi i strukturës së preventivit dhe pagesës në situacionin përfundimtar u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</i></p> <p>1. Në situacionin përfundimtar të QSH “Mesopotam”, kapitulli e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 4, nr. 2.358/b “<i>Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva</i>” me çmimin prej 1,600 lekë/m². Sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet Grafiato për suva.</p> <p>Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 7, nr. anal 2.308/a “<i>Suvatim me grafiato h>4m</i>” me çmimin sipas VKM prej 1,057 lekë/m² (në përlllogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga OE “C.” shpk me 600 lekë/ m², i cili është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Gjithashtu referuar përlllogaritjeve në librezën e masave “<i>Suvatimi me grafiato</i>”, ndodhet në të njëjtat sipërfaqe të veshjes me sistem kapotë. Rrjedhimisht për sa më sipër, zëri i “<i>Suvatim me grafiato</i>”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasinë prej 176.87 m² me çmimin 600 lekë/m², ku rezulton vlera prej <u>106,122 lekë</u>.</p> <p>2. Njësoj si në QSH “Mesopotam”, në situacionin përfundimtar të QSH “10 Korriku”, kapitulli IV, zëri nr. 1, nr. 2.358/b “<i>Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva</i>”, me çmimin 1,600 lekë është llogaritur në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet Grafiato për suva. Ndërkohë, po në kapitullin IV, zëri nr. 2, nr. anal 2.308/a “<i>Suvatim me grafiato</i>” me çmimin e ofertuar nga kontraktori me 600 lekë/ m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Rrjedhimisht për sa më sipër, zëri</p>

	<p>i “<i>Suvatim me grafiato</i>”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasinë prej 232.3 m² me çmimin 600 lekë/m², ku rezulton vlera prej <u>139,380 lekë</u>.</p> <p>3. Njësoj si në QSH “Mesopotam”, në situacionin përfundimtar të QSH “Aliko”, kapitulli e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 3, nr. anal An1 “<i>Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva</i>, me çmimin 1,600 lekë është llogaritur në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet Grafiato për suva. <i>Ndërkohë</i>, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 5, nr. anal 2.308/a “<i>Suvatim me grafiato h>4m</i>” me çmimin e ofertuar nga kontraktori me 600 lekë/ m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Rrjedhimisht për sa më sipër, zëri i “<i>Suvatim me grafiato</i>”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasinë prej 73.82 m² me çmimin 600 lekë/m², ku rezulton vlera prej <u>44,292 lekë</u>. Si përfundim, nga kontraktori OE “C.” sh.p.k, është përfituar padrejtësisht punime të mbivendosura, në vlerën 289,794 lekë pa TVSH (44,292 + 139,380 + 106,122) ose 347,752 lekë me TVSH.</p>
Kriteri:	<p>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Shkaku:	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	MSHMS, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej 347,752 lekë nga kontraktori OE “C.” shpk, për punime të mbivendosura dhe të likuiduara.

2.5 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga audituesit e autorizuar të KLSH-së u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe mbi këtë bazë u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve përkatës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku rezultoi sa vijon:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo

ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta referuar përcaktimeve të VKM-së nr.609 datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të tij hartohet nga institucioni dhe dërgohet për miratohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke ndjekur ecurinë për miratimin përfundimtar për tu vënë në dispozicion fondet buxhetore.

Për periudhën objekt auditimi 01.04.2021 deri në 31.12.2022 rezultoi se:

Sa më sipër, në përmbushje sipas kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”.

Kështu, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar deklaratën vjetore të cilësisë së kontrollit të brendshëm për vitin 2021 dhe vitin 2022 me shkresat nr.1075 prot, datë 28.02.2022, nr.1075/1 prot datë 15.03.2022 drejtuar Njësisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe shkresa me nr.1075 prot, datë 28.02.2023, për vitin 2022.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe gjetjet e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

-Aktivitetet e planifikuara për tu ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur urdhri me nr.163, datë 17.03.2021 për Ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve në Sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2022-2024. Programet janë ndarë si më poshtë:

- Programi i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 07220,
- Programi i Shërbimeve të Kujdesit Spitalor 07330,
- Programi i Shërbimeve të Shëndetit Publik 07450,
- Programi i Planifikimit, Administrim dhe Menaxhim 01110,
- Programi i Shërbimit Kombëtar të Urgjencës 07460,
- Programi i Përkujdesjes Sociale 10430,
- Programi i të Përndjekurve Politikë 10430.

Krijimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), në zbatim të ligjit nr. 10296 datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljen etike dhe se ky grup përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Me urdhrin e brendshëm të Ministrit të MSHMS znj. O. M.me nr.166, datë 18.03.2021 me nr.1465 prot është ngritur GMS me këtë përbërje: znj. O. M., kryetare, znj. M. R., nënkryetare znj. G. P., koordinator dhe z. S. K., sekretar, në total prej 17 anëtarësh që asistohen nga sekretariati teknik i përbërë nga 2 punonjës.

Ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS-së për periudhën objekt auditimi viti 2021 ndërsa për vitin 2022 nuk janë vënë në dispozicion audituesve.

1. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjelltë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, Institucioni ka hartuar një kod etike miratuar me Urdhrin nr.44, datë 26.01.2023 “Për miratimin e Kodit të Etikës së Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale funksionon në bazë të strukturës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.121, datë 28.10.2021 ku në total ka 148 punonjës. MSHMS ka miratuar rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e MSHMS-së” miratuar me Urdhrin e Ministrit të MSHMS nr.124/1, datë 07.03.2022 ku janë përcaktuar: struktura organizative e MSHMS funksionet dhe detyrat e funksioneve të larta të drejtimit, funksionet e drejtorive dhe sektorëve, si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit.

II. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës

Për auditimin e marrëdhënieve të punës grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore:

- VKM nr.893, datë 17.12.2014 pika 3 “*Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki.*”
- VKM nr. 187 datë 8.3. 2017 “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*” i ndryshuar.
- VKM 929, datë 27.11.2010 “*Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë*”, të ndryshuar.
- Urdhri nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil*”.
- Rregullorja e Brendshme “*Për organizimin dhe funksionimin e MSHMS-së*” miratuar me Urdhrin e Ministrit të MSHMS nr.124/1, datë 07.03.2022.

Struktura:

Struktura e MSHMS e planifikuar dhe realizuar për periudhën objekt auditimi prill 2021-dhjetor 2022 është si vijon:

Për vitin 2021, struktura e MSHMS-së ka funksionuar me 148 pozicione pune referuar Urdhrit të Kryeministrit nr.169, datë 05.10.2017 i ndryshuar ku në total ka 148 punonjës.

Në fund të vitit 2021, me shkresën nr.4047/3 prot., datë 01.11.2021 të Sekretares së Përgjithshme të MSHMS-së drejtuar Drejtorit të Administratës Publike i është kërkuar krijimi i komisionit të ristrukturimit. Me urdhrin e Drejtorit të Administratës Publike nr.274 datë 03.11.2021 është krijuar

komisioni i ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të MSHMS-së i përbërë nga:

a. O.M., Specialist në Sektorin e Rekrutimit në DAP,

b. G. P., Sekretar i Përgjithshëm i MSHMS-së,

c. N. L., Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MSHMS.

Komisioni ka hartuar procesverbalin përkatës i cili është protokolluar me shkresën nr.4047/86 datë 14.12.2021 ku specifikohen në mënyrë të detajuar lëvizjet. Referuar procesverbalit u hartua vendimi nr. 4047/87 prot., datë 14.12.2021 i komisionit të ristrukturimit për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civile në kuadër të ristrukturimit të MSHMS-së. Riorganizimi nuk ka sjell ndryshime në numrin e përgjithshëm, 148 vetë gjithsej, me status total 114 nëpunës, me kod pune 34 punonjës. Të prekur nga ristrukturimi janë gjithësej 87 pozicione pune, aktual nëpunës 74 vetë i cili u është konfirmuar me shkresën nr.6947/1 prot., datë 17.12.2021 të Drejtorit të Administratës Publike.

Për vitin 2022, struktura e MSHMS ka funksionuar me 148 pozicione pune referuar Urdhrit të Kryeministrit nr.121, datë 28.10.2021 ku në total ka 148 punonjës. *Konkretisht*, përveç pozicionit të Ministrit janë, *9 punonjës të Kabinetit; 4 zëvendësministra 4 Sekretarë; 1 Sekretar i Përgjithshëm + 1 sekretar, 26 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Shëndetësinë, 18 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme e Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale; 10 punonjës në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, 17 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale, 52 punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse; 5 punonjës në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.*

Për periudhën objekt auditimi në MSHMS ka pasur punonjës me kontratë të rekrutuar referuar VKM nr. 1151, datë 24.12.2020, *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore”* dhe sipas VKM nr. 35, datë 19.01.2022, *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore.* Për vitin 2021 në MSHMS kanë qenë të punësuar në total 13 punonjës me kontratë (punonjës 6 orësh) ndërsa për vitin 2022 kanë qenë të punësuar në total 10 punonjës me kontratë (10 punonjës 6 orësh).

Gjithashtu për periudhën objekt auditimi në MSHMS ka pasur punonjës të rekrutuar me praktikën e Planit Kombëtar për studentët e ekselencës referuar VKM nr. 665, datë 10.11.2021, *“Punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil”* 6 punonjës për vitin 2021 dhe 4 punonjës për vitin 2022.

Procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna:

MSHMS ka të implementuar Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) i cili i ndërtuar për të ndihmuar institucionet shtetërore në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Sistemi përmban të dhëna dhe informacion të zgjeruar për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet. Në dosjet personale të të punësuarve reflektohen të dhëna për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, trajnimet, pagat dhe sigurimet. HRMIS përmban informacion për strukturën dhe organikën e institucioneve. Strukturat e hedhura në sistem plotësohen nga personi përgjegjës i institucionit znj. A. F. bazuar në VKM nr. 117, datë 05.03.2014 *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”* dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”* parashikojnë se sistemi HRMIS duhet të ndërveprojë me bazat e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Sistemit të Thesarit në Ministrinë e Financave etj. HRMIS shërben si burim planifikimi dhe informacioni për pagat dhe pagesat e nëpunësve publikë, nëpërmjet ndërveprimit me Sistemin e Thesarit.

Gjatë periudhës objekt auditimi ka pasur disa procedura largimi dhe disa procedura rekrutimi.

Procesi i rekrutimit të punonjësve kryhet nga DAP kurse largimet për periudhën objekt auditimi kanë qenë kryesisht me dorëheqje/ mosha e daljes në pension. Lidhur me aktivitetin e aparatit për këto procedura paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: Procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna.

Vitet	Largime nga puna (shkurtime)	Largime me dorëheqje/mosha e daljes në pension	Emërimet/ Rritje në detyrë
Prill -dhjetor 2021	Nuk ka	16 punonjës	5 punonjës
Janar- dhjetor 2022	Nuk ka	27 punonjës	29 punonjës

Burimi: MSHMS përpunuar nga grupi i auditimit

Institucioni për periudhën objekt auditimi nuk ka tejkaluar numrin e punonjësve të planifikuar për çdo vit kalendarik.

Bazuar nga dokumentacioni i audituar, në dhjetor 2022 MSHMS ka 19 vende vakante nëpunës civile konkretisht:

Nr. Rendor	Kategorizimi	Vend vakant
1	Drejtor i Përgjithshëm	2
2	Përgjegjës sektori	6
3	Specialist	11
	Totali	19

Në zbatim të nenit 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, MSHMS ka krijuar bazën e të dhënave si dhe me urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm nr.351 , datë 02.06.2022 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për zbatimin e vendimeve të formës së prerë”, i ndryshuar me urdhrin nr.351/1 datë 29.06.2022 ka ngritur Komisionin e Posaçëm për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ky komision ka ndjekur vetëm 1 procedurë konkretisht për z. P. P., i cili me shkresën nr.4222/3 prot., datë 05.07.2022 është emëruar në pozicionin e zv/drejtorit të përgjithshëm pranë Institutit të Integritit të Ish të Përndjekurve Politikë.

Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me Memon nr. 1301 prot., datë 16.03.2023 i drejtohet Ministrit dhe Sekretares së Përgjithshme të mbahet në vëmendje zbatimi i vendimeve ndaj 13 (trembëdhjetë) gjyqfituesve:

1. N. I.
2. A. Gj.
3. D. B.
4. I. P.
5. F. B.
6. S. F.
7. H. M.
8. A. Xh.
9. K. V.
10. M. C.
11. R. Z.
12. L. Gj.
13. L. B.

Titulli i gjetjes:	Vijojnë pagesa për ish punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna.
Situata:	Nga auditimi është konstatuar se për periudhën objekt auditimi vijojnë 13 vendime gjyqësore me detyrimin për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna për të cilët vijon pagesa. Komisioni i Posaçëm ka shqyrtuar vetëm një rast dhe nuk është mbledhur për vlerësimin dhe kthimin në punë të 13 punonjësve të tjerë. Nga ana tjetër, MSHMS ka rekrutuar staf të ri, si dhe struktura është e paplotësuar, pra ka vende vakante të lira. Mosveprimi i këtij komisioni në MSHMS për kthimin e punonjësve në punë dhe shqyrtimin e vendimeve rëndon edhe më shumë buxhetin e shtetit me shpenzime për vendime gjyqësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Urdhrin nr.5151 datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil” .
Kriteri:	Urdhri nr. 5151 datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”.
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ në buxhetin e shtetit për vendime gjyqësore.
Shkaku:	Mosmbledhja e Komisionit të Posaçëm për të shqyrtuar për vlerësimin dhe kthimin në punë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Strukturat përgjegjëse të MSHMS, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Dosjet e personelit

Dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore duke u bazuar në VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishtme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, e cila përcakton se:

- 1. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.*
- 2. Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrave, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.*

Sa i përket dokumenteve që duhet të jenë në dosjet e të punësuarve, baza ligjore në fuqi përcakton se:

Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

-Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar.

-Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes.

-Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë); certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicionin e punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse “nota

mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i laurimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfutur jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës; akti i dhënies së masës disiplinore; librezja e punës; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

Nga auditimi i dosjeve të personelit me zgjedhje grupi i auditimit konstatoi se nga 34 dosje personeli të përzgjedhura rezultoi se 7 punonjës në dosjen e tyre kanë kopjen e diplomës të panoterizuar. Gjithashtu konstatohet edhe mangësia e vërtetimit mjekësor për 5 dosje. Gjatë periudhës së auditimit filluan të plotësohen dosjet me dokumentet e kërkuar.

Titulli i Gjetjes:	Administrimi i dosjeve të personelit nuk është bërë sipas kuadrit ligjor në fuqi.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit është konstatuar mangësi në noterizimin e diplomave dhe mungesa e vërtetimit mjekësor jo konform përcaktimeve të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
Kriteri:	-VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. -VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
Ndikimi/Efekti:	Dokumentacioni në dosjet personale të punonjësve nuk është i plotë, sipas kërkesës në VKM-ve të sipërcituara.
Shkaku:	Dokumentacioni në dosjet personale të punonjësve nuk është i plotë, sipas kërkesës në VKM-ve të sipërcituara.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa në vazhdimësi për plotësimin e dosjet së personelit me dokumentacionin përkatës.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kemi konstatuar se ka rregullore të brendshme të miratuar nga titullari, ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 01.04.2021- 31.12.2022 janë kryer vlerësimet e punonjësve për vitet 2021 dhe 2022.

e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës për vitin 2021 dhe maj- dhjetor 2022 me shkresat respektive nr.367/1 prot, datë 21.01.2021 “Për miratimin e planit të trajnimit 2021” dhe nr.2151/1 prot datë 20.05.2022 “Për miratimin e planit të trajnimeve për periudhën maj-dhjetor 2022”.

2. Menaxhimi i riskut.

Nuk është hartuar e miratuar Strategjia e Menaxhimit të Risqeve për institucionin e MSHMS për periudhën objekt auditimi dhe nuk janë përditësuar regjistrat e riskut dy herë në vit në përputhje me kërkesat e pikës nr. 3.2.5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.7.2016.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Nga auditimi është konstatuar se është hartuar Urdhri me nr.224, datë 08.03.2019, “Për angazhim Auditimi” për menaxhimin e aktiveve, për hartimin e PBA-së, për investimet dhe prokurimet publike sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit” pika 2 ku përcaktohet: *“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”*, si dhe Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 anekset 2, 3 dhe 4.

4. Informim komunikimi.

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Sektori i Financës ka raportuar tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, duke hartuar raporte monitorimi mujore, apo tremujore. Punonjësit brenda instiucionit vijojejnë të komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. MSHMS ka faqen e tij zyrtare dhe nëpërmjet këtij website të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të MSHMS-së.

5. Monitorimi.

Nga auditimi i të gjitha fushave të veprimtarisë së këtij institucioni rezultoi se, janë hartuar raporte totale të monitorimit të buxhetit dhe raportet e monitorimit vjetor të tij për institucionet e varësisë sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në nenin 65 “Monitorimi”, në të cilin citohet: *“Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore, i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, nëpunësit të parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm.*

Ndërsa për aparatën e MSHMS-së, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Nga MSHMS monitorimi është kryer për të gjithë programet e MSHMS pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65. Nga MSHMS nuk është hartuar një udhëzues, për përcaktimin e procedurave apo rregullave specifike që duhet të ndjekin njësitet e varësisë së qeverisjes qendrore për procesin e monitorimit të buxhetit si dhe përcaktimi i afateve për paraqitjen e dërgimin e tyre pranë institucioneve eprorë, në zbatim të Udhëzimit të MFE-se nr. 22, datë 17.11.2016, pika 9.

Nga auditimi i pikës mbi prokurimet publike u konstatua se problematikë është dhe monitorimi i

kontratave, pasi në pjesën më të madhe ku Ministria e Shëndetësisë ka qenë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, lidhja dhe zbatimi i kontratave është realizuar në Institucionet në varësi të saj prej të cilave nuk kanë marrë një informacion monitorues përshkrues të ecurisë përfundimtare për zbatimin e suksesshëm të kontratave.

III.VLERËSIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është e organizuar në rang drejtorie që nga viti 2004. Struktura dhe organika e Njesisë së AB në MSHMS është miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 169, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Shëndetësisë“, i ndryshuar. Me Urdhër të Kryeministrit Nr. 27, datë 09.02.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr. 169, datë 05.10.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale“, të ndryshuar“, Njësia e Auditimit në MSHMS nga (1+6) bëhet (1+4).

Njësia e auditimit funksionon në mënyrë të pavarur dhe raporton drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndërsa varësia organizative është nga Sekretari i Përgjithshëm.

Viti 2021

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitet e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjOH/AB.

Plani vjetor dhe strategjik është miratuar nga Ministri i MSHMS me shkresën nr. 4403/1 prot., datë 19.10.2020.

Referuar shkresës nr.4403/2 prot., datë 19.10.2020 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për ushtrimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm gjatë vitit 2021 është përgatitur “Plani vjetor dhe Strategjik 2021 për zhvillimin e auditit për vitet 2021-2023”.

-Plani Strategjik për periudhën 2021 – 2023, përbëhet nga:

- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2021-2023.
- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2021-2023.
- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2021.
- Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2021.
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2021.

Me shkresën nr.728 prot., datë 08.02.2021 është miratuar një ndryshim në planin vjetor të vitit 2021, i cili i është përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Bazuar në Planin Vjetor 2021, i ndryshuar, ishin parashikuar gjithsej 24 angazhime auditimi, nga të cilat 23 auditime “Të Kombinuara”, dhe 1 auditim “I Përputhshmërisë”.

- Auditimi i përputhshmërisë është programuar në Aparatin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për fondet IPA II.
- Auditimet e kombinuara janë programuar të kryhen në institucionet e varësisë, në kategoritë si; shërbimi dytësor 1 subjekt; shëndeti publik 11 subjekte; shërbimi i urgjencës 1 subjekt; shërbimi spitalor 9 subjekte; dhe shërbimi spitalor universitar 1 subjekt.

Nga 24 auditime të planifikuara janë realizuar 18 prej tyre ose 75 % dhe 4 auditime në proces.

Nuk janë realizuar auditimet në: **1)** MSHMS për fondet IPA II, **2)** NJVKSH Përmet, **3)** NJVKSH Skrapar, **4)** Spitali Rajonal Berat, **5)** Shërbimi Spitalor Has, **6)** Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi” Tiranë.

Sa më sipër të pasqyruara në **Aneksin 4.1** “Planin Vjetor 2021” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Viti 2022

Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, pas miratimit nga titullari i institucionit, dërgohen jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti pranë NjOH/AB.

Plani vjetor dhe strategjik është miratuar nga Ministri i MSHMS me shkresën nr. 3746/3 prot., datë 11.10.2021.

Referuar shkresës nr.3746/4 Prot., datë 20.10.2021 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ka dërguar Planin Vjetor dhe Strategjik, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për ushtrimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm gjatë vitit 2022 është përgatitur “Plani vjetor dhe Strategjik 2022 për zhvillimin e auditit për vitet 2022-2024”.

-Plani Strategjik për periudhën 2022 – 2024, përbëhet nga:

- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2022-2024
- Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2022-2024
- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2022
- Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2022
- Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2022

Bazuar në Planin Vjetor 2022 ishin parashikuar gjithsej 13 angazhime auditimi, nga të cilat 11 auditime “Të Kombinuara”, 1 auditim “Të Përputhshmërisë” dhe 1 auditim “Të performancës”.

- Auditimet e kombinuara janë programuar të kryhen në institucionet e varësisë, në kategoritë si; administrimi; shëndeti parësor; shërbimi parësor; shërbimi dytësor; shërbimi spitalor universitar; dhe rehabilitimi i përndjekurve politikë.
- Auditimi i përputhshmërisë është programuar në Aparatin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për fondet IPA II.
- Auditimi i performancës është programuar në katër subjekte të shërbimit spitalor me objekt “Shpenzimet për barna, materiale mjekimi, ushqime, materiale të buta, etj., në raport me numrin e shtretërve dhe statistikat vjetore për shtrimet”.

Fushat e identifikuara për auditim kanë të bëjnë me; shpenzimet operative, të drejtat dhe detyrimet, projektet e investimeve, menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i pajisjeve mjekësore, zbatimi i sistemit të referimit, performanca e trajtimit të pacientëve nga personeli mjekësor, dhe performancë e shpenzimeve operative në raport me shtrimet.

Janë realizuar gjithsej 11 angazhime auditimi nga 13 angazhime të planifikuara; **ose 85 %**.

Nuk janë realizuar auditimet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për fondet IPA II; dhe Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë i cili është mbuluar me auditim nga KLSH.

Sa më sipër të pasqyruara në **Aneksin 4.2** “Planin Vjetor 2022” bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Dosjet e audituara

1.Drejtorja e Shërbimit Spitalor Librazhd

Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit, drejtuar me email njësisë që do auditohet referuar planit vjetor 2021. Takimi fillestar është kryer me datë 16.07.2021 duke ju referuar programit të auditimit në të cilën janë përshkruar drejtimit kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuara nga titullari i institucionit. Është kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, nga korriku deri më 18.02.2022, datë në të cilën është realizuar takimi përmbyllës. Kohëzgjatja për arsye objektive, ngarkesë e stafit si dhe u shtua në grupin e auditimit një inxhinier i ministrisë. Me shkresën nr.797/1 prot., datë 07.03.2022 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar dhe ku me datë 16.03.2022 është kthyer nje kopje e firmosur të projekt-raportit pa kundërshtime. Me shkresën nr.797/5 datë 25.03.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Librazhd si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS,

me shkresën nr.797/7 prot., datë 27.04.2022. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga subjekti i audituar ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit, me shkresën nr.344/10 prot., datë 14.04.2022.

2. Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar

Njoftimi nr. 2370 prot., datë 24.05.2021 për fillimin e angazhimit të auditimit, njësisë që do auditohet referuar planit vjetor 2021. Takimi fillestar është kryer me datë 07.06.2021 duke ju referuar programit të auditimit në të cilën janë përshkruar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuara nga titullari i institucionit. Është kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, nga 07.06.2021 deri më 26.06.2021, më datë 26.05.2021 është realizuar takimi përmblyllës për periudhën 01.10.2016-31.05.2021. Me shkresën nr.2370/3 prot., datë 13.07.2021 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar dhe ku me shkresën nr.300 prot., datë 30.07.2021 sjellin sqarime. Me shkresën nr.2370/5 datë 01.09.2021 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS, me shkresën nr.797/9 prot., datë 21.09.2021. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga subjekti i audituar ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit, me shkresën nr.352/1 prot., datë 09.09.2021.

3. Qendra e Shërbimit Mjekësor Tiranë

Njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit, drejtuar me email njësisë që do auditohet referuar planit vjetor 2022 miratuar me shkresën e Ministrit nr.3746/3 prot., datë 11.10.2021. Takimi fillestar është kryer me datë 08.03.2022 duke ju referuar programit të auditimit në të cilën janë përshkruar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuara nga drejtuesi i njësisë AB me shkresën 1039/1 prot., datë 18.03.2021. Është kryer auditim nga 08.03.2022-01.04.2022 në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, sistemi menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemi i prokurimeve, sistemi i pagesave dhe sistemi i kontabilitetit dhe ai i raportimit financiar, për periudhën 01.01.2017-31.12.2021. Takimi përmblyllës është realizuar me datë 05.04.2022. Me shkresën nr.1039/2, datë 15.04.2022 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar dhe ku me datë 06.05.2022 është kthyer nje kopje e firmosur të projekt-raportit pa pretendime. Me shkresën nr.1039/3 prot., datë 06.05.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Qendrës së Shërbimit Mjekësor Tiranë si dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS , me shkresën nr.1039/5 prot., datë 06.06.2022. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga subjekti i audituar ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit, me shkresën nr.62 prot., datë 24.05.2022

4. Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Reabilituese për Fëmijët Tiranë.

Njoftimi nr.2060 prot., datë 10.05.2022 për fillimin e angazhimit të auditimit, drejtuar edhe me email njësisë që do auditohet referuar planit vjetor. Takimi fillestar është kryer me datë 26.05.2022 duke ju referuar programit të auditimit në të cilën janë përshkruar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuara nga titullari i institucionit. Është kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë, nga 06.06.2022 deri më 24.06.2022 për periudhën 01.01.2017-30.04.2022, datë në të cilën është realizuar takimi përmblyllës. Me shkresën nr.2060/3 prot., datë 08.07.2022 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar. Me shkresën nr.2060/5 datë 15.08.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Reabilituese për Fëmijët Tiranë dhe Memo drejtuar Ministrit të MSHMS, me shkresën nr.2060/7 prot., datë 20.09.2022. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga subjekti i audituar ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit, me shkresën nr.108/3 prot., datë 07.09.2022.

5. Menaxhimi i pajisjeve mjekësore zbatimi i sistemit të referimit dhe shërbimi ndaj pacientit për:

- a. Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë
- b. Spitali Rajonal Shkodër
- c. Spitali Rajonal Korçë
- d. Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 1 Tiranë

e. Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 2 Tiranë

Njoftimi nr.2177 prot., nr.2178, nr.2179, nr.2180 prot., datë 17.05.2022 për fillimin e angazhimit të auditimit, drejtuar edhe me email njësisve respektive që do auditohen referuar planit vjetor. Takimi fillestar është kryer me datë 26.05.2022 duke ju referuar programit të auditimit në të cilën janë përshkruar drejtimet kryesore të auditimit, si dhe afatet e miratuara nga titullari i institucionit. Është kryer auditim i Kombinuar Financiar dhe i Përputhshmërisë për njësitë e sipërcituara nga 30.05.2022 deri më 19.07.2022 për periudhën 01.01.2022-31.05.2022.

*Për Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë takimi fillestar është realizuar me datë 27.06.2022 ndërsa me datë 06.07.2022 është mbajtur takimi përmbyllës për të cilën janë mbajtur procesverbalet përkatëse. Me shkresën nr.2178/2 prot., datë 09.08.2022 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar i cili me shkresën nr.127/2 prot datë29.08.2022 përcolli disa observacione. Me shkresën nr. nr.2178/7 prot., datë 14.09.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë.

*Për Spitali Rajonal Shkodër takimi fillestar është realizuar me datë 30.05.2022 ndërsa me datë 10.06.2022 është mbajtur takimi përmbyllës për të cilën janë mbajtur procesverbalet përkatëse. Gjithashtu i është komunikuar zgjatja e afatit me shkresën nr.2180/2 prot., datë 06.06.2022. Me shkresën nr.2180/3 prot., datë 29.07.2022 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar i cili me shkresën nr.1066/4 prot datë 22.08.2022 përcolli disa sqarime. Me shkresën nr. nr.2180/5 prot., datë 29.08.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Spitalit Rajonal Shkodër. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga subjekti i audituar ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit, me shkresën nr.2010 prot., datë 20.09.2022.

*Për Spitali Rajonal Korçë takimi fillestar është realizuar me datë 12.07.2022 ndërsa me datë 19.07.2022 është mbajtur takimi përmbyllës për të cilën janë mbajtur procesverbalet përkatëse. Me shkresën nr.2179/2 prot., datë 10.08.2022 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar i cili me shkresën nr.1223 prot datë 19.08.2022 përcolli observacione. Me shkresën nr. nr.2179/4 prot., datë 29.08.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit Spitalit Rajonal Korçë. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga subjekti i audituar ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit, me shkresën nr.1424 prot., datë 20.09.2022.

*Për Qendrën Shëndetësore e Specialiteteve nr.1 takimi fillestar është realizuar me datë 15.06.2022 ndërsa me datë 21.06.2022 është mbajtur takimi përmbyllës për të cilën janë mbajtur procesverbalet përkatëse. Me shkresën nr.2181/2 prot., datë 10.08.2022 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar. Me shkresën nr. nr.2181/4 prot., datë 29.08.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe Qendrës Shëndetësore e Specialiteteve nr.1. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga subjekti i audituar ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit, me shkresën nr.602 prot., datë 16.09.2022.

*Për Qendrën Shëndetësore e Specialiteteve nr.2 takimi fillestar është realizuar me datë 08.06.2022 ndërsa me datë 14.06.2022 është mbajtur takimi përmbyllës për të cilën janë mbajtur procesverbalet përkatëse.

Me shkresën nr.2177/2 prot., datë 02.08.2022 është dërguar projekt-raport përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar i cili me shkresën nr.321 prot datë 15.08.2022 përcolli observacione Me shkresën nr. nr.2177/4 prot., datë 29.08.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe Qendrës Shëndetësore e Specialiteteve nr.2. Nga grupi i auditimit u konstatua se nga subjekti i audituar ka ardhur informacion mbi Planin e Veprimit, me shkresën nr.388 prot., datë 19.09.2022 si dhe Memo drejtuar Ministrisë të MSHMS, me shkresën nr.2181/6 prot., datë 06.10.2022.

Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit, ka konstatuar si më poshtë vijon:

-Nga auditimi i grupit të KLSH rezultoi se nga NjAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri të MSHMS. Në përgjithësi nga NJAB

është respektuar procedura e auditimit në përputhje me bazën ligjore dhe manuali i auditimit të brendshëm . Nga auditimi u konstatua se përgjithësisht janë respektuar afatet e auditimit.

Nga auditimi u konstatua se plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit e cila plotësohet nga njësi publike e audituar si dhe e miratuar nga titullari, jo më vonë se 20 ditë pune pasi subjekti njihet me raportin përfundimtar, i është dërguar njësisë së auditit të brendshëm.

Konkluzion

Grupi i auditimit të KLSH-së konstatoi se Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nuk ka krijuar Komitetin e Auditimit të Brendshëm, detyrim i ligjit nr.114/2015 ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12 germa b Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike “Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për: b) krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji.

Grupit të Auditimit iu vu në dispozicion një Memo nga drejtori i auditit të brendshëm të MSHMS-së që i drejtohet Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi propozimet për krijimin e këtij komiteti.

Titulli i Gjetjes:	Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.
Situata:	Grupi i Auditimit konstatoi se nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale veprime në kundërshtim me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12 germa b Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike “Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për: b) krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji.
Kriteri:	Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12 germa b. VKM nr.160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e garancisë së arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësive publike dhe monitorimit të çështjeve që lidhen me funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Shkaku:	Mospërbushja e detyrimit ligjor në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për miratimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	MSHMS të marrë masa të menjëhershme për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, i cili ofron këshilla e rekomandime objektive Titullarit të njësive publike në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim arritjen e objektivave si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësisë së saj.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

1.1. Për 41 (dyzet e një) projekte investimi të realizuara në vitin 2021 me një vlerë prej 393,529,023 lekë, si dhe 45 (dyzet e pesë) projekte investimi të realizuara në vitin 2022 me

vlerë 250,909,423 lekë, të çelura për MSHMS nuk kishin kaluar në procesin ligjor të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, pra nuk kishin kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të investimeve publike sikundër përcakton VKM nr. 887, datë 29.03.2018, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike” pika 7, pasi këto projekte, nuk kanë kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e MFE nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, pika 21 ku përcaktohet se projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së, dhe duhet të jenë në përputhje me prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qendrore.

1.2. Në 4 (katër) raste u konstatuan projekte investimi në tejkalim të planifikimit në Programin Buxhetor Afatmesëm, konkretisht:

- Projekti i investimit me kod 20AB701- “Ndërtim i godinës së re për akomodimin e QSH1, Njvksh dhe kl.stomatologjike Durrës” është parashikuar në PBA 2021-2023 në shumën 12,000,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 17,399,165 lekë, me një diferencë prej 5,399,165 lekë në tejkalim të planifikimit;

- Projekti i investimit me kod 18BB057 - “Rikonstruksion i godinës së pediatriisë spitali Elbasan” është parashikuar në PBA 2021-2023 në shumën 66,627,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 225,379,036 lekë, me një diferencë prej 158,752,036 lekë në tejkalim të planifikimit;

- Projekti i investimit me kod 18BB059- “F.V pajisje hotelerie dhe mjekësore për pediatriinë e sp. Elbasan” është parashikuar në PBA 2021-2023 në shumën 0 lekë, dhe është realizuar në shumën 27,000,000 lekë, me një diferencë prej 27,000,000 lekë në tejkalim të planifikimit;

- Projekti i investimit me kod 18BB008 – “Rikonstruksion i godinës së QKT Gjakut Tiranë” është parashikuar në PBA 2022-2024 në shumën 54,046,000 lekë, dhe është realizuar në shumën 88,059,200 lekë, me një diferencë prej 34,013,200 lekë në tejkalim të planifikimit.

Veprime e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 11 dhe 64; VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikatat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore, si dhe të respektohen projektet e investimeve të parashikuara në PBA.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga MSHMS është kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh, duke kërkuar lëvizje fondesh në projektet ekzistuese, si dhe duke shtuar projekte te reja gjatë vitit, të cilat janë çelur pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm. Këto ndryshime kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes për rishpërndarjen e fondeve me impakt në buxhetin e MSHMS-së, e cila konsiderohet me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

Një numër i konsiderueshëm i kërkesave për shtesë dhe pakësime fondesh nuk janë të shoqëruara me argumentet si: a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektiveve të tjerë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.

9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar pika 75. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me njësitë shpenzuese në varësi të saj dhe ekipet e ngritura për menaxhimin e programeve buxhetore të MSHMS, të marrin masatë nevojshme për rritjen e bashkëpunimit me tyre dhe kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucionale, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta në buxhet të fondeve, situatë kjo me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, aparati i MSHMS, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Nga MSHMS monitorimi është kryer për të gjithë programet e MSHMS pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr 17-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: NA dhe NZ të marrin masat për monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit duke hartuar raportet të monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për aparatin e MSHMS si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve, duke i analizuar dhe me regjistrimin në sistemin SIFQ për vitet 2021 dhe 2022, u konstatuan vonesa dhe mosrespektim të afateve për likuidimin e faturave, duke tejkaluar afatin ligjor 30 ditor, të përcaktuar në Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7 dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: MSHMS të marrë masat për një planifikim/programim sa më real dhe të besueshëm të buxhetit, duke u mbështetur në analizën e të dhënave që raportohet nga Sektori i Financës, si dhe të dhënave që gjenerohen nga sistemi SIFQ, me qëllim shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të blerjeve të vogla u konstatua se:

5.1. OE fitues nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me nenin 92 pika 3 e LPP. Gjithashtu, nuk kanë të dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, me anë të procesverbaleve dhe dokumentacionit të plotë për procedurat e kryera sa i takon marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

- Për të gjithë procedurat e blerjeve të vogla të audituara u konstatua se këto procedura në të gjitha rastet nuk ishin të inventarizuara e për pasojë të arkivuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë

06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenin 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

5.2. Nga auditimi i kryer i procedurës me objekt “Blerje sistemi financiar Financa 5” rezultoi se e gjithë procedura nuk është kryer konform rregullave të prokurimit publik. Nga ana e grupit të auditimit u konstatuan mangësi që në parashikimin e fondit gjatë fazës së planifikimit buxhetor, mos përcaktimit të fondit limit, parregullsive në fazën e lidhjes së kontratës, dorëzimit të faturës para datës së hyrjes në fuqi të kontratës si dhe marrjes në dorëzim të aktivitetit pa specialistë të fushës. Nga auditimi i dokumentacionit nga ana e Grupit të Auditimit, rezultoi se kemi një mospërputhje në kronologjinë e dokumenteve të dorëzuara dhe procesverbaleve të mbajtura, pasi:

- Fatura e dorëzuar nga ana e OE mban datën 28.12.2021, fakt i cili evidenton se është dorëzuar kjo faturë 1 (një) ditë para lidhjes së kontratës, (e cila mban datë 29.12.2021), për rrjedhojë këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, pasi nga ana e MSHMS-së nuk duhej pranuar dhe ekzekutuar një faturë e cila është më përpara se data e lidhjes së kontratës.

- Gjithashtu aktiviteti është bërë hyrje në magazinë në datën 31.12.2021, datë e cila përkon edhe me likuidimin e kryer për shërbimin e realizuar sipas Urdhër Shpenzimit nr. 967, datë 31.12.2021, në shumën 849,000 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se Programi Financiar është marrë në dorëzim vetëm nga një punonjës, veprim i cili është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2021, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, pika 43.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 34, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr. 40 ku citohet “E drejta për të kryer shpenzime”, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr. 64, Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2021, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, pika 43.

Gjithashtu, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se “Sistemi financiar Financa 5”, i prokuruar nga MSHMS, nuk është përdorur në asnjë moment nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për të realizuar hedhjen e të dhënave të kontabilitetit, magazinës, inventarit etj, pasi të gjithë të dhënat nga Drejtoria e Financës i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit në formatin Excel, dhe jo me Financa 5. Për rrjedhojë qëllimi kryesor për të cilën është kryer kjo procedurë prokurimi rezultoi i pa përmbushur. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e MSHMS-së të merren masa në vijimësi për dokumentimin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, si dhe realizimin e inventarizimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, me qëllim krijimin dhe ndjekjen e gjurmës së auditimit si dhe shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit.

Në vijimësi

5.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për vënien në punë të sistemit financiar “Financa 5”, me qëllim evidentimin në kohë dhe me besueshmëri të të dhënave të kontabilitetit, magazinës dhe inventarit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar është konstatuar se blerja e biletave është realizuar në kufijtë e datës së nisjes jashtë vendit, megjithëse ftesa për pjesëmarrje nga organizatorët e takimit/ aktivitetit është dërguar disa javë para kryerjes së procedurave të prokurimit dhe blerjes së biletave. Kjo ka ardhur si pasojë e miratimit me vonesë të autorizimeve, mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të MSHMS-së në këto aktivitete. Një fenomen i tillë sjell si pasojë riskun e blerjes së biletave me çmim më të lartë, kur prokurohet pak ditë para

datës së nisjes, dhe jo në kohën e administrimit të njoftimit/ftesës për takim jashtë vendi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar.

Në të gjithë urdhër shpenzimet e përzgjedhura për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës u konstatua mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve. Me anë të këtyre dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a. nenin 4, pika 26, nenin 2, pika 16. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evete jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet në përputhje me shpenzimet me efektivitet të fondeve buxhetore.

Në vijimësi

6.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në të gjitha praktikatat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave t’i bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve/takimeve etj.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” rezultoi se shuma e kontabilizuar me datën 31.12.2022 në llogarinë 6020 “Materiale zyre e të përgjithëshme”, në vlerën prej 21,274,365 lekë krahasuar me vlerën e paguar gjatë vitit 2022 dhe me faturat e konstatuara dhe të cilat do të paguhen në vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

Në lekë

	Paraqitur ne bilanc	21,274,365
1	Nga likuidimet me bankë (Kontabilizimi)	1,846,525
2	Nga blerja e mallrave e materialeve, (hyrjet ne magazine)	15,446,982
3	Detyrimet e prapambetura nga viti i kaluar (Evidernca)	3,451,518
4	Likuidimet e viteve te kaluara	529,341

Sa më sipër konstatohet se shpenzimet në shumën prej 3,980,859.00 lekë, e cila përbëhet nga vlerat e zërit “Detyrimet e prapambetura nga viti i kaluar (Evidernca)” dhe “Likuidimet e viteve të kaluara” nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime në momentin e ndodhjes së tyre, por janë njohur në një periudhë të më vonshme, të cilës nuk i përkasin, veprime në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithëshme”, i ndryshuar pika 34 dhe 42. Kjo vlerë duhet të ishte reflektuar në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” të vitit në të cilën kanë ndodhur.

7.1. Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre ne kontabilitet rezultoi se shuma e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit, në

kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, paragrafi 34 dhe 42. Sa më sipër, shumat e vendimeve gjyqësore duhet të ishte reflektuar në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së faturave për blerje mallra/shërbime/punë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

7.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave “Llogari të arkëtueshme” u konstatua se: Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 308,932 lekë, të cila përbëhen nga detyrimi i krijuar:

- Në vitin 2001 në vlerën prej 105,089 lekë, si dhe “Parapagime” në vlerën 3000 lekë;
- Në vitin 2005 në vlerën prej 108,900 lekë;
- Në vitin 2011 në vlerën prej 106,753 lekë, si dhe “Parapagime” në vlerën 8,810 lekë.

Nga ana Institucionit për këtë vlerë nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e tyre, si rrjedhojë **ky detyrim është i paarkëtueshëm**, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në nenin 203 pika 1 Kodi i Punës “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115, gërma “dh”, Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.

- Në lidhje me zërin parapagime” në vlerën 11,810 lekë, të krijuar në vitin 2001 dhe 2011, bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” që nënvizon se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” **ky detyrim është i parashkruar**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të analizojë mosveprimet dhe të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe të paarkëtueshme, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analizave të Llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitor” në vlerën 634,356,074 lekë, e cila përfaqëson detyrimet që ka MSHMS ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2021, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore dhe për llogarinë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, që ka të bëjë

me komisionet e bonuseve të bebeve që i paguan MSHMS ne vlerën 14,650,595 lekë, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në shumën prej 618,564,317 lekë., vlerë e cila ka të bëjë me fatura të viteve 2015; 2017; 2018 dhe 2020, u konstatua një diferencë prej 1,141,162 lekë e debituar në llogarinë 4342, vlerë e cila është e paargumentuar. Gjithashtu u konstatua se, në lidhje me letër kreditë e “Q.H.” është regjistruar vlere prej (2,240,650.8) në kontabilitet, ndërsa në SIFQ vlera është (224.065,80) lekë me një diferencë prej 2,000,000 lekë, vlerë e cila është e paargumentuar, me efekt në saktësinë e raporteve dhe pasqyrave financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që për diferencat e konstatuara dhe të paargumentuar të bëjë sistemimet kontabël, me qëllim paraqitjen e drejte të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Llogarisë 213 “*Rruge, rrjete, vepra ujore*”, u konstatua se në këtë llogari është regjistruar zëri “*Regjistri elektronik i ndihmës ekonomike*” me kosto historike në shumën prej 71,400,000 lekë. Shuma prej 71,400,000 lekë është pasqyruar gabim në llogarinë kontabël 213, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit të pasqyrave financiare të institucionit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar; Klasa 2 “*Aktivitet Afatgjata*” . *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, duke debituar llogarinë 2140160 “*Instalimi i sistemit te kompjuterëve*” për shumën 71,400,000 lekë dhe kredituar llogarinë 213 “*Rruge, rrjete, vepra ujore*” për të njëjtën vlerë.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi analitik i Llogaria 28 “*Caktime*” u konstatua se, në këtë zë janë pasqyruar Investimet për të tretët, por që janë likuiduar nga MSHMS, si dhe donacionet për situatën pandemike Covid-19. Në këtë zë, pas vlerësimit të aktiveve të ish- Ministrinë e Mirëqenies dhe Rinisë e bërë nga eksperti i kontraktuar janë pasqyruar dhe

-Vlera prej 22,337,073 lekë, e cila ka të bëjë me “*Rikonstrukcione të ambienteve*”.

-Vlera prej 113,416,554 lekë, e cila ka të bëjë me regjistrin e PAK,

- Vlera prej 164,496,000 lekë, e cila ka të bëjë me “*Sistemin e Shërbimit Social*” , të cilat janë aktive nën administrimin e MSHMS.

Kontabilizimi i këtyre aktiveve në llogarinë kontabël 28 “*Caktime*” janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Klasa 2 “*Aktivitet Afatgjata*”, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare të institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, duke debituar llogarinë 212 “*Ndërtime e Konstrukcione*” në shumën prej 22,337,073 lekë dhe llogarinë 2140160 “*Instalimi i sistemit te kompjuterëve*” për shumën 277,912,554 lekë për regjistrin PAK dhe “*Sistemi i Shërbimit Social*” dhe duke kredituar llogarinë 28 “*Caktime*”, për shumat respektive.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit dhe regjistrit për vitet 2021-2022 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e “Fondit të konsoliduar” të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.

- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e “pajisjeve elektronike” janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 218600 “pajisje elektronike”.

- Një pjesë e “Pajisjeve dhe instalimi i kondicionerëve” janë klasifikuar në llogarinë 218600 “Inventar ekonomik”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”.

- Një pjesë e zërave “zyre orendi” janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 2187000 “Te tjera pajisje zyre”.

Sa më sipër veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Klasa 2 ‘Aktive afatgjata”.

12.1. Nga auditimi i llogaritjes së amortizimit u konstatua se amortizimi vjetor i zërave të aktiveve “Kompjuter, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni” është përlllogaritur me 20% dhe jo me 25%; si dhe për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” transferuar nga Ish-Ministria e Mbrojtjes Sociale, amortizimi vjetor është llogaritur mbi vlerën e mbetur dhe jo me metodën lineare, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 36; Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.

12.2 Nga auditimi analitik i llogarive 218 “Inventar ekonomik”, u konstatua se:

Me Urdhrin e NA nr. 305, datë 16.05.2022 është ngritur komisioni “Për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata”, i cila ka bërë nxjerrjen jashtë përdorimi të:

- Aktiveve si pajisje kompjuterike, fotokopje dhe pajisje elektronike me vlerë fillestare 18,807,408 lekë, të cilat janë konsideruar për riciklim, dhe do të ruhen në një ambient të përshtatshëm deri në organizimin e ankandit, ku do të peshohen dhe do të bëhen hyrje në magazine si materiale të riciklueshme. MSHMS në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022 këto vlera i ka hequr fare nga pasqyrat në regjistrin e aktiveve Veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109. Aktivet kalojnë në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një flete hyrje rikupero. Për vitin 2022, në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” (me koston historike) duhet të ishin reflektuar këto aktive si nxjerrje jashtë përdorimi, duke debituar llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në vlerën neto, por pa ndikim në rezultatin financiar të vitit 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

Menjëherë

12.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” dhe rakordimit me vlerat në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C ka një pasqyrim jo të drejtë të vlerave në pasqyrë. Vlera e pasqyruar në llogarinë 12 “Nga Rezultatet e mbartura(+,-“ në shumën prej 1,472,634 lekë është dubluar, pasi kjo vlerë është e reflektuar në llogarinë 85 “Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)”. Ky pasqyrim është bërë gabim dhe në vitin 2021, ku vlera 5,935,118 lekë e ndryshimit të gjendjes së inventarit është dubluar duke e pasqyruar dhe në llogarinë 12 “Nga Rezultatet e mbartura(+,-)“ dhe në llogarinë 85 “Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)”.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(vlera neto)” për vitin 2021, për zërin “kompjuter” nga institucioni është përlllogaritur amortizim vjetor më i lartë se vlera e aktiveve, ku si rrjedhojë vlera e amortizimit të akumuluar është më e lartë se vetë kostoja historike e aktiveve. Në kontabilitet është përlllogaritur vlera negative për këto aktive në shumën prej (19,291,624) lekë, vlerë e cila është zbritur nga gjendja e aktiveve, duke ndikuar dhe në pasqyrimin jo real të gjendjes së tyre në kontabilitet dhe pasqyrim jo të drejtë të **ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto**. Ky veprim kontabël është bërë dhe për vitin 2022 për një grup aktivesh.

Veprimi në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”. Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, **me ndikim material në fondet neto të institucionit**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MSHMS të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të manualit të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim më të drejtë të fondit neto, me qëllim që të parandalohen gabimet materiale dhe parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, mbështetur në Urdhrat përkatës kalim papagesë, u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, ku nga MSHMS është regjistruar në kontabilitet vlera e kostos historike të tyre; Akt konfirmimi i njësisë pritëse dhe fletë-hyrja e regjistrimit të aktivitetit, si dhe në rastin e kalimit të mjeteve të transportit pa pagesë, autorizimin i personit për tërheqjen e mjeteve të transportit .

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, kapitullin III, të Udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktiveve në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të administrojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit të kapitalit të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e regjistrimit në kontabilitet të tyre.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit u konstatua se, kryetari i komisionit i ngritur sipas urdhrin të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS me nr. 304, datë 16.05.2022 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve” i ndryshuar me urdhrin me nr. 304/1, datë 22.07.2022 ishte Përgjegjësi i Sektorit të Financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 82 ku citohet se “Komisioni nuk duhet te jete me pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet te kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka ne ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi ,,” si dhe ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 22 “veprimtaria e kontrollit” pika 3. b “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 39-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në cilësinë e NA të marrë masa në vijimësi për shmangien e përfshirjes së punonjësve në proceset e punës, të cilat e vendosin atë në konflikt interesi, me qëllim funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sa më të qëndrueshëm dhe më efektiv.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrin të parashikimit dhe të realizimit të procedurave të prokurimit dhe arkivimit të tyre në SPE, u konstatua se:

Regjistrat e parashikimit nuk janë përgatitur, sipas afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 të APP-së, pika 3 ku citohet se “Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit duhet të përgatitet nga AK jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës” përkatësisht me “Ligjin e buxhetit nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” botuar në fletoren zyrtare nr. 221 datë 17.12.2020” dhe “Ligjin e buxhetit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” botuar në fletoren zyrtare nr. 197 datë 21.12.2021.

- Regjistrat e realizimit nuk janë të plotësuar me të gjithë procedurat e realizuara gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022.

- Nga njësia përgjegjëse për SPE nuk është realizuar arkivimi i dosjeve të prokurimit në sistem, të cilat nuk janë pasqyruar as në regjister si të realizuara. Në vitin 2022, nga MSHMS është realizuar procedura “B3-Blerje barna të ndryshme për përdorim spitalor”, ndarë në 40 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 628,100,541 (gjashtëqind e njëzet e tetë milion e njëqind mijë e pesëqind e dyzet e një) Lekë pa TVSH”, e cila nuk figuron e realizuar në regjistrin e realizimit të prokurimeve për vitin 2022. Referuar procedurave të prokurimit për B1 dhe B2 “Blerje barna të ndryshme për përdorim spitalor”, për të cilën janë nënshkruar marrëveshjet respektive nr. 1532/128 prot., datë 26.07.2022 dhe 1533/152 prot., datë 19.07.2022 konstatohet se në regjistrin e realizimit nuk janë përfshirë si të realizuar të gjitha Lot-et e procedurave të prokurimit.

Sa më sipër mos arkivimi i dosjeve të prokurimit dhe mos pasqyrimi në regjistrin e realizimit janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 30.07.2021 “Për Mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike” pika 3.11. “Arkivimi i procedurës së prokurimit në SPE”, me Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021, Kreu II “Regjistri i realizimit të procedura të prokurimeve publike” pika 1, si dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, gjurma e auditimit.

- Në regjistrin e vitit 2021 dhe 2022 mungon element, tipi i kontratës: mall/shërbim

punë/marrëveshje kuadër, minikontrata, i cili është kërkesë sipas Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 të APP-së.

- Nga AK nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit të gjitha kategoritë e mallrave dhe shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100,000 lekë, pavarësisht se këto procedura nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik.

-Procedura, të cilat janë realizuar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara dhe nga MSHMS janë lidhur kontratat e realizimit të mallrave/shërbimeve nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit, veprime në kundërshtim të Kreut II, të Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021, pika 2. Grupi i auditimit i konstaton këto vlera të realizuar, por të pa pasqyruara në regjistrin e prokurimeve, nga analiza e shpenzimeve në ditarin e bankës, për periudhën objekt auditimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Nga personat përgjegjës për prokurimet në MSHMS të merren masat e arkivimit të procedurave të prokurimit në SPE, si dhe përgatitjen e regjistrin të parashikimit sipas afateve ligjore në fuqi dhe përditësimin e regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit me të gjithë elementet e parashikuara.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, për të cilat AK ka hartuar dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht, u konstatua se:

- Përkthimi i dokumentacionit është bërë pa realizuar asnjë procedurë paraprake blerje të vogël por është bërë blerje e drejtpërdrejtë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 1 pika 2, që nënvizon se “Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike”, dhe neni 3 pika 2: “Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën” dhe neni 7 ku specifikohen përjashtimet e veçanta. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit pranë MSHMS të marrë masa në vazhdimësi për planifikimin e shërbimit të përkthimit në regjistrin e procedurave të prokurimit, duke realizuar sipas parashikimit marrëveshjen përkatëse kuadër, për procedura të cilat janë mbi kufirin e lartë monetar dhe që kërkohet hartimi i dokumenteve të tenderit në anglisht.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt:

• “Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore” u konstatua se:
- Kriteret në lidhje me Kapacitetet teknik nën-pika 3.3, pika 3 nga AK është kërkuar “Të ketë të paktën një inxhinier për mirëmbajtjen e aparaturave objekt te këtij prokurimi. Për këtë duhet të paraqiten CV e specialistit dhe certifikatat/dëshmitë e trajnimit lëshuar nga kompania prodhuese”. Sa më sipërm kriteri i vendosur është i pa plotë pasi nga AK nuk është vendosur profili i inxhinierit që AK kërkon/pranon e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton profilin e inxhinierit, veprime në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenit 28 “Kontratat e shërbimeve” pika 2, që nënvizon se...”Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë

dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.

- Në pikën 3.3 Kapaciteti teknik pika 8 nga AK është kërkuar “Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import, eksport, tregtim të pajisjeve mjekësore dhe mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kërkesa e mësipërme “për import, eksport, tregtim..” nuk përputhet me objektin dhe natyrën e kontratës.

- “Blerje pajisje mjekësore për QKTRF” u konstatua se:

- NJP e ngritur nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS ka mbajtur procesverbalin me datën 24.09.2021, ku janë bërë ndryshime të specifikimeve teknike për artikullin:

Ishte: Body composition analyser (Peshore për matjen e indekseve trupore) :

Kapaciteti: 300 kg, Gradimi: 100g.

Pajisur me të paktën dy ekran LCD.

Bëhet: Kapaciteti: 150kg ose me shume, Gradimi: 100g.

Pajisur me të paktën një ekran LCD.

Sa më sipër NJP nuk ka marrë konfirmimin, nga QKTRF nëse specifikimet e rishikuara/modifikuara përmbushin qëllimin për të cilin nevojitet objekti i prokurimit i kërkuar, veprime në kundërshtim me nenin 67, pika 9 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Pas ndryshimit të specifikimeve teknike të artikullit “Body composition analyser (Peshore për matjen e indekseve trupore)”, NJP nuk ka rishikuar përlllogaritjen e fondit limit.

- “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore” u konstatua se:

- Përcaktimi i “Specifikimeve teknike: DEXA” nuk është e dokumentuar se nga kush janë hartuar.

- Nga auditimi i dosjes fizike konstatohet se mungon deklarata e konfliktit të interesit të grupi të punës, veprime në kundërshtim me VKM-në 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 13, pika 5, ku citohet se “Në çdo rast, duhet të shmangët rreptësishtë çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. Zyrtaret e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit”.

- “B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike ” dhe “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore”, u konstatua se:

Komisioni i ngritur nga titullari i AK përbëhet prej 4 anëtarësh, veprim në kundërshtim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 2: “Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit. Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.....”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve/punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës, si dhe Njësia e Prokurimit të ketë në përbërje të saj numër anëtarësh tekë, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt:

- *“Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore”* u konstatua se:
- Nga KVO është kërkuar sqarim BOE, me shkresën, e cila nuk ka numër protokollit dhe datë, për sqarim në lidhje me sigurimin e ofertës ku i është lënë afat deri me datën 21.05.2021. Edhe në SPE nuk gjendet kërkesa e drejtuar OE për sqarim. Me datën 19.05.2021 është sjellë nga BOE “HL” Shpk dhe “SM” Shpk, dokument sqarimi, i cili është pa numër protokollit dhe pa datë, për të vërtetuar se kur është administruar nga MSHMS, ndërsa sigurimi i ofertës është lëshuar me datën 20.05.2021. Kjo shkresë nuk përkon me sqarimet e kërkuara nga AK, pasi me datën 21.05.2021, kur është mbajtur procesverbali nga KVO nuk ka rezultuar të ketë qenë dokument i administruar, pasi anëtarët e KVO janë shprehur se BOE nuk e plotëson këtë kriter. Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO përfshin veprime procedurale, që nga faza e argumentimit të specifikimeve deri tek kualifikimi i OE, të cilët kanë marrë pjesë në tender. Veprime në kundërshtim me nenin 84 *“Raporti përmbledhës”* ku përcaktohet: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor”*

- *“F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore”* u konstatua se:

Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO përfshin veprime procedurale, që nga faza e argumentimit të specifikimeve deri tek kualifikimi i OE, të cilët kanë marrë pjesë në tender. Veprime në kundërshtim me nenin 84 *“Raporti përmbledhës”* ku përcaktohet: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo proces pune të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *“F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore”* u konstatua se:

- Urdhri i prokurimit për realizimin e procedurës ka dalë me datën 04.10.2021, ndërsa regjistrimi në SIFQ është bërë me datën 28.12.2021 veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 25.01.2021 *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”* pikat 36-38; *“Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, regjistrojnë në sistem çdo vlerë prokurimi të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit në SIFQ, procedojnë me dërgimin në Agjencinë e Prokurimeve Publike. Të gjithë urdhrat e prokurimit që nxirren gjatë vitit për mallrat, shërbimet dhe investimet duhet të paraqiten në degën e Thesarit, së bashku me ftesën për prokurim, të cilat duhet: (i) t'i përmbahen listës së prokurimeve të dorëzuar në Thesar. (ii) të kontrollohen për përputhshmëri me regjistrin e prokurimeve dhe të vulosen nga dega e Thesarit, përpara procedimit, sipas rregullave të prokurimit publik”* dhe Udhëzimit nr. 9 dt. 20.3.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, pika 153-155.

- Përpara lidhjes së kontratës mes OE dhe AK nga një e-mail i dërguar më datë 16.11.2021 është kërkuar nga Kabineti ndryshimi i destinacionit të pajisjeve nga qendrat e përcaktuara në DT.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me:

- Rregulloren e Brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Neni 3* ku citohet ... *“Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të*

ministrisë. Funkionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetence drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.”

- DST Shtojca 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”.

- Udhëzimit të MFE me nr. 9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 64, si dhe paragrafi III ‘*Procedurat për kryerjen e shpenzimeve*’, pasi këto njësi nuk e kanë patur të planifikuar nevojën për këto aparatura dhe nuk ka kërkesë me shkresë nga këto spitale për nevojat për këtë pajisje. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Njësia Përgjegjëse për Prokurimet të marrë masë në vijimësi që përpara realizimit të çdo procedure prokurimi, të regjistrojnë ne sistem SIFQ çdo vlerë prokurimi të përcaktuar ne planin e miratuar te prokurimeve te institucionit dhe pasi marrin numrin unik te regjistrimit ne SIFQ, të fillojë me procesin e prokurimit.

Në vijimësi

20.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat në vijimësi që destinacioni final i mallrave/shërbimeve dhe punëve që prokurohen të jetë në përputhje me DT dhe me kërkesat të cilat janë planifikuar që në PBA dhe në planin vjetor nga njësitë.

Nëse për kërkesa emergjente kërkohet ndryshimi i destinacionit, të merren masa për argumentimin me dokumentacione bashkëngjitur, si dhe miratimi i ndryshimit të bëhet nga NA i Institucionit dhe jo nga persona që s’kanë “asnjë kompetence drejtuese ose administrative mbi stafin ministror”.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut*” për:

• **Lot 100 “Sevoflurance”** u konstatua se:

Në njoftimin e fituesit OE/ “F” sha, me ofertën më të ulët është s’kualifikuar pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin provues që bari i ofertuar është i regjistruar sipas kriterit në DT, ndërsa në procesverbalin e vlerësimit (nuk korrespondon me njoftimin e fituesit), pasi citohet që skualifikimi është për afatin e sigurimit të ofertës.

Ndërsa për lotet Lot83 “Flumazenil” dhe Lot104 “Valproic”, OE/ “F” sha është shpallur fitues pa plotësuar kriterin e vendosur në DT që bari i ofertuar të jetë i regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

OE/F.N.A. shpk është shpallur fitues për Lot 96 “Phenytoin” pa plotësuar kriterin e vendosur në DT që bari i ofertuar të jetë i regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Për Lot83; Lot104 dhe Lot 96, KVO argumenton se për barnat e paregjistruar autorizohet importi i tyre sipas përcaktimeve në ligjin nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" neni 11 pika 1 ku citohet "*Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave*".

Ky përcaktim ligjor dhe argumentim nuk është bërë nga KVO në vlerësimin e ofertave në Lot 100 “Sevoflurance”, duke s’kualifikuar OE të renditur të parin me ofertë në shumën prej 113,233,080 lekë me një diferencë më pak se me ofertën fituese prej 11,561,574 lekë.

Sa më sipër, KVO ka vepruar në kundërshtim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i

ndryshuar neni 2, pika d ”të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik” dhe nenin 3 pika 1, ku përcaktohet se "Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale"; VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë vlerësimit të ofertave të procedurave prokuruese, të merren masa të pranohen oferta kur përputhen plotësisht specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 82 si devijime të vogla, të cilat të specifikohen në raportet përmbledhëse të procedurave prokuruese, duke mbajtur në konsideratë parimet e economicitetit dhe eficiencës, bazuar kriterëve të vlerësimit të çmimit më të ulët.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit “B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lende kontrasti per CT, Lende kontrasti per MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike”, ndarë në 128 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” u konstatua se për:

- **Lot32 “Trastuzumab Biosimilar ose origjinator”**

Autorizimi i prodhuesit nga Viatrix për “RF” shpk, lëshuar me datën 06.05.2022, nuk është paraqitur si MAH/ Prodhuesi, si dhe nuk është e cituar nëse është kompani prodhuese apo distributor, si dhe nuk është i autorizuar nga AKBPM.

Autorizimi nga F. H-L R Ltd, për “RF” shpk ka afat të shprehur; “This Authorization is valid for the period 2022-2023”, në kundërshtim me DST që është kërkuar 2022-2024.

Sa më sipër BOE nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në DT, dhe në njoftimin e fituesit nuk është cituar se produktet nga MAH/ F. H-LR Ltd, autorizimi i dorëzuar nga OE nuk plotëson kushtet e përcaktuar në DT.

- **Lot27 “Rituximab Biosimilar ose origjinator”**

BOE “EF” shpk dhe “DP-A” shpk është i identifikuar si i suksesshëm për këtë procedurë.

Autorizimi i “P” për “E-F” shpk lëshuar me datën 19.05.2022 nuk ka të përcaktuar afatin e vlefshmërisë, që sipas përcaktimeve të DST është 2022-2024.

“E-F” shpk ka prokurë nga C.H. Hungari, e cila nuk është regjistruar në AKBPM për këtë bar.

DP-A shpk ka dorëzuar Autorizimin nga S. Gmbh, Austri, ku në AKBPM është regjistruar 100 mg/ 10ml dhe 500 mg, e cila nuk është në përputhje me DT, 10 mg/ml-10 ml.

- **Lot18 “Goserelin acetate”**

Autorizimi për barin “Goserelin acetate” është në process miratimi nga AKBPM për atë që prodhohet në Britaninë e Madhe.

Në momenti e hapjes së ofertave bari “Goserelin acetate” i ofertuar nga “R.F” shpk është marrë autorizimi nga “A.AB, a company incorporated in S distributor”. Në ofertë dhe në deklaratën e origjinës është vënë nga Britania e Madhe, e cila është e autorizuar si bar dhe nga AKBPM dhe jo nga distributori i autorizuar. Autorizimi i AKBPM dorëzuar nga OE është jashtë afatit pasi mban datën 10.03.2017 dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE është data 17.05.2022. Sa më sipër jemi në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DST.

- **Lot60 “Eptacog Alfa (Activated)” (1mg/ml after reconstitution)**

Në ofertën e paraqitur nga BOE është cituar se MAH/ Prodhuesi: NNA/S / V.P.F

Autorizimi i prodhuesit nga N.N A/S për “R.F” shpk lëshuar me datën 18.05.2022.

Autorizimi nga prodhuesi V.P.F nuk është i bashkëngjitur dokumentacionit në SPE sic është paraqitur në ofertën ekonomike. Në njoftimin e fituesit nuk është përcaktuar se OE fitues duhet të lidhë kontratën vetëm për Autorizimi i prodhuesit nga Nova Nordisk A/S.

- **Lot25 “Paclitaxel”**

Autorizimin e ka marrë nga F.K, A GMBH, ndërsa ai i ofertuar në ofertë është nga India dhe Gjermania.

Në ofertë është ofertuar dhe nga W Hungari; P Ltd, M H.W GMBH Gjermani, për të cilën “Rf” nuk ka paraqitur asnjë autorizim. Në njoftimin e fituesit nuk është përcaktuar se OE fitues duhet të lidhë kontratën vetëm për Autorizimin e prodhuesit të dorëzuar.

- **Lot109 “Atorvastatine”**

A - F shpk i shpallur fitues nuk ka autorizim nga P për shitjen e këtij produkti, duke mos plotësuar kriteret e DT.

- **Lot28 “Rituximab Origjinator”**

Autorizimi i prodhuesit nga R.P lëshuar me datën 29.04.2022 dhe formë doza e autorizuar është **Rituximab vial 100mg/10ml dhe Rituximab vial 500mg/50ml.**

AKBPM ka lëshuar autorizimin për “R.O” është për 10mg/1ml me mbajtës autorizuese RP, Zvicër, ndërsa në DST është kërkuar 10mg/50ml. Autorizimi i lëshuar nuk përmbush kushtet e DST.

- **Lot29 “Rituximab Origjinator”**

Autorizimi i prodhuesit nga Roche Pharma lëshuar me datën 29.04.2022 dhe formë doza e autorizuar është **Rituximab vial 100mg/10ml dhe Rituximab vial 500mg/50ml.**

AKBPM ka lëshuar autorizimin për “Rituximab Origjinator:: është për 10mg/1ml me mbajtës autorizuese RP, Zvicër, ndërsa në DST është kërkuar 10mg/10ml. Autorizimi i lëshuar nuk përmbush kushtet e DST.

- **Lot52 “Alteplase”**

Subjekti ka sjellë një deklaratë që bari është i regjistruar në Agjencinë Rregullatore për barnat dhe pajisjet në Londër. Autorizimi nga prodhuesi nuk ka asnjë specifikim që prodhon këtë bar me këtë specifikime të përcaktuara në DST. KVO ka kualifikuar OE, por në dokumentacionin e dorëzuar si dhe në procesverbalin e mbajtur nga KVO nuk është cituar se si është verifikuar që bari që do silllet është brenda specifikime të përcaktuara të DT.

Për sa më sipër nga auditimi i loteve të procedurës B2 konstatohet se KVO për konstatimet e evidentuara nga grupi i auditimit për këto lotet e sipërcituara ka bërë skualifikimin e OE në rastin kur *”autorizimi nuk ka qënë për periudhën e përcaktuar ne DST”* ose *“...në njoftimin e fituesit e ka shpallur fitues OE vetëm për produktet që autorizimet kanë qënë në përputhje me DT”*.

Veprime në kundërshtim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 2 pika d *“të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”* dhe neni 3 pika 1 e ku citon se *”Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”* dhe VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë vlerësimit të ofertave të procedurave prokuruese, të marrë masa, që të pranohen oferta, kur përputhen plotësisht specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në neni 82 si devijime të vogla, të cilat të specifikohen në raportet përmbledhëse të procedurave prokuruese, duke mbajtur në konsiderate parimet e ekonomicitetit dhe eficiensës, bazuar kriterëve të vlerësimit të çmimit më të ulët.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit “B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lende kontrasti për CT, Lende kontrasti për MRI, Lende Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike”, ndarë në 128 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” për Lot14 “Filgastrim”; Lot109 “Atorvastatine” dhe Lot104 “Iodine x 300mg/ml” u konstatua, se në dosje (por dhe në SPE) nuk janë administruar kërkesat e KVO-së për ofertën anomalisht të ulët/korrigjimin e gabimeve aritmetike siç parashikohet në nenin 80 të VKM-së nr. 285 datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, “Hapja e ofertave”, pika 4, që nënvizon se “Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave”, neni 82 pika 4 “Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së”, si dhe neni 2, pika 1 e 2 germa d e j.

Në rastin e Lot18 “Goserelin acetate” dhe Lot25 “Paclitaxel”, në dosje dhe në SPE nuk gjendet asnjë dokument kërkesë për sqarim dhe sqarimi nga OE i argumentuar pse vlera është kaq e ulët. Edhe pas kërkesës nga grupi i auditimit drejtuar KVO, u vu në dispozicion sqarimi nga OE, në të cilën nuk jepet argumentimi në lidhje me ofertën anomalisht më të ulët por, sqarohet vetëm se ky “...OE siguron dhe garanton furnizimin e mallit 100% sipas specifikimeve teknike”, veprim në kundërshtim me neni 82 pika 4, ku citon se “... Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat e nevojshme për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas kuadrit ligjor dhe rregullator të prokurimeve.

Procesverbalet dhe raportet përmbledhëse të hartuara nga KVO duhet të jenë të argumentuara me:

- Arsytet e s’kualifikimit të OE:

- Në rastin e ndryshimeve që kanë formë dozat e barit të ofertuar nga OE me atë të kërkuar në DT dhe të regjistruara në AKBPM, të jenë argumentuar nga KVO këto ndryshime dhe të bashkëshoqëruara me dokumentacionin përkatës, ku vërtetohet ekuivalenca e dozave të barit të prokuruar me atë të ofertuar.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave me nr. 4073/9, datë 19.11.2021 “F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore” lidhur mes AK/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe OE “F” shpk, u konstatua se:

Spitali Rajonal Shkodër ka marrë në dorëzim pajisjen “DEXA Model primus SN: M2100121 Prodhues OC, Kore” me procesverbalin e datës 22.12.2022, nga komisioni i marrjes në dorëzim të ngritur me urdhër të titullarit të Spitalit Rajonal Shkodër me nr. 210, datë 21.12.2022. pajisja është bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 22.12.2021 në vlerën 3,840,000 lekë.

Spitali Rajonal Vlorë ka marrë në dorëzim pajisjen “DEXA Model primus SN: M2100121 Prodhues O.C, Kore” me procesverbalin e datës 22.12.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim të ngritur me urdhër të titullarit të Spitalit Rajonal Vlorë me nr. 4916, datë 02.12.2022. pajisja është

bërë hyrje me fletë hyrjen nr.3 datë 22.12.2021 në vlerën 3,840,000 lekë. Nga Spitali Rajonal Vlorë është bërë transferimi i pajisjes DEXA në Poliklinikën e Vlorës (Ortopedia) me Fletë daljen nr. 84, datë 22.12.2021.

Nga verifikimi në vend i pajisjes rezultoi se:

Në referencat që kishte pajisja e montuar citohej se

- X-Ray Generation prodhues ishte "PC., Ltd." i cili është jo në përputhje me dokumentacionet e dorëzuara nga OE në ofertë në të cilën ka marrë autorizimin e prodhuesit të pajisjeve nga "OC., Ltd" dhe katalogu i paraqitur është për P po nga i njëjti prodhues.

- Ray Tube "Maximume tube current" ishte 30mA, ndërsa nga OE në katalogun e dorëzuar në ofertë ky kriter "Maximume tube current" ishte 25mA.

- Printeri i marrë nga OE "HP DeskJet 2320 All-in-One Printer (7WN42B)" ishte në kapacitete të vogla printimi "Duty cycle (monthly, A4): Up to 1000 pages", si dhe "Print speed: Print speed up to 7.5 ppm (black) and 5.5 ppm (colour) 2" dhe "Scan resolution, optical: Up to 1200 dpi" ishte shumë i vogël për të patur një ndërlidhje optimale me DEXA-an.

- Nga auditimi u konstatua se, nga Spitali Rajonal Shkodër nuk kishte të dokumentuar me procesverbal trajnimin e stafit nga OE për përdorimin e aparaturës së marrë në dorëzim, sipas përcaktimeve të DT, në pikën 2 "**Kriteret e veçanta të kualifikimit**" pika 11 "Vetëdeklarate" ku kërkohet që OE "Merr përsipër trajnimin e dy personave (mjekë dhe teknikë) për çdo pajisje".

- Pajisja për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore ishte e instaluar në "Poliklinikën e Shkodrës". Transferimi kapital i pajisjes nga Spitali Shkodër në Poliklinikën e Shkodrës nuk kishte dokumentacion transferimi, veprim në kundërshtim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" pika "*Transportimi i aktiveve*". (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa në vijimësi, që përpara se të japë aprovimin për likuidimin e kontratave të mallrave/shërbimeve/punëve të cilat merren në dorëzim nga njësitë e vartësisë, të kërkohet që nga grupi i mbikëqyrjes ngritur me urdhrin e NA të MSHMS, të dokumentohet verifikimi fizik se mallrat/shërbimet/punët e marra nga njësitë e vartësisë janë në përputhje me kontratat e nënshkruara dhe me specifikimet e përcaktuara në DT.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës "*Mirëmbajtja e përqendruar e pajisjeve të mëdha mjekësore*", lidhur marrëveshje kuadër me nr. 1546/10, datë 18.06.2021, midis AQP/MSHMS dhe BOE "H&L" Shpk. dhe "SM" Shpk, me përfaqësues "H&L" Sh.p.k: me vlerën 216,842,640 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSH, rezultoi se:

- Nga verifikimi i kontratës së lidhura nga Spitali Rajonal Shkodër dhe BOE "H&L" Shpk dhe "SM" Shpk, me nr. 1537, datë 05.07.2021 për vlerën 10,200,960 Lekë pa TVSH për 24 muaj 2021-2023 për pajisjen "Skaner", rezultoi se: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve dhe procesverbaleve të mbajtura nga komisioni i marrjes në dorëzim pajisja ka qenë jashtë funksionit nga data 14.02.2023 deri me datën 09.03.2023, pra më shumë se 10 ditë pune.

- Nga verifikimi i kontratave të lidhura nga Spitali Lezhë dhe BOE "H&L" Shpk dhe "S.M" Shpk, me nr. 470/1prot., datë 02.07.2021 për fondin 10,200,960 Lekë pa TVSH për 24 muaj (2021-2023) për pajisjet "Skaner" u konstatua se, me procesverbalin e mbajtur me datë 25.09.2022, komisioni ka cituar që skaneri është jashtë funksionit, për shkak të mosfunksionimit së një lllampe, i cili është vënë në funksion dhe riparuar nga OE me datën 26.10.2022.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit në "specifikimet teknike" shtojca 9 citohej se..."**Kontraktuari duhet të sigurojë që pajisjet të mos qëndrojnë të difektuara për më shumë se 10 ditë zyrtare pune në vit**".

Sa më sipër veprimet janë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në DT dhe kontratës së lidhur

neni 6 “Specifikimet teknike”.

-Nga verifikimi i kontratës së lidhura nga Spitali Rajonal Shkodër dhe BOE “H&L” Shpk dhe “SM” Shpk me nr. 1538, datë 05.07.2021 për fondin 1,689,870 lekë pa TVSH me afat lëvrimi të nga data 05.07.2021-31.12.2021 dhe kontratës me nr. 580, datë 15.03.2022, për vlerën 2,731,956.5 Lekë pa TVSH me afat lëvrimi nga data 15.03.2022-31.12.2022, për pajisjet Angiograf/Hemodinamika, rezultoi se:

- Për muajt 01.01.2022-15.03.2022 dhe 01.01.2023-01.03.2023 AK nuk ka pasur kontratë të lidhur me OE për mirëmbajtjen e pajisjeve., veprime në kundërshtim me Marrëveshjen kuadër me nr. 1546/10, datë 18.06.2021 e cila ka të bëjë me mirëmbajtjen 24 muaj të pajisjes pa shkëputje. Nga Spitali Rajonal Shkodër nuk ka shpenzime të tjera të paguara për këtë shërbim dhe asnjë procesverbal apo dokumentacion që të vërtetoje nëse pajisja ka funksionuar për këtë periudhë dhe nëse janë realizuar shërbimet e mirëmbajtjes nga OE sipas kushteve të marrëveshjes kuadër.

Nga auditimi në terren të zbatimit të kontratës Lot2: Pajisje mjekësore të prodhuesit Siemens “Mirëmbajtja e përqendruar “full risk” e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Siemens” me fond limit 178,438,321 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzetë e një) lekë pa TVSH. lidhur marrëveshje kuadër me nr. 1546/7, datë 15.06.2021, midis OQB/MSHMS dhe OE “M” shpk rezultoi se:

Nga verifikimi i kontratës së lidhura nga Spitali Shkodër dhe OE “M” shpk, me nr. 1539, datë 05.07.2021 për vlerën 10,152,000 Lekë pa TVSH me afat lëvrimi të nga data 05.07.2021-04.07.2023, për periudhën 26.11.2022-02.02.2023, për pajisjen Magnetom Essenza/ Siemens, nuk është mbajtur asnjë akt kolaudim. Nga Spitali Rajonal Shkodër nuk ka shpenzime të tjera të paguara për këtë shërbim dhe asnjë procesverbal apo dokumentacion që të vërtetoje nëse pajisja ka funksionuar për këtë periudhë dhe nëse janë realizuar shërbimet e mirëmbajtjes nga OE sipas kushteve të kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masat në vijimësi që për marrëveshjet kuadër të lidhura për Spitalet Rajonale në përfundim të afatit të marrëveshjes të kërkojë nga njësitë raportet e monitorimit të zbatimit dhe të mbarëvajtjes së këtyre kontratave, me qëllim që minikontratat e lidhura nga këto njësi të mbulojnë të gjithë afatin kohor të parashikuara në këtë kontratë. Për mangësitë e konstatuara nga zbatimi i tyre si rrjedhojë e mosmarrjes së masave konkrete nga Spitalet Rajonale dhe nga OE, MSHMS të ngarkojë me përgjegjësi personat, të cilët nuk kanë zbatuar kushtet e marrëveshjes dhe specifikimeve të përcaktuara në DT.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të Marrëveshjen Kuadër me nr. 1533/152 prot., datë 19.07.2022 të lidhur mes OQB/MSHMS dhe OE “T” për Lot52 “Alteplase” dhe minikontratës së furnizimit nr. 1911, datë 12.09.2022 midis Spitalit Rajonal Shkodër dhe OE “T” Shpk për barin “Alteplase” u konstatua se:

Sasia që subjekti duhet të furnizonte sipas DST për 4-mujorin e parë është në vlerën 80 flakon (200*40%). Me fletë hyrjen nr. 1381, datë 13.09.2022 është bërë hyrje në magazinë sasia prej 4 flakon, vlera 236,000 lekë. Sasia që subjekti duhet të furnizonte sipas DST për 4-mujorin e parë dhe minikontratën është në vlerën 80 flakon (200*40%) bazuar dhe në marrëveshjen kuadër me nr. 1533/152 prot., datë 19.07.2022.. Spitali Rajonal Shkodër për mosfurnizimin në kohë të sasisë sipas minikontratës së lidhur nuk ka mbajtur asnjë penalitet ose garanci e kontratës me arsyetimin se: MSHMS me shkresën nr. 1533/186, datë 25.11.2022 ka njoftuar Spitalet Rajonale për prishjen e marrëveshjes kuadër me nr. 1533/152 prot., datë 19.07.2022 bazuar në nenin 62 pika 7 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Veprime në kundërshtim me nenin 36 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit*

Përfundimtar të Auditimit).

26.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të kërkoj nga Spitalet Rajonale, që për minikontratat e lidhura deri në prishjes e marrëveshjes kuadër me datën 25.11.2022 dhe e parealizuar për furnizimet, sipas minikontratës nga OE “T” shpk, që të mbahet sigurimi i kontratës.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve” u konstatua se:

- Me urdhrin nr. 637, datë 17.11.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS është ngritur grupi i punës për miratimin e specifikimeve, termat e referencës, sasitë, si dhe fondit limit të nevojshëm për zhvillimin e procedurës “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-v” dhe “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-v për një periudhë 12 mujore”.

Nga Njësia e Prokurimit e ngritur me urdhrin nr 646/1, datë 24.11.2020, në datën 24.11.2020 është mbajtur procesverbali, në të cilën janë përcaktuar dhe argumentuar kriteret e veçanta të kualifikimit dhe vendosja e specifikimeve teknike, të cilat janë të njëjta me ato të përcaktuara në DT të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me REF-79766-11-24-2020. Sa më sipër për procedurën mbi kufirin e lartë monetare nuk është bërë asnjë studim i mëtejshme i çmimeve të tregut dhe nuk janë riparë specifikimet teknike të vendosura, të cilat duhet të ishin sa më të argumentuara dhe mundësisht të plotësueshme nga OE që duan të marrin pjesë.

Ne specifikimet teknike është përcaktuar:

- Në pikën 2.3.9: Certifikata e regjistrimit të testit antigen pranë AKBPM sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.

- Në pikën 2.3.10: Operatori duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Tenderi është ndërkombëtar pasi edhe DT janë publikuar në anglisht dhe njoftimi i kontratës është botuar në një gazetë ndërkombëtare.

Nëse një OE i huaj që duhet të merrte pjesë në tender, duhet të plotësonte këto dy kushte të vëna nga AK, por:

- Për tu certifikuar pranë AKBPM ka një afat minimumi 30 ditë, sipas përcaktimeve të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” neni 13 “Procesi i regjistrimit” pika 2.

- Operatori ekonomik për të marrë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore” të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” neni 21, ka afat ligjor, e cila nuk realizohet brenda një afati kaq të shkurtër kohor.

Kjo ka ardhur si rrjedhojë e urdhrin nr. 637, datë 17.11.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, ku në pikën nr. 2 citon se “...grupit të punës i caktohet miratimi i specifikimeve, termat e referencës, sasitë, si dhe fondit limit të nevojshëm për dy procedura të përcaktuara në pikën 1/germën a dhe b. Grupi i lihet një afat tre ditor për përgatitjen e relacionit në lidhje me këto dy procedura”.

• Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE fitues rezultoi se:

Dokumentacioni i dorëzuar për të plotësuar kriterin 2.3.3 “Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për artikullin e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull...”.

Kataloguteknik për artikullin e ofertuar për produktin SD B..... nuk ka të numrin e “CAT number 99COV30D, i cili është numri i “Product code(s)”, të aprovuara dhe të renditura në listën e OBSH, i aksesueshëm në linkun: [201125_EUL_SARS-CoV-2_product_list.pdf \(Who.int\)](https://www.who.int/publications/m/item/201125_EUL_SARS-CoV-2_product_list.pdf)”.

Në pikën 2.3.7 kërkohet “Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejjimin e tregtimit të artikujve të tij”.

OE ka dorëzuar autorizim nga "RD GmbH", të lëshuar në 12.12.2019 si distributor për produktet e prodhuara nga RD, por nuk ka paraqitur autorizim nga distributori "RD GmbH", ku SD.B me autorizimin e datës 06.11.2020 autorizon "R.D GmbH" të shpërndajë, shesë dhe të ofrojë suport për produktet e autorizuara, i cili është i vlefshëm deri me datë 31.12.2022.

- OE E. shpk është distributor për produktet e prodhuara nga SD.B për produktet Sars Cov -2 antigen Rapid Test lëshuar me datën 25.11.2020, në autorizim nuk është përcaktuar afati nëse është brenda realizimit të kontratës.

- OE fitues ka një autorizim për tender nga "P" shpk me datën 12.01.2021, ku jep garancinë për furnizimi dhe dorëzim të produkteve "A.R.D.J GmbH" (411FK10 Panbio Covid-19 rapid test device), në të cilën nuk është përcaktuar afati i vlefshmërisë së këtij autorizimi, duke qenë se jemi në kushtet e një marrëveshje kuadër 12-mujore.

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim, rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT, konkretisht me Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit "Udhëzime për operatorët ekonomikë" ku përcaktohet se: "Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme", si dhe me VKM-në me nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 66, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Titullari i AK/MSHMS të marrë masa në vijimësi që për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale,

- procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe
- procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik nga komisionet e vlerësimit të ofertave, me qëllim rritjen e eficiencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara në plotësimin e nevojave të AK.

Në vijimësi

28. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i 3 (tre) procedurave të prokurimit në kategorinë/zërin "Punë publike", në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u konstatua se nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave si më poshtë:

a. Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruktion i godinës së Qendrës Kombëtare Transfuzionit të Gjakut Tiranë", janë s'kualifikuar operatorët ekonomik "P.G" shpk, "N.M.P" sha, "S" 2F shpk, me arsyen e gabimit në sasinë e ofertës, referuar edhe vendimit të KPP 550/2020. KVO nuk ka mbajtur në konsideratë legjislationin e Prokurimit Publik, nenin 92 të ligjit 162/2020 "Shqyrtimi i ofertave", pika 2. "Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet". Komisioni i Vlerësimit të ofertave, ka s'kualifikuar në mënyrë të padrejtë OE "E.K" shpk, pasi oferta e tij rezultoi pa gabime. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues "A.C" shpk, u konstatuan disa pasaktësi në katalogët e pajisjeve duke mos përmbushur specifikimet teknike të kërkuara në DST. Gjithashtu operatori i shpallur fitues, nuk plotëson pikën 2.3.11.a të DST, ku ishte përcaktuar se operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet. Nga dokumentacioni i hedhur në sistem, ky operator ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania "G.R.A" shpk për zërat 8, 9, 10. Nga auditimi i kompanisë "G.R.A" shpk u konstatua se "Objekti i veprimtarisë së kësaj kompanie është "Tregtim, prodhim dhe instalim i pjesëve të aparateve për ventilim, filtrimin

e kondicionimin e ajrit, import eksport, artikuj të ndryshëm, elektroshtëpiake, konfeksione, materiale inerte për ndërtim”. Pra u konstatua se kjo kompani nuk prodhon pajisjen ose njësinë e ventilimit të ajrit, por vetëm pjesë këmbimi të tyre. Kjo kompani nuk është prodhuese por assembluese e njësive të kondicionimit dhe ventilimit. Referuar edhe faqes zyrtare në internet <https://gandr.al/>, konstatohen produktet e kompanisë, ku operatori ekonomik ka paraqitur autorizimin e prodhuesit, çka do të thotë se ky operator nuk e plotëson kriterin e përcaktuar në DST.

b. Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023) e ndarë në 2 Lote*”, janë s’kualifikuar operatorë ekonomik me arsyen e gabimit në sasinë e ofertës dhe njësive matëse, referuar edhe vendimit të KPP 550/2020. Nga KVO nuk është mbajtur në konsideratë legjislacioni e Prokurimit Publik, nenin 92 të ligjit 162/2020 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 2. “*Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1 Rekomandimi: MSHMS, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente.

Në vijimësi

28.2 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s’kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit të MSHMS është konstatuar mangësi në noterizimin e diplomave dhe mungesa e vërtetimit mjekësor në shkelje të përcaktimeve të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “*Për rregullat e hollësishtme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

29.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorja e Burimeve Njerëzore, të marrë masa në vazhdimësi për plotësimin e dosjet së personelit me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i MSHMS u konstatua se nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale veprime në kundërshtim me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar, neni 12 germa b Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike “*Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për: b) krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kriterëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 140-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1 Rekomandimi: MSHMS të marrë masa për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, sipas përcaktimeve ligjore në VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”, i cili ofron këshilla e rekomandime objektive Titullarit të njësisë publike në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim arritjen e objektivave si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësi të saj.

Menjëherë

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, geramat b) dhe c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,032,139 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës “Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan”, u konstatuan disa pasaktësi për punime të pakryera por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve. Në QSH Pajovë, kapitulli e punimeve e dyer dritareve zëri nr. 6, nr. Anal. 2.413 “F.V zgara dekorative hekuri me figuracion mesatare”, me vlerën 5,158 lekë nuk ishte vendosur në objekt. Në QSH Gjergjan, kapitulli e punimeve çatie zëri nr. 5, nr. Anal. 2.206 “kasetë shkarkimi me llamarinë xingat”, me vlerën 4,260 lekë nuk ishin vendosur në objekt. Në disa QSH-re Gjergjan, kapitulli e punimeve suvatimi dhe lyerje nr. 4, nr. Anal. 2.35 “suva xokoli me granil e çimento”, u konstatua se xokoli nuk kishte lartësi më të madhe se 30 cm, ndërkohë në librezën e masave është llogaritur me lartësi 65 cm, rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej 15 m² me çmimin 434 lekë rezulton vlera prej 6,510 lekë. Në disa QSH-re dhe AMB-ca, nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet *Grafiato për suva*. Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 6, nr. anal 2.308/a “Suvatim me grafiato” me çmimin sipas VKM-së prej 1,057 lek/m² (në përlllogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga BOE “B” shpk & “B.N” shpk me 719 lekë/m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato, bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Gjithashtu referuar përlllogaritjeve në librezën e masave “Suvatimi me grafiato”, ndodhet në të njejtat sipërfaqe të veshjes me sistem kapotë. Rrjedhimisht, zëri i “Suvatim me grafiato”, përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasi më tepër. Nga kontraktori BOE “B” shpk & “B.N”, është përfituar padrejtësisht punime të mbivendosura dhe të pa realizuara, në vlerën 570,323 lekë pa TVSH ose **684,387 lekë** me TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 134-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: MSHMS, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin

e vlerës prej **684,387 lekë** nga kontraktori BOE "B" shpk dhe "B.N" shpk, për punime të mbivendosura dhe të likuiduara, por të pa realizuara.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës "*Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier*", u konstatuan disa pasaktësi për punime të mbivendosura zërave të punimeve. Në disa QSH-re, nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.358/b, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet *Grafiato për suva*. Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të suvatimit, veshje bojatisje, zëri nr. 6, nr. anal 2.308/a "*Suvatim me grafiato*" me çmimin sipas VKM-së prej 1,057 lek/m² (në përlllogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga BOE "B" shpk & "B.N" shpk me 600 lekë/ m², është zë pune i mbivendosur proceseve të Veshjes së fasadës, pasi përfshihet edhe suvatimi me grafiato, bazuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*". Gjithashtu referuar përlllogaritjeve në librezën e masave "*Suvatimi me grafiato*", ndodhet në të njëjtat sipërfaqe të veshjes me sistem kapotë. Rrjedhimisht, zëri i "*Suvatim me grafiato*", përbën mbivendosje të punimeve të veshjes së fasadës, për shkak të pasaktësisë së preventivit, në të cilën sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sasi më tepër. Nga kontraktori OE "C" sh.p.k, është përfituar padrejtësisht punime të mbivendosura, në vlerën 289,794 lekë pa TVSH ose **347,752 lekë** me TVSH. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7 dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 134-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: MSHMS, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **347,752 lekë** nga kontraktori OE "C" shpk, për punime të mbivendosura dhe të likuiduara.

Menjëherë

B.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë është konstatuar se, për vitin 2021 është paguar shuma prej 16,324 mijë lekë dhe për vitin 2022 shuma prej 22,611 mijë lekë, për ekzekutimin dhe pagesën e 13 vendimeve gjyqësore me detyrimin për "*Pagesë page deri në kthim në punë*" për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa.

Komisioni i Posaçëm ka shqyrtuar vetëm një rast dhe nuk është mbledhur për vlerësimin dhe kthimin në punë të 13 punonjësve të tjerë. Mosveprimi i këtij komisioni në MSHMS për kthimin e punonjësve në punë dhe shqyrtimin e vendimeve rëndon edhe më shumë buxhetin e shtetit me shpenzime për vendime gjyqësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Urdhrin nr. 5151 datë 28.10.2015 "*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil*". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 140-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në vijimësi

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, pika 1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i rekomandojmë Titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, sipas kontratave respektive, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave përkatëse dhe sanksioneve administrative:

1. Subjekti BOE "N.S" sh.p.k, përfaqësuar nga administrator z. E.N , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me objekt: “Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan”, datë 08.06.2020, për mbivendosje të volume të punime të deklaruara përfituar padrejtësisht nga kontraktori, në vlerën 684,387 lekë me TVSH.

2. Subjekti "T" sh.p.k, përfaqësuar nga administrator Znj. D.Q., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me objekt: “Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier”, datë 02.11.2020, për mbivendosje të volume të punime të deklaruara përfituar padrejtësisht nga kontraktori, në vlerën 347,752 lekë me TVSH. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 34-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

V. ANEKSE

Aneksi nr. 1: “Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit” nga faqja 17 deri 29 të Raportit.

Aneksi nr. 1/1: “Ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2021 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm”.

Në lekë

Nr	Program	Kodi i Projektit	Përshkrimi	Vlera
1	01110	18BA302	Blerje programi financiar "Financa 5"	894,000
2	07220	20AB606	F.V pajisje për matjen e densitometrisë kockore për strukturat shëndetësore	15,360,000
3	07220	M130334	TVSH, Detyrime Doganore (Paresori)	13,391,874
4	07220	M131944	TVSH& Det . Dog. Për ndërtimin e QSH & amb. (Gjysme hëna e kuqe)	2,464,155
5	07220	M132168	TVSH	1,174,847
6	07220	M133831	TVSH & detyrim doganor per projektin e Cooperacionit Zviceran- Grant	20,458,372
7	07220	20AB604	Blerje pajisje mobilimi dhe elektronike për Njvksh Gramsh	946,992
8	07220	20AB605	Blerje pajisje mjekësore për Njvksh Gramsh	535,200
9	07220	20AB608	F. V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore	19,669,188
10	07330	18BB141	F.V Mamograf	25,079,999
11	07330	19AD303	Pajisje mjekësore për spitalet	19,854,000
12	07330	18BB073	TVSH per pajisje ne kuadër te luftës kundër COVID	62,877,011
13	07330	18BB070	Pagesë e taksës se infrastrukturës për ndërtimin e Poliklinikës se sp.Peshkopi	1,683,527
14	07330	18BB059	F.V pajisje hotelerie dhe mjekësore për pediatriinë e sp.Elbasan	24,224,925
15	07330	18BB144	F.v pajisje mjekësore për okulistikën e spitalit rajonal Korçë	9,578,400
16	07330	18BB074	Rikonstruksione në spitalin rajonal Kukës- shtesë kontrate	28,143,437
17	07330	18BB075	Supervizion+kolaudim për rikonstruksione në spitalin rajonal Kukës -shtesë kontrate	356,000
18	07330	18BB143	F.V aparat C-Arm për sallën operatore dhe tavoline operatore ortopedike për sp.rajonal Lezhe	9,960,000
19	07330	18BB142	F.v pajisje mjekësore për okulistikën e spitalit rajonal Vlorë	9,582,000
20	07330	18BB079	Rikonstruksion i godinës se Arkivës së Kartelave Mjekësore në QSU Nënë Tereza Tiranë	6,499,956
21	07330	18BB080	Supervizion dhe kolaudim për rikonstruksion i godinës së Arkivës së Kartelave Mjekësore në QSU Nënë Tereza Tirane	60,000
22	07330	18BB140	F.V pajisje mobilimi dhe sinjalistika për godinën e re te pediatriisë ndërtuar me kredi te Bankës Botërore	26,920,848
23	07330	18BB078	Pagese TVSH për projektin granti japonez	2,300,000
24	07330	18BB047	Pagese leje ndërtimi për Maternitetin Mbretëresha Geraldine	6,343,104
25	07330	18BB138	F.V aparat grafie dixhitale me panel detektues dhe me printer lazer për printimin e imazheve radiologjike ne SU	3,860,000
26	07330	18BB145	F.V unite dentare për KSU Tirane	9,600,000
27	07330	18BB146	F.V pajisje stomatologjike për KSU Tirane	2,772,000
28	07330	18BB119	Pajisje për QKMZHRF Tirane	15,351,474
29	07330	20AE202	F.V kabina e rojes për sp. psikiatrik Vlore	117,600
30	07330	20AE203	F.V pajisje kompjuterike për sp.psikiatrik Vlore	887,880
31	07330	18BB139	Blerje pajisje mjekësore për sp.Gramsh	528,000
32	07330	20AE201	Blerje pajisje mobilimi dhe elektronike për sp.Gramsh	748,800
33	07330	18BB072	Pagese leje ndërtimi për lejen e ndërtimit te maternitetit Koco Gliozheni	1,389,516
34	07330	18BB210	Kosto lokale për shërbimin e supervizimit për ndërtimin e spitalit te sëmundjeve te brendshme ne QSUT	3,026,079
35	07330	18BB211	Pagese TVSH-je për shërbimin e supervizimit për ndërtimin e spitalit te sëmundjeve te brendshme ne QSUT	611,891
36	07450	M132168	TVSH	3,299,999
37	07460	18BB904	F.V pajisje mjekësore për shërbimin e urgjencës kombëtare	6,542,400
38	07460	20AB902	TVSH për pajisjet mjekësore te dhuruara nga Komisioni Europian referuar "Qendrës Ndërkombëtare për Teknologji dhe Shkence	922,564
39	10430	19AB007	Pagese TVSH-je për projektet e PNUD për programin e shërbimit social	33,093,461
40	10430	18BC203	Rikonstruksioni i zyrave te SHSSH rajonal Elbasan dhe Durrës	2,369,057
41	10430	18BC204	Supervizion i rikonstruksionit te zyrave te SHSSH rajonal Elbasan dhe Durrës	50,467
Totali				393,529,023

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Aneksi nr. 1/2: “Ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2022 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm”.

Në lekë

Nr	Program	Kodi i Projektit	Përshkrimi	Vlera në realizim
1	07220	18BA612	Projekt preventiva zbatimi per rikonstruksionin e qsh-ve dhe amb-ve per v.2023-2024	2,491,042
2	07220	M134028	F.V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendra shëndetësore	3,682,575

Nr	Program	Kodi i Projektit	Përshkrimi	Vlera në realizim
3	07220	M132168	TVSH	738,024
4	07220	M133959	Blerje pajisje	105,600
5	07220	20AB616	Blerje pajisje kompjuterike për njvksH Kukës	586,800
6	07220	20AB613	F.V pajisje për arkivin e njvksH Kruje	999,600
7	07220	20AB609	Blerje pajisje kompjuterike për njvksH Mat	588,514
8	07220	20AB611	Blerje pajisje kompjuterike për njvksH Permet	587,640
9	07220	20AB610	Blerje pajisje kompjuterike për njvksH Puke	591,480
10	07220	20AB612	Blerje pajisje kompjuterike për njvksH Malesi e Madhe	555,600
11	07220	20AB602	F.V. pajisje mobilimi për godinën e Drejtorisë Qendrore te OSHKSH-se	258,480
12	07220	20AB603	F.V. pajisje kompjuterike për godinën e Drejtorisë Qendrore te OSHKSH-se	493,200
13	07220	20AB608	F. V pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendrat shëndetësore	3,819,084
14	07220	20AB615	Blerje pajisje kompjuterike për DROSHKSH Tirane	662,800
15	07220	20AB614	Blerje pajisje kompjuterike për DROSHKSH Shkodër	663,360
16	07330	18BB311	Pagese e taksës se infrastruk për rikonstr e god se infekt ne QSUT- nderhyrje nga UNOPS	23,697,664
17	07330	19AD307	Rikonstruksion i pediatriisë infektive ne QSUT	17,020,605
18	07330	19AD308	Supervizion për rikonstruksionin e pediatriisë infektive ne QSUT	371,542
19	07330	20AB606	F.V pajisje për matjen e densitometrise kockore për strukturat shëndetësore	14,160,000
20	07330	18BB153	TVSH për Grantin Japonez	2,883,888
21	07330	22AC606	TVSH për 5 Poliklinikat (Gjirokastra+ Peshkopi)- kredi e qev italiane	1,569,169
22	07330	18BB150	Furnizimi vendosje pajisje biomjekesore per shërbimin e okulistikës sp.Elbasan	16,669,200
23	07330	18BB123	F.V pajisje teknologjike për fazën I sp.Kukës	2,301,432
24	07330	18BB124	Superv+kolaudim për f.v pajisje teknologjike për fazën I sp.Kukës	646,552
25	07330	18BB148	F.V pajisje mobilimi për farmacinë dhe dispancerine e sp.Vlorë	3,359,900
26	07330	22AC601	Rikonstruksioni i Farmacisë dhe Dispancerise sp.Vlore	39,066,614
27	07330	22AC602	Superv+kolaudim per Rikonstruksioni i Farmacisë dhe Dispancerisë sp.Vlorë	590,185
28	07330	18BB079	Rikonstruksion i godinës se Arkives se Kartelave Mjekesore ne QSU Nene Tereza Tirane	2,500,044
29	07330	18BB080	Super dhe kol për rik i godinës se Arkives se Kartelave Mjekesore ne QSUT	48,791
30	07330	18BB149	F.V p mjekësore, mobilimi spitalor dhe paj biomjekesore për pediatriinë e re QSU	25,000,000
31	07330	18BB154	F.V pajisje dhe orendi per disa nga shërbimet e QSUT	12,096,000
32	07330	22AC603	Lidhja e re e energjisë elek per god e re A2 te semund te brend ne QSUT-pagese ndaj OSSH	6,458,386
33	07330	22AC604	Takse infrastrukture për azhormin leje ndërtimi per projektin: Rikonstruksion godine dhe ndërtim i ri per SUOGJ 'Mbretëresha Geraldine'	4,477,617
34	07330	18BB147	Projekt -preventiva zbatimi per rikonstruksionin e pavionit te te sëmurëve kronik burra dhe pavionit te te sëmurëve kornik gra ne sp.Psikiatrik Vlore	2,574,990
35	07330	18BB155	F.V UPS per aparaturat e laboratorit ne sp.psikiatrik Vlore	119,500
36	07330	18BB152	Furnizim vendosje pajisje mjekësore për shërbimet mjekësore dhe okulistike	9,640,799
37	07330	18BB061	Rikonstruksion i sallave te lindjes, repartit te neonatologjise dhe repartit i urgjence-pranimit te Maternitetit Koco Gliozheni Tirane	26,938,255
38	07330	18BB062	Superv+kolaudim per rikonstruksionin e sallave te lindjes, repartit te neonatologjise dhe repartit te urgjence-pranimit ne Maternitetin Koco Gliozheni Tirane	623,281
39	07330	18BB212	Kosto Lokale për PIU-n (njësia e zbatimit te projekteve te huaja)	1,725,308
40	07330	18BB213	Pagese kosto lokale për shërbimin e supervizimit për ndërtimin e spitalit te sëmundjeve te brendshme ne QSUT	12,000,000
41	07330	18BB211	Pagese TVSH-je për shërbimin e supervizimit për ndërtimin e spitalit te sëmundjeve te brendshme ne QSUT	2,399,910
42	07450	18BB605	Blerje pajisje kompjuterike për ISHP	482,640
43	07450	18BB606	Blerje pajisje aspirimi për vivariumin e ISHP	36,000
44	07450	18BB705	Pagese tvsh dhe takse doganore për disa pajisje dhe automjete ne kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAEA dhe marrëveshjes me JICA qe do t'ji dhurohen Institutit të Shëndetit Publik	4,286,133
45	10430	18BC205	TVSH e asistencës teknike për projektin "Përfshirja sociale" IPA II	341,219
Totali				250,909,423

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MSHMS

Aneksi nr. 2: “Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” nga faqja 29 deri 39 të Raportit.

Aneksi nr. 2/1: “Urdhër shpenzimet e konstatuara në mosrespektim të afateve sa i takon likuidimit të faturave/ Viti 2021”.

Ofrimi i trajnimit për armatën e vaksinatorëve të rinj në kuadër të fushatës së vaksinimit në komunitet kundër COVID-19	Blerje pajisje kompjuterike për zyrën e projekteve PIU
Materiale pastrimi	Materiale pastrimi
Blerje goma për automjete	Materiale kancelarie me baze letre
Blerje materiale kancelarie 2021	Shërbim riparimi të pajisjeve elektronike printera dhe fotokopje
Blerje materiale pastrimi	Lavazh automjetesh
Blerje tonera	Pastrim fasade e godinës
Shërbim desinfektimi, deratizimi dhe desinsektimi bodrumi, ambientet e jashtme dhe të brendshme të godinës së MSHMS, pastrim pusetash dhe kanalizimesh si dhe shërbime desinfektimi e ambienteve të brendshme për Covid -19	Siguracion TPL dhe KASKO për automjetet
Siguracion për ndërtesën	Siguracion për ndërtesën
Blerje program financiar "Financa 5	Blerje bileta për transport ndërkombëtar
Blerje bileta për transport ndërkombëtar	

Aneksi nr. 3: “Auditimi i llogarive vjetore” nga faqja 39 deri 54 të Raportit.

Aneksi nr. 3/1: “Aktivet qarkulluese”.

Në lekë

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
2		I. Aktivët Afat shkurtër	129,283,216	781,905,935
3		1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	55,889,752	71,639,721
4	531	Mjete monetare në Arkë		
6	520	Disponibilitete në Thesar	55,889,752	71,639,721
8	532	Vlera të tjera (pulla)		
11		2. Gjendje Inventari qarkullues	12,009,070	13,481,704
12	31	Materiale	9,158,999	9,070,620
13	32	Objekte inventari	2,850,071	4,411,084
21		3. Llogari të Arkëtushme	57,932,876	663,290,088
22	411	Klientët e llogarit të ngjashme		
23	423-429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	2,656,636	2,677,636
24	431	Tatim e Taksa		
32	468	Debitorët të ndryshëm	26,256,378	26,256,378
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	29,019,862	634,356,074
36		4. Të tjera aktive afatshkurtra	3,451,518	33,494,422
37	409	Parapagime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	3,451,518	33,494,422

Burimi: MSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 3/2: “Aktivet afatgjata”.

Në lekë

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
42		II. Aktivët Afat gjatë	2,032,602,591	2,146,099,984
43	20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	7,013,457	19,193,940
45	202	Studime dhe kërkime	7,013,457	19,193,940
47	21	2. Aktive Afatgjata materiale	2,025,589,134	2,126,906,044
48	210	Toka, Troje, Terrene		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	129,442,819	136,255,599
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	9,870,336	12,337,920
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	5,553,054	6,941,317
53	215	Mjete Transporti		3,107,734
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	118,501,751	158,512,459
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara		
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjata	1,762,221,174	1,809,751,015
62		4. Investime	0	0

Burimi: MSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 3/3: "Pasivet Afatshkurtra".

Në lekë

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
67		1. Llogari te Pagueshme	88,578,937	750,560,386
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	3,131,072	3,185,651
69	42	Detyrime ndaj personelit	9,339,173	8,707,568
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,028,697	945,497
75	435	Sigurime Shoqërore	1,994,579	1,942,606
76	436	Sigurime Shëndetësorë	1,340,130	1,595,848
77	437	Organizma te tjerë shtetërore		
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	27,194,543	53,775,876
82	467	Kreditore te ndryshëm	15,637,729	65,147,3326
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	28,913,014	28,934,014
84	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		

Burimi: MSHMS, përpunuar nga grupi i auditimit

Aneksi nr. 3/4: "Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto".

Nr. Reshti	Reference	EMERTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Rezerva	Fonde te Tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Tepricoce/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Tepricoce/Deficit	GJITHESHEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6
1	101	IAKTIVET NETO/FONDET NETO	2,177,445,533					2,177,445,533
2		II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	-	-	-113,497,393	-	9,358,731	-104,138,662
3		1.NGA BURIME TE BRENDSHME	-	-	-278,291,532	-	9,358,731	-268,932,801
4	105	Nga grantet e brendshme kapitale(+)						0
5	1016, 1058	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre. (+,-)			-222,469,866			-222,469,866
6	1014, 116	Nga Shtetit e AAGJ(+)						0
7	12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)					1,472,634	1,472,634
8	85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)					7,886,097	7,886,097
9	111	Nga Rezervat (+,-)						0
10	115	Nga Fonde te veta te investimeve (+,-)						0
11	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)						0
13	1013	Nga konsumi i AAGJ(-)			-29,177,116			-29,177,116
14	1015	Nga nxjerrjet jashteperdorimit dhe demtimet(-)			-26,644,550			-26,644,550
15	107	Vlera te AAGJ te Caktuara ne perdorim(+,-)						0
16	109	Diferenca nga Rilveresimi i AAGJ(+,-)						0
17		2.NGA BURIME TE JASHTME			164,794,139			164,794,139
18	106	Nga grantet e jashtme kapitale(+)			112,564,278			112,564,278
19	1016, 1068	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre. (+,-)			52,229,861			52,229,861
20		TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	2,177,445,533	-	-113,497,393	-	9,358,731	2,073,306,871

Aneksi nr. 4: "Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm" nga faqja 148 deri 152 të Raportit.

Aneksi nr. 4/1: "Planin Vjetor 2021".

Nr.	Subjekte të planifikuara për auditim	Subjekte të paaudituar
1	Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondet IPAII	Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondet IPAII
2	Spitali Psikiatrik Vlorë në proces	
3	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Mirditë	
4	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Përmet	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Përmet
5	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Skrapar	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Skrapar
6	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (Qendror) Tiranë	
7	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Berat	
8	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Dibër	
9	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Durrës	
10	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Elbasan	
11	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Fier	
12	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Lezhë në process	
13	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Vlorë	
14	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë	
15	Spitali Rajonal Berat	Spitali Rajonal Berat
16	Spitali Rajonal Durrës	
17	Spitali Rajonal Kukës	
18	Spitali Rajonal Lushnje	
19	Shërbimi Spitalor Has	Shërbimi Spitalor Has
20	Shërbimi Spitalor Laç	
21	Shërbimi Spitalor Librazhd në process	
22	Shërbimi Spitalor Peqin në process	

23	Shërbimi Spitalor Skrapar	
24	Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë	Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë

Aneksi nr. 4/2: "Planin Vjetor 2022".

Planifikimi	Auditime të përealizuara
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondet IPA II	Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondet IPA II
Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim sot Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor Tiranë	
Qendra e Shërbimit Mjekësor Tiranë	
Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë	
Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët Tiranë	
Spitali Psikiatrik Elbasan	
Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut Tiranë	
Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë	Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë
Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë	
Instituti i Integritit të Përndjekurve Politik Tiranë	
Performancë e shpenzimeve për mallra e shërbime Shërbimi Spitalor Kavajë Shërbimi Spitalor Mallakastër Shërbimi Spitalor Mirditë Shërbimi Spitalor Përmet	
Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tiranë Spitali Rajonal	
Menaxhimi i pajisjeve mjekësore dhe shërbimi ndaj pacientit Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë Spitali Rajonal Shkodër Spitali Rajonal Korçë Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 1 Tiranë Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr. 2 Tiranë	

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT